



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo*

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL  
MINISTARSTVO LOKALNE SAMOUPRAVE  
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT

# SISTEMI PËR MENAXHIMIN E PERFORMANCËS SË KOMUNAVE

**MATJE PËR T'U PËRMIRËSUAR**  
Versioni i ndryshuar dhe plotësuar 2020



Prishtinë 2020

## Dokumenti u rishikuar prej ekipit:

Diellor Gashi, udhëheqës i departamentit për performancë dhe transparencë dhe komunale  
Haxhi Krasniqi, zyrtar në kuadër të divizionit për performancë komunale  
Lazar Mitic, zyrtar në kuadër të divizionit për performancë komunale  
Shqiponja Vokshi, përgjegjëse për projektin nga ana e DEMOS  
Berat Abdiu, ekspert i angazhuar nga MPL me përkrahjen e DEMOS  
Jetmir Bakija, ekspert i angazhuar nga MPL me përkrahjen e DEMOS  
Evetar Zeqiri, ekspert i angazhuar nga MPL me përkrahjen e DEMOS  
Clive Grace, ekspert ndërkombëtar

Versioni i plotësuar në vitin 2020

## SHKURTESAT

MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
DPTK	Departamenti për Performancë dhe Transparencë të Komunave
DPK	Divizioni për Performancë të Komunave
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
SMPSHK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale
ZAP	Zyra Kombëtare e Auditimit
SMPK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Komunave
USAID	United States Agency for International Development
DEMI	Iniciativa për Komuna demokratike dhe Efektive
DEMOS	Decentralisation and Municipal Support
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	United Nations Development Programme
SHKSH	Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkërendim Ekonomik dhe Zhvillim
KK	Komiteti Këshillues
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
QSHQK	Qendra për Shërbim të Qytetarëve në Komunë
CMS	Content Management System
MPMS	Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale
QPS	Qendra për punë sociale
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
ZHHK	Zhvillimi Hapësinor Komunal
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
HZK	Harta Zonale e Komunës
PRRH	Planet Rregulluese të Hollësishme
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PRRK	Plani Rregullues Komunal
UA	Udhëzimi administrativ
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
BB	Banka Botërore
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim Mjedisor
PVLM	Plani për Veprim Lokal Mjedisor
PM	Programi mjedisor
NjOK	Njësia organizative komunale
KKP	Koordinatori komunal i performancës

Përmbajtja

<b>HYRJE.....</b>	<b>7</b>
<b>KONTEKSTI I ZHVILLIMIT TË SMPK.....</b>	<b>9</b>
<b>KONCEPTE THEMELORE.....</b>	<b>11</b>
Matja e Performancës.....	11
Qëllimi i SMPK.....	11
Objektivat e SMPK.....	11
Parimet themelore të SMPK.....	12
Struktura e SMPK-së.....	12
Sistemi elektronik.....	14
Sistemi i performancës ndërlidhja me GPK.....	15
<b>Shtojca 1: Rregullorja Nr. 01 / 2020 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemës së grantit të performances komunale.....</b>	<b>18</b>
<b>Shtojca 2 – Rolet, detyrat dhe kompetencat e akterëve kryesorë.....</b>	<b>33</b>
<b>Shtojca 3: Metodologjia për verifikimin dhe sigurinë e të dhënave të performancës komunale....</b>	<b>36</b>
<b>Shtojca 4: Procedura e menaxhimit të ndryshimeve në SMPK.....</b>	<b>57</b>
Shtojca 5: Fushat, rezultatet dhe treguesit e SMPK-së.....	62
FUSHA 1 - SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE.....	62
Rezultati 1.1 - Ofrimi i shërbimeve administrative sipas kërkesave të qytetarëve.....	62
FUSHA 2 - TRANSPARENCA KOMUNALE.....	71
Rezultati 2.1 - Sigurimi i qasjes në të dhëna komunale.....	71
Rezultati 2.2 - Transparenca buxhetore.....	79
FUSHA 3 PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE.....	83
Rezultati 3.1 - Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në komunë.....	83
Rezultati 3.2 - Sigurimi i llogaridhënies dhe respektimi i afateve ligjore në proceset e Kuvendit Komunal.....	96
Rezultati 3.3 - Përgjegjshmëria në prokurim dhe kontraktim.....	107
Rezultati 3.4 - Sigurimi i masave antikorrupsion në administratën e komunës.....	111
Rezultati 3.5 - Sigurimi i trajtimit të barabartë në kuadrin e menaxhimit të burimeve njerëzore.....	116
FUSHA 4 - BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE.....	122
Rezultati 4.1 - Sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi.....	122
Rezultati 4.2 - Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare.....	126
FUSHA 5 - KULTURË, RINI DHE SPORT.....	131
Rezultati 5.1 - Ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive sportive.....	131
Rezultati 5.2 - Rritja e numrit të veprimtarive kulturore, rinore e sportive dhe e pjesëmarrjes së qytetarëve.....	133
FUSHA 6 - MENAXHIMI I FATKEQËSIVE.....	139
Rezultati 6.1 - Mbrojtja e qytetarëve dhe e pasurisë së tyre nga fatkeqësitë.....	139
FUSHA 7 PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL.....	143
Rezultati 7.1 - Planifikim i qëndrueshëm komunal.....	144
Rezultati 7.2 - Ndërtim i planifikuar komunal.....	146
FUSHA 8 HAPËSIRAT PUBLIKE.....	153
Rezultati 8.1 - Hapësirë publike e mjaftueshme për një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt.....	154
FUSHA 9 - INFRASTRUKTURA RRUGORE.....	159
Rezultati 9.1 - Infrastruktura rrugore lokale e zgjeruar, e shtruar dhe e mirëmbajtur.....	159
Rezultati 9.2 - Infrastruktura rrugore lokale e sigurt për qytetarët.....	164

FUSHA 10 - TRANSPORTI PUBLIK.....	173
Rezultati 10.1 - Ofrimi i transportit lokal publik për të gjitha vendbanimet e komunës .....	174
FUSHA 11 - PARKINGJET PUBLIKE .....	179
Rezultati 11.1 - Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike.....	179
FUSHA 12 - UJË I PIJSHËM.....	186
Rezultati 12.1 - Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm.....	186
FUSHA 13 - KANALIZIMI.....	191
Rezultati 13.1 - Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit.....	192
Rezultati 13.2 - Trajtimi i ujërave të zeza.....	195
FUSHA 14 - MBETURINAT .....	197
Rezultati 14.1 - Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave .....	198
Rezultati 14.2 - Ofrim i qëndrueshëm i shërbimeve në mbledhjen e mbeturinave .....	202
Rezultati 14.3 - Deponimi i mbeturinave.....	205
FUSHA 15 - MBROJTJA E MJEDISIT .....	207
Rezultati 15.1 - Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm .....	208
FUSHA 16 - PËRFAQËSIMI GJINOR.....	214
Rezultati 16.1 Përfaqësimi i grave në trupa komunale.....	214
Rezultati 16.2 - Barazia gjinor në përfitime të programeve dhe aktiviteteve të komunës .....	222
Rezultati 16.3 - Përfaqësimi gjinor në procese të rëndësishme shoqërore në komunë .....	229
FUSHA 17 - ARSIMI PARAUNIVERSITAR.....	231
Rezultati 17.1 Shtrirje adekuate të infrastrukturës arsimore, objekte dhe hapësira të paisura me mjete bashkohore për zhvillimin e aktiviteteve mësimore.....	233
Rezultati 17.2 Resurset dhe personeli i pregaditur dhe i mjaftueshem për zhvillimin e aktiviteteve mësimore .....	244
Rezultati 17.3 Shkallë e lartë dhe e qëndrueshme e vijueshmërisë së nxënësve si dhe rezultate të mira në nivelet e arsimit parauniversitar.....	258
FUSHA 18 - KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR.....	272
Rezultati 18.1 Shtrirje adekuate të infrastrukturës së KPS, objekte dhe hapësira të paisura me mjete bashkohore për ofrimin e shërbimeve shëndetësore .....	273
Rezultati 18.2 Resurset dhe personeli i pregaditur dhe i mjaftueshem për ofrimin e shërbimeve shëndetësore ..	276
Rezultati 18.3 Shkallë e lartë dhe e qëndrueshme e ofrimit të shërbimeve shëndetësore si dhe rezultate të mira .....	279
FUSHA 19 – ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL .....	284
Rezultati 19.1 Aktivitete të planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësimi i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve, dhe shkallë e lartë e inkasimit .....	285

**Annex 7 - Udhëzime të punës për të gjithë treguesit..... 292**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument përmbanë informata për qëllimin (SMPK), fushëveprimin, ndërtimin dhe hierarkinë, strukturën institucionale, funksionimin, sigurimin e cilësisë së të dhënave e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale si dhe ndërlidhjen e tij me Grantin e Performancës. Rishikimi i fundit i SMPK-së është bërë në vitin 2019 me qëllim të përmirësimit të zbatueshmërisë në segmente të veçanta të sistemit, duke pasë parasysh përvojat dhe mësimet e marra gjatë viteve të zbatimit pas rishikimit të vitit 2016, i cili rezultoi me plotësimin të sistemit me pesë fusha të reja (Arsimi parauniversitar, Kujdesi primar shëndetësor, Zhvillimi ekonomik lokal, Përgjegjshmëria komunale dhe Përfaqësimi gjinor).

Interesimi dhe mbështetja nga MPL për zhvillimin dhe avancimin e qeverisjes dhe shërbimeve në nivel lokal, si dhe avancimin e politikave të qeverisjes të autoriteve komunale, ka bashkëdyzuar resurset me organizatat ndërkombëtare zhvillimore në Kosovë. Kjo ka rezultuar me ngritjen e instrumentit të përbashkët financiar për mbështetjen e komunave në ngritjen e performancës, përkatësisht unifikimin e skemave stimuluese dhe rritjen e fondit të përgjithshëm përmes kontributeve nga MPL, SDC, SIDA, dhe NORAD. Fondi monetar i quajtur Granti i Performancës Komunale (GPK), ka për qëllim ndarjen e mjeteve financiare (granteve) për komunat të cilat plotësojnë kriteret minimale për qasje në grant dhe nivel më të lartë të performancës së tyre informohet nga treguesit e SMPK-së.

Procesi i rishikimit është udhëhequr nga MPL, përkatësisht nga këshilli drejtues në kryesim të sekretarit të ministrisë dhe menaxhuar nga drejtori i departamentit për Performancë dhe Transparencë Komunale. Procesi është mbështetur në aspektin teknik dhe financiar nga ana e projektit DEMOS<sup>1</sup>. Rishikimi i SMPK-së është i dakorduar nga të gjithë akterët dhe mbi bazën e informatave të mbledhura dhe organizuara sistematikisht nga ana e njësisë menaxhuese në kuadër të MPL-së, e këto të mbledhura me qëllim të referimit gjatë procesit të rishikimit.

Gjatë rishikimit të SMPK janë marrë për bazë parimet themelore të përcaktuara në dokumentin e SMPK-së të vitit 2016, duke u siguruar se qëllimi i SMPK-së është i bazuar me përcaktimet ligjore në fuqi. Më tutje, në përputhje me bazën ligjore, janë përcaktuar orientimet, mjetet dhe proceset e tjera të matjes së performancës së komunave. Matja e performancës bëhet me qëllim të sigurimit se monitorohet ofrimi i shërbimeve përmes matjeve të vlefshme (vlerësim i organizuar sistematik), ofrimin të informatave për të përmirësuar vendimmarrjen në komunë, motivuar autoritetet e qeverisjes lokale, si dhe për të promovuar përgjegjësinë dhe llogaridhënien e autoriteteve komunale në raport me qytetarët, duke ngritur kështu transparencën dhe krahasueshmërinë.

Për arritjen e qëllimit të SMPK-së, objektivat e përgjithshme janë të lidhura ngushtë me veprimet e MPL-së, komunave dhe palëve tjera të interesit. Objektivat themelore të SMPK janë:

- ◁ Njoftimi, përgatitja dhe mbështetja e zyrtarëve komunal përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për performancën komunale dhe koordinatorëve komunalë të performancës për zbatimin e SMPK-së në nivel të komunës;
- ◁ Zbatimi i metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunave;
- ◁ Zbatimi i procedurave dhe procesit për menaxhimin e cilësisë për të siguruar besueshmërinë e të dhënave për performancën e komunave;
- ◁ Publikimi i informatave të besueshme për shkallën e performancës së komunave;

---

<sup>1</sup> Projekti për Decentralizim dhe përkrahja komunave (DEMOS) është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bashkëfinancuar nga Suedia dhe Norvegjia implementuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo.

- ◁ Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes dhe lehtësimi i veprimit të administratës komunale;
- ◁ Ndarja e Grantit të Performancës Komunale sipas rezultateve të performancës së komunave.

Gjatë rishikimit të SMPK-së është shqyrtuar edhe pjesa e verifikimit të të dhënave të raportuara, duke drejtuar procesin në drejtim të konceptit të menaxhimit të cilësisë së të dhënave. Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti, janë marrë parasysh edhe zhvillimet, plotësimet dhe ndryshimet e kuadrit ligjor dhe akteve përkatëse nënligjore, kjo pasi që fushëveprimi i matjeve të SMPK-së shtrihet përgjatë brezit të kompetencave që kanë komunat sipas Ligjit 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale.

Ky rishikim do të rezultojë edhe me ndryshimin e rregullores Nr. 02 / 2017 Për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave, në mënyrë që në rregulloren e re të pasqyrohen ndryshimet në përmbajtje dhe funksionim të SMPK-së së dhe GPK.

Hierarkia konceptuale mbi të cilën është ndërtuar sistemi përbëhet prej tri shkallëve kryesore: fushat, rezultatet dhe treguesit. Sistemi është i ndërtuar nga **19 fusha** (që mbulojnë **18 kompetenca** vetanake), **37 rezultate**, **119 tregues** dhe **343 të dhëna**.

Për nga mënyra e përmbushjes dhe e raportimit të treguesve, SMPK ka dy lloje të treguesve: treguesit të cilët përmbushen dhe raportohen në mënyrë përmbledhëse (kumulative) dhe treguesit të cilët përmbushen dhe raportohen vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës raportues, duke filluar me “zero” më 01 janar dhe vlerën e arritur më 31 dhjetor të vitit përkatës për të cilin edhe raportohet. Nga cikli i raportimit të të dhënave për performancës për peridhën Janar-Dhjetor, përjashtim bëjnë treguesit e fushës së arsimit parauniversitar, pasi që ka cikël Shator-Gusht dhe raporton për të dhënat sipas kalendarit përkatës.

Pjesë përbërëse e SMPK është edhe sistemi elektronik (SE) i cili mundëson raportimin e të dhënave nga komunat në mënyrë elektronike. Njëkohësisht me rishikimin e sistemit është rishikuar edhe SE.

SMPK i rishikuar siguron udhëzimet e nevojshme të funksionimit të sistemit, pjesë e të cilit është edhe metodologjia standarde e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit zyrtar të të dhënave për raportin e performancës së komunave. Në këtë dokument është paraqitur edhe procedura e ndryshimeve të sistemit. Ky dokument siguron informata për formatin e raportit të informatave të cilat do të raportohen sipas nevojave standarde dhe atyre prioritare të kohës për palët e ndryshme të interesit. Me këtë do t’u mundësohet, që të gjitha palëve të interesit, të gjejnë informatat relevante dhe rrjedhimisht raportin ta bëjmë shumë të besueshëm dhe të përdorshëm, në përputhje me qëllimin e SMPK.

## HYRJE

Ndryshimi dhe zhvillimi në kuadër të një SMPK-je nënkupton evoluimin e tij, duke reflektuar zhvillimin dhe ndryshimet në shoqëri, institucione dhe ato në sferën e teknologjisë. Kosova ka hyrë në dekadën e dytë të pavarësisë, e karakterizuar kjo me sfidat e zhvillimit dhe përparimit të aspekteve të qeverisjes si dhe të përmirësimit të shërbimeve për qytetarë, duke u marrë me sfidat e periudhës post-reformuese dhe të konsolidimit, e të cilat karakterizonin dekadën e parë. Zhvillimi i qeverisjes lokale në Kosovë gjatë dekadës së kaluar është karakterizuar me zhvillime të hovshme dhe me përmasa më të mëdha se sa mundësitë reale i që kishte. Progresi në shërbime dhe administratë i atribuohet përpjekjeve të profesionistëve si dhe të politikanëve të përkushtuar në të gjitha nivelet brenda komunës dhe gjithashtu atyre që i kanë mbështetur ata nga Qeveria. Qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në organet e pushtetit lokal që të jenë të shërbyer në mënyrë profesionale dhe me cilësinë e duhur, nëpërmjet modeleve më të përshtatshme. Qeveria e Kosovës dhe MPL kanë miratuar kuadrin rregullues si infrastrukturë e nevojshme ligjore përmes së cilës autoritetet lokale veprojnë dhe iu ofrojnë shërbime qytetarëve me barazi, drejtësi dhe transparencë të plotë. SMPK përfaqëson një instrument të rëndësishëm për vrojtimin e respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të organeve të pushtetit lokal gjatë ofrimit të shërbimeve, të përcaktuara me politikat, prioritetet dhe rregullativën përkatëse ligjore dhe nënligjore. Dokumenti sjell, në përgjithësi, përvojën e Republikës së Kosovës në matjen e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve komunale dhe përvojën ndërkombëtare të vendeve të ndryshme, por kryesisht të vendeve të OECD. Nëpërmjet kësaj përvoje janë vlerësuar nevojat e ndryshimeve dhe zhvillimeve në sistemin e rishikuar, duke e ruajtur nevojën dhe mundësitë e Kosovës në njërën anë dhe duke e ruajtur trendin e zhvillimeve ndërkombëtare në anën tjetër. Po ashtu, dokumenti sjellë në mënyrë të detajuar përshkrimet e nevojshme të ndërtimit të SMPK, për të gjitha fushat, rezultatet, treguesit dhe të dhënat. Në përgjithësi mund të themi se dokumenti është përpjekur të sjellë informata të mjaftueshme për definimin sa më të saktë të asaj se: çfarë matë, pse matë dhe si matë një tregues, një rezultat dhe një fushë përkatëse e SMP. Gjithashtu dokumenti përshkruan edhe problemet, sfidat dhe çfarë nuk ka mundësi të matë një tregues përkatës në këtë fazë të zhvillimit të SMPK.

Rishikimi i fundit i SMPK-së është bërë në vitin 2019 dhe ky version i dokumenti është rezultat i tij. Këtu janë të reflektuara ndryshimet dhe plotësimet që rezultuan nga procesi. Dokumenti përmbanë informata për qëllimin e sistemit, fushëveprimin, ndërtimin dhe hierarkinë e sistemit, strukturën institucionale, funksionimin, sigurimin e cilësisë së të dhënave, si dhe dhe ndërlidhjen e tij me Grantin e Performancës. Rishikimi i vitit 2019 ka pasë për qëllim përmirësimin e zbatueshmërisë së SMPK-së në segmente të veçanta, duke pasë parasysh përvojat dhe mësimet e marra gjatë viteve të zbatimit pas rishikimit të vitit 2016, si dhe nevojat e identifikuar nga zbatimi e poashtu dhe nga palët e interesit për zgjerimin e kornizës me fusha dhe tregues të rinj. Fokusi i përhershëm përgjatë rishikimit ka qenë në mandatin e autoriteteve komunale për të ofruar performancë më të mirë, në aspektin e qeverisjes në ushtrim të kompetencave dhe ofrimin e shërbimeve. Rishikimi i vitit 2019 ka rezultuar me shtimin e 5 fushave në SMPK, ku 3 fusha janë tërësisht të reja (Arsimi parauniversitar, Kujdesi primar shëndetësor, Zhvillimi ekonomik lokal), kurse 2 fushat e tjera janë ndarë nga fushat e mëparshme (Përgjegjshmëria komunale, Përfaqësimi gjinor). Interesimi dhe mbështetja nga MPL për zhvillimin dhe avancimin e nivelit të shërbimeve në nivel të qeverisjes lokale, si dhe avancimin e cilësisë dhe politikave të qeverisjes të autoriteteve komunale, ka bashkëdyzuar resurset



me organizatat ndërkombëtare zhvillimore në Kosovë. Koordinimi dhe bashkërendimi i agjendave për përmirësimin e cilësisë së qeverisjes dhe avancimin e cilësisë dhe brezit të shërbimeve ka çuar deri te ngritja e instrumentit të përbashkët financiar për mbështetjen e performancës së komunave, përkatësisht unifikimin skemave stimuluuese dhe rritjen e fondit të përgjithshëm përmes kontributeve nga MPL, Helvetas/SDC, SIDA, dhe NORAD. Fondi stimulues i quajtur Granti i Performancës, ka për qëllim ndarjen e mjeteve financiare (granteve) për komunat të cilat kanë nivel më të mirë të performancës, e cila informohet nga treguesit e SMPK-së. Në këtë mënyrë vazhdon në formë të unifikuar dhe transparente, por dhe financiarisht më domethënëse, mbështetja për komunat me rezultate më të mira në qeverisje, duke pasur si qëllim sigurimin si të motivimit e poashtu edhe mbështetjes financiare për të arritur suksese për shërbime dhe qeverisje më cilësore për qytetarët. Gjatë rishikimit janë marrë për bazë parimet themelore të përcaktuara në dokumentin e SMPK-së të vitit 2016, duke u siguruar se qëllimi i SMPK-së është i bazuar me përcaktimet ligjore në fuqi. Më tutje, në përputhje me bazën ligjore, janë përcaktuar orientimet, mjetet dhe proceset e tjera të matjes së performancës së komunave, si dhe qëllimi i SMPK-së duke synuar ofrimin e përgjigjeve në pyetjen: përse bëhet matja e performancës së shërbimeve të ofruara për qytetarët si dhe për vet qeverisjen nga ana e autoriteteve komunale. Ku implikohet se matja e performancës bëhet me qëllim të sigurimit se monitorohet ofrimi i shërbimeve përmes matjeve të vlefshme (vlerësim i organizuar sistematik), ofrimin të informatave për të përmirësuar vendimmarrjen në komunë, motivuar autoritetet e qeverisjes lokale, si dhe për të promovuar përgjegjësinë dhe llogaridhënien e autoriteteve komunale në raport me qytetarët duke ngritur kështu transparencën dhe krahasueshmërinë.

Për të qenë më lehtë i komunikueshëm dhe i kuptueshëm, dokumenti është i ndërtuar prej **nëntë (9)** kapitujve. Dokumenti është i shoqëruar edhe me një numër të shtojcave të cilat e plotësojnë pjesën normative të dokumentit me informata të rëndësishme dhe specifike. Dokumenti iu hynë në punë, në radhë të parë, zyrtarëve të MPL, zyrtarëve të komunave në veçanti koordinatorëve për performancë komunale, zyrtarëve të kompanive publike dhe operatorëve tjerë ekonomik, ministrive të linjës, bizneseve, qytetarëve, shoqërisë civile të cilat monitorojnë punën e komunave, institucioneve të pavarura profesionale, organizatave ndërkombëtare, ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe të gjitha palëve tjera të interesit.

## KONTEKSTI I ZHVILLIMIT TË SMPK

Në vitin 2008, është themeluar Departamenti për Vetëqeverisje Lokale, në përbërje të të cilit ka funksionuar Divizioni për Performancë të Komunave. Divizioni me përkrahjen e USAID-it ka bërë të gjitha përgatitjet për krijimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale. Në përputhje me këtë, MPL, nga viti 2009 ka filluar zbatimin e Sistemit të Performancës së Komunave (SMPK), me qëllim të monitorimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave. Me Rregulloren 02/2011, MPL merr përgjegjësinë për mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve komunale të ofruara nga komuna për qytetarët e saj. Me mbështetjen e projektit USAID (projekti EMI dhe pastaj DEMI), MPL ka zhvilluar Sistemin për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale (SMPSHK), i cili ka adresuar performancën e komunave nga fushat e kompetencave vetanake. Ndërtimi dhe funksionimi i sistemit është rregulluar me Rregulloren 02/2013 dhe është përshkruar hollësisht me anën e një doracakut (MPL -USAID 2013). Sistemi ka has në pengesa të ndryshme gjatë zbatimit. Nga vitit 2012, Ministria e Pushtetit Lokal, duke e parë nevojën e funksionimit më të mirë dhe të qëndrueshmërisë së sistemit, kishte vendosur për të hyrë në një proces të modernizimit të tij. Në bazë të analizave të bëra, është vërejtur se për rezultatet, treguesit dhe të dhënat, nuk ka pasur përkufizime të normuara dhe standarde si dhe elaborim të qartë për përmbajtjen e tyre dhe nuk janë dhënë udhëzime të mjaftueshme me shkrim për mënyrën e llogaritjes dhe të raportimit të të dhënave nga komunat. Treguesit nuk kanë qëndruar në harmoni apo në përputhje të plotë me rezultatin përkatës të fushës dhe si i tillë rezultati është në të shumtën e rasteve jashtë funksionit dhe i pamatshëm. Treguesit kanë qenë të ndërtuar me kritere të ndryshme matëse dhe shpesh të pakrahasueshëm. Nga informatat e prodhuara nuk është kuptuar qartë se a janë ofruar mjaftë dhe me cilësinë e duhur shërbimet për qytetarët. SMPSHK nuk ka pas kritere të matjes së sasisë dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga ana e organeve të pushtetit lokal. Kjo e ka bërë sistemin më shumë të orientuar në aktivitete se sa në rezultate, qofshin ato sasiore apo cilësore. Informatat e prodhuara, janë përdorë me vështirësi si pika referimi për përmirësimin e performancës së komunave në ofrim të shërbimeve përkatëse. Pra ka qenë një sistem i treguesve që ka grumbulluar shumë të dhëna statistikore dhe ka prodhuar pak informata dhe rrjedhimisht ka zvogluar shkallën e ndikimit në përmirësimin e punës së institucioneve të pushtetit lokal. Si i tillë sistemi nuk ka prodhuar llogaridhënie për performancën e institucioneve lokale.

Kapacitetet e paqëndrueshme njerëzore në komunë në vazhdimësi kanë qenë problem i madh në menaxhimin e sistemit. Zyrtarët komunal të certifikuar kanë lëvizur në pozita tjera dhe burimet njerëzore të pa trajnuara dhe të pa certifikuar kanë zënë vendin e tyre. Kjo i ka dëmtuar dhe po i dëmton kapacitetet profesionale të funksionimit të sistemit dhe po rritë mundësinë e lëshimit të gabimeve, që nuk janë të pakta gjatë raportimit. Menaxhimi i sistemit në mënyrë plotësuese vështirësohet nga kompanitë publike, kryesisht përmes vonësive në raportimin e të dhënave në komunat përkatëse lidhur për shërbimet e ofruara. Këto dhe mosrespektimi i udhëzimeve profesionale të raportimit e bënë sistemin jo shumë të besueshëm! Ndër problemet e identifikuar ka qenë edhe mirëmbajtja e sistemit. Pjesë të ndryshme teknike të sistemit dështonin gjatë punës nëpër komuna (serverët janë të vendosur në komuna) dhe komunat kërkojnë që MPL ta bëjë riparimin dhe mirëmbajtjen.

Nga tërësia e problemeve dhe sfidave, barra më e madhe ka qenë vështirësia e matjes së performancës. Puna e institucioneve publike është e natyrës së ndryshme dhe në shumë raste ato nuk mund të maten me të njëjtat njësi matëse. Si zgjedhje u imponua formulimi i parametrave specifik për tregues në bazë të natyrës dhe koncepteve të cilat ishin objekt i matjes, respektivisht u imponua formulimi i treguesve ashtu

që të mundësohej matja përkatëse e cila përveç se kërkohet të ishte objektive duhet të ishte relevante, dhe e zbatueshme universalisht mes të gjitha komunave të Kosovës. Rishikimi i SMPK-së në vitin 2016, prodhoi një tërësi të rregulluar të proceseve dhe procedurave, funksioneve, përkufizimeve, duke riorganizuar SMPK-në dhe njësitë ndërtuese në aspektin qëllimor, përmbajtësor, funksional, dhe aplikativ . Rishikimi i vitit 2016 ka përshkuar një rrugë shtruese konsultative me palët e interesit duke zbatuar metodologji uniforme më qëllim të standardizimit të elementeve të SMPK-së, dhe krijimin e një sistemi të zbatueshëm i cili është i drejt, i bazuar në kritere transparente, relevante, dhe mbi të gjitha i besueshëm dhe i dobishëm në aspektin e matjes së performancës dhe informimin e politikave zhvillimore lokale. Procesi i rishikimit të vitit 2016 u përmbyll me përgatitjen e dokumentit kryesor me përmbajtje të reviduar, dokumentet ndihmëse si (udhëzuesit për punë), dhe u normua ligjërisht me rregulloren Nr. 02 / 2017 Për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave

## KONCEPTE THEMELORE

Është shumë me rëndësi për MPL dhe institucionet tjera relevante monitoruese për të kuptuar se sa mjaft dhe sa mirë komunat ju ofrojnë qytetarëve të tyre shërbimet nga fushat e kompetencave të tyre. Gjithashtu është shumë me rëndësi të përdoren rezultatet e performancës në ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të komunave në procesin e vendimmarrjes dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët. MPL së bashku me palët tjera të interesit ka ndërtuar konsenzusin për përmirësimin e SMPK-së me qëllim që këto funksione të zbatohen më mirë në praktikë. Që SMPK të jetë më funksional dhe më i zbatueshëm në komunat e Republikës së Kosovës, së pari duhet elaborohen konceptet themelore për matjen e performancës dhe konceptet që janë të lidhura me matjen e performancës.

### Matja e Performancës

Matja e performancës ka të bëjë me nxjerrjen e përfundimeve apo të mendimeve për të kuptuar se si një sistem i përgjithshëm i menaxhimit të punës ndihmon në identifikimin dhe parandalimin e punës së pasuksesshme, duke ndihmuar komunën në konfirmimin e arritjeve të synuara në ofrimin cilësor të shërbimeve sipas kërkesave të qytetarëve të saj. Përveç kësaj, ka të bëjë me rritjen e optimizmit për punë më efikase dhe më efektive në procesin e ofrimit të shërbimeve cilësore. Këto veprime ndodhin në një cikël të vazhdueshëm, që krijojnë mundësitë për zgjerim dhe përmirësim të procesit të punës, duke u bazuar në metodologjitë standarde. Qëllimi kryesor është krijimi i bazës relevante profesionale për vendimmarrje praktike dhe strategjike, që ndikojnë në cilësinë e punës së komunës për të prodhuar shërbime cilësore.

### Qëllimi i SMPK

Matja e performancës bëhet me qëllim që të sigurojë monitorimin e ofrimit të shërbimeve nëpërmjet matjeve të vlefshme të performancës, të ofrojë informata të nevojshme për lehtësimin e vendimmarrjes në komunë, të motivojë organet e pushtetit lokal dhe të promovojë përgjegjësinë dhe llogaridhënien gjatë punës së tyre në krijimin e kushteve për jetë të dinjitetshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

### Objektivat e SMPK

Objektivat themelore të SMPK janë:

- ◁ Zbatimi i metodologjisë standarde (uniforme) për matjen e performancës së komunave në ofrimin shërbimeve komunale;
- ◁ Sigurimi i besueshmërisë së të dhënave për performancën e komunave;
- ◁ Publikimi i informatave të besueshme për shkallën e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- ◁ Sigurimi i mekanizmave të nevojshëm për futjen në përdorim të raporteve të performancës në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

### **Parimet themelore të SMPK**

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punëve ndërmjet akterëve kryesor (komunat, AKK, ZKA, ministritë e linjës, kompanitë publike) të udhëhequr nga MPL si përgjegjëse në këtë proces, bazohet në disa parime themelore, që janë:

**Parimi i ligjshmërisë** - nënkupton se organet përgjegjëse veprojnë në pajtim me rregullat e legjislacionit të zbatueshëm për matjen e performancës komunale;

**Parimi i transparencës** - nënkupton qasjen e hapur për qytetarët dhe palët e tjera të interesit në informatat lidhur me performancën komunale, si dhe përfshirje në zhvillimin e politikave për performancën komunale;

**Parimi i subsidiaritetit** - nënkupton që matja e performancës shtrihet për aq sa është e mundur tek ofruesit më të afërt të shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe ndikimi i grantit reflekton interesat dhe nevojat e numrit më të madh të qytetarëve të komunës;

**Parimi i meritës** - nënkupton se niveli i performancës së arritur ndikon në rradhitjen e komunave sipas rezultateve të treguara në ushtrimin e kompetencave në fushat e matura. Granti i performancës komunale merr parasysh nivelin e performancës së arritur të komunave;

**Parimi i efikasitetit dhe efijencës** - organet përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror sigurojnë zbatimin e thjeshtë dhe ekonomik, në kohë të arsyeshme dhe mënyrë profesionale të rregullave dhe procedurave administrative për matjen e performancës komunale, si dhe menaxhimin e grantit të performancës komunale;

**Parimi i vlefshmërisë** - Nënkupton se organet përgjegjëse krijojnë mekanizmat e nevojshëm profesional, administrativ dhe ligjor për të matë atë që synohet të matë. Sistemi e ka të përcaktuar qartë qëllin e matjes së performancës së komunave dhe ai duhet ta matë pikërisht atë dhe jo diçka tjetër, që shpesh mund të ndodhë;

**Parimi i barazisë** - nënkupton që në kontekst të SMPK-së dhe grantit të performancës komunale, komunat nuk diskriminohen në bazë të karakteristikave gjeografike dhe demografike apo strukturës etnike të popullatës;

**Parimi i zbatueshmërsë** - nënkupton që sistemi përcakton në mënyrë të qartë objektin dhe mënyrën e matjes, si dhe përgjegjësitë për matje me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në komuna;

### **Struktura e SMPK-së**

SMPK është i ndërtuar në atë mënyrë që i mundëson sistemit të matë aspektet themelore, në përputhje me kapacitetet e komunave, ofrimin e shërbimeve nga ana e komunave. SMPK hynë në kuadër të sistemeve të hapura ndaj llogaridhënies dhe i mbyllur ndaj sistemeve tjera relevante dhe informative, është mjaftë i decentralizuar, çka në të vërtetë e bën sistemin e kombinuar (menaxhim nga MPL dhe nga komunat) dhe është plotësisht i bazuar në rezultate, ngjashëm sikur përvojat ndërkombëtare të bazuara në objektiva dhe standarde.

Nga pikëpamja e përgjithshme SMPK është i ndërtuar prej Njesisë Qendrore (NQ) në MPL dhe Njesisë Lokale (NL) në komuna. Njësia qendrore është Divizioni për Transparencë dhe Performancë të Komunave (DPK) i përkrahur nga Departamenti për Performancë dhe Transparencë të Komunave dhe strukturat tjera të MPL që ndërlidhen me monitorimin e punës së komunave. NQ harton dokumentet përkatëse profesionale, administrative dhe ligjore dhe menaxhon në tërësi ndërtimin dhe funksionimin e SMPK. Njësia tjetër

ndërtuese e SMPK është e vendosur në komuna dhe quhet njësia lokale (NL). NL është koordinatori komunal për performancë (tani e tutje koordinatori), i përkrahur nga drejtoritë përkatëse të fushave për të cilat matet performanca, kompanitë përkatëse publike dhe nga drejtori i administratës së komunës përkatëse. Koordinatorit është i vendosur në një strukturë përkatëse të komunës, nga ku e organizon mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për performancën e komunës përkatëse në NQ – MPL. Pjesa kryesore vërtetuese e të dhënave të komunës për SMPK është kryetari i komunës. Këto dy pjesë të sistemit janë të ndërlidhura me një sistem të teknologjisë informataive, i cili mundëson transportimin e të dhënave nga komuna për në NQ në MPL. Të dy pjesët janë të ndërvuara njëra me tjetrën dhe e krijojnë një sistem të integruar të performancës.

Zakonisht sistemet janë të ndërtuara prej një kornize të përgjithshme dhe prej pjesës thelbësore në brendi të sistemit. Në kornizën e përgjithshme të sistemit është e vendosur pjesa vepruese (operative) e SMPK. Pjesa vepruese SMPK përshkruhet si programi i sistemit, nga ndërtimi i të cilit varet funksionimi dhe lloji i redimentit apo i prodhimit të tij. Elementet ndërtuese të pjesës vepruese të SMPK janë:

- ◁ **fusha** e veprimeve që i mbulon komuna;
- ◁ **rezultati** të cilin komunat dhe MPL-ja do të kishin dëshirë ta arrinin;
- ◁ **treguesi** që demonstron (tregon) se deri në çfarë shkalle janë arritur rezultatet; dhe
- ◁ **të dhënat** të cilat treguesin e bëjnë kuptimplotë dhe të matshëm.

**Fushat** - Fushat shprehin grupin e të drejtave (kompetencave) dhe të detyrave që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve. Këto të drejta janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL). Me LVL janë përcaktuar 29 të drejta dhe detyra vetanake të komunave. Prej tyre janë përzgjedhur si pjesë e SMPK 18 kompetenca, të grupuara në 19 fusha të sistemit për matjen e performancës së komunave. Fushat përshkruajnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e komunës për të ofruar shërbime themelore për qytetarët e vetë. Përshkrimin detal për secilën fushë specifike e gjeni në shtojcën 6..

**Rezultatet** - Rezultatet janë elementet më të rëndësishme të SMP-së. I tërë sistemi për matjen e performancës është i orientuar në rezultate. Rezultatet janë arritje afatshkurtra apo afatgjata që komunat i synojnë në secilën fushë specifike që e ushtrojnë. Për secilën fushë është i caktuar një numër përkatës i rezultateve. Rezultatet qëndrojnë në përputhshmëri horizontale me rezultatet tjera dhe në përplotësim vertikal me treguesit dhe fushën e vetë që i takon. Rezultatet ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Rezultati tregon se shërbimi është ofruar në sasinë apo cilësinë përkatëse të planifikuar, mbi bazën e kapaciteteve që ka komuna apo kritereve përkatëse të vendosura paraprakisht. (shih kapitullin 7)

**Treguesit** - Përfaqëson bazën kryesore llogaritëse për shkallën e arrijës së rezultatit. Treguesi është një madhësi (në përgjithësi) statistikore, por edhe logjike e lidhur në mënyrë të natyrshme ose në mënyrë arbitrare për matjen e arritjeve të politikave (rezultateve) të një institucioni përkatës – komunës përkatëse. Treguesit ofrojnë informata të mjaftueshme për t'iu mundësuar komunave dhe palëve të tjera të interesit që të masin ose të vlerësojnë se deri në çfarë shkalle është arritur rezultati përkatës i fushës përkatëse. Secili rezultat ka një ose më shumë tregues të lidhur ndër vete horizontalisht, ndërkaq vertikalisht janë në harmoni të plotë me rezultatin dhe të dhënat që e ushqejnë me informata. SMPK ka gjithsej 119 tregues.

Treguesit janë të ndërtuar dhe të përshtatur që të prodhojnë informata kurdoherë që është e mundur dhe jo thjeshtë vetëm statistika. Ata përpiqen të matin rezultatin sa më mirë që të jetë e mundur edhe pse dihet se matja është e pjesshme sa do mirë që të jenë ndërtuar treguesit.

**Të dhënat** - Janë fakte që dëshmojnë se një shërbim është përmbushur në masën dhe cilësinë e caktuar apo të kërkuar. Lloje të ndryshme të të dhënave e ushqejnë me informata treguesin përkatës. Secili tregues është i informuar zakonisht me dy lloje të të dhënave, rralleherë me një dhe me tri e më shumë. SMPK ka gjithsej 343 të dhëna. Nga saktësia dhe besueshmëria e të dhënave varet vlefshmëria e treguesve dhe e matjes së performancës së komunave.

### **Sistemi elektronik**

Treguesit për matjen e performancës janë vendosur në një program kompjuterik, të shoqëruar edhe me të dhëna përkatëse shtesë dhe me mundësi të raportimit të të dhënave nga ana e koordinatorëve të performancës komunale.

Program i vendosur në MPL është i përbërë nga faqja elektronike e MPL dhe Baza e të dhënave, ku po ashtu edhe secila komunë e ka të instaluar faqen e vetë elektronike dhe bazën e të dhënave. Komunitat, respektivisht zyrtarët e autorizuar, e shfrytëzojnë sistemin nëpërmjet faqes së internetit, ndërsa informatat ruhen në bazën e të dhënave. Në faqen e MPL, përpos faqes së vetë, janë të vendosura edhe të gjitha faqet elektronike të komunave dhe baza e të dhënave të tyre. Në linkun përkatës janë të vendosura të gjitha komunitat e Republikës së Kosovës, ku në momentin e klikimit tek komuna përkatëse koordinatorit i jepet mundësia e qasjes në sistem duke i kërkuar fjalëkalimin dhe kodin e sigurisë së këtij linku. Qasja dhe mënyra e përdorimit të programit elektronik të SMPK janë të përshkruara detajisht në Manualin e përdorimit të Sistemit elektronik.

### **Akterët kryesorë**

**Ministria e Pushtetit Lokal** - është autoriteti përgjegjës për funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të performancës komunale. Të gjitha ndryshimet të cilat kanë të bëjnë me avansimin e sistemit, bien mbi ministrinë.

**Zyrtar në divizionin për performancë komunale** – është zyrtari i ministrisë, përgjegjës për analizën e sistemit dhe avansimin e tij. Po ashtu përgjegjës për grumbullimin e të dhënave të raportuara nga komunitat dhe përgatitjen e raportit të performancës.

**Koordinatori komunal për Performancë** - është zyrtari i komunës i cili caktohet nga Kryetari i Komunës, përgjegjës për bashkërendimin e përgjithshëm të punëve në komunë për administrimin dhe menaxhimin e sistemit të performancës komunale.

**Zyrtar komunal për raportim/performancë** - është zyrtari i komunës i cili caktohet nga kryetari i komunës, përgjegjës për grumbullimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave zyrtare të komunës, të përcaktuara me SMPK, për matjen e performancës së komunës përkatëse.

**Kryetari** – është autoriteti më i lartë në komunë, i cili autorizon raportimin e të dhënave në ministri.

Asambleistët - janë organi komunal i cili kërkon llogaridhënjen nga ekzekutivi në lidhje me performancën e komunës në fushat e SMPK-së.

**Zyra Kombëtare e Auditimit** – është organi shtetëror i cili ka përgjegjësinë e auditimit të funksionimit të sistemit dhe të rekomandoj përmirësimet e mëtutjeshme.

**Donatorët** – janë palë të interesit të cilët përorin të dhënat e sistemit me qëllim të identifikimit të fushave me performancë të dobët dhe të fokusojnë kontributin në zhvillimin e atyre fushave. Palët e lartpërmendura mund edhe të ofrojnë edhe mbështetje financiare për komunat përmes skemës së grantit për performancë komunale.

**Shoqëria civile** – janë organe publike të cilët përdorin të dhënat e SMPK për të njoftuar më për së afërmi qyterët për gjendje e qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve në komunën e tyre.

### Operimi i SMPK

Procesi i mbledhjes së të dhënave në komuna fillon pas marrjes së informatës nga ministria se procesi i raportimit të të dhënave ka filluar. Afati i raportimit të të dhënave të performancës nga komuna është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendrike, nga momenti i pranimit të kërkesës për raportim.

Koordinatori komunal për performancë bashkërendon aktivitetet me njësitë e tjera organizative në nivel komunal për mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe raportimin e të dhënave të performancës komunale. Mbledhja e të dhënave bëhet nga zyrtari komunal për raportim të performancës, sipas përgjegjësive të ngarkuara në kuadër të fushave të matjes së performancës (detaje për secilën fushë janë të dhëna në shtojcën 6 të këtij dokumenti, kurse udhëzimet e punës janë të paraqitura në shtojcën 7).

Koordinatori bënë verifikimin dhe përmbledhjen përfundimtare të të dhënave të raportuara dhe pas nënshkrimit apo autorizimit elektronik, i dërgon për aprovim tek kryetari i komunës. Kryetari i komunës autorizon raportimin e të dhënave për performancën e komunës në ministri. Mosaprovimi i të dhënave dhe mosdhënia e autorizimit nga kryetari, ka për pasojë shpalljen e tyre të pavlefshme nga ministria. Të dhënat e raportuara pas afatit të raportimit nuk do të merren në konsideratë.

Pas raportimit nga komunat, njësia përgjegjëse për performancë në ministri siguron se janë përmbushur të gjitha kriteret për pranimin e të dhënave të raportuara nga komunat, përkatësisht:

- Raportimi është bërë me kohës sipas afatit të përcaktuar në kërkesën për raportim të ministrisë;
- Janë respektuar kriteret për raportim përfshirë: nënshkrimet apo autorizimet e zyrtarit komunal për raportim të performancës, koordinitorit për performancë dhe kryetarit të komunës;

Njësia përgjegjëse në ministri bën përpunimin, analizën, verifikimin e të dhënave dhe hartimin e raportit të performancës komunale. Në rastet kur zyrtarët e ministrisë hasin në gabime teknike të raportimit, ato përmirësohen në bashkëpunim me zyrtarët komunal. Kurse të dhënat të cilat nuk i përmbushin kriteret e cilësisë konsiderohen si të dhëna të pavlefshme.

I gjithë procesi i raportimit dhe verifikimit të cilësisë së të dhënave është shpjeguar në Kapitullin IV dhe V të Rregullores (shtojca 1).

### Sistemi i performancës ndërlidhja me GPK

Granti i performancës komunale ofrohet në formë të përkrahjes financiare për komunat dhe ka për qëllim stimulimin e tyre që të përmirësojnë më tej performancën e tyre në fusha të caktuara, respektivisht në qeverisje të mirë, menaxhim komunal dhe ofrim të shërbimeve.



GPK i stimulon komunat në dy mënyra: së pari, inkurajon pajtueshmërinë komunale me standardet minimale ligjore (standardet themelore). Së dyti, granti stimulon performancën 'reale' që shkon përtej pajtueshmërisë ligjore ('të detyrueshme').

Duke pasur parasysh analizën e faktorëve kritikë, të cilët i pengojnë komunat të bëhen '*institucione demokratike vibrante të qeverisjes lokale që ofrojnë shërbime cilësore*', GPK do të fokusohet në tre temat e mëposhtme:

- Š Qeverisja demokratike;
- Š Menaxhimi komunal;
- Š Ofrimi i shërbimeve.

Këto tre tema ndahen tutje në dhjetë nën-tema siç paraqitet më poshtë në Tabelën 1. Në kuadër të këtyre dhjetë nën-temave, janë identifikuar 30 tregues të performancës (siç paraqitet në Tabelën 2), të cilët bashkërisht u mundësojnë komunave të marrin 100 pikë në vlerësimin e performancës. Pikët, siç do të shpjegohet në kapitullin 2, përcaktojnë shumën e grantit që merr komuna në vit duke u bazuar në performancën e saj.

**Tabela 1: Tre temat kryesore dhe dhjetë nën-temat me pikët maksimale**

Temat dhe nën-temat		Pikët maksimale të mundshme
<b>1. Qeverisja demokratike</b>		<b>40</b>
I	Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës	13
II	Pjesëmarrja, konsultimi i qytetarëve dhe gjithëpërfshirja	12
III	Transparenca, çësja në informata dhe integriteti	15
<b>2. Menaxhimi komunal</b>		<b>30</b>
IV	Menaxhimi financiar	13
V	Menaxhimi i kontratave	7
VI	Menaxhimi i burimeve njerëzore	10
<b>3. Ofrimi i shërbimeve</b>		<b>30</b>
VII	Shërbimet administrative	6
VIII	Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi	8
IX	Arsimi para-universitar	8
X	Kujdesi primar shëndetësor	8
<b>Numri maksimal i pikëve që mund të merren</b>		<b>100</b>

GPK bazohet në parimet e mëposhtme:

- Š Komunat duhet që për secilin vit, të plotësojnë një numër kushtesh minimale që të mund të kualifikohen për marrjen e grantit në baza vjetore (në pajtim me nenin 30.2 të Rregullores për SMPK dhe për skemën e grantit për performancë komunale);
- Š Për të gjitha komunat që kanë plotësuar kushtet minimale, granti shtesë që merr secila komunë bazohet në pikët e saj relative të arritura në 30 treguesit e performancës komunale (pikët e saj në krahasim me ato të të gjitha komunave të tjera) (në pajtim me nenin 30.3 të Rregullores për SMPK dhe për skemën e grantit për performancë komunale).

Kushtet minimale kanë për qëllim të sigurojnë që shumica në dispozicion t'u ndahet vetëm komunave që janë në gjendje t'i shfrytëzojnë mjetet financiare mirë; janë në gjendje të shpenzojnë në mënyrë të

përgjegjshme; kanë respektuar obligimet ligjore për të rishikuar aktet komunale dhe kanë raportuar në të gjithë treguesit e SMPK.

Treguesit e performancës komunale (dhe pikët relative) kanë për qëllim të nxisin konkurrencën ndërmjet komunave për burimet financiare shtesë, por edhe për krenarinë dhe lavdinë e të qenit ndër komunat me pikët më të larta në fushat kyçe të performancës. Publikimi i rezultateve të vlerësimit (dhe diskutimi publik lidhur me analizën e rezultateve të vlerësimit) është një aspekt i rëndësishëm i grantit të performancës komunale.

Mënyra e kalkulimit të Grantit dhe të gjitha qështjet e tjera rregullohen me Rregullat e Grantit të Performancës Komunale, të cilat azhurnohen për secilin vit të vlerësimit.

## **Shtojca 1: Rregullorja Nr. 01 / 2020 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemës së grantit të performances komunale**

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (QRK) - NR. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (shtojca 13), si dhe nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011 (GZ Nr. 15, 12.09.2011), ministri

Nxjerr:

**RREGULLORE Nr. 01/ 2020 PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS SË KOMUNAVE DHE SKEMËS SË GRANTIT TË PERFORMANCES KOMUNALE**

### **KAPITULLI - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

1.1 Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i parimeve, rregullave, procedurave dhe standardeve për sistemin e performancës së komunave dhe funksionimit të skemës së grantit për performancën komunale.

1.2. Me këtë rregullore përcaktohet:

1.2.1 Ngritja dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit të performancës komunale;

1.2.2 Hapat për planifikim, koordinim, raportim, verifikim dhe publikim të rezultateve të performancës komunale;

1.2.3. Strukturat përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror për menaxhimin e sistemit të performancës komunale;

1.2.4. Udhëzimet referuese në dokumentet profesionale të sistemit të menaxhimit të performancës komunale;

1.2.5. Përbajtja e sistemit të cilësisë dhe për procesin e verifikimit të të dhënave të performancës komunale;

1.2.6. Zhvillimi dhe funksionimi i skemës së grantit të performancës komunale.

1.2.7. Përcatimi i procedurave për ndryshimin e SPMK-ës.

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Kjo Rregullore është e aplikueshme për matjen e performancës së komunave në ushtrimin e kompetencave vetanake sipas Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale, që zbatohet nga institucionet e nivelit lokal dhe ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe për funksionimin e skemës së Grantit për Performancë Komunale.

#### **Neni 3**

##### **Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

3.1. Ministria - nënkupton Ministrinë e Pushtetit Lokal.

3.2. Performancë komunale – nënkupton nivelin e arritjeve të komunave në kuadër të një apo më shumë fushave të kompetencave të tyre, si rezultat i një procesi standard të mbledhjes, analizimit, përpunimit dhe të raportimit të të dhënave.

3.3. Sistemi i menaxhimit të performancës komunale (SMPK) - nënkupton një instrument për vlerësimin e performancës së komunave bazuar në fusha, rezultate dhe tregues dhe të dhëna.

3.4. Dokumenti kryesor i SMPK-së - nënkupton dokumentin që përshkruan konceptet themelore të ndërtimit dhe funksionimit të SMPK-së, hapat dhe procesin e matjes së performancës komunale, përmbajtjen e fushave, rezultateve dhe treguesve të performancës, si dhe dokumentet tjera përcjellëse për zbatimin e SMPK-së.

3.5. Zyrtar komunal për raportim të performancës - nënkupton zyrtarin e komunës i cili caktohet nga kryetari i komunës, përgjegjës për grumbullimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave zyrtare të komunës, të përcaktuara me SMPK, për matjen e performancës së komunës përkatëse.

3.6. Koordinator komunal për performancë - nënkupton zyrtarin publik të komunës përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të aktiviteteve rreth menaxhimit të sistemit të performancës komunale në komunë.

3.7. Njësia përgjegjëse në ministri – nënkupton departamentin apo njësinë përgjegjëse për performancë komunale.

3.8. Granti i performancës komunale (GPK)– instrument financiar me karakter stimulues që u ndahet komunave në baza periodike, bazuar në kriteret e veçanta në raport me performancën e arritur.

3.9. Rregullat e grantit për performancës komunale – nënkupton sistemin e rregullave të veçanta të aprovuara nga ministria dhe kontributdhënësit, me të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e vlerësimit të komunave për qëllim të përfitimit nga skema e grantit për performancë komunale.

3.10. Sistemi elektornik i menaxhimit të performancës komunale (SEMPK) - nënkupton sistemin kompjuterik i cili mundëson lidhjen në mes të komunave dhe ministrisë për qëllim të komunikimit, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave.

3.11. Përdoruesit e SEMPK-së – nënkuptojnë personat e autorizuar të cilët kanë qasje në SEMPK sipas niveleve të autorizimit të përcaktuar me nenin 27 të kësaj rregullore.

3.12. Kontributdhënës të grantit – nënkupton subjektet publike apo jopublike të cilët ofrojnë mbështetje financiare për komunat përmes skemës së grantit për performancë komunale.

3.13. Cilësia e të dhënave – do të thotë se të dhënat e raportuara nga komunat janë të sakta, të vërteta, të mbështetura me fakte dhe dokumente zyrtare, të cilat dëshmojnë një proces, ngjarje, veprim apo punë konkrete, duke ofruar pasqyrë reale të performancës komunale.

3.14. Palë e interesit – ministritë, komunat, kontributdhënësit, shoqëria civile dhe qytetarët.

#### **Neni 4**

##### **Parimet**

4.1. Sistemi i menaxhimit të performancës komunale bazohet në këto parime:

4.1.1. Parimi i ligjshmërisë - organet përgjegjëse veprojnë në pajtim me rregullat e legjislacionit të zbatueshëm për matjen e performancës komunale.

4.1.2. Parimi i transparencës – nënkupton qasjen e hapur për qytetarët dhe palët e tjera të interesit në informatat lidhur me performancën komunale,

4.1.3. Parimi i subsidiaritetit –matja e performancës shtrihet për aq sa është e mundur tek ofruesit më të afërt të shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe ndikimi i grantit reflekton interesat dhe nevojat e qytetarëve të komunës.

4.1.4. Parimi i meritës –niveli i performancës së arritur ndikon në rradhitjen e komunave sipas rezultateve të treguara në ushtrimin e kompetencave në fushat e matura. Granti i performancës komunale merr parasysh nivelin e performancës së arritur të komunave.

4.1.5. Parimi i efikasitetit dhe efektivitetit - organet përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror sigurojnë zbatimin e thjeshtë dhe ekonomik, në kohë të arsyeshme dhe mënyrë profesionale të rregullave dhe procedurave administrative për matjen e performancës komunale, si dhe funksionimin e grantit të performancës komunale.

4.1.6 Parimi i vlefshmërisë –organet përgjegjëse krijojnë mekanizmat e nevojshëm profesional, administrativ dhe ligjor për të matë atë që synohet të mate dhe jo diçka tjetër.

4.1.7. Parimi i barazisë - ë në kontekst të SMPK-së dhe grantit të performancës komunale, komunat nuk diskriminohen në bazë të karakteristikave gjeografike dhe demografike apo strukturës etnike të popullatës.

4.1.8. Parimi i zbatueshmërisë –n sistemi përcakton në mënyrë të qartë objektin dhe mënyrën e matjes, si dhe përgjegjësitë për matje me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në komuna.

## KAPITULLI II – SISTEMI I MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE

### Neni 5

#### Elementet përbërëse të SMPK-së

1. SPMK formohet dhe funksionon sipas elementeve përbërëse të bazuara në këtë strukturë hierarkike: fushë, rezultat, tregues dhe të dhëna;

1.1. Fushat - shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore.

1.2. Rezultatet - tregojnë se shërbimet janë ofruar në sasinë apo cilësinë përkatëse të planifikuar, mbi bazën e kapaciteteve që ka komuna apo kriterëve përkatëse të vendosura paraprakisht. Rezultati poashtu tregon se organet komunale kanë përmbushur standardet ligjore të qeverisje.

1.3. Treguesit - Përfaqësojnë bazën kryesore llogaritëse për shkallën e arritjes së rezultateve.

1.4. Të dhënat – Janë parametra që korospondojnë me fakte apo statistika që shërbejnë për llogaritjen e treguesit.

2. Ndryshimet në përkufizime, shtim apo largim të fushës, rezultatit, treguesit apo të dhënave, i nënshtrohen procesit formal për ndryshim të SMPK-së sipas kapitullit VI të kësaj Rregulloreje.

## KAPITULLI III

### PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE

#### Neni 6

#### Përgjegjësitë e ministrisë

1. Ministria është institucion përgjegjës për menaxhimin e SMPK-së dhe Grantit për Performancë Komunale.

2. Në funksion të zbatimit të kësaj rregullore, ministria siguron:

2.1. Ndërtimin e kapaciteteve të mjaftueshme për menaxhimin e SMPK-së dhe grantit për performacë komunale, përmes njësisë së veçantë organizative përgjegjëse për performancë;

2.2. Hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave për matjen e performancës komunale;

2.3. Hartimin dhe përditësimin e dokumentit kryesor të SMPK-së dhe instrumenteve përcjellëse profesionale në konsultim me komunat dhe palët e tjera të interesit;

- 2.4. Funksionimin e SMPK-së duke përfshirë procedurën e mbledhjes, përpunimit, verifikimit dhe raportimit të të dhënave, periudhën e raportimit dhe linjat e llogaridhënies gjatë procesit të raportimit dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave;
- 2.5. Lehtësimin e ushtrimit të roleve dhe përgjegjësi të secilit organ përgjegjës për funksionimin e SMPK-së në pajtim me këtë Rregullore
- 2.6. Definimin e saktë të fushave, rezultateve dhe treguesëve të SMPK-së, duke mundësuar që të jenë të matshëm, relevant, të definuar mirë, të krahasueshëm dhe që masin përpjekjen e vet komunës në ofrimin e shërbimeve për qytetarë;
- 2.7. Zbatimin e procedurave për ndryshimin e SMPK-së;
- 2.8. Administrimin e sistemit të performancës komunale dhe sistemit informativ, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për administratë publike dhe në koordinim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit;
- 2.9. Monitorimin dhe përkrahjen e komunave në zbatimin e SMPK-së;
- 2.10. Përpunimin e të dhënave dhe informatave për performancën e komunave dhe publikimin e raportit të performancës;
- 2.11. Sigurimin e zbatimit të rregullave të grantit për performancë komunale dhe ridefinimin e politikave të grantit në konsultim me komunat dhe kontributdhënësit, në pajtim me këtë rregullore;
- 2.12. Pranimin dhe shqyrtimin e ankesave dhe interpretimin e çështjeve të tjera lidhur me SMPK-në dhe menaxhimin e grantit për performancë komunale;
- 2.13. Koordinimin dhe bashkëpunimin me komuna dhe partnerë të tjerë të interesuar për funksionimin e SMPK-së dhe kontributdhënësit në grantin e performancës komunale.

## **Neni 7**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e komunës**

1. Komuna është përgjegjëse për krijimin e kushteve për funksionimin efikas të SMPK-së.
2. Me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, komuna siguron:
  - 2.1. Bashkëpunim me ministrinë për qëllim të ndërtimit, zhvillimit dhe zbatimit të SMPK-së;
  - 2.2. Mbledhjen e të dhënave për performancën e komunës për treguesit sipas fushave të përcaktuara në dokumentin kryesor të SMPK-së;
  - 2.3. Verifikimin dhe miratimin e të dhënave për performancën e komunës;
  - 2.4. Raportimin e të dhënave të miratuara në ministri sipas afateve me këtë rregullore;
  - 2.5. Publikimin e raportit të performancës në faqen zyrtare të komunës;
  - 2.6. Prezantimin e raportit vjetor të performancës dhe diskutimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës;
  - 2.7. Adresimin e rekomandimeve të raportit të performancës për përmirësimin e shërbimeve përkatëse për qytetarët dhe sigurimin e qeverisjes së mirë;
3. Kryetari i komunës është instanca më e lartë vendimmarrëse për SMPK në nivel lokal, përgjegjës për:
  - 3.1. Caktimin e koordinatorit komunal për performancë;
  - 3.2. Në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive koordinon caktimin e zyrtarëve komunal për raportim të performancës;
  - 3.3. Miratimin e tërësisë së të dhënave për performancën komunale, para raportimit në ministri;

4. Caktimi i koordinatorit komunal për performancë dhe zyrtarëve përgjegjës për raportim bëhet me vendim të kryetarit të komunës dhe dërgohet në ministri.

#### **Neni 8**

##### **Kriteret për caktimin e koordinatorit komunal për performancë**

1. Kryetari i komunës duhet të marr për bazë përgjegjësinë, kompleksitetin, shkathtësitë, kualifikimet dhe përvojën profesionale me rastin e caktimit të koordinatorit për performancë.
2. Koordinatori duhet të jetë person me integritet të lartë dhe me kompetencë profesionale në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi për koordinimin e procesit të matjes së performancës në komunë.
3. Mandati i koordinatorit caktohet në vendim të kryetarit të komunës.

#### **KAPITULLI IV – MATJA E PERFORMANCËS KOMUNALE**

#### **Neni 9**

##### **Procesi i matjes së performancës**

1. Matja e performancës organizohet në baza të rregullta vjetore nga ministria;
2. Ministria dhe komuna sigurojnë resurset e nevojshme për zbatimin e procesit të matjes së performancës, përmes strukturave përgjegjëse për performancë komunale.

#### **Neni 10**

##### **Fillimi i procesit të matjes së performancës**

1. Procesi i matjes së performancës fillon me dërgimin e kërkesës për raportim në komunë nga ministria.
2. Kërkesa për raportim nënshkruhet nga sekretari i ministrisë dhe i dërgohet kryetarit të komunës dhe koordinatorit për performancë komunale.
3. Kërkesa për raportim dërgohet në komunë të paktën 7 (shtatë) ditë para rrjedhjes së afatit për raportimi.
4. Njësia përgjegjëse në ministri koordinon procesin e matjes së performancës, përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për raportim, njoftimin paraprak të komunave, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve të tjera administrative, teknike dhe profesionale.

#### **Neni 11**

##### **Menaxhimi i procesit të matjes së performancës në komunë**

1. Koordinatori komunal për performancë bashkërendon aktivitetet me njësitë e tjera organizative në nivel komunal për mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe raportimin e të dhënave të performancës komunale;
2. Mbledhja e të dhënave bëhet nga zyrtari komunal për raportim të performancës, sipas përgjegjësi të ngarkuara në kuadër të fushave të matjes së performancës;
3. Për fushat specifike të matjes, zyrtari komunal për raportim të performancës dhe koordinatori për performancë, kanë autorizime për të kërkuar informata rreth performancës në të gjitha institucionet të cilat janë nën menaxhim të komunës;
4. Në rast të paqartësive të shfaqura gjatë procesit të raportimit, komuna duhet të konsultohet me njësinë përgjegjëse për performancë në ministri.

#### **Neni 12**

##### **Procesi dhe mënyra e raportimit**

1. Koordinatori njofton zyrtarët komunal për raportim të performancës me të dhënat e nevojshme për procesin e matjes së performancës;
2. Zyrtari komunal për raportim të performancës bën raportimin e të dhënave te koordinatori, pas verifikimit për saktësinë e tyre. Të dhënat duhet të janë të dokumentuara dhe të japin fakte të mjaftueshme

për objektivitetin e tyre. Formulari me të dhënat e raportuara duhet të nënshkruhet, apo të autorizohet përmes sistemit elektronik për të vërtetuar aprovimin nga zyrtari komunal për raportim të performancës.

3. Koordinatori bënë verifikimin dhe përmbledhjen përfundimtare të të dhënave të raportuara dhe pas nënshkrimit apo autorizimit elektronik, i dërgon për aprovim tek kryetari i komunës;
4. Kryetari i komunës autorizon raportimin e të dhënave për performancën e komunës në ministri;
5. Mosaprovimi i të dhënave dhe mosdhënia e autorizimit nga kryetari, ka për pasojë shpalljen e tyre të pavlefshme nga ministria;
6. Të dhënat e performancës raportohen nga komuna në sistemin elektronik sipas nenit 25 dhe 26 të kësaj rregulloreje.
7. Në rastet e mosfunksionimit të sistemit elektronik, raportimi bëhet në formularë fizik. Në raste të tilla, zhvillohen procedura të njëjta administrative për menaxhimin e të dhënave si në formën elektronike.

### **Neni 13**

#### **Afati për raportim nga komuna**

1. Afati i raportimit të të dhënave të performancës nga komuna është 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike, nga momenti i pranimit të kërkesës për raportim nga ministria.
2. Në raste të veçanta, afati për raportim mund të zgjatet me vendim të posaçëm nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e përfundimit të afatit të rregullt;
3. Tejkalimi i afatit të përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përbën kusht për mbylljen e sistemit elektronik apo mospranimin e të dhënave të raportuara në formë fizike.

### **Neni 14**

#### **Menaxhimi i procesit të vlerësimit të performancës në ministri**

1. Njësia përgjegjëse për performancë komunale pranon të dhënat e performancës të dërguara nga komuna;
2. Njësia përgjegjëse për performancë siguron se janë përmbushur të gjitha kriteret për pranimin e të dhënave të raportuara nga komunat, përkatësisht:
  - 2.1. Raportimi është bërë me kohës sipas afatit të përcaktuar në kërkesën për raportim të ministrisë sipas kësaj rregulloreje;
  - 2.2. Janë respektuar kriteret për raportim përfshirë: nënshkrimet apo autorizimet e zyrtarit komunal për raportim të performancës, koordinatot për performancë dhe kryetarit të komunë;
  - 2.3. Të dhënat e raportuara përmbajnë kriteret e kërkuara të cilësisë, përkatësisht: dokumentimin, vërtetësinë, saktësinë, si dhe kritereve të tjera të përcaktuara në nenin 16 të kësaj rregulloreje.
3. Njësia përgjegjëse në ministri bën përpunimin, analizën, verifikimin e të dhënave dhe hartimin e raportit të performancës komunale.

## **KAPITULLI**

### **SIGURIMI I CILËSISË SË TË DHËNAVE TË RAPORTUARA**

### **Neni 15**

#### **Procesi i sigurimit të cilësisë së raportimit**

1. Sigurimi i cilësisë mbështetet në procesin e verifikimit i cili mundëson krahasimin e të dhënave të raportuara me dokumentet ose faktet që dëshmojnë vërtetësinë;



2. Sigurimi i cilësisë bëhet sipas procedurave të parapara në këtë rregullore si dhe në dokumentin kryesor të SMPK-së.

3. Koordinatorët e performancës komunale dhe Njësia përgjegjëse për performancë në ministri, sigurojnë se janë përmbushur kriteret e verifikimit sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 16**

##### **Kriteret dhe procedurat e verifikimit të të dhënave**

1. Verifikimi është proces që siguron saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të raportuara.
2. Procedurat e verifikimit zbatohen për të siguruar përmbushjen e kritereve të cilësisë së të dhënave, si vijon:
  - 2.1. Kontrollimin nëse të dhënat e raportuara janë të plota, përkatësisht nëse formulari është i plotësuar në tërësi dhe përfshinë të dhënat për të gjithë treguesit;
  - 2.2. Pastrimin e të dhënave me qëllim të eliminimit të gabimeve teknike dhe logjike, duke siguruar që:
    - 2.2.1. Vlerat e të dhënave të raportuara janë të shënuara në formularë, në hapësirat përkatëse në mënyrë të drejtë;
    - 2.2.2. Treguesit japin vlerën e saktë të performancës;
    - 2.2.3. Vlerat e të dhënave të raportuara korrespondojnë me vlerat burimore sipas dokumenteve referente – dëshmime.
  - 2.3. Identifikimin nëse të dhënat e raportuara janë të dokumentuara përmes dokumenteve apo burimeve zyrtare sipas kërkesave teknike ku përfshihen:
    - 2.3.1. Emri i dokumentit;
    - 2.3.2. Numri i protokolit (nëse kërkohet);
    - 2.3.3. Datën e aprovimit;
    - 2.3.4. Vulën e komunës apo institucionit komunal;
    - 2.3.5. Nënshkrimin e organit vendimmarrës;
    - 2.3.6. Vegzën (linkun) e publikimit të dokumentit.

#### **Neni 17**

##### **Organet përgjegjëse për verifikim në komunë**

1. Në nivel lokal, koordinatori për performancë është përgjegjës për zbatimin e kritereve për verifikimin e të dhënave.
2. Koordinatori për performancë bashkëpunon me ministrinë në procesin e sigurimit të cilësisë, me qëllim të ofrimit të dokumenteve zyrtare të cilat kërkohen nga ministria gjatë procesit të verifikimit.
3. Zyrtari komunal për raportim të performancës, gjatë procesit të raportimit kontribon në verifikimin e të dhënave në nivelin e komunës, duke ofruar dokumentet zyrtare tek koordinatori komunal i performancës.
4. Me rastin e raportimit, koordinatori për performancë bashkëngjet formularin e plotësuar dhe nënshkruar për verifikim të të dhënave.
5. Kryetari i komunës siguron se janë përmbushur të gjitha kriteret për sigurinë e cilësisë së të dhënave.

#### **Neni 18**

## Krijimi i dosjes së verifikimit

1. Komuna siguron se të dhënat e raportuara për të gjitha fushat janë të arkivuara në një dosje të veçantë me dokumentet përcjellëse.
2. Komuna sistemon dosjen e verifikimit (dokumentet, vegzat-linqet e dokumenteve) nëpër treguesit e fushave përmes SEMPK-së.

### Neni 19

#### Organet përgjegjëse për verifikim në ministri

1. Verifikimi i të dhënave të performancës është përgjegjësi e njësisë përgjegjëse për performancë komunale.
2. Sekretari i përgjithshëm është autoriteti kryesor në nivel të ministrisë që siguron mbarëvajtjen procesit e zbatimit të rregullave për vlerësimin e performancës.

### Neni 20

#### Procesi i verifikimit në ministri

1. Verifikimi realizohet pas raportimit të komunave dhe duhet të përfundoj para procedurës së konsultimit paraprak.
2. Njësia përgjegjëse për performancë në ministri harton raportin për procesin e verifikimit të të dhënave, i cili aprovet nga sekretari i përgjithshëm së bashku me raportin përfundimtar të performancës.
3. Forma të tjera shtesë të verifikimit mund të aplikohen në pajtim me dokumentin e metodologjisë së verifikimit i cili hartohet nga ministria si pjesë e Dokumentit kryesor të SMPK-së.
4. Njësia përgjegjëse në ministri gjatë menaxhimit të procesit të vlerësimit të performancës, mund të përmirësoj të dhënat e raportuara të komunave, në rast se gjatë fazës së verifikimit konstatohen gabime teknike dhe për të cilat komuna ofron dëshmi zyrtare që dëshmojnë se vlerat e të dhënave janë në pajtim me konstatimet e nxjerra gjatë procesit të verifikimit.
5. Komunikimi i ndryshimeve të të dhënave sipas paragrafit 4 të këtij neni bëhet gjatë fazës së konsultimit paraprak të paraparë me nenin 23 të kësaj rregullore.

### Neni 21

#### Kategorizimi i komunave sipas shkallës së gabimeve

1. Në rastet kur komunat nuk i përmbahen kriterëve të cilësisë, përkatësisht kur të dhënat e raportuara nga komunat nuk korespondojnë me vlerat burimore sipas dokumenteve zyrtare, ministria do të zbatoj masa administrative-materiale sipas kriterëve në vijim:
  - 1.1. Komuna ka për pasojë nënrenditjen – Ky kriter zbatohet në rastet kur të dhënat e raportuara të performancës shfaqin nivel të pasaktësisë deri në 10%. Rezultatet e treguesëve për të cilët janë identifikuar vlera të pasakta do të shpallen të pavlefshme dhe me të kenë për pasojë nënrenditjen.
  - 1.2. Komuna ka për pasojë renditjen në vendin e fundit – Ky kriter zbatohet në rastet kur të dhënat e raportuara nga komuna shfaqin nivel të pasaktësisë prej 10% e më tepër.

### Neni 22

#### Pavlefshmëria e të dhënave

1. Të dhënat të cilat nuk i përmbushin kriteret e cilësisë konsiderohen si të dhëna të pavlefshme.
2. Në rast se procesi i verifikimit identifikon tregues me të dhëna të padokumentuara, për këta tregues komunave do t'iu ndahet vlera zero e rezultatit. I njëjti vlerësim do të nënkuptohet në kontekst të Grantit të Performancës Komunale.
3. Në rast se gjatë procesit të verifikimit vërtetohet se një komunë ka raportuar të dhëna të pasakta që rezulton në performancë më të lartë, performanca e asaj komune në fushën për të cilën të dhënat janë të pasakta, shpallet e pavlefshme.

### **Neni 23**

#### **Konsultimi paraprak dhe e drejta për ankesë**

1. Para përfundimit të raportit të performancës, njësia përgjegjëse për performancë në ministri dërgon të dhënat e përpunuara te secila komunë veç e veç;
2. Brenda afatit prej 7 ditë nga dorëzimi i të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna ka të drejtën e ofrimit të vërejtjeve ose parashtrimit të ankesës rreth rezultateve të performancës;
3. Ankesa shqyrtohet nga komisioni i ankesave, i themeluar me vendim të veçantë nga sekretari i përgjithshëm. Komisioni përbëhet prej 5 (pesë) antarëve, prej të cilëve 3 (tre) nga ministria me të drejtë vote dhe 2 (dy) nga shoqëria civile apo donatorët pa të drejtë vote.
4. Komisioni i ankesave brenda 15 ditësh nxjerr vendim në lidhje me ankesën e komunës, si dhe ofron përgjigjet në pyetjet dhe vërejtjeve e parashtruara nga komunat veç e veç.

### **Neni 24**

#### **Aprovimi dhe publikimi i raportit të performancës komunale**

1. Pas përfundimit të procesit të ankesave, njësia përgjegjëse e harton raportin përfundimtar të performancës komunale;
2. Raporti i performancës komunale aprovohet me vendim të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë;
3. Raporti vjetor i performancës publikohet jo më vonë se muaji maj i vitit vijues, përveç rasteve të veçanta kur për shkaqe të arsyeshme lejohet shtyerja e publikimit sipas vendimit të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë.
4. Raporti publikohet në ueb-faqen zyrtare të ministrisë dhe të komunave në gjuhët zyrtare.

### **NËNKAPITULLI 1 -**

#### **SISTEMI ELEKTRONIK I PERFORMANCËS KOMUNALE**

### **Neni 25**

#### **Raportimi përmes sistemit elektronik**

1. Komunat raportojnë të dhënat për performancë përmes sistemit elektronik të SMPK-së;
2. Raportimi i të dhënave prej komunave në ministri mund të bëhet përmes platformave të tjera vetëm kur kjo lejohet me shkrim nga ministria;
1. Ndryshimet e të dhënave të raportuara në sistem nuk lejohen pas skadimit të afateve të përcaktuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 26**

#### **Shërbimet e sistemit elektronik**

1. Sistemi elektronik i SMPK-së mundëson procesimin e veprimeve si vijon:

- 1.1. Regjistrimin dhe hapjen e llogarive sipas niveleve të të drejtave të shfrytëzuesve;
  - 1.2. Regjistrimin e datës së raportimit dhe cilit do veprim tjetër në sistem nga përdoruesit;
  - 1.3. Regjistrimin e shënimeve për dokumentet e evidentuara si dëshmi për tregues, që mundëson ngarkimin e materialeve dhe vegëzave (linqeve) për dokumentet referente;
  - 1.4. Autorizimin e të dhënave të regjistruara në sistem pas verifikimit nga koordinatori i performancës;
  - 1.5. Autorizimin e të dhënave të regjistruara në sistem pas verifikimit nga kryetari i komunës;
  - 1.6. Dërgimin e të dhënave në ministri pas autorizimit nga ana e koordinatorit të performancës dhe autorizimin nga kryetari i komunës;
  - 1.7. Ndryshimin e të dhënave të raportuara përmes procedurës së regjistrimit të dëshmisë të aktit për ndryshim;
  - 1.8. Konfigurimin e formulave për llogaritjen e vlerave të treguesve, pa nevojë për ndryshim në strukturën e programit kompjuterik;
  - 1.9. Përgatitjen automatike të grafikoneve të performancës prej të dhënave të raportuara nga komunat;
  - 1.10. Ruajtjen e të dhënave të raportuara të performancës, si dhe raportet e prodhuara për shumë cikle të raportimit.
2. Sistemi elektronik duhet t'i përshtatet specifikave të rishikimit të SMPK-së, konform nenit 45 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 27**

### **Autorizimet e përdoruesve**

1. Përgjegjës për menaxhimin e autorizimeve në sistemin informativ është njësia përgjegjëse për menaxhimin e performancës komunale;
2. Autorizimet për qasje në sistem informativ nga ana e përdoruesve janë të kufizuara sipas niveleve;
3. Autorizimet për përdoruesit e sistemit elektronik janë të kategorizuara në 5 nivele:
  - 3.1. Niveli parë i autorizimit nuk ka kufizime dhe i takon përdoruesve në ministri, të autorizuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm;
  - 3.2. Niveli i dytë i autorizimit i ka të gjitha të drejtat përveç të drejtës për ndryshime në konfigurim të sistemit dhe i takon përdoruesve në njësinë përgjegjëse për menaxhimin e performancës komunale të cilët e shfrytëzojnë sistemin në baza të rregullta;
  - 3.3. Niveli i tretë i autorizimit ka të drejtë për regjistrimin, leximin, autorizimin dhe ndryshimin e shënimeve dhe i takon kryetarit të komunës dhe koordinatorit komunal për performancë komunale;
  - 3.4. Niveli i katërt ka të drejtë për regjistrimin dhe leximin e shënimeve dhe i takon zyrtarëve komunal për raportim të performancës;
  - 3.5. Niveli i pestë, ka qasje të limituar në sistem, që i jep të drejtën shoqërisë civile për leximin e të dhënave. Kjo qasje krijohet sipas autorizimit të lejuar nga ministria në pajtim me ligjin për qasje në dokumentet publike. Në autorizim duhet të përfshihet deklarata e konfidencialitetit që siguron përdorimin e të dhënave vetëm mbi bazën e autorizimit.
  - 3.6. Niveli 6 – qasje e hapur për të gjithë qytetarët në të dhënat e performancës

## **KAPITULLIV – SKEMA E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE**

### **Neni 28**

#### **Pronësia e grantit të performancës komunale**

1. Ministria është insitucion përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e grantit të performancës komunale;
2. Ministria, në bashkëpunim me kontributdhënësit, përcakton politikat zhvillimore të grantit të performancës komunale, si dhe nxjerr rregullat e veçanta për funksionimin dhe zbatimin e grantit;
3. Granti i performancës komunale është sistem i hapur për kontributdhënësit të cilët e bashkëfinancojnë grantin sipas rregullave të grantit.

#### **Neni 29**

##### **Qëllimi i grantit**

Granti ofrohet në formë të përkrahjes financiare për komunat dhe ka për qëllim stimulimin e tyre që të përmirësojnë performancën në fusha të caktuara.

#### **Neni 30**

##### **Planifikimi buxhetor i grantit**

Granti i performancës komunale planifikohet në Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin vijues dhe në projeksionet afatmesme buxhetore.

#### **Neni 31**

##### **Qasja në grant**

1. Të gjitha komunat kanë të drejtë për pjesëmarrje në grantin e performancës komunale;
2. E drejta për qasje në grant fitohet përmes plotësimit të kushteve minimale të përcaktuara në rregullat e grantit;
3. Të gjitha komunat që plotësojnë kushtet minimale arrijnë të përfitojnë lartësinë e caktuar të grantit, në pajtim me pikët relative të arritura të performancës komunale dhe kritereve të tjera të formulës së alokimit të përcaktuar në rregullat e grantit.

#### **Neni 32**

##### **Burimi i të dhënave**

1. Burim kryesor i të dhënave për grantin e performancës komunale është Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale;
2. Granti mund të shfrytëzojë edhe burime të tjera shtesë të të dhënave zyrtare, në rast se SMPK nuk mund të ofroj të dhëna të tilla.

#### **Neni 33**

##### **Hartimi i rregullave të grantit dhe autorizimi për zbatim**

1. Rregullat e grantit hartohen dhe miratohen nga ministria në bashkëpunim me kontributdhënësit.
2. Procedurat e hartimit apo ndryshimit, afatet, përbërja e grupeve përgjegjëse punuese dhe çështje të tjera përcaktohen me vendim të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë, pas konsultimit me kontributdhënësit.
3. Rregullat e grantit përcaktojnë parametrat dizajnuar të grantit, procesin e vlerësimit të performancës së komunave për grant si dhe japin udhëzime të nevojshme për vlerësim.
4. Parametrat e grantit përfshijnë përcaktimin e objektivave të grantit, kushteve minimale, sistemin e treguesëve që mund të aplikohen në ciklet e vlerësimit, vlerat e grantit, kushteve të shfrytëzimit dhe

aspektet e sigurimit të cilësisë së menaxhimit të grantit, si dhe çështje të tjera të mbikëqyrjes në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Zbatimi i Rregullave të grantit autorizohet para çdo cikli të vlerësimit nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë dhe kontributdhënësit e grantit.

6. Rregullat e autorizuara u shpërndahen komunave dhe publikohen ne ueb-faqen e ministrisë.

#### **Neni 34**

##### **Ciklet e menaxhimit të grantit**

1. Periudha e vlerësimit për grantin e performancës ndahet në 3 faza kryesore, e të cilat ndahen sipas:

1.1. Periudhës së performancës - që nënkupton vitin për të cilin vlerësohet performanca e komunës;

1.2. Periudhës së vlerësimit – që nënkupton periudhën në të cilën kryhet vlerësimi i performancës, apo vitin aktual në të cilin shpallen rezultatet e vlerësimit për grant;

1.3. Periudhës së ndarjes dhe shfrytëzimit të grantit - nënkupton vitin pasues nga periudha e vlerësimit, në të cilin granti vihet në dispozicion për shfrytëzim nga komunat.

#### **Neni 35**

##### **Organet përgjegjëse për menaxhim të grantit**

1. Grupi teknik dhe komisioni i grantit janë organet përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës komunale, të themeluara me vendim të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë;

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e organeve përgjegjëse për menaxhim të grantit përcaktohen në rregullat e grantit për performancë komunale.

#### **Neni 36**

##### **Përbërja e Grupit Teknik dhe Komisionit të Grantit**

1. Grupi teknik është organ i nivelit profesional i përbërë nga zyrtarë publik të njësisë përgjegjëse për performancë komunale.

2. Përfaqësuesit e subjekteve kontributdhënëse mund të jenë poashtu pjesë e grupit teknik.

3. Komisioni i grantit të performancës komunale është organi më i lartë vendimmarrës për grant, i cili themelohet me vendim të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë.

4. Komisioni i grantit të performancës komunale themelohet për një afat të pacaktuar. Ky komision përbëhet nga 3 (tre) anëtarë me të drejtë vote, nga të cilët:

4.1. Sekretari i përgjithshëm i ministrisë, kryesues i grupit;

4.2. Një (1) zyrtar publik i nivelit drejtues të ministrisë;

4.3. Një (1) zyrtar publik nga ministria përgjegjëse për financa.

5. Anëtarë të komisionit nuk mund të jenë zyrtarë të përfshirë në të njëjtën kohë në grupin teknik dhe komisionin e ankesave.

6. Në rast të paraqitjes së rrethanave që pamundësojnë ushtrimin e funksionit të Kryesuesit të Komisionit të GPK-së, ky funksion mund të ushtrohet nga një zyrtar tjetër publik i nivelit drejtues nga ministria i autorizuar nga sekretari i përgjithshëm.

7. Në komisionin e grantit të performancës komunale mund të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve përfaqësues nga subjektet kontributdhënëse në grant dhe shoqëria civile.

#### **Neni 37**

##### **Procedurat e vlerësimit të performancës për grant**

1. Grupi teknik e bën vlerësimin e performancës së komunave në bazë të rregullave të autorizuara të grantit, duke përfshirë:

1.1. Zbatimin e standardeve të vlerësimit dhe llogaritjes së performancës siç përcaktohet në rregullat e grantit;

1.2. Llogaritjen e shumës së grantit sipas formulës së përcaktuar në rregullat e grantit.

2. Grupi teknik e harton raportin e vlerësimit për grant dhe adreson atë për aprovim në Komisionin e grantit të performancës komunale.

#### **Neni 38**

##### **Miratimi i rezultateve të vlerësimit**

1. Komisioni i grantit të performancës komunale merr vendim për miratimin e rezultateve të vlerësimit të performancës për grant.

2. Komisioni i grantit mbikëqyrë procesin dhe siguron që grupi teknik ka ndjekur kriteret dhe procedurat e vlerësimit të përcaktuara në rregullat e grantit.

3. Në rast të konstatimit të parregullsive, Komisioni mund të kthejë në rishqyrtim procesin e vlerësimit.

4. Komisioni i grantit nuk mund të ndryshojë rezultatet e vlerësimit dhe shumën e grantit, pa aplikimin e tërësishëm të procesit të vlerësimit në pajtim me rregullat e grantit.

#### **Neni 39**

##### **Komunikimi i rezultateve tek komunat**

1. Ministria e njofton komunën për rezultatin e vlerësimit të grantit të performancës për atë komunë përkatëse.

2. Fletëvlerësimi i dërgohet komunës në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga momenti i miratimit të rezultateve të vlerësimit nga Komisioni i grantit të performancës komunale.

#### **Neni 40**

##### **Procedura e ankesave për ndarjen e grantit të performancës**

1. Komunat mund të ushtrojnë ankesë kundër vendimit për vlerësimin e grantit të performancës në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga momenti i pranimit të fletëvlerësimit nga ministria.

2. Ankesa nuk mund të kundërshtojë burimin e të dhënave zyrtare të përdorura gjatë vlerësimit.

3. Shqyrtimi i ankesave për grant bëhet nga komisioni i ankesave, i themeluar me vendim të skretarit të përgjithshëm të ministrisë.

4. Komisioni i ankesave themelohet për një afat të pacaktuar dhe përbëhet nga 3 anëtarëve, 2 nga ministria dhe 1 përfaqësues i jashtëm. Anëtarët e komisionit të grantit apo grupit teknik, nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të ankesave.

5. Komisioni i ankesave merr vendim lidhur me ankesën e parashtruar në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga mbyllja e afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

#### **Neni 41**

##### **Finalizimi i rezultateve të vlerësimit dhe publikimi**

1. Në rast të ndryshimit të rezultateve të vlerësimit si rezultat i vendimit për ankesë të nxjerrë nga komisioni i ankesave, komisioni i grantit përmes grupit teknik bënë ndryshimet në raportin e vlerësimit dhe njofton komunën përkatëse për rezultatin përfundimtar.
2. Ministria e publikon raportin përfundimtar të vlerësimit të performancës në ueb-faqen e saj.

#### **Neni 42**

##### **Shfrytëzimi i grantit**

1. Shfrytëzimi i grantit i nënshtrohet rregullave të mbikëqyrjes dhe kontrollit konform legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe rregullave të grantit.
2. Granti përdoret për të financuar projekte komunale në dobi të qytetarëve, konform rregullave të grantit.

#### **Neni 43**

##### **Auditimi i grantit**

1. Shpenzimet e grantit i nënshtrohen rregullave të mbikëqyrjes së financave publike dhe mund t'i nënshtrohen auditimeve shtesë.
2. Në rast të konstatimit të shkeljeve dhe parregullsive të evidentuara nga auditimi, ministria dhe kontributdhënësit mund të vendosin për përjashtimin e komunës nga e drejta e përfitimit të grantit për një periudhë të caktuar.

### **KAPITULLI VI - PROCEDURA PËR NDRYSHIMIN E SMPK-së**

#### **Neni 44**

##### **Menaxhimi i ndryshimeve në SMPK**

Procesi i ndryshimeve të SMPK-së, për aq sa nuk cenon dispozitat e kësaj rregulloreje, përcaktohet me Rregulla të veçanta për procedurën e menaxhimit të ndryshimeve të inkorporuara në Dokumentin kryesor të SMPK-së.

#### **Neni 45**

##### **Procedura e ndryshimeve të SMPK-së**

1. Kërkesa për ndryshime mund të inicohet nga ministria, komunat, kontributdhënësit dhe palët e interesit.
2. Inicimi i kërkesës për ndryshime bëhet sipas hapave në vijim:
  - 2.1. Paraqitja e kërkesës për ndryshim - Kërkesa duhet të arsyetohet, të ketë bazë të argumentit me të dhëna faktike dhe të dorëzohet me shkrim në njësinë përgjegjëse për performancë në ministri.
  - 2.2. Shqyrtimi dhe adresimi nga njësia përgjegjëse për performancë - Kërkesa për ndryshim të SMPK-së, shqyrtohet paraprakisht nga njësia përgjegjëse për performancë, e cila përgatit arsyeshmërinë e kërkesës së propozuar. Pas shqyrtimit, kërkesa adresohet te sekretari i përgjithshëm i ministrisë për shqyrtim dhe aprovim.
  - 2.3. Miratimi i kërkesës për ndryshim - Kërkesa për ndryshim aprovohet me vendim të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë. Vendimi nënkupton fillimin e procesit për rishikim të SMPK-së.

#### **Neni 46**

##### **Procedura për ndryshim të SMPK-së**

1. Procedura për ndryshim të SMPK-së fillon sipas vendimit të sekretarit të përgjithshëm të përcaktuar në paragrafin 2.3 të nenit 45 të kësaj rregulloreje.
2. Vendimi për ndryshim përfshinë themelimin dhe përbërjen e grupin përgjegjës për ndryshim të SMPK-së.



3. Grupi përgjegjës për ndryshim udhëhiqet nga ministria, përkatësisht njësia përgjegjëse për performancë dhe përbëhet nga palët e tjera të interesit.

#### **Neni 47**

##### **Konsultimi paraprak dhe përfshirja aktive në procesin e ndryshimeve të SMPK-së**

1. Procesi i ndryshimeve të SMPK-së i nënshtrohet konsultimit me të gjitha palët e tjera të interesit, duke siguruar përfshirje aktive të komunave, kontributdhënësve, shoqërisë civile.
2. Procedurat e ndryshimit të SMPK-së merr për bazë zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik.

#### **Neni 48**

##### **Aprovimi i ndryshimeve të SMPK-së**

1. Miratimi i ndryshimeve në SMPK bëhet me vendim të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë.

#### **Neni 49**

##### **Zbatimi i ndryshimeve të SMPK-së**

Implementimi i ndryshimeve udhëheqet nga njësia përgjegjëse për performancë në ministri.

KAPITULLI VII - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### **Neni 50**

##### **Monitorimi i zbatimit**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e kësaj Rregullore.

#### **Neni 51**

##### **Shfuqizimi**

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 02 / 2017 për Sistemin e Menaxhimit e Performancës së Komunave.

#### **Neni 52**

##### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

## Shtojca 2 – Rolet, detyrat dhe kompetencat e akterëve kryesorë

Burimet njerëzore duhet të rivendosen në numër dhe cilësi të mjaftueshme. Duke qenë se sistemi si tërësi përbëhet prej dy pjesëve kryesore: njësisë lokale dhe asaj qendrore, edhe detyrat e punës janë të ndara dhe kërkojnë numër dhe shkallë të përgatitjes profesionale në përputhje me detyrat e punës. Komuat përcaktojnë numrin dhe profilin e zyrtarëve në përputhje me kriteret e përcaktuara me dokumentet e SMPK. Po ashtu, në përputhje me kërkesat për zbatimin e SMPK, MPL përcakton kriteret bazë për angazhimin e zyrtarëve të saj në menaxhimin e sistemit për matjen e performancës.

Detyrat e punës për administrimin e SMPK në komunë

Puna e administrimit të SMPK kërkon angazhimin e disa zyrtarëve të niveleve të ndryshme të organizimit administrativ në komunë, që secili prej tyre është përgjegjës për detyra të caktuara. Përbushja e këtyre detyrave kërkon bashkërendim të saktë ndërmjet këtyre hallkave të ndryshme organizative për administrim të sukseshëm të SMPK. Detyrat kryesore për administrimin e SMPK në komunë janë:

### **Koordinatori:**

- ◁ Bashkërendon punën e përgjithshme në komunë për administrimin e sistemit për matjen e performancës.
- ◁ Propozon listën e zyrtarëve komunal për performancë (zyrtarëve përgjegjës) për miratim nga kryetari i komunës dhe udhëheqë punën e tyre në procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave (MVR DH).
- ◁ Harton planin e veprimit dhe organizon takime pune me zyrtarët komunal të performancës (ZKP) për metodologjinë e zbatimit të tij për MVRDH në sistem.
- ◁ Monitoron procesin e MVRDH në sistem dhe jep udhëzime profesionale ZKP gjatë MVRDH sipas nevojë.
- ◁ Bashkërendon punën, sipas nevojë, me drejtoritë përkatëse nëpërmjet drejtorit të administratës.
- ◁ Bën verifikimin e të dhënave të raportuara nga ZKP sipas një orari përkatës gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri më 14 shkurt të vitit vijues.
- ◁ Përgatitë të dhënat e verifikuara dhe i dërgon për miratim tek kryetari i komunës nëpërmjet drejtorit të administratës deri më 21 janar të vitit vijues për vitin përkatës të raportimit. Në të njëjtën kohë bën verifikimin e të dhënave, nëpërmjet ZKP, nëse kryetari kërkon për shkak të dyshimeve eventuale në saktësinë e tyre.
- ◁ Sipas nevojë, bën raportimin e të dhënave të miratuara nga kryetari në MPL kur kjo nuk bëhet automatikisht nëpërmjet sistemit.
- ◁ Bën arkivimin e të dhënave të miratuara nga kryetari i komunës në kopje fizike në arkivin e komunës apo në arkivin zyrtarë të KKP. Një kopje e miratuar nga kryetari i komunës i të dhënave, arkivohet në mënyrë automatike nga programi elektronik në bazën e të dhënave në kompjuterin e KKP, të kryetarit të komunës dhe në MPL – zyrtari përgjegjës për menaxhimin e të dhënave në DPK.

### **Zyrtari komunal për performancë**

- ◁ Harton planin për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për fushën përkatëse i ngarkuar nga kryetari i komunës, mbi bazën e kërkesave të KKP.
- ◁ Mbledhë, verifikon dhe raporton apo futë të dhënat në sistem gjatë tërë vitit të raportimit dhe deri më 20 janar të vitit vijues.
- ◁ Kujdeset që para futjes së të dhënave në sistem, ta verifikojë saktësinë e të dhënës duke u bazuar vetëm në burimin zyrtarë të të dhënave përkatëse dhe bazuar në dokumente përfundimtare zyrtare, që d.m.th. në dokumente të miratuara nga organet përgjegjëse të komunës, të protokolluara dhe me datën përkatëse të protokollimit apo të miratimit, varësisht nga lloji i dokumentit zyrtar.
- ◁ Bashkërendon dhe bashkëpunon me përgjegjësit e njësisë përkatëse ku punon dhe prej ku i merr të dhënat dhe me KKP.
- ◁ Raporton të dhënat e verifikuara tek KKP, në kopje fizike, kur kjo nuk bëhet në mënyrë automatike nga programi elektronik i SMPK. Është përgjegjësi kryesor për saktësinë e të dhënave të raportuara në komunë për SMPK.

#### **Kryetari i komunës**

- ◁ Është autoriteti më i lartë ekzekutiv në komunë, i cili emron KKP për bashkërendimin e të gjitha punëve në komunë për administrimin e SMPK.
- ◁ Miraton listën e ZKP të propozuar nga KKP për mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave në sistemin elektronik të SMPK për fushat përkatëse të SMPK.
- ◁ Verifikon të dhënat e dërguara nga KKP. Kryetari i komunës mund të përdorë edhe mekanizma tjerë të brendshëm për verifikimin e të dhënave përpos rrugës nëpërmjet SMPK. Po ashtu, mund të kërkojë nga KKP për hartimin e një raporti të shkurtër analitik për performancën e komunës në vitin përkatës të raportimit.
- ◁ Bën miratimin e të dhënave për performancën e komunës përkatëse kur sigurohet për saktësinë e tyre. Një kopje elektronike e miratimit të të dhënave shkon automatikisht në arkivin përkatës të komunës dhe të MPL.
- ◁ Paraqet raportin e performancës për komunën përkatëse në kuvendin komunal dhe merr masat për zbatimin e rekomandimeve përkatëse për prioritizimin e burimeve, përmirësimin e vendimmarrjes dhe organizimin e punës në funksion të përmirësimit të shërbimeve përkatëse.

#### **Detyrat e punës për administrimin e SMPK në ministri**

##### ***Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Performancë Komunale janë:***

- Harton politika për matjen dhe vlerësimin e performancës komunale dhe funksionimit të skemës së grantit për performancë;
- Ndërmerr veprime për zhvillimin dhe funksionimin e rregullt të Sistemit të Menaxhimit të Performancës së Komunave;
- Përcakton kriteret dhe standardet për matjen dhe vlerësimin e performancës së komunave;
- Harton dhe zbaton rregullat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së të dhënave të raportuara për performancën e komunave;
- Udhëheq procesin për vlerësimin dhe ndarjen e grantit për performancë komunale në pajtim me sistemin e rregullave të veçanta juridike të aprovuara;

- Siguron mbarëvajtjen dhe funksionimin e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Performancës Komunale;
- Hulumton dhe analizon performancën e komunave, si dhe rekomandon veprime për zhvillimin e kapaciteteve të komunave në funksion të përmirësimit të qeverisjes dhe shërbimeve;
- Bashkëpunon aktivitetet me donatorë dhe kontributëdhënës të tjerë për avancimin e performancës së komunave dhe rritjes së vlerës së grantit për performancë komunale;
- Zhvillon rregullat dhe kriteret për funksionimin e skemës së grantit për performancë komunale;
- Rishikon dokumentet profesionale për matjen dhe vlerësimin e performancës si dhe grantit për performancë, përfshirë: dokumentin kryesor të SMPK-së (zhvillimin/rishikimin e fushave, rezultateve dhe treguesëve të SMPK-së), rregullat e grantit, parimet, kriteret, udhëzimet e punës, proceset, procedurat dhe standaret e tjera të vlerësimit.
- Zhvillon rregullat për sigurimin e cilësinë së vlerësimit të performancës komunale dhe metodologjitë përkatëse;
- Ofron mbështetje profesionale për zbatimin e metodologjisë për verifikim të të dhënave dhe rregullave të cilësisë së performancës.
- Hulumton dhe analizon në vazhdimësi performancën e komunave si dhe harton raporte analitike të veçanta për fushat e matjes së performancës.
- Rekomandon veprime për zhvillimin e kapaciteteve të komunave me qëllim të menaxhimit efikas të shërbimeve dhe përmirësim të qeverisjes;
- Krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave të performancës së komunave me informata konstante apo të pandryshueshme.
- Siguron harmonizimin e të dhënave të departamentit me të dhënat e njësive të tjera të ministrisë, për të siguruar informata të plota dhe valide në databazën e performancës komunale;
- Ofron mbështetje profesionale për strukturat e ministrisë për të përmirësuar proceset, kualitetin e hulumtimeve dhe monitorimit të performancës në përgjithësi;
- Zhvillon dhe zbaton programe të veçanta për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal për sistemin e menaxhimit të performancës komunale;

#### **Sekretari i përgjithshëm**

- ◁ Është autoriteti kryesor në nivel të ministrisë që siguron mbarëvajtjen procesit e zbatimit të rregullave për vlerësimin e performancës.
- ◁ Nënshkruan kërkesën për raportim e cila l dërgohet komunës.
- ◁ i përgjithshëm aprovon raportin për procesin e verifikimit të të dhënave së bashku me raportin përfundimtar të performancës.
- ◁ Themelon komisionin e Ankesave për performancën komunale.
- ◁ Autorizon para çdo cikli të vlerësimit Zbatimin e Rregullave të grantit.
- ◁ Themelon grupin teknik dhe komisionin e grantit të cilat janë organet përgjegjëse për vlerësimin dhe ndarjen e grantit të performancës komunale.
- ◁ Është kryesues i komisioni i grantit të performancës komunale.
- ◁ Shqyrton dhe aprovon ndryshimet e SMPK-së.
- ◁ Bën miratimin e ndryshimeve në SMPK sipas kërkesës se akterëve të përcaktuar me rregullore.

### Shtojca 3: Metodologjia për verifikimin dhe siguria e të dhënave të performancës komunale

#### Hyrje

Sistemi për menaxhimin e performancës së komunave përveç mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, karakterizohet edhe nga procesi i sigurimit të cilësisë së të dhënave, përmes procedurave të punës të për verifikimin e cilësisë së të dhënave të raportuara. Në vijim të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, verifikimi i të dhënave të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale, paraqet fazën thelbësore e cila mundëson besueshmërinë në SMPK, dhe ndikon direkt në qendrueshmërinë e këtij sistemi. Nga pikëpamja e përgjithshme, cilësia e të dhënave mbështetet në standardizim i cili ka të bëjë me zbatimin e dokumenteve bazike që e rregullojnë funksionimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Parimet dhe metodologjia e sigurimit të cilësisë përmes verifikimit përbën pjesën e brendshme të proceseve për sigurimin e cilësisë, duke lënë pjesën e jashtme të sigurimit të cilësisë si përgjegjësi e autoriteteve si ZKA, auditorë të jashtëm apo instrumente të tjera për verifikim të jashtëm të cilësisë. Mekanizmat e formuluar për mbledhje dhe raportim të të dhënave duhet zbatohen me përpikëri me qëllim që të kemi verifikim të suksesshëm në cilësinë e të dhënave bazuar në dokumente referente. Parimi fillestar në kontekstin e sigurimit të cilësisë së të dhënave është se çdo e dhënë e pa dokumentuar nga ana e organeve komunale, nuk konsiderohet si e dhënë e besueshme, dhe do të konsiderohet si e dhënë e pabazuar pasi që për të nuk ekziston mbështetja në dokumente valide të komunës. Për më tepër, secila e dhënë e raportuar e cila nuk është bazuar në dokumente të prodhuara apo menaxhuara nga komuna, apo edhe me lidhje ligjore me komunën, prodhon pasoja në kualifikimin e komunës për të drejtën e shfrytëzimit të grantit të performancës komunale.

#### Qëllimi

Qëllimi kryesor është që përmes metodologjisë dhe mekanizmave të përcaktuar të sigurohet cilësia e të dhënave komunale. Saktësia e të dhënave komunale është me rëndësi kyçe dhe në këtë metodologji përshkruhen masat dhe procedurat e parapara për arritjen e sigurimit të cilësisë, përmes proceseve të strukturuar të verifikimit të të dhënave.

#### 1. Objektivat e verifikimit

- ◁ Verifikimi i plotë i të dhënave të raportuara nga komunat në SMPK me qëllim të rritjes së qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë në sistem;
- ◁ Përcaktimi i kriterëve të qarta dhe mekanizmave konkret për verifikim të të dhënave;
- ◁ Përfshirja e të gjitha palëve të interesuara në procesin e verifikimit të të dhënave dhe ndarja e përgjegjësive institucionale për verifikim.

#### 2. Mënyra e renditjes së komunave bazuar në cilësinë e të dhënave

Procesi i verifikimit mundëson klasifikimin e të dhënave sipas cilësisë. Cilësia e të dhënave ndikon në renditjen e komunave sipas rezultateve të verifikimit. Ky proces i nënshtrohet skemës së klasifikimit të bazuar në cilësi sipas kriterëve të përcaktuar në këtë dokument.

Klasifikimi i komunave mundësohet përmes zbatimit të formulës në vijim, ku mbledhen të dhënat që kanë rezultuar të sakta dhe ato me pasaktësi sipas procedurës:

- 1) Numri i përgjithshëm i të dhënave të verifikuara formohet sipas formulës,

Formula *të dhëna gjithsej* = *të dhëna të sakta* + *të dhëna me pasaktësi*

- 2) Shkalla e gabimit e gjetur pas verifikimit në ministri në nivel të raportimit të një komune.

Formula *shkalla e gabimit* =  $\frac{\textit{të dhëna me pasaktësi}}{\textit{të dhëna gjithsej}} * 100$

### 3. Pavlefshmëria e të dhënave

Të dhënat të cilat nuk i përmbushin kriteret e cilësisë konsiderohen si të dhëna të pavlefshme.

Në rast se procesi i verifikimit identifikon tregues me të dhëna të pa dokumentuara, atëherë komunave për këta tregues do t'iu ndahet vlera zero. I njëjti vlerësim do të nënkuptohet në kontekst të grantit të performancës komunale.

Në rast se gjatë procesit të verifikimit vërtetohet se një komunë ka raportuar të dhëna të pasakta që rezulton në performancë më të lartë, performanca e asaj komune në fushën për të cilën të dhënat janë të pasakta, shpallet e pavlefshme. Kjo masë vjen në shprehje në rastet kur vërtetohen të dhëna të pasakta të referuara në dokumente fiktive me qëllim të ndikimit në lartësinë e performancës.

### 4. Detyrat dhe përgjegjësitë institucionale për verifikim

Përgjegjësitë në nivel të komunës:

- ◁ **Zyrtari komunal për raportim të performancës** - është pjesë e raportimit dhe kontribon për verifikimin e të dhënave në nivelin e komunës, me ç'rast ka përgjegjësi për ofrimin e dokumenteve referente tek koordinatori komunal i performancës. Poashtu, është përgjegjës për bashkëpunim me ministrinë gjatë verifikimit në hallkën e dytë, ku bashkëpunimi kalon përmes koordinatorit komunal të performancës.
- ◁ **Koordinatori komunal për performancë** - është përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e procedurave për sigurimin e cilësisë së të dhënave të komunës. Poashtu, ka përgjegjësi për bashkëpunim me ministrinë për sigurim të cilësisë, me qëllim të sigurimit të komunikimit dhe sigurimit të dokumenteve referente të cilat kërkohen nga ministria gjatë procesit të verifikimit.
- ◁ **Kryetari i komunës** – është instancë përgjegjëse për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të verifikimit të të dhënave të raportuara duke siguruar alokimin e burimeve njerëzore dhe materiale për zbatimin e verifikimit në hallkën e parë. Kryetari është përgjegjës sipas hierarkisë për

koordinatorin komunal të cilësisë, ashtu që ky i fundit të këtë mjaft kohë dhe resurse njerëzore në dispozicion për kryerjen e procesit të verifikimit në nivel të komunës. Poashtu, kryetari është përgjegjës për të siguruar se koordinatori komunal i cilësisë ka mjaft resurse në dispozicion në raport me kërkesat e ministrisë për të bashkëpunuar gjatë procesit të verifikimit në hallkën e dytë.

- ◁ **Auditori i brendshëm** – është instancë e pavarur e sigurimit të cilësisë dhe rregullsisë në pjesën e proceseve të brendshme të komunës. Tërthorazi auditori i brendshëm ka përgjegjësi për të siguruar qëndrueshmërinë e dokumenteve referente në nivel të komunës, si dhe zbatimin e procedurave të rregullta të funksionimit të komunës për të cilat raportohet në treguesit përkatës.

Përgjegjësitë për verifikimin e të dhënave në nivel të ministrisë

- ◁ **Njësia përgjegjëse për performancë** - është përgjegjëse për organizimin e punës dhe zbatimin e procedurave për verifikim në hallkën e dytë sipas përshkrimit të procedurave në këtë metodologji. Kjo nënkupton edhe bashkëpunimin me zyrtarët e instancave të tjera të qeverisë sipas kërkesave teknike për verifikim, si dhe për bashkëpunimin me koordinatorin komunal të performancës dhe zyrtarët raportues sipas kërkesave teknike të hapave procedural.
- ◁ **Drejtori i njësisë implementuese të SMPK në ministri** – është përgjegjës për të siguruar mbarëvajtjen e procesit të sigurimit të cilësisë dhe verifikimit të të dhënave në SMPK, në hallkën e dytë, duke emëruar zyrtarin përgjegjës dhe duke alokuar resurset e nevojshme njerëzore dhe materiale për zbatimin e masave procedurale të përshkruara në këtë metodologji për sigurimin e cilësisë së të dhënave. Poashtu drejtori është përgjegjës për formimin e komisionit për trajtimin e rasteve të dyshuara të fabrikimit të dëshmimeve për qëllim të sigurimit të të dhënave referente për raportim.
- ◁ **Sekretari i përgjithshëm** – është autoriteti kryesor në nivel të ministrisë që siguron mbarëvajtjen e zbatimit të rregullave për vlerësimin e performancës në pajtim me rregullat juridike të kësaj fushe.
- ◁ **Auditori i brendshëm** - është instancë e pavarur e sigurimit të cilësisë dhe rregullsisë në pjesën e proceseve të brendshme të komunës. Edhe pse drejtperdrejt nuk ka përgjegjësi në raport me SMPK, tërthorazi auditori i brendshëm ka përgjegjësi për të siguruar qëndrueshmërinë e dokumenteve referente në nivel të ministrisë dhe njërive qëndrore ku janë marrë për krahasim të dhënat me qëllim të krahasimit. Auditori i brendshëm i ministrisë poashtu mund të trajtojë vet procesin e verifikimit në aspektin e rregullsisë në nivel të ministrisë, përkatësisht të auditojë procesin dhe rezultatet e verifikimit në hallkën e dytë të sigurimit të cilësisë.

Përfshirja e palëve të interesit në procesin e verifikimit të të dhënave

- ◁ Zyra Kombëtare e Auditimit – ka mandat ligjor për të zbatuar procedurat e auditimit dhe për të zbatuar masat e sigurimit të cilësisë së të dhënave nga pozita e palës së jashtme. (procedurat e jashtme të sigurimit të cilësisë). Modalitetet e përfshirjes së ZKA-së si instancë e rregullt për sigurimin e cilësisë mbeten çështje në diskrecion dhe kontekst të resurseve dhe prioriteteve të vet institucionit (ZKA).
- ◁ Shoqëria civile – përfaqësojnë palë të interesit dhe poashtu mund të konsiderohen për përfshirje në masat e jashtme për sigurimin e cilësisë. Shoqëria civile ka qasje të limituar në SMPK, me të drejtën e leximit të të dhënave sipas autorizimit të lejuar nga ministria në pajtim me ligjin për qasje

në dokumentet publike. Në autorizim përfshihet deklarata e konfidencialitetit që siguron përdorimin e të dhënave vetëm mbi bazën e autorizimit.

- ◀ Donatorët - përfaqësojnë palë të interesit dhe poashtu mund të konsiderohen për përfshirje në masat e jashtme për sigurimin e cilësisë. Në ç'rast ekziston mundësia e kontraktimit të shërbimeve profesionale të auditimit me qëllim të sigurimit të masave të jashtme për sigurim të cilësisë.

## 5. Procedurat për verifikimin e të dhënave

Procesi i sigurimit të cilësisë së të dhënave i nënshtrohet rregullave procedurale për mbledhjen, analizimin, përpunimin dhe raportimin të të dhënave të performancës. Sigurimi i cilësisë së të dhënave bazohet në zbatimin e masave të parapara në nivel të komunës dhe në nivel të ministrisë, duke organizuar kështu sistemin për menaxhimin e cilësisë së të dhënave në dy nivele.

Në kontekstin e sistemit aktual të menaxhimit të cilësisë, përmes procedurave të verifikimit në secilën hallkë përgjatë zinxhirit të raportimit, premisa fillestare është se kërkesa për raportim e në këtë kontekst, të dhënat e treguesit janë plotësisht të qarta dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fjalë të janë të zbatueshme në kuadër të kompetencave të zyrtarit përgjegjës dhe në kuadër të afatit kohor të paraparë. Kjo nënkupton se përshkrimi i treguesit në dokumentin i cili e definojnë atë është i kuptueshëm dhe i zbatueshëm, së bashku me të dhënat të cilat kërkohen, formulën e llogaritjes, burimin e të dhënave (njësia organizative prej nga merren) dhe burimi referent për krahasim të tërthortë.

## 6. Procedurat e verifikimit në komunë

Në nivel të komunës, sistemi i sigurimit të cilësisë së të dhënave paraqet nivelin e parë, ku të dhënat e raportuara së bashku me dëshmitë përbëjnë lëndën mbi të cilën kryhet verifikimi.

Me verifikim në nivel të komunës nënkuptohet krahasimi i vlerave të të dhënave të raportuara në formularët e treguesve, me vlerat e paraqitura në dokumentet referuese.

Koordinimi i procesit të verifikimit të të dhënave të raportuara është përgjegjësi e koordinatorit komunal të performancës. Procesin e verifikimit të cilësisë, koordinatori komunal mund ta bëjë së bashku apo në konsultim me zyrtarin raportues me qëllim të interpretimit të dokumenteve referente.

Zyrtari raportues për performancë komunale krijon dosjen e veçantë për të gjitha fushat e matjes së performancës, e cila i dërgohet koordinatorit komunal për performancë.

Përgjegjësia lidhur me plotësimin e kriterëve të verifikimit është përgjegjësi e koordinatorit komunal të performancës. Verifikimi është pjesë e pandashme e procesit të mbledhjes së të dhënave dhe raportimit dhe shtrihet paralel me mbledhjen dhe raportimin në nivel të komunës.

Verifikimi kryhet sipas procedurave të përshkruara më poshtë, dhe këto janë të njejta dhe përsëriten për të gjithë treguesit.

Procesi i verifikimit dokumentohet përmes plotësimit dhe nënshkrimit të formularit të verifikimit nga koordinatori komunal për performancë.

Verifikimi i të dhënave për treguesit fillon në momentin e plotësimit dhe dokumentimit të të dhënave për tregues nga ana e zyrtarëve raportues, kurse përmbyllet para raportimit të të dhënave në ministri, me rastin e nënshkrimit të formularit të verifikimit.



Kriteret për verifikim të të dhënave në komunë

Në procesin e verifikimit, komuna siguron përmbushjen e kriterëve si në vijim:

**Të dhënat janë të plota** - formulari është i plotësuar në tërësi, për të gjitha të dhënat e treguesit dhe dëshmitë përkatëse – dokumentet referente për çdo të dhënë.

**Nuk ka gabime teknike** - vlerat e të dhënave të raportuara janë të shënuara në formular në hapësirat përkatëse në mënyrë të drejt dhe treguesi tregon vlerën e saktë.

**Dëshmitë janë valide** - dëshmitë e paraqitura si burim i të dhënave përbëjnë bazë të qëndrueshme referente, janë dokumente zyrtare dhe kanë përdorim tjetër përveç raportimit në SMPK.

**Të dhënat janë të sakta** – vlerat e të dhënave të raportuara korrespondojnë me vlerat burimore sipas dokumenteve referente – dëshmime.

**Plotësohen kriteret e kërkuara të verifikimit** – shënohet se treguesi i shqyrtuar i plotëson kriteret 1 deri 4 dhe konstatohet i kryer verifikimi.

**Krijimi i dosjes së verifikimit** – Komuna siguron se të dhënat e raportuara për të gjitha fushat janë të arkivuara në një dosje të veçantë me dokumentet përcjellëse.

**Ngarkimi i dokumenteve (ose vegëzave/linqeve) në SEMPK** – Komuna sistemon dosjen e verifikimit nëpër treguesit e fushave përmes SEMPK-së.

Me qëllim të sigurimit të kushteve për zbatimin e procesit të verifikimit për koordinatorin komunal të performancës, zyrtari raportues ka për obligim sigurimin e materialeve të paraqitura si dëshmi për treguesit, përkatësisht për të dhënat e paraqitura sipas përshkrimit të dokumenteve referente – dëshmime. Komuna është e obliguar të plotësoj formularin e verifikimit sipas shojcës 1 të këtij dokumenti.

Koordinatori e bashkëngjet formularin e plotësuar të verifikimit dhënave me rastin e raportimit të të dhënave në ministri.

## 7. Procedurat e verifikimit në ministri

Në nivel të ministrisë, sistemi i sigurimit të cilësisë së të dhënave paraqet nivelin e dytë, ku të dhënat e raportuara së bashku me dëshmitë përbëjnë lëndën mbi të cilën kryhet verifikimi.

Procesi i verifikimit të të dhënave të raportuara në ministri është përgjegjësi e zyrtarëve në Njësinë përgjegjëse për implementimin e SMPK-së. Zyrtari përgjegjës i ministrisë, procesin e verifikimit mund ta bëjë së bashku apo në konsultim me koordinatorin komunal të performancës, me qëllim të interpretimit të dokumenteve referente. Vendimmarrja lidhur me plotësimin e kriterëve të verifikimit është përgjegjësi e zyrtarit përgjegjës të ministrisë.

Verifikimi në nivel të ministrisë i referohet dëshmime të paraqitura për treguesit e raportuar si dhe burimeve të tjera të dëshmime, duke shfrytëzuar krahasimin e tërthortë të dokumentacionit referent me qëllim të krahasimit të vlerave të raportuara për të dhënat dhe vlerat referente të dokumentuara.

Akti i verifikimi kryhet sipas procedurave të përshkruara më poshtë dhe kryhen duket ju referuar metodologjisë sipas grupit ku i përkasin treguesit. Grupimi i treguesve sipas metodologjisë për verifikim në nivel të ministrisë bazohet në kriterin se ku gjenden burimet e informatave, përveç se në komunë, si dokumente referente në MAPL, Ministrinë e tjera, ZKA, etj.

Procesi i verifikimit në ministri fillon me përgatitjen e listën e treguesve të përzgjedhur për verifikim, duke përdorur listën sipas shtojcës 3 të këtij dokumenti.

Procesi i shqyrtimit të shkallës së vërtetësisë (saktësisë) së të dhënave realizohet në një sistem standard të klasifikimit të të dhënave, konform kritereve të pikës 5 të këtij dokumenti, si vijon:

- 1) Të dhënat prezantohen në formatin Excel, apo në SEMPCK;
- 2) Përpunimi i të dhënave bëhet sipas formulave të llogaritjes (të përcaktuara në pikën 4 të këtij dokumenti);
- 3) Komunat klasifikohen duke u bazuar në nivelin e saktësisë dhe rezultateve përfundimtare;
- 4) Formulari i punës duhet të nënshkruhet në formë fizike, apo të autorizohet përmes përdoruesit në SEMPCK (Divizioni për Performancë Komunale).
- 5) Formulari përmban datën e fillimit të procesit të verifikimit, datat e përditësimit të të dhënave dhe datën e aprovimit;

#### 7.1. Llojet e verifikimit të aplikuara nga ministria

Procesi i verifikimit të të dhënave kalon nëpër dy faza kryesore:

- Verifikimi i rregullt;
- Verifikimi i ex-post.

**Verifikimi i rregullt** - Verifikimi i rregullt ndahet në dy faza:

- 1) Faza e parë – nënkupton verifikimin paraprak, pas pranimit të raporteve të komunave nga divizioni për performancë, i cili bëhet në proces të sistemit të të dhënave në databazë.
- 2) Faza e dytë – nënkupton verifikimin sipas mostrës, që ndodh pas hartimit të raportit të përgjithshëm për performancë.

**Faza 1- Verifikimi paraprak**, përfshinë ndërmarrjen e veprimeve si vijon:

- 1) Kontrollimin nëse të dhënat e raportuara janë të plota, përkatësisht nëse formulari është i plotësuar në tërësi dhe përfshinë të dhënat për të gjithë treguesit;
- 2) Pastrimin e të dhënave me qëllim të eliminimit të gabimeve teknike dhe logjike, duke siguruar që:
  - Vlerat e të dhënave të raportuara janë të shënuara në formularë, në hapësirat përkatëse në mënyrë të drejtë;
  - Treguesit japin vlerën e saktë të performancës;
  - Vlerat e të dhënave të raportuara korrespondojnë me vlerat burimore sipas dokumenteve referente – dëshmime.
  - Identifikimin nëse të dhënat e raportuara janë të dokumentuara përmes dokumenteve apo burimeve zyrtare sipas kërkesave teknike ku përfshihen:

Po ashtu, ky lloj i verifikimit përfshinë respektimin e kërkesave teknike si vijon:

- Emri i dokumentit;
- Numri i protokolit (nëse kërkohet)
- Vulën e komunës apo institucionit komunal;
- Nënshkrimin apo autorizimin e organit vendimmarrës;

- Vegëzën (linkun) e publikimit të dokumentit.

**Faza 2 - Verifikimi sipas mostrës** - Ky proces zbatohet për të gjitha komunat, sipas një përzgjedhje të treguesve të cilët janë të domosdoshëm t'i nënshtrohen verifikimit.

Pregaditja e mostrës së treguesve për t'u nënshtuar procesit të verifikimit bëhet sipas kritereve dhe hapave të specifikuar më poshtë.

- Në kuadër të çdo fushe të performancës, përzgjedhet së paku 1 (një) tregues. Gjatë përzgjedhjes së treguesve, prioritet do të kenë treguesit e përfshirë në vlerësimin për grantin e performancës;
  - Tregues të tjerë do të zgjedhen sipas indikacioneve të shfaqura gjatë verifikimit paraprak (fazës së parë);
- Treguesit e përzgjedhur duhet të jetë me vlera më të larta të performancës, krahasuar me vlerën mesatare të treguesve në nivel të vendit.;
- Vlerat ekstreme të ulëta apo të larta të performancës së treguesve, merren për bazë gjatë përzgjedhjes së treguesve për verifikim. Në rast se nuk ka tregues me vlera ekstreme prej mesatares, treguesit përzgjedhen për rastësisë sistematike.

**Verifikimi i ex-post** - Vlerësimi ex-post është proces i verifikimit që realizohet pas publikimit të raportit të performancës komunale deri para fillimit të vlerësimit të komunave për grantin e performancës komunale.

Ky lloj i vlerësimit zbatohet për 3 komunat me performancën më të mirë sipas rezultateve të raportit. Objekt i trajtimit të këtij procesi janë indikatorët e përzgjedhur për grantin e performancës komunale. Vlerësimi i këtyre indikatorëve bëhet përmes:

## 7.2. Kriteret për verifikim të të dhënave në ministri

**Të dhënat janë të plota** - formulari është i plotësuar në tërësi, për të gjitha të dhënat e treguesit dhe dëshmitë përkatëse – dokumentet referente për çdo të dhënë.

**Nuk ka gabime teknike** - vlerat e të dhënave të raportuara janë të shënuara në formular në hapësirat përkatëse në mënyrë të drejt, dhe treguesi tregon vlerën e saktë.

**Dëshmitë e ofruara nga komuna janë valide** - dëshmitë e paraqitura si burim i të dhënave përbëjnë bazë të qëndrueshme referente, - ku është e mundur të dhënat krahasohen me burime alternative të dokumenteve reference (ministri, ZKA, etj).

**Dëshmitë e ofruara kanë mbështetje faktike** – për të dhënat të cilat mbështeten në informata të mbledhura prej vizitave në terren. Për vizitë në terren plotësohet formulari i dhënë në shtojcën X.

**Të dhënat janë të sakta** – vlerat e të dhënave të raportuara korrespondojnë me vlerat burimore sipas dokumenteve referente – dëshmime.

**Plotësohen kriteret e kërkuara të verifikimit** – shënohet se treguesi i shqyrtuar i plotëson kriteret 1 deri 5 dhe konstatohet i kryer verifikimi.

Me qëllim të sigurimit të kushteve për zbatimin e procesit të verifikimit për zyrtarin përgjegjës të ministrisë, koordinatori komunal i performancës ka për obligim sigurimin e materialeve të paraqitura si dëshmi për treguesit, përkatësisht për të dhënat e paraqitura sipas përshkrimit të dokumenteve referente – dëshmime. Poashtu në rast të vizitës në komunë, koordinatori komunal i performancës e organizon vizitën sipas kërkesave të komunikuara nga ministria.

## Implementimi i ndryshimeve gjatë fazës së verifikimit

Njësia përgjegjëse në ministri gjatë menaxhimit të procesit të vlerësimit të performancës, mund të përmirësojë të dhënat e raportuara të komunave, në rast se gjatë fazës së verifikimit konstatohen gabime teknike dhe për të cilat komuna ofron dëshmi zyrtare që dëshmojnë se vlerat e të dhënave janë në pajtim me konstatimet e nxjerra gjatë procesit të verifikimit.

Komunikimi i ndryshimeve të të dhënave bëhet gjatë fazës së konsultimit parapraktë paraparë me nenin 23 të Rregullores për SMPK.

### 7.3. Grupet e treguesve – burimet e të dhënave për verifikim

Verifikimi i treguesve duke i krahasuar të dhënat e raportuara me vlerat në dokumentet referente zhvillohet duke konstatuar se në cilin kategori të dëshmime bënë pjesë treguesi, për shkak se në bazë të instancave ku gjinden burimet e të dhënave plotësuese apo si sigurohen ato, zhvillohet edhe procedura për verifikim. Në përgjithësi janë 6 kategori lidhur me formën e sigurimit të të dhënave për krahasim me qëllim të verifikimit, dhe ato janë:

1. Treguesit që kanë për bazë të dhëna nga intraneti, për këtë kategori verifikimi është i drejtëpërdrejtë, duke ju referuar vlerave;
2. Treguesit që kanë për bazë dëshmi në raporte dhe dokumente të cilat janë edhe në MAPL, mund të verifikohen duke iu referuar raporteve të ndryshme;
3. Treguesit që kanë për bazë dëshmi në raporte dhe dokumente nëpër institucione të tjera të Kosovës (ZKA, Ministri të tjera) mund të verifikohen duke iu referuar raporteve të ndryshme;
4. Treguesit që kanë për bazë dëshmi prej ueb faqeve të komunave;
5. Treguesit që kanë për bazë dëshmi prej dokumenteve të ndryshme të komunës;
6. Treguesit që kanë për bazë dëshmi për të cilat është e domosdoshme vizita në terren.

Grupimi i treguesve në varësi të mënyrës së verifikimit, është paraqitur në shtojcën 4.

Zyrtari përgjegjës ia bashkangjet formularin me verifikimin e përfunduar të dhënave dosjes së të dhënave të raportuara të komunës ndaj së cilës është ushtruar verifikimi.

Të dhënat e mbledhura gjatë procesit të verifikimit ruhen në dosjen e procesit të verifikimit në nivel të ministrisë, dhe regjistrohen në bazë të vitit për të cilin është kryer verifikimi (jo viti në të cilin është kryer verifikimi).

Me përmbylljen e procesit të verifikimit, raportet e nënshkuara me format përkatëse i paraqiten drejtorit të njësisë implementuese të SMPK. Secila komunë njoftohet me gjetjet nga procesi i verifikimit.

Për çdo komunë në veçanti, në bazë të rezultateve të verifikimit, zbatohen dispozitat e rregullores për SMPK. Si pasojë, ndryshohen apo plotësohen të dhënat e treguesve, si dhe zbatohen masat si: anulim të vlerës së treguesit (ulje në zero), ndryshimi në rradhitje të përgjithshme, dhe diskualifikimi nga e drejta për pjesëmarrje në konkursin për grant të performancës. Ndryshimet zbatohen menjëher me rastin e miratimit të raportit të verifikimit nga ana e drejtorit të njësisë implementuese të SMPK-së.

Shtojca 1: Formulari i verifikimit në komunë

Nr	Ref. Tregues	Emërtimi i treguesit	1.Të dhënat janë të plota	2.Nuk ka gabime teknike	3. Dëshmitë janë valide	4. Të dhënat janë të sakta	5. Plotësohen kriteret e kërkuara të verifikimit
1	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	1	1	1	1	1
2	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	1	1	1	0	0
3	1.1.3	Koha mesatare e shqyrtimit të lëndëve gjatë vitit <i>(tregues i ngrirë deri në funksionalizim të sistemit elektornik)</i>	1	1	1	1	1
4	1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	1	0	1	0	0
5	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	1	1	1	1	1
6	2.1.2	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	1	1	1	1	1
7	2.1.3	Përmbushja e kriteve të faqes zyrtare elektronike të komunës	1	1	1	1	1
8	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës	1	1	1	1	1
...							
119							

Data dhe nënshkrimi kur ka përfunduar verifikimi në komunë

Formulari plotësohet me vlerat 0 dhe 1 në fushat e kriterëve prej 1 deri në 5, sipas çelësit:

*0- Nuk përmbushet kriteri*

*1- Plotësohet kriteri*

Shtojca 2: Grupimi i treguesve në varësi të mënyrës së verifikimit

Grupi	Llojet e treguesve	Dokumente që duhet të konsultohen gjatë verifikimit	Personi përgjegjës	Afati kohor i verifikimit
Grupi 1 Treguesit që vijnë nga intraneti dhe platformat elektronike për raportim, verifikimi është i drejtëpërdrejtë duke ju referuar vlerave.	<p>1.1.1 Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit</p> <p>1.1.2 Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore</p> <p>1.1.3 Koha mesatare e shqyrtimit të lëndëve gjatë vitit (tregues i ngrirë deri në funksionalizim të sistemit elektornik)</p> <p>2.1.2 Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët</p> <p>3.1.7 Intervenimet pas raportimeve të qytetarëve për mbeturina (I ngrirë deri në integrim të sistemit të raportimit të qytetarëve në intranet)</p> <p>3.1.8 Intervenimet pas raportimeve të qytetarëve për dëmtime në infrastrukturë (I ngrirë deri në integrim të sistemit të raportimit të qytetarëve në intranet)"</p>	N/A	N/A	N/A
Grupi 2 Treguesit që kanë për bazë dëshmi në raporte dhe dokumente të cilat janë edhe në MAPL, verifikohen duke iu referuar raporteve të ndryshme	<p>2.1.1 Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtëpërdrejt online</p> <p>2.1.4 Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës</p> <p>2.1.5 Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës</p>	Raporti i funksionimit të komunave (MAPL)	Personeli nga divizioni i performances komunale	Periudha pas përfundimit të raportimit nga komunat deri para publikimit të raportit të performances komunale
Grupi 3 Treguesit që kanë për bazë dëshmi në	3.2.1 Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	Raportet e Rregullsisë (ZKA)	Personeli nga divizioni i	Periudha pas përfundimit të raportimit nga

<p>raporte dhe dokumente nëpër institucione të tjera të Kosovës (ZKA, Ministri të linjave përkatëse) verifikohen duke iu referuar raporteve të ndryshme;</p>	<p>3.2.2 Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal</p> <p>3.3.2 Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve</p> <p>3.3.3 Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit</p> <p>3.5.1 Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil</p> <p>3.5.2 Vende të hapura të punës që janë procesuar përmes SIMBNj</p> <p>7.1.1 Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)</p> <p>15.1.3 Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale</p> <p>17.1.2 m2 të hapësirave shkollore për kokë nxënësi – urban dhe rural</p> <p>17.1.3 Shkollat e paisura me kabinet te internetit</p> <p>17.1.4 Shkollat me masa te eficiencës së energjisë</p> <p>17.1.5 Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar</p> <p>17.1.6 Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar</p> <p>17.2.1 Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licensuar</p> <p>17.2.2 Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës – urban dhe rural</p> <p>17.3.2 Shkalla bruto e regjistrimit ne kl.1</p> <p>17.3.3 Shkalla e qasjes – tranzicioni kl9- k10</p> <p>17.3.4 Rezultatet e testit të arritshmërisë për kl.9-ta</p>	<p>Raporti i monitorimit te komunave, etj</p> <p>Raportet e Ministrisë së Financave – Buxhetet Komunale</p> <p>Sistemi elektronik i pagesave – Freebalance</p> <p>Sistemi për menaxhimin e informatave në arsim (SMIA)</p> <p>Raportet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor – tatimi në pronë</p> <p>Raportet e Ministrisë së Shëndetësisë – Kujdesi Primar Shëndetësor</p>	<p>performances komunale</p>	<p>komunat deri para publikimit te raportit te performances komunale</p>
--	---	---	------------------------------	--

	<p>17.3.5 Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë)</p> <p>17.3.6 Indeksi i barazisë gjinore (për të gjitha nivelet ISCED 0-3)</p> <p>17.3.7 Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)</p> <p>17.3.8 Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit</p> <p>18.1.2 Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike</p> <p>18.2.1 Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë</p> <p>18.3.1 Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori</p> <p>18.3.2 Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit</p> <p>18.3.3 Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe femijë</p> <p>19.1.3 Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë</p> <p>19.1.4 Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)</p>			
Grupi 4 - Treguesit që kanë për bazë dëshmi prej ueb faqeve të komunave	<p>1.1.4 Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna</p> <p>2.1.3 Përbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës</p> <p>2.1.4 Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës</p> <p>2.1.5 Publikimit i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqën zyrtare të komunës</p>			



	<p>2.2.1 Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit</p> <p>2.2.2 Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave</p> <p>3.1.3 Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun</p> <p>3.1.4 Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal</p> <p>3.1.5 Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike</p> <p>3.2.5 Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale</p> <p>3.3.3 Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit</p> <p>3.4.1 Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal</p> <p>19.1.2 Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim</p>			
<p>Grupi 5 -Treguesit që kanë për bazë dëshmi prej dokumenteve të ndryshme të komunës.</p>	<p>2.2.1 Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit</p> <p>2.2.2 Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave</p> <p>3.1.1 Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike</p> <p>3.1.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike</p> <p>3.1.3 Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun</p> <p>3.1.4 Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal</p> <p>3.1.5 Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike</p> <p>3.1.6 Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit</p>	<p>Procesverbale nga Kuvendi Komunal</p> <p>Raporte të Drejtorive komunale</p> <p>Raporti i punës së Kryetarit të Komunës</p> <p>Dokumente nga zyra e personelit</p> <p>Raporte nga zyrtari për barazi gjinore</p>	<p>Personeli nga divizioni i performances komunale</p>	<p>Periudha pas perfundimit të raportimit nga komunat deri para publikimit të raportit të performances komunale</p>

	<p>3.2.3 Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak</p> <p>3.2.4 Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë Komunale</p> <p>3.2.5 Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale</p> <p>3.2.6 Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës</p> <p>3.3.1 Niveli i zbatimit të planit të prokurimit</p> <p>3.3.3 Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit</p> <p>3.4.1 Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal</p> <p>3.4.2 Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre (tregues i ngrirë deri në shqyrtimin e Ligjit për Zyrtarë Publik nga Gjykata Kushtetuese)</p> <p>3.5.3 Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore (tregues i ngrirë deri në shqyrtimin e Ligjit për Zyrtarë Publik nga Gjykata Kushtetuese)</p> <p>4.1.1 Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale</p> <p>4.1.2 Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë</p> <p>4.2.1 Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social</p> <p>4.2.2 Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar</p>			
--	---	--	--	--

	<p>5.1.1 Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve</p> <p>5.2.1 Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal</p> <p>5.2.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në veprimtari për kulturë, rini dhe sport</p> <p>6.1.1 Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive</p> <p>6.1.2 Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë</p> <p>7.2.1 Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit</p> <p>7.2.2 Ndërtesa të reja të inspektuara</p> <p>7.2.3 Objekte të reja me leje të ndërtimit</p> <p>8.1.1 Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m<sup>2</sup> për kokë banori</p> <p>8.1.2 Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht</p> <p>9.1.2 Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës</p> <p>9.1.3 Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit</p> <p>9.2.1 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare</p> <p>10.1.1 Realizimi i planit komunal për transport lokal publik</p> <p>12.1.1 Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit</p> <p>12.1.2 Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm</p> <p>13.1.1 Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit</p> <p>13.1.2 Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë</p>			
--	--	--	--	--

<p>biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit</p> <p>13.2.1 Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujrave të zeza</p> <p>14.1.1 Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave</p> <p>14.1.2 Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave</p> <p>14.2.1 Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave</p> <p>14.2.2 Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave</p> <p>14.3.1 Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori</p> <p>15.1.1 Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis</p> <p>15.1.2 Lejet mjedisore komunale të lëshuara</p> <p>16.1.1 Gratë e punësuar në institucione /administratën komunale</p> <p>16.1.2 Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive</p> <p>16.1.3 Gratë e emëruara në pozita politike në komunë</p> <p>16.1.4 Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale</p> <p>16.1.5 Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale</p> <p>16.2.1 Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor</p> <p>16.2.2 Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave</p> <p>16.2.3 Pjesëmarrja e grave në konsultime publike</p> <p>16.2.4 Plani komunal për barazi gjinore</p>			
---	--	--	--

	<p>16.3.1 Përfaqësimi gjinore tek emërtimet e rrugëve</p> <p>16.3.2 Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive</p> <p>17.1.1 Çerdhe dhe kopshte në zona rurale për 10000 banorë</p> <p>17.1.5 Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar</p> <p>17.1.6 Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar</p> <p>17.2.3 Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake</p> <p>17.2.4 Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt</p> <p>17.2.5 Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues</p> <p>17.3.1 Fëmijët që vijnë kopshtin - rural dhe përgjithësi (ndarje sipas gjinisë)</p> <p>18.1.1 m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë</p> <p>18.2.2 Përqindja e buxhetit për kujdes primar shendetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake</p> <p>19.1.1 Plani për zhvillim ekonomik lokal</p> <p>19.1.2 Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim</p>			
Grupi 6 - Treguesit që kanë për bazë dëshmi për të cilat është e domosdoshme vizita në terren.	<p>8.1.3 Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik</p> <p>9.1.1 Rrugët lokale të shtruara</p> <p>9.2.1 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare</p> <p>9.2.2 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik</p> <p>9.2.3 Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal</p>	<p>Kontaktimi i zyrtarëve përgjegjës nëpër komuna apo koordinatorët e performancës (p.sh. Plani i integritetit)</p> <p>Verifikimi përmes vizitës në terren bëhet duke shqyrtuar lokacionet për të cilat do të duhej të</p>	<p>Personeli nga divizioni i performancës komunale</p>	<p>Peridha pas perfundimit të raportimit nga komunat deri para publikimit të raportit të performancës komunale</p>

9.2.4 Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave	vlenin të dhenat e treguesit.		
9.2.5 Rrugët lokale të riasfaltuara	Vizita përmyllet me raport nga vizita me gjetjet dhe konkludimet.		
10.1.2 Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik			
10.1.3 Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik			
11.1.1 Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike			
11.1.2 Vendparkime për mjete motorike në territorin e komunës			
11.1.3 Vendparkimet e destinuar për taksit			
11.1.4 Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar			

### Shtojca 3: Lista e treguesve të përzgjedhur për verifikim

Nr	Nr referent i treguesit	Vlera referente mesatare e treguesit	Vlera e raportuar e treguesit
	Emri i treguesit		
1	1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	
2	1.1.3	Koha mesatare e shqyrtimit të lëndëve gjatë vitit	
3	1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna	
4	2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	
5	2.1.2	Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët	
6	2.1.3	Përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	
7	2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës	
8	2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqën zyrtare të komunës	
9	2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	
10	2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave	
11	3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike	
12	3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	

13	3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun		
14	3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal		
15	3.1.5	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike		
16	3.1.6	Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit		
17	3.1.7	Intervenimet pas raportimeve të qytetarëve për mbeturina		
18	3.1.8	Intervenimet pas raportimeve të qytetarëve për dëmtime në infrastrukturë		
19	3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal		

#### Shtojca 4: Formulari i verifikimit në ministri

Nr	Ref. Tregues	Emërtimi i treguesit	1. Të dhënat janë të plota	2. Nuk ka gabime teknike	3. Dëshmitë janë valide	4. Dëshmitë e ofruara kanë mbështetje faktike	5. Të dhënat janë të sakta	6. Plotësohen kriteret e kërkuara të verifikimit
Emri i komunës A								
1	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	1	1	1	1	1	1
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
...								
19								
Emri i komunës B								
1	1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit	1	1	1	1	1	1
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
...								
19								

Data dhe nënshkrimi kur ka përfunduar verifikimi në ministri

Formulari plotësohet me vlerat 0 dhe 1 në fushat e kriterëve prej 1 deri në 6, sipas çelësit:

0- Nuk përmbushet kriteri

1- Plotësohet kriteri

Shtojca 5: Formularët për vizitën në terren

Vizita në terren – shqyrtimi i dëshmive dhe mbledhja e provave

Emri i komunës: \_\_\_\_\_

Data e vizitës: \_\_\_\_\_

Antarë të komisionit në vizitë dhe pozita:

	Emërat e anëtarëve të komisionit	Funksioni/pozita
1		
2		
3		
4		
5		

Procesverbali  
(të shënohen lokacionet e vizituara me shqyrtimet e bëra dhe gjetjet)

Tabela përmbledhëse e vizitës

Identifikimi i treguesit			Vlerat e raportuara		Gjetjet gjatë vizitës dhe konstatimet	
Nr	Nr. Referent i treguesit	Emërtimi i treguesit	Vlera e raportuar e treguesit	Përshkrimi dhe vlerat e raportuara	Përshkrimi i gjetjeve në terren dhe konstatimi për të dhënat e shqyrtuara gjatë vizitës.	Dëshmitë e mbledhura (psh. foto...etj).
1						
2						
3						

Nënshkrimi i antarëve të komisionit të vizitës

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_



4. \_\_\_\_\_

5. \_\_\_\_\_

## Shtojca 4: Procedura e menaxhimit të ndryshimeve në SMPK

### 1. Hyrje

Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) është një pjesë kritike e infrastrukturës së shërbimeve publike të Kosovës. Ai i siguron Qeverisë, komunave, palëve të interesuara dhe donatorëve informacion mbi performancën e një game të gjerë të shërbimeve komunale dhe qeverisjes demokratike, si dhe mundëson krahasimin ndërmjet komunave dhe krahasimet e performancës nëpër vite. Bartësi i SMPK është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe ky sistem gjithnjë e më shumë po përdoret edhe nga Ministrinë e tjera që janë përgjegjëse për politikën dhe financimin e disa shërbimeve kyçe të ofruara nga komunat.

Një nga arsyet kryesore për suksesin në rritje (si një instrument i përmirësimit të qeverisjes demokratike edhe shërbimeve publike) ka qenë besueshmëria e tij dhe fakti që palët e interesuara kanë besim në rezultatet e tij. Ky besim është i bazuar në një numër karakteristikash të SMPK, përfshirë përkufizimet e qarta dhe të hollësishme të treguesve të performancës dhe procedurave të tij të hollësishme dhe rigoroze për verifikimin e të dhënave.

SMPK është zhvilluar dhe ndryshuar që nga fillimi i tij në vitin 2008. Ka pasur dy rishikime të mëdha gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, sisteme si SMPK gjithmonë iu nënshtrohen ndryshime të vazhdueshme. Arsyet për ndryshim janë më të ndryshme:

- Mund të ketë interpretime të ndryshme për kuptimin e një rezultati ose treguesi, të cilat duhet të sqarohen;
- Mund të ketë gabime në dokumentacionin që duhet të korrigjohen;
- Mund të ketë një ndryshim të politikave që çon në një përcaktim të një treguesi ose rezultati;
- Fushat, rezultatet ose treguesit e rinj mund të shtohen ose fshihen;
- Përvoja mund të tregojë që një procedurë në SMPK duhet të modifikohet ose zëvendësohet.

Ndryshimet që rregullohen me këtë dokument janë përshkruar në tabelën vijuese.

### 1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj procedure është përshkrimi i mënyrës se si realizohen ndryshimet në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK).

Kjo procedurë do të specifikojë qartë se kush është përgjegjës për iniciimin, zhvillimin, aprovimin dhe zbatimin e ndryshimeve në sistem. Kjo është e nevojshme të hartohet dhe të respektohet me qëllim të sigurimit të efektivitetit të sistemit si dhe me qëllim që komunat raportuese të njoftohen me kohë me ndryshimet për të qenë në gjendje të marrin masat e nevojshme.

Menaxhimi i ndryshimit duhet të sigurojë që të reflektohen më mirë rezultatet e synuara, ndryshimet janë më tepër të orientuara drejt produkteve dhe rezultateve dhe mbështeten në të dhëna të sakta që raportohen nga komunat.

### 1.2 Fushëveprimi

Ky dokument aplikohet në Departamentin e Performancës dhe Transparencës Komunale (DPTK) në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe rregullon procesin e realizimit të ndryshimeve në SMPK ekzistuese ose në SMPK të ardhme. Ndryshimet që rregullohen me këtë dokument janë të përshkruara në tabelën në vijim.

Natyrë e çështjes që kërkohet të adresohet/ndryshohet	Natyrë e ndryshimit
Ndryshim minor, jo shumë i rëndësishëm	Qartësimi i një përkufizimi, rishikimi i formularëve standardë, ndryshimi i ndonjë formule, i afateve për raportim;
Ndryshim i rëndësishëm	Ndryshim i treguesve, largim i treguesve për të cilët ka vështirësi në matje, zëvendësim i treguesve ekzistues me tregues të rinj, modifikime të tjera për të mundësuar matjen më të mirë të performancës së komunave;
Rishikim i tërësishëm i sistemit	Rishikimi i objektivave, fushave, treguesve që mund të ketë efekt në ndryshimin e tërësishëm të sistemit;
Ndryshim emergjent	Kërkesa për një ndryshim të menjëhershëm, duke e anashkaluar përkohësisht procesin e kontrollit të ndryshimit, p.sh ndryshime që janë të domosdoshme për Grantin e performancës komunale.

### 1.3 Rolet dhe përgjegjësitë

Bartësi i procedurës për menaxhimin e ndryshimeve në SMPK është Departamenti për Performancë dhe Transparencë komunale në MAPL. Specifikisht, përgjegjës për zbatimin e procedurës është Udhëheqësi i DPTK-së.

Përgjegjësitë e tij/saj janë:

- ◁ Të zbatoj procedurën e kontrollit të ndryshimit të përcaktuar në këtë dokument,
- ◁ Raporton te Sekretari i përgjithshëm në mënyrë periodike për funksionin e procedurës, përfshirë të gjitha ndryshimet e realizuara si rezultat i procedurës,
- ◁ Të iu përgjigjet kërkesave për ndryshime dhe të gjitha komentet që pranohen nga palët e ndryshimeve në proces të ndryshimit,
- ◁ Mban regjistrin e gjithëpërfshirjes për ndryshimet e realizuara, përfshirë këshillat/vërejtjet e përdoruesve të SMPK-së,
- ◁ Koordinon komunikimin për ndryshimet e realizuara për të gjitha palët e interesit
- ◁ Koordinon detyrat në azhurnimin e të gjitha dokumenteve ndërlidhës të SMPK, përfshirë ndryshimet në sistemin elektronik, si dhe shpërndarjen e dokumenteve me të gjitha palët e interesit
- ◁ Në mënyrë aktive, mbikqyrë funksionimin e SMPK duke u siguruar që SMPK përshtatet me mjedisin e gjerë të politikave Qeveritare.
- ◁ Duke komunikuar me palët e interesit, informohet në mënyrë aktive, për funksionimin e SMPK.

Palët tjera të në këtë procedurë përfshijnë:

Roli	Përshkrimi
Parashtruesi i kërkesës	Personi i cili parashtron kërkesë për ndryshim. Mund të jetë secili nga palët e interesit.
Person autorizues për ndryshime	Sekretari i përgjithshëm i MAPL-së Sekretari aprovon kërkesat iniciuese për ndryshim, për të cilat njoftohet nga udhëheqësi i DPTK-së
Palët e interesit	MAPL (Ministri, Sekretari, DPTK, departamentet funksionale) Komuna: strukturat menaxhuese të SMPK-së në komunë (kryetari, koordinatori, zyrtari raportues) Palë të tjera: donatorët, shoqëria civile
Departamenti për performancë dhe transparencë komunale	Nën autoritetin e udhëheqësit, mban regjistrin e kërkesave për ndryshim dhe përmirësim të funksionimit të SMPK.

	Vlerëson kërkesat dhe inicon ndryshimin dhe rishikimin sipas nevojës. Mban inventarin e ndryshimeve të bëra dhe sigurohet që të azhurnohen të gjitha dokumentet përcjellëse.
Grupi punues brenda MAPL	Grupi punues për ndryshime kryesohet nga udhëheqësi i DPTK-së, në përbërje të Divizionit për Performancë.  Në konsultim me udhëheqësin harton propozimet për ndryshime minore;
Grupi punues përfshirë ekspertët dhe palët e tjera të interesit	Themelohet me vendim të sekretarit të përgjithshëm. Ka mandat për një mandat të ndryshimit. Nëse ka cikle të reja të ndryshimit, ri-vendoset grupi i njejtë apo me anëtarë tjerë. Përbëhet nga udhëheqësi i DPTK-së (kryesues), Divizioni për performancë, 2 përfaqësues të komunave, donatorët dhe shoqëria civile.  Nën udhëheqjen e udhëheqësit të DPTK-së hartojnë propozimin për ndryshime të rëndësishme ose rishikim të tërësishëm të sistemit;
Udhëheqësi i DPTK-së	Koordinon procesin e ndryshimeve të propozuara dhe i dërgon për aprovim tek sekretari i MAPL
Zyrtarët zbatues	Nën autoritetin e udhëheqësit të DPTK-së ekzekutojnë ndryshimet e kërkuara sipas procedurës dhe reflektojnë ndryshimet në dokumentet e ndërlidhura (përfshirë sistemin elektronik) si dhe ofrojnë këshilla për palët e interesit dhe konsideron organizimin e trajnimeve në rast nevojë.

## 2. Procedura

Departamenti për Performancës dhe Transparencës Komonale në mënyrë sistematike bën inventarizimin e nevojave për ndryshime dhe përmirësime të funksionimit të SMPK-së.

Procedura për realizimin e ndryshimeve do të përfshijë:

- Pranimin e kërkesës për ndryshim; (kërkesa për ndryshim duhet të arsyetohet me të dhëna faktike dhe të dorëzohet me shkrim në DPTK)Vlerësimin e kërkesës nga DPKT;
- Propozimi i DPTK te Sekretarja per ndryshim te SMPK
- Vendimi i Sekretares per nryshim, dhe nese eshte e nevojshme themelimi i grupeve punuese
- Dërgimin e kërkesës tek grupet përkatëse punuese sipas nevojës;
- Hartimin e propozimit për ndryshim;
- Konsultimi me palët e interesit
- Pilotimin, nëse është e nevojshme;
- Konsultimi i propozimit me palët e interest;
- Koordinimin e procedurave të aprovimit me sekretarin e përgjithshëm (si miratues i fundit);
- Informimi i palëve të inetesit
- (Ri)draftimin e të gjitha dokumenteve të ndërlidhura; përfshirë ndryshimet në sistemin e elektronikTrajnimin e zyrtarëve përgjegjës dhe
- Zbatimin dhe dokumentimin.

### 2.1 Frekuenca

Ndryshimet në SMPK mund të bëhen më së shumti një herë në vit, deri në maj të vitit vijues. Ndryshimi hyn në fuqi në janar të vitit vijues. Në qoftë se ndryshimet ndodhin pas muajit maj, ndryshimet hyjnë në

fuqi në vitin n+2. Sidoqoftë, disa ndryshime mund të zbatohen edhe brenda vitit, si rastet kur është një kërkesë urgjente apo nevoja për ndonjë përmirësim minor. Në të gjitha rastet, Drejtori/sha e DPTK vlerëson kohën e zbatimit të ndryshimit.

## 2.2 Inicimi i kërkesës për ndryshim

Çdo palë e interesit mund të dërgojë kërkesë për ndryshim. Kërkesa për ndryshim paraqitet në DPTK apo në raste të tjera te Sekretari i përgjithshëm. Çështja që duhet adresuar identifikohet gjatë kësaj faze dhe kërkesa për ndryshim regjistrohet.

## 2.3 Vlerësimi

Departamenti i Performancës dhe Transparencës Komunale e bën vlerësimin e rëndësisë dhe natyrës së kërkesës. Departamenti mund ta propozoj te sekretari i MAPL-së refuzimin e kërkesës nëse nuk ka bazë për një ndryshim të tillë. Në qoftë se kërkesa është e arsyeshme dhe aprovohet në bashkëpunim me Sekretarin e përgjithshëm. DPTK mund ta përcjellë kërkesën për trajtim tek grupet punuese për të zhvilluar propozimet për ndryshim në varësi të rëndësisë dhe natyrës së çështjes që adresohet.

## 2.4 Konsultimi

Varësisht nga natyra e ndryshimit, përfshirja e palëve të interesit është e domosdoshme, qysh në fazë të hershme dhe deri kur të hartohen propozimet specifike.

Propozimet e dala nga grupet punuese për ndryshim i dërgohen për aprovim udhëheqësit të DPTK-së.

## 2.5 Pilotimi

Varësisht nga natyra e ndryshimit, MAPL mund të vendosë që të bëjë pilotimin e ndryshimeve. Në rast se pilotimi rezulton i suksesshëm, atëherë bëhet trajnimi i zyrtarëve të përfshirë dhe fillon zbatimi. Në të kundërtën, rezultatet e pilotimit mund të qojnë në ridraftimin e dokumenteve para se të fillojë trajnimi dhe zbatimi i ndryshimeve.

## 2.6 Aprovimi

Udhëheqësi i DPTK-së aprovon kërkesën për ndryshim dhe të njetën e kumton te Sekretari/ja e MAPL.

## 2.7 Informimi i palëve të interesit

Të gjitha ndryshimet (edhe ndryshimet e realizuara brenda vitit), duhet t'ju kumtohen të gjitha palëve të interesit sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të gjithë të punojnë me të njëjtin skenar. Në rast të ndryshimeve në dokumentet përcjellëse të gjitha duhet të ju dërgohen përdoruesve dhe të vendosen në ëeb faqet të MAPL.

## 2.8 Draftimi i dokumenteve dhe komunikimi i ndryshimit

Pas aprovimit të ndryshimit, doracaku i përgjithshëm i sistemit duhet të ndryshohet me të gjitha dokumentet përcjellëse si udhëzimet e punës dhe formularët e raportimit, aty ku është e nevojshme. Mund të jetë i nevojshëm edhe plotësim-ndryshimi i Rregullores së SMPK-së. Të gjitha këto ndryshime duhet të komunikohen tek komunat. Zyrtarët përgjegjës duhet të trajnohen për të zbatuar ndryshimet. Sistemi elektronik poashtu duhet të përditësohet për të reflektuar ndryshimet e bëra.

## 2.9 Zbatimi dhe dokumentimi

E gjithë procedura e ndryshimit që nga pranimi i kërkesës për ndryshim deri tek komunikimi i ndryshimit duhet të dokumentohet.

## Shtojca 5: Fushat, rezultatet dhe treguesit e SMPK-së

### FUSHA 1 - SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE

Emri i fushës është “Shërbimet Publike Administrative”. Fusha përfshinë shërbimet publike administrative (SHPA) dhe menaxhimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizikë dhe juridikë drejtuar organeve komunale për çështjet që lidhen me kompetencat e komunave dhe të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve në Komunë. Njëkohësisht, kjo fushë matë gatishmërinë e komunave për të ofruar këto kërkesa online.

Baza ligjore për procedurat e ofrimit të shërbimeve publike administrative dhe trajtimin e kërkesave të qytetarëve nga ana e organeve komunale është e shpërndarë në një numër të madh të akteve ligjore dhe nënligjore. Ligji për Procedurën Administrative<sup>2</sup> paraqet kornizën kryesore dhe të përgjithshme që përcakton parimet, procedurat dhe mekanizmat e përgjithshëm për trajtimin e kërkesave të palëve dhe zhvillimin e procedurave administrative. Megjithatë, shërbimet e veçanta administrative rregullohen qoftë me akte ligjore ose me akte nënligjore të veçanta.

Matja e performancës së komunave për ofrimin e shërbimeve publike administrative bëhet për të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me shërbimet publike administrative. Në kuadër të shërbimeve publike administrative hyjnë të gjitha kërkesat të cilat menaxhohen nga QSHQK.

Duke pas parasysh se ekzistojnë lloje të shumta të kërkesave, të cilat trajtohen nga struktura të ndryshme të komunës, SMPK matë performancën e komunës përkatëse vetëm për kërkesat që menaxhohen nëpërmjet Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Komunë (QSHQK). Në QSHQK bëhet pranimi dhe regjistrimi i kërkesave dhe i parashtresave të qytetarëve.

Informatat e prodhuara nga matja e performancës së kësaj fushe janë të rëndësishme për strukturat e pushtetit lokal për të kuptuar më mirë shkallën dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike administrative, për MPL për të kuptuar shkallën e ofrimit të këtyre shërbimeve dhe respektimin e afateve ligjore, për punën e strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe palëve tjera të interesit që merren me ofrimin e këtij shërbimi.

Arritjet e komunës në fushën e SHPA maten nëpërmjet një rezultati dhe katër treguesve përkatës.

#### Rezultati 1.1 - Ofrimi i shërbime administrative sipas kërkesave të qytetarëve

Rezultati pasqyron arritjet e komunës përkatëse në efektivitetin dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike administrative dhe menaxhimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizikë dhe juridikë drejtuar organeve komunale nëpërmjet Qendrave për Shërbimin e Qytetarëve në Komuna (QSHQK)<sup>3</sup>. Në komunë parashtrohen kërkesa të llojeve të ndryshme dhe për nevoja të ndryshme të qytetarëve. Edhe pse të gjitha kërkesat e qytetarëve do të duhej të parashtroheshin nëpërmjet QSHQK, megjithatë një numër i tyre kalojnë nëpërmjet kanaleve tjera dhe strukturave organizative në komunë. Ato kërkesa të cilat nuk parashtrohen nëpërmjet QSHQK, nuk pasqyrohen nëpërmjet këtij rezultati.

<sup>2</sup> Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (miratuar me 25 maj 2016)

<sup>3</sup> Udhëzimi administrativ i MPL 2018/03 për Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komuna

Rezultati pasqyron përqindjen e lëndëve të shqyrtuara gjatë vitit, të cilat janë regjistruar në QSHQK, me theks të veçantë në respektimin e afateve ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen lëndëve të parashtuara nga qytetarët që janë kompetencë e komunës.

Matja e shkallës së arritjes së rezultatit 1.1. bëhet nëpërmjet tre treguesve kryesor: treguesi 1.1.1; treguesi 1.1.2; 1.1.3 dhe treguesi 1.1.4.

### **Treguesi 1.1.1 - Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim të matë shkallën e performancës, përkatësisht efikasitetin e komunës në shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe të palëve të ndryshme të interesit. Komunitat janë të obliguara që t'i shqyrtojnë të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe të marrin vendime meritore për shërbimet publike administrative në bazë të ligjit. Treguesi matë vetëm kërkesat apo lëndët e proceduara nëpërmjet QSHQK.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë përqindjen e shqyrtimit të kërkesave për të gjitha lëndët që menaxhohen nëpërmjet QSHQK. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në ofrimin e SHPK, por jo plotësisht, për shkak se një numër i caktuar i kërkesave të qytetarëve nuk menaxhohen nëpërmjet QSHQK. Komunitat inkurajohen që t'i menaxhojnë të gjitha kërkesat apo parashtresat e qytetarëve dhe palëve tjera të interesit vetëm nëpërmjet QSHQK.

#### **Sqarime të hollësishme**

Lëndë të shqyrtuara janë të gjitha ato kërkesa të cilat janë të drejtuara tek organet komunale për katëse, të regjistruara në Sistemin e QSHQK dhe për të cilat është kthyer një përgjigje qoftë pozitive apo negative qytetarëve nga ana e organeve përgjegjëse komunale. Këtu përfshihen lëndët kërkesat si ato për: qasje në dokumente apo informatë publike, certifikata të gjendjes civile, shërbime publike, lejet për shërbime publike, shfrytëzimin e hapësirave të komunale publike, lejet ndërtimore, urbanistike dhe kërkesat kadastrale, pëlqimet mjedisore, etj. Po ashtu, bëhet fjalë për lëndët të cilat janë paraqitur në vitin raportues, lëndët e trashëguara nga viti paraprak dhe ato të bartura në vitin vijues për të cilat komuna ka dhënë përgjigje brenda afatit të paraprë me ligj deri më 15 janar të vitit vijues. Ndërsa lëndët të cilat janë bartur në vitin vijues dhe afati për përgjigje sipas legjislacionit përkatës ka kaluar gjatë vitit të raportimit, llogariten si lëndë të pashqyrtuara. QSHQK-ja obligohet të mban evidencë të saktë për të gjitha kërkesat e qytetarëve të adresuara në komunë dhe duhet të paraqes raport statistikor tek drejtorja e administratës për lëndët e pranuar, të përfunduara dhe të pazgjidhura<sup>4</sup>. Andaj, këto evidenca shërbejnë për të dhënat e këtij treguesi.

#### **Kategoria**

<sup>4</sup> Udhëzim i administrativ i MPL 2018/03 për Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komuna – Neni 10.



Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 1.1.1. mblidhen dy lloj të të dhënave:

1. Gjithsej numri i lëndëve të parashtruara gjatë vitit nga qytetarët dhe palët tjera të interesit dhe
2. Numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e komunës.

Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e lëndëve të parashtruara me numrin e lëndëve të shqyrtuara, shumëzuar me 100.

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi kryesor** i të dhënave të këtij treguesi është sistemi elektronik për menaxhimin e lëndëve në QSHQK. Ky sistem gjithashtu është i lidhur në rrugë elektronike me faqen elektronike të MPL. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga dosjet që mbahen në QSHQK.

Lëndët të cilat pranohen në QSHQK regjistrohen dhe procedohen nëpërmjet Sistemit për Menaxhimin e Përmbajtjes digjitale të informacionit.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

## Treguesi 1.1.2 - Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të matë shkallën e performancës, përkatësisht efektivitetin dhe efikasitetin e komunës përkatëse në shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe të palëve të ndryshme të interesit brenda afateve ligjore. Komunitat janë të obliguara që t'i shqyrtojnë të gjitha kërkesat e qytetarëve gjatë vitit dhe të marrin vendime meritore për shërbimet publike administrative në bazë të ligjit.

### Çfarë matet?

Treguesi matë vetëm kërkesat apo lëndët e proceduara nëpërmjet QSHQK. Treguesi matë për qindjen e kërkesave të shqyrtuara gjatë vitit brenda afateve ligjore për të gjitha ato lëndë të cilat janë shqyrtuar sipas treguesit 1.1.2.

### Sqarime të hollësishme

Afatet për përgjigje ndaj kërkesave të qytetarëve dallojnë varësisht prej natyrës së kërkesave. Afatet përcaktohen me akte ligjore dhe nënligjore<sup>5</sup>. Këtu nuk hyjnë kërkesat që janë të miratuara në heshtje pasi ato kërkesa nuk konsiderohen 'të shqyrtuara' siç e kërkon edhe treguesi. Komuna duhet t'i respektojë afatet ligjore gjatë shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve. Shërbimi është i vlefshëm vetëm kur ofrohet në kohën e duhur. Treguesi matë mjaftë saktë nëse kërkesat janë shqyrtuar brenda afateve kohore të përcaktuara me ligjet në fuqi apo jo, por nuk mund të matë nëse përgjigjet (vendimet) e organeve komunale kanë qenë në përputhje me ligjin apo jo. Gjithashtu një numër i kërkesave që nuk janë menaxhuar nga QSHQK nuk mund të maten pavarësisht a kanë qenë në përputhje me afatet ligjore apo jo. Treguesi synon t'i nxis organet komunale që ofrimi i shërbimeve administrative për qytetarët dhe palët e interesit të ofrohet me kohë apo ashtu si është përcaktuar me dispozita ligjore.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 1.1.2. mbliidhen dy lloj të të dhënave:

1. Gjithsej numri i lëndëve të shqyrtuara gjatë një viti nga ana e komunës dhe
2. Numri i lëndëve të cilat janë shqyrtuar brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Për të kuptuar se cilat lëndë janë shqyrtuar brenda afateve ligjore, duhet të dihet koha e paraqitjes së secilës kërkesë dhe koha e shqyrtimit të lëndëve apo i kthimit të përgjegjës parashtuesit të kërkesës për të vlerësuar nëse shqyrtimi është bërë brenda afatit ta paraparë me ligj apo jo. Krahas kësaj, me ndihmën e sistemit elektronik, duhet të grupohen kërkesat sipas afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve, sepse jo të gjitha kërkesat e kanë afatin e njëjtë ligjor për kthimin e përgjigjes. Me të kuptuar numrin e lëndëve të cilat janë shqyrtuar brenda afateve ligjore, e kuptojmë edhe numrin e lëndëve të cilat nuk janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Komuna tregon performancë pozitive nëse e rritë numrin e lëndëve të shqyrtuara brenda afateve ligjore.

Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e lëndëve të shqyrtuara brenda afateve ligjore me numrin e përgjithshëm të kërkesave të shqyrtuara brenda vitit raportues, shumëzuar me 100.

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$\text{Treguesi} = \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 100$$

---

<sup>5</sup> Afati i ligjor për kërkesat për qasje në dokumente publike është shtatë (7) ditë (duke numëruar edhe ditët e fundjavës dhe festat) me mundësi të shtyrjes edhe për 15 ditë kur kërkesa përmban një numër të madh të dokumenteve apo dokumenti i prodhohet jashtë institucionit ku është kërkuar (Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike – Neni 12). Afati i ligjor për kërkesat e lejeve ndërtimore është 30 ditë për ndërtimet e kategorisë I, dhe 45 ditë për ndërtimet e kategorisë II dhe III (Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim – Neni 17). Ligji Nr 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative – Neni 98 përcaktan se afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është 45 ditë nga fillimi i saj. Po ashtu, ky ligj përcaktan me Nenin 100 që nëse organi administrativ nuk njofton palën për aktin administrativ brenda 45 ditëshit, kërkesa e bërë vlerësohet si e pranuar në tërësi dhe akti administrativ vlerësohet të jetë miratuar, e njohur si "akt administrativ i miratuar në heshtje."

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** i të dhënave të këtij treguesi është sistemi elektronik për menaxhimin e lëndëve në QSHQK. Ky sistem gjithashtu është i lidhur në rrugë elektronike me faqen elektronike të MPL. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga dosjet që mbahen në QSHQK. Të dhënat mund të verifikohen në dosjet e lëndëve në zyrat për shërbim me qytetarët në komuna.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 1.1.3 - Koha mesatare e shqyrtimit të lëndëve administrative gjatë vitit

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të matë shkallën e efikasitetit të komunës në shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe të palëve të ndryshme të interesit. Komunitat janë të obliguara që t'i shqyrtojnë të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe të marrin vendime meritore për shërbimet publike administrative në bazë të ligjit. Treguesi matë vetëm kërkesat apo lëndët e proceduara nëpërmjet QSHQK. Treguesi matë kohën mesatare të shqyrtimit të kërkesave për të gjitha lëndët që menaxhohen nëpërmjet QSHQK. Megjithatë, ky tregues do të fillojë të matet vetëm pas funksionalizimit të sistemit elektronik të SMPK-së, pasi koha mesatare e shqyrtimit të lëndëve nuk matet ndryshe objektivisht.

#### Çfarë matet?

Afatet për përgjigje ndaj kërkesave të qytetarëve dallojnë varësisht prej natyrës së kërkesave dhe legjislacionit që i përcakton ato. Afatet përcaktohen me akte ligjore dhe nënligjore ose përcaktohen nga ana e vetë organit publik<sup>6</sup>. Treguesi në krahasim me treguesit paraprak 1.1.1 dhe 1.1.2 të cilët masin numrin total të lëndëve të shqyrtuara gjatë vitit dhe numrin e lëndëve të shqyrtuara brenda afateve ligjore, ky tregues synon të matë efikasitetin e komunës nga aspekti i kohëzgjatjes së shqyrtimit të lëndëve sipas kategorive përkatëse të kohëzgjatjes të përcaktuara me ligjet në fuqi. Ky tregues synon të nxis komunitat që t'i shqyrtojnë lëndët në një kohë sa më të shkurtër të mundshëm edhe në kuadër të afatit ligjor. Shpejtësia e shqyrtimit të lëndëve matet me numrin e ditëve apo me mesataren e numrit të ditëve të nevojshme për secilën kategori të lëndëve të përcaktuara sipas ligjeve. Sa më pak ditë që merr komuna në shqyrtimin e lëndëve të qytetarëve, aq më efikase është ajo dhe po aq më e mirë është performanca e komunës përkatëse.

#### Sqarime të hollësishme

Kjo detyrë rrjedh nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 10 sipas të cilit "Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative". Prandaj edhe lëndët për të cilat matet koha mesatare e shqyrtimit ndahen në disa kategori sipas afateve që i përcakton legjislacioni përkatës apo organi publik. Sipas kësaj, lëndët sipas afateve kategorizohen si më poshtë:

<sup>6</sup> Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji, neni 78.1, 78.2 dhe 78.3.

1. Kategoria e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 7 ditor<sup>7</sup>
2. Kategoria e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 10 ditor
3. Kategoria e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 15 ditor
4. Kategoria e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 30 ditor dhe
5. Kategoria e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 45 ditor<sup>8</sup>

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit – ndikimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 1.1.3. mblidhen 15 lloje të të dhënave si në vijim:

#### Numri i lëndëve të shqyrtuara sipas kategorive

1. Numri i lëndëve të shqyrtuara për kategorinë e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 7 ditor
2. Numri i lëndëve të shqyrtuara për kategorinë e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 10 ditor
3. Numri i lëndëve të shqyrtuara sipas kategorisë së lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 15 ditor
4. Numri i lëndëve të shqyrtuara për kategorinë e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 30 ditor
5. Numri i lëndëve të shqyrtuara për kategorinë e lëndëve të cilat duhet të shqyrtohen brenda afatit 45 ditor

#### Numri i ditëve për shqyrtim sipas kategorive:

1. Numri i ditëve për shqyrtimin e lëndëve me afat 7 ditor
2. Numri i ditëve për shqyrtimin e lëndëve me afat 10 ditor
3. Numri i ditëve për shqyrtimin e lëndëve me afat 15 ditor
4. Numri i ditëve për shqyrtimin e lëndëve me afat 30 ditor
5. Numri i ditëve për shqyrtimin e lëndëve me afat 45 ditor

#### Numri i lëndëve që i tejkalojnë afatet përkatëse

1. Numri i lëndëve me tejkalim të afatit 7 ditor
2. Numri i lëndëve me tejkalim të afatit 10 ditor
3. Numri i lëndëve me tejkalim të afatit 15 ditor
4. Numri i lëndëve me tejkalim të afatit 30 ditor
5. Numri i lëndëve me tejkalim të afatit 45 ditor

---

<sup>7</sup> Ligji Nr. 06/081 për Qasje në Dokumente Publike.

<sup>8</sup> Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim.

Mbledhja dhe raportimi i të dhënave bëhet duke i klasifikuar lëndët sipas kategorive përkatëse. Lëndët për shqyrtim me afat ligjor prej 7 ditëve vendosen në kategorinë e parë, duke përfshirë të gjitha ato lëndë që janë shqyrtuar brenda këtij afati dhe ato të cilat e kanë tejkaluar këtë afat. Kështu ngjashëm mblidhen dhe raportohen të gjitha të dhënat për secilën kategori përkatëse.

Treguesi llogaritet duke nxjerr mesataren e kohës (numrin mesatar të ditëve) për shqyrtimin e lëndëve për secilën kategori dhe mesataren e përgjithshme që nxjerrët duke nxjerrë mesataren e të gjitha mesatareve sipas formulave në vijim:

## Formula e llogaritjes

### I. Formula për llogaritjen e mesatares së ditëve sipas kategorive të lëndëve

1. mesatarja e ditëve për lëndët me afat 7 ditor:  $\frac{\text{numri i ditëve}}{\text{numri i lëndëve}}$
2. mesatarja e ditëve për lëndët me afat 10 ditor:  $\frac{\text{numri i ditëve}}{\text{numri i lëndëve}}$
3. mesatarja e ditëve për lëndët me afat 15 ditor:  $\frac{\text{numri i ditëve}}{\text{numri i lëndëve}}$
4. mesatarja e ditëve për lëndët me afat 30 ditor:  $\frac{\text{numri i ditëve}}{\text{numri i lëndëve}}$
5. mesatarja e ditëve për lëndët me afat 45 ditor:  $\frac{\text{numri i ditëve}}{\text{numri i lëndëve}}$

### 2. Formula për llogaritjen e mesatares së ditëve për të gjitha kategoritë

Vlera e treguesit / mesatarja e përgjithshme e ditëve për lëndët me afat ligjor =  $[(7 \text{ ditor}) + (10 \text{ ditor}) + (15 \text{ ditor}) + (30 \text{ ditor}) + (45 \text{ ditor})] / 5$

Formula:

$$Treguesi = \frac{(7 \text{ ditor}) + (10 \text{ ditor}) + (15 \text{ ditor}) + (30 \text{ ditor}) + (45 \text{ ditor})}{5}$$

Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** Burimi i të dhënave për këtë tregues është sistemi elektronik për menaxhimin e lëndëve në QSHQK. Ky sistem gjithashtu është i lidhur në rrugë elektronike me faqen elektronike të MPL. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga dosjet që mbahen në QSHQK. Të dhënat mund të verifikohen në dosjet e lëndëve në zyrat për shërbim me qytetarët në komuna.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### **Treguesi 1.1.4 - Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim të matë performancën komunal në instalimin e qeverisë elektronike (e-qeveria). E-qeveria e rrit efikasitetin e shërbimeve administrative komunale, lehtëson punën e tërheqjes së dokumenteve që kërkohen nga komuna dhe parandalon korrupsionin. Për atë legjislacioni dytësor që Qendrat për Shërbime të Qytetarëve në Komuna “duhet të informoj dhe të ofroj shërbime të hapura online në të cilën do të kenë qasje të barabartë të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit.”<sup>9</sup>

#### **Çfarë matet?**

Ky tregues matë sa prej shërbimeve administrative ofrohen në mënyrë elektronike përmes Internetit ose duke shfrytëzuar e-kioskën komunal. Pra treguesi nuk matë në çfarë mase përdoren por vetëm sa prej dokumenteve që lëshohen nga komuna për qytetarë mundësohen të tërhiqen në formë elektronike përmes ueb-faqes së komunës dhe janë funksionale.

#### **Sqarime të hollësishme**

Shërbime administrative këtu mendohet dokumentet kyçe që ofrohen nga komuna për qytetarë, biznese dhe kategori tjera jashtë komunës. Këtu përfshihen dokumentet të gjendjes civile, dokumente të kadastrit dhe urbanizmit si dhe faturat për shërbime që ofrohen nga komuna. Ofrimi i shërbimit elektronik nënkupton aplikimi dhe tërheqja përmes Internetit ose përmes e-kioskut (kioskut elektronik). Pra, nëse një dokument nga komuna mundësohet të tërhiqet nga qytetari pa patur kontakt direkt me një zyrtarë komunal, atëherë konsiderohet që ai shërbim administrative ofrohet në mënyrë elektronike nga komuna. Ky tregues vlerëson ofrimin e shërbimeve kyçe në forma elektronike dhe për atë vlerëson dhjetë (10) shërbime administrative kyçe. Mirëpo, institucionet komunal ofrojnë shumë më shumë shërbime tjera të cilat mund t'i ofrojnë online.

#### **Të dhënat**

Të dhënat:

E dhëna 1: Certifikata e lindjes e lëshuar formë elektronike;

E dhëna 2: Certifikata e martesës; e lëshuar formë elektronike;

<sup>9</sup> Udhëzimi i administrativ i MPL 2018/03 për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komuna – Neni 6.4.

- E dhëna 3: Certifikata e vdekjes e lëshuar formë elektronike;
- E dhëna 4: Certifikata e shtetësisë e lëshuar formë elektronike;
- E dhëna 5: Certifikata e gjendjes familjare e lëshuar formë elektronike;
- E dhëna 6: Certifikatën e pronës e lëshuar formë elektronike;
- E dhëna 7: Fatura e mbeturinave e lëshuar formë elektronike;
- E dhëna 8: Fatura për tatimin mbi pronë e lëshuar formë elektronike;
- E dhëna 9: Leje të ndërtimit e lëshuar formë elektronike;
- E dhëna 10: Lejet mjedisore e lëshuar formë elektronike;

### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të **prodhimit dhe përmbushet** sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Formula e llogaritjes**

$$Treguesi = 10 * (\text{secili dokument i ofruar online})$$

### **Burimi kryesor i të dhënave**

Burimi i të dhënave për këtë tregues është Drejtoria për Administratë e komunës. Të dhënat mund të verifikohen me testimin e e-kioskave në komunë apo kërkesave online.

## FUSHA 2 - TRANSPARENCA KOMUNALE

Emri i fushës është “Transparenca Komunale”. Sigurimi i transparencës nga ana e komunave është një nga parimet e përgjithshme të përcaktuara nga Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 123. parag. 4), dhe shumë akte ligjore dhe nënligjore të cilat obligojnë komunat që të punojnë në pajtim me këtë parim. Qasja në dokumente publike si një nga segmentet e transparencës gjithashtu është një nga parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 41). Akte të veçanta vendosin rregulla dhe specifika të veçanta përmes të cilave sigurohet transparenca e punës së komunave në secilin segment të punës së saj.

Në rastet kur komuna nuk mund të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, ajo krijon mekanizma të përshtatshëm për t’i informuar ata për punën e organeve komunale, nëpërmjet qasjes në dokumente fizike publike, qasjes në dokumente elektronike në faqet zyrtare të komunës, në veçanti sigurimi i qasjes në planifikimin e buxhetit dhe shpenzimin e tij, si dhe qasjen që ka të bëjë me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës.

Matja e performancës së komunave në fushën e transparencës ka një rëndësi të madhe të vetëkontrollit të punës së komunave dhe të institucioneve tjera të pushtetit lokal dhe mundëson MPL dhe organet tjera qendrore në monitorimin punës së komunave me qëllim të parandalimit të shkeljeve ligjore. Komunat në bashkëpunim me institucionet qendrore, nëpërmjet matjes së performancës së tyre, identifikojnë prapambetjet në punë, gabimet eventuale dhe mundësohet marrja e masave të nevojshme për përmirësimin e tyre.

Arritjet e komunës në fushën e transparencës maten nëpërmjet dy rezultateve dhe 7 treguesve përkatës.

### Rezultati 2.1 - Sigurimi i qasjes në të dhëna komunale

Ky rezultat përfaqëson arritjen e publikimit të informatës publike dhe dokumenteve publike të komunës në mënyrë elektronike. Rezultati përfshin publikimin e dokumenteve kryesore në ueb-faqe të komunës si dhe njoftimin e transmetimin e seancave të kuvendit komunal. Ky rezultat përfaqëson arritjen kryesore të komunës në zbatimin e legjislacionit përkatës në fuqi që lidhet me transparencën Komunale<sup>10</sup>, transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave të kuvendit, publikimin e akteve komunale si dhe qasjen në dokumente publike.

Elementet që e pasqyrojnë më së miri transparencën e punës së komunave për këtë rezultat janë: publikimi i njoftimeve për pjesëmarrje të qytetarëve në mbledhjet e kuvendit komunal, transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave në ueb-faqe të komunës, qasja në dokumente publike, transparenca e të dhënave bazike në ueb-faqe të komunës si dhe publikimi i akteve të komunës në ueb-faqe.

Se deri në çfarë shkalle është arritur rezultati 2.1. e kuptojmë nëpërmjet matjes së treguesve 2.1.1; 2.1.2; 2.1.3, 2.1.4 dhe treguesit 2.1.5.

<sup>10</sup> MPL, Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr. 04/2018 për Transparencën Komunale



### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim të matë shkallën e zbatimit të obligimeve ligjore nga ana e kuvendeve komunale për të qenë të hapura ndaj publikut përmes njoftimeve të seancave me kohë dhe të transmetimit drejtpërdrejtë në kohë reale.

### Çfarë matet?

Treguesi matë se sa publike janë seancat e kuvendit komunal për t'u shikuar nga publiku i interesuar online dhe sa organet komunale i njoftojnë qytetarët e tyre për mbledhjet e kuvendit nëpërmjet publikimit të tyre në vendet që janë të qasshme për publikun.

### Sqarime të hollësishme

Seancat e kuvendit komunal duhet të bëhen publike 7 ditë para mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme (neni 43 për mbledhjet e kuvendeve dhe neni 45 për mbledhjet e komisioneve të kuvendit sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale). Në kuadër të njoftimit për mbledhjet e kuvendeve hyjnë edhe njoftimet që i bëhen MPL (Udhëzimi Administrativ i MPL 04/2018 për Transparencë Komunale, Rregulloret Komunale për Transparencë Komunale, Statutet Komunale). Publikimi me kohë i të gjitha informatave për mbledhje komunale i kontribuon drejtpërdrejt promovimit dhe zbatimit të transparencës në punën e komunës. Njoftimet publike shpallën në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës, së paku në mjetet e shkruara dhe elektronike të komunës përkatëse dhe në faqen elektronike zyrtare të komunës. Ndërsa, seancat e kuvendit transmetohen në kohë reale në ueb-faqe të komunës ashtu siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 04/2018 për Transparencë, Neni 4.8. Treguesi matë mjaftë saktë publikimin e njoftimeve për mbledhjet e kuvendit komunal dhe të komisioneve të tij, por nuk mat pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në komunë. Megjithatë me rëndësi për këtë tregues është krijimi i mundësive reale në bërjen publike të punëve të organeve komunale dhe ndjekjen e seancave në kohë reale nga publiku.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 2.1.1. mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i mbledhjeve të mbajtura të kuvendit komunal dhe
2. Numri i njoftimeve publike për mbledhjet e kuvendit.
3. Numri i mbledhjeve të kuvendit komunal të transmetuara drejtpërdrejt online në ueb-faqe

Krahas kësaj mblidhen edhe të dhëna të ngjashme për mbledhjet e komisioneve të kuvendit: gjithsej numri i mbledhjeve të komisioneve të kuvendit dhe gjithsej numri i njoftimeve apo ftesave publike për mbledhjet e komisioneve.

### Formula e llogaritjes

Llogaritja e të dhënave për matjen e treguesit bëhet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të njoftimeve për mbledhjet e kuvendit dhe të komiteteve të tij me numrin e përgjithshme të mbledhjeve të mbajtura të kuvendit dhe komisioneve të tij dhe shumëzohet me 100.

$$Treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 20 + \frac{e\ dhëna\ 3}{e\ dhëna\ 1} * 80$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Verifikimi i të dhënave bëhet duke krahasuar të dhënat e raportuara nga koordinatori komunal me të dhënat e publikuara në faqet zyrtare elektronike të komunës, me të dhënat dërguara në Divizionin për Monitorimin e Punës së Komunave (MPL) dhe në arkivin e kuvendit komunal.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 2.1.2 - Niveli i qasjes në dokumente publike nga qytetarët

### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të matë performancën e komunës në realizimin e kërkesave publike, që nuk ndalohen ligjërisht, të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit.

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e realizimit të kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare (publike), sipas dispozitave ligjore për qasje në dokumente publike (Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2015 për Transparencën në Komuna).

E drejta për të pasur qasje në dokumentet publike garantohet në aktet themelore të shtetit “çdo person gëzon të drejtën për të pasur qasje në dokumente publike”, ndërsa “dokumentet e institucioneve dhe organeve publike të autoriteteve shtetërore janë publike, përveç se për informatat të cilat janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë, sekreteve afariste tregtare ose klasifikimit të sigurisë” (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41).

### Sqarime të hollësishme

Qasja në dokument zyrtar nënkupton qasjen në të gjitha informatat e regjistruara në çfarëdo forme, të hartuara apo pranuar dhe mbajtura nga institucionet publike. Dokument zyrtar është çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audio vizuale të

prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik<sup>11</sup>.

## Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 2.1.2 nevojiten të mblidhen 2 lloje të të dhënave:

1. Numri i kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike në komunën përkatëse gjatë vitit dhe
2. Numri i dokumenteve që komuna iu ka dhënë qasje plotësisht apo pjesërisht sipas kërkesës.

Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e dokumenteve që komuna iu ka dhënë qasje plotësisht apo pjesërisht sipas kërkesës me numrin e përgjithshëm të kërkesave në gjuhët përkatëse për qasje në dokumente zyrtare, duke e shumëzuar me 100.

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

Duke pas parasysh se koha ligjore e trajtimit të kërkesave nga komuna për qasje në dokumente zyrtare është e ndryshme, kërkohet që programi elektronik të bëjë kategorizimin e lëndëve sipas afateve ligjore, në mënyrë që të dhënat të jenë të sakta me rastin e raportimit apo futjes së të dhënave në sistem (programin elektronik) nga zyrtarët përgjegjës. Shembull: të gjitha kërkesat për qasje në dokumente zyrtare që duhet lejuar qasja brenda shtatë (7) dite kategorizohen në një kategori të veçantë në sistemin elektronik, ndërsa ato që duhet t'iu ipet qasje brenda 30 ditëve, kategorizohen në një kategori tjetër e kështu me radhë.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** QSHQK, Zyra për informim në komunë. Verifikimi i të dhënave bëhet nga lista e kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare, të pranuar dhe të protokolluara në QSHQK, shkresat zyrtare për lejim apo miratim të kërkesës për qasje në dokumentin përkatës zyrtar.

---

<sup>11</sup> Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike – Neni 3.1.2.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 2.1.3 - Përbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të ngrit performancën komunale në shfrytëzimin e faqeve zyrtare komunale për të shpërndarë dokumentet kyçe të punës së komunës.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallen e respektimit të obligimeve ligjore të komunës për formën dhe përmbajtjen e standardeve kryesore të faqes zyrtare elektronike, duke përfshirë popullimin me informatat e nevojshme të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për Ueb Faqet e Institucioneve Publike.

#### Sqarime të hollësishme

Faqja zyrtare elektronike e komunës është mjeti kryesor përmes të cilës komuna është e obliguar t'i publikojë informatat të cilat kërkohen për fushën e transparencë komunale. Treguesi matë saktësisht nëse komuna e ka themeluar dhe e ka populluar apo e popullon me informatat e nevojshme të obliguara me dokumente zyrtare, kanalin më të rëndësishëm zyrtar për komunikim me publikun (faqen zyrtare elektronike të komunës), sipas një liste standarde (shih listën në paragrafin e fundit) që reflekton respektimin e formës dhe përmbajtjes standarde të faqes zyrtare elektronike.

Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës përkatëse nëse i ka respektuar standardet e formatit zyrtar dhe standardet e përmbajtjes së informatave të obliguara me Udhëzimit Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 dhe në mënyrë specifike me listën e përmbajtjes së informatave me këtë dokument.

#### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përbushet sipas kriterëve brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

#### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 2.1.3 nevojiten të mblidhen 8 lloje të të dhënave, të listuar në vazhdim:

1. Të dhënat e përditësuara për veprimtarinë publike të institucionit;
2. Strategjitë dhe dokumentet të tjera të politikave të miratuara, në fushën e veprimit dhe funksionimit të institucionit publik;
3. Informata në formë të tabelës lidhur me të gjitha lejet dhe licencat ekzistuese që janë lëshuar, pezulluar ose revokuar nga institucioni publik, siç është përcaktuar në ligjin në fuqi për sistemin e lejeve dhe licencave si dhe shërbimet të tjera që ofrohen nga institucioni publik, duke përfshirë të gjitha informatat mbështetëse të aplikimit apo marrjessë shërbimit;

4. Lista e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen edhe:
  - procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
  - dokumentacioni i nevojshëm dhe kostoja për realizimin e shërbimit;
  - formulari i aplikimit për çdo shërbim dhe udhëzuesi i plotësimit të tij;
  - afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar;
  - afati dhe organi, ku bëhet ankimi, në rast refuzimi të përgjigjes, apo të mos ofrimit të shërbimit në afatin e detyrueshëm ligjor;
5. Raportet vjetore të institucionit;
6. Të dhënat për shpenzimet e institucionit;
7. Arkivi elektronik i informacioneve për institucionin;
8. Forumin për komunikim me publikun (qytetarët), për marrjen e opinionëve për tema të caktuara;

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke vlerësuar plotësimin e secilës të dhënë në faqen zyrtare elektronike të komunës, nga lista e lartë shënuar, me 12,5% sipas formulës në vazhdim:

*Formula:*

$$Treguesi = 12,5 * (secila\ e\ dhënë\ e\ plotësuar\ në\ faqën\ zyrtare)$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Burimi dhe verifikimi i të dhënave është faqja zyrtare elektronike e komunës përkatëse. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 2.1.4 - Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të matë përmbushjen e obligimeve të komunave që ka të bëjë me publikimin e të gjitha aktet të kuvendit komunal në faqen zyrtare të komunës dhe të bëjë ato të qasshme për publikun menjëherë pas shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga ana e MPL (Udhëzimi administrativ i MPL 04/2018 për Transparencë në Komuna, neni 5).

### Çfarë matet?

treguesi matë numrin e publikimit në faqen zyrtare të komunës të vendimeve të miratuara në kuvendin komunal, numrin e rregulloreve të publikuara dhe dokumentet tjera të kuvendit të komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumente zyrtare.

### Sqarime të hollësishme

Sipas Udhëzimit Administrativ 04/2018 për Transparencë në Komuna, të gjitha këto dokumente bëhen të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushtetit Lokal. Publikimi i dokumenteve të kuvendit komunal bëhet nëpërmjet: faqes zyrtare të komunës, e cila shërben si burim i matjes së këtij treguesi, si dhe nëpërmjet shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe mediave të shkruara dhe elektronike lokale. Publikimet e dokumenteve bëhen në gjuhët zyrtare. Treguesi matë plotësisht thelbin e qëllimit të matjes së performancës së komunës për t'i bërë të hapura për publikun punët e kuvendit komunal.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 2.1.4 nevojiten të mblidhen dy lloj të dhënat:

1. Gjithsej numri i akteve të miratuara në kuvendin komunal që nuk kufizohet me ligj publikimi i tyre
2. Gjithsej numri i akteve të publikuara, nga aktet e miratuara nga kuvendi i komunës, në faqen zyrtare të komunës.

Këtu duhet të mblidhet edhe një e dhënë plotësuese që ka të bëjë me numrin e atyre akteve që nuk janë publikuar me kohën e paraparë me ligj.

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e akteve të publikuara me numrin e përgjithshëm të akteve të miratuara nga kuvendi komunal, shumëzuar me 100.

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Lista e akteve të miratuara nga ana e kuvendit komunal në komunën përkatëse, lista e akteve të kuvendit komunal përkatës në MPL, numri i akteve të publikuara në faqen zyrtare të komunës përkatëse. Të dhënat verifikohen në faqen zyrtare elektronike të komunës përkatëse, ku edhe duhet të publikohen aktet të cilat janë miratuar nga kuvendi komunal. Të dhënat për miratimin e akteve të kuvendit komunal mund të verifikohen nga procesverbalet dhe raportet e mbledhjeve të kuvendit komunal apo nga lista e akteve të miratuara që duhet të jetë në sekretarinë e kuvendit të komunës dhe në MPL.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 2.1.5 - Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të matë përmbushjen e obligimeve ligjore (Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni 13), që ka të bëjë me publikimin e të gjitha akteve me karakter të përgjithshëm, të nxjerra nga Kryetari i komunës. Aktet me karakter të përgjithshëm, që i nxjerrë kryetari i komunës janë: urdhëresat dhe vendimet e ndryshme me karakter të përgjithshëm të publikut.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë mjaftë saktë përmbushjen e obligimeve ligjore për bërjen publike punën e kryetarit të komunës dhe krijimin e mundësisë së publikut të ketë qasje në punën e kryetarit të komunës. Qëllimi specifik i matjes së performancës është publikimi vetëm i atyre akteve që kanë karakter të përgjithshëm të nxjerra nga kryetari i komunës përkatëse.

#### Sqarime të hollësishme

Me akt administrativ kolektiv – të përgjithshëm kuptojmë të gjitha vendimet e organeve të administratës publike (kryetarit të komunës), të cilat krijojnë pasoja juridike për dy apo më shumë persona fizikë dhe juridikë (Ligjit 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 44, paragrafi 2, pika 1.2.). Publikimi i akteve të miratuara nga kryetari i komunës bëhet në gjuhët zyrtare.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

#### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 2.1.5 nevojiten të mblidhen dy lloj të dhënash:

1. Gjithsej numri i akteve të nxjerra nga kryetari i komunës që janë me interes të përgjithshëm për publikun dhe
2. Gjithsej numri i akteve të publikuara, nga aktet e nxjerra me karakter të përgjithshëm nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës.

#### Formula e llogaritjes

Llogaritja e treguesit. Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e akteve të publikuara me numrin e përgjithshëm të akteve të miratuara nga kryetari komunal, shumëzuar me 100.

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Lista e akteve të nxjerra nga kryetari i komunës në kabinetin e kryetarit, Divizioni për Monitorimin e Komunave në MPL, faqja zyrtare elektronike e komunës. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumenteve zyrtare të formës përfundimtare të urdhërësive dhe vendimeve të nxjerra nga kryetari i komunës dhe me dokumentet e njëjta të publikuara në faqen zyrtare elektronike të komunës.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Rezultati 2.2 - Transparenca buxhetore

Rezultati përfaqëson arritjen që e synon komuna në publikimin e dokumenteve buxhetore dhe financiare sipas afateve kohore të përcaktuara me ligj. Komuna është e obliguar të publikoj buxhetin e miratuar të komunës, raportet periodike të shpenzimeve dhe të hyrave (raportet financiare)<sup>12</sup> si dhe dokumentacionin e prokurimit publik për gjitha punët që prokuron. Andaj ky rezultat matë performancën e komunës në transparencë buxhetore dhe financiare dhe respektimin e afateve kohore.

Synimi kryesor i këtij rezultati është që ta bëjë të hapur punën e komunës në interes të publikut të gjerë dhe t'ia mundësoi taksapaguesve, grupeve të interesit dhe bizneseve që të kenë informata për këto çështje sa më parë.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet nëpërmjet dy treguesve: 2.2.1 dhe 2.2.2.

### Treguesi 2.2.1 - Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim të matë shkallën e zbatimit të obligimeve komunale për publikimin e dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit komunal brenda periudhës së paraparë kohore me legjislacion.

#### Çfarë matet?

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ 04/2018 për Transparençë në Komuna (Neni 6), treguesi matë performancën e komunës në publikimin e vetëm këtyre dokumenteve të rëndësishme në faqen zyrtare elektronike të komunës përkatëse në kohën e paraparë dhe në gjuhët zyrtare:

1. Kornizën Afatmesme Buxhetore duhet publikuar gjatë muajit gusht pasi që komuna është e obliguar ta miratojë atë deri në fund të muajit korrik;

<sup>12</sup> Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 45.4.



2. Plani Vjetor Buxhetor duhet publikuar gjatë muajit shtator pasi që është e obliguar ta miratojë atë deri me 1 shtator;
3. Lista e investimeve kapitale duhet publikuar së bashku me publikimin e buxhetit komunal vjetor;
4. Raporti periodik (tremujor) financiar duhet publikuar brenda muajit vijues pas tremujorit për të cilin raportohet (nëse vetëm njëri raport nuk publikohet brenda kohës së paraparë ky element vlerësohet 0 %)<sup>13</sup>;
5. Raporti përfundimtar financiar duhet të publikohet gjatë tremujorit të parë të vitit vijues nga viti për të cilin raportohet, d.m.th. deri në fund të muajit mars.

### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë relativisht mirë performancën e komunës për këto lloje të shërbimeve apo për publikimin e dokumenteve kryesore me interes të përgjithshëm për qytetarët. Probleme mund të shfaqen në llogaritjen e publikimit të grup dokumenteve, si raportet periodike, numri i të cilave nuk është i caktuar dhe raporti përfundimtar financiar i cili nuk mund të publikohet në kohën raportuese për SMPK.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 2.2.1 nevojiten të mblidhen 5 lloje të ndryshme të të dhënave nga faqja zyrtare elektronike e komunës përkatëse:

1. Data e publikimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore,
2. Data e publikimit të Plani Vjetor të Buxhetit të komunës,
3. Data e publikimit të listës së investimeve kapitale,
4. Data e publikimit të raportit periodik (tremujor) financiar,
5. Data e publikimit të raportit përfundimtar financiar.

### Formula e llogaritjes

Llogaritja e të dhënave për demonstrimin e këtij treguesi është mjaftë e ndërlikuar dhe nuk tregon saktësisht transparencën e komunës për secilin dokument. Secili dokument është e dhënë përkatëse e treguesit dhe vetëm në nivel të të dhënës mund ta masim performancën individuale të komunës për këto dokumente. Megjithatë llogaritja e integruar e treguesit bëhet duke shumëzuar 20 me secilin të dhënë (publikimi i secilës të dhënë llogaritet si 20% e përfundimit të punës apo performancës së komunës, sipas këtij specifikimi:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 20%

---

<sup>13</sup> Ligji nr. 03/II-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 45, pika 45.4

2. Plani vjetor buxhetor 20 %
3. Lista e investimeve kapitale 20%
4. Raportet periodike (tremujore) financiare 20 % (nëse vetëm njëri raport nuk publikohet brenda kohës së paraparë ky element vlerësohet 0 %)
5. Raporti Përfundimtar financiar 20 %

*Formula*

$$\text{Treguesi} = 20 * (\text{secili dokument i publikuar})$$

### **Burimi kryesor i të dhënave**

Faqja zyrtare elektronike e komunës, Drejtoria për financa e komunës, sekretaria e kuvendit të komunës, arkivi i komunës. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumenteve zyrtare të formës përfundimtare të pesë dokumenteve të shënuar në paragrafin më sipër me dokumentet e njëjta të publikuara në faqen zyrtare elektronike të komunës.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 2.2.2 - Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik të komunës

### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim të matë performancën komunale të transparencës në prokurim publik përmes publikimit të dokumenteve të prokurimit dhe kontratave që lidh komuna për investime kapitale dhe shërbime.

### **Çfarë matet?**

Treguesi matë performancën e transparencës së komunës përkatëse në fushën e prokurimit publik. Matja e performancës së transparencës komunale përfshinë publikimin e dy dokumente kryesore të prokurimit: planin vjetor të prokurimit dhe raportin për realizimin e planit të prokurimit në kohën e paraparë dhe në gjuhët zyrtare si dhe kontratat e komunës me kompani.

### **Sqarime të hollësishme**

Komuna brenda një periudhe prej një muaji nga dërgimi i planit përfundimtar të prokurimit në AQP (Ligji i Prokurimit Publik – LPP (nenin 8)<sup>14</sup>, duhet të sigurojë mjetet për bërjen transparente (neni 10 i LPP), ta publikojë atë në faqen zyrtare elektronike të komunës. Koha e publikimit do të përcaktohet varësisht nga koha e miratimit dhe e shpalljes së Ligjit të buxhetit. Publikimi i planit të prokurimit bëhet sipas Udhëzimit Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike (neni 9.1.20) si dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik nga KRPP (Neni 5.7). Publikimi i kontratave kërkohet me nenin 22.3 pika f. Po ashtu komuna në muajin janar të vitit vijues e publikon raportin vjetor për realizimin e planit të prokurimit publik në komunën përkatëse për vitin paraprak. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në bërjen publike të planit të prokurimit publik, shkallën e realizimit të tij me interes të përgjithshëm për qytetarët si dhe publikimin e kontratave.

<sup>14</sup> Ligji Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik – Neni 5

## Kategoria

Ky treguesi i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 2.2.2 nevojiten të mblidhen 2 lloje të të dhënave nga faqja zyrtare elektronike e komunës përkatëse:

1. Publikimi i planit të prokurimit për komunën përkatëse me kohë;
2. Publikimi i raportit për realizimin e planit të prokurimit me kohë;
3. Kontrata të lidhura me kompani;
4. Kontrata të publikuara në ueb-faqe

## Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke vlerësuar publikimin e secilit prej dokumenteve ( e dhëna 1 dhe e dhëna 2) me nga 25% ndërsa përqindja që nxjerret nga e dhëna 3 dhe e dhëna 4 përbën 50%-shin tjetër të vlerësimit. Kjo do të thotë:

- Publikimi planit i vjetor të prokurimit në faqen zyrtare elektronike të komunës sipas afatit ligjor, vlerësohet me 25% të performancës së komunës për këtë tregues dhe
- Publikimi i raportit për zbatimin e planit të prokurimit në faqen zyrtare elektronike të komunës përkatëse sipas afatit ligjor, vlerësohet me 25% të performancës së komunës për këtë tregues.
- Përqindja nga e dhëna 3 dhe e dhëna 4 shumëzohet me 50%

*Formula:*

$$Treguesi = (\text{secili dokument i publikuar}) * 25 + \frac{e\ dhëna\ 4}{e\ dhëna\ 3} * 50$$

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** faqja zyrtare elektronike e komunës, drejtorja e prokurimit publik, sekretaria e kuvendit të komunës, arkivi i komunës. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumenteve zyrtare të formës përfundimtare të dy dokumenteve të shënuar ne paragrafin më sipër me dokumentet e njëjta të publikuara në faqen zyrtare elektronike të komunës.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### FUSHA 3 PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE

Fusha e Përgjegjshmërisë Komunale përmbledh tregues që matin përgjegjshmërinë komunale ndaj përfshirjes së publikut në konsultim, respektimi i afateve ligjore për shqyrtim dhe miratim të dokumenteve të rëndësishme të qeverisjes lokale, përgjegjshmëria e kryetarit ndaj kuvendit komunal si dhe funksionalizimi e zbatimi i sistemeve për administratë publike. Institucionet komunale përpos transparencës, duhet të sigurojnë llogaridhënie tek qytetarët si dhe llogaridhënie ndër-institucionale si praktika themeltare në sistem demokratik. Pjesëmarrja e qytetarëve në politika lokale si dhe shpenzim të parasë publike është më se e rëndësishme të sigurohet në qeverisje lokale, nivel ky që është përgjegjës për nevojat më bazike të shërbimeve publike. Andaj, edhe pse kjo fushë nuk përfaqëson një sektorë të veçanta, matja e performancës komunale do të ishte jo e plotë pa matjen e përgjegjshmërisë komunale.

Krijimi i mekanizmave për pjesëmarrje qytetare është mjaft i rregulluar në nivel lokal. Ligji për Vetëqeverisje Lokale obligon komunat që të mbajnë së paku dy takime publike me banorë të komunës për të jap llogari për punën e bërë dhe punën e planifikuar. Ndërsa, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë kërkon që të ketë dëgjime publike gjatë procesit të përpilimit të buxhetit të komunës. Në vijë me ligjet e Kosovës, MPL ka përpiluar disa udhëzime administrative që rregullojnë procedurat për konsultime publike me qëllim të lehtësimit dhe standardizimit të praktikave për përfshirje të qytetarëve. Kjo fushë prek edhe obligimet ligjore që dalin nga legjislacioni për shërbyes civil siç është suspendimi i shërbyesve me aktakuza si dhe promovimi i shërbyesve në bazë të legjislacionit dytësor.

Treguesit e radhitur në këtë fushë shërbejnë për të orientuar udhëheqësit komunal për të ngritur përgjegjshmërinë institucionale ndaj qytetarëve, shërbyesve civil dhe institucioneve komunale dhe performanca e mirë në këta tregues shpjen edhe tek shërbime publike më efikase. Qytetarët e komunës mund të bëhen burimi më i mirë i institucioneve komunale për ide dhe sugjerime në qeverisje, ndërsa shërbimi civil mirë i menaxhuar rezulton me shërbime më të mira. Andaj, komunat në bashkëpunim me MPL-në, nëpërmjet matjes së performancës në këta tregues, mund të shohin mundësitë për përmirësim dhe të marrin masa për të ngritur përgjegjshmërinë komunale.

Arritjet e komunës në fushën e përgjegjshmërisë komunale maten nëpërmjet pesë rezultateve dhe 22 treguesve përkatës.

#### Rezultati 3.1 - Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në komunë

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës në zbatimin e legjislacionit përkatës në fuqi që lidhet me standardet minimale të konsultim publik për komuna<sup>15</sup> dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra dhe lagje<sup>16</sup>. Rezultati përfshinë produktet e veprimtarisë që kanë të bëjnë me rritjen e llogaridhënies komunale duke promovuar pjesëmarrjen e publikut në mënyrë direkte në proceset e vendimmarrjes.

<sup>15</sup> MPL, Udhëzim i Administrativ 06/2018 për Standardet Minimale për Konsultim Publik në Komuna.

<sup>16</sup> MPL, Udhëzim i Administrativ 02/2019 për Organizmin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatra, Vendbanime dhe Lagje Urbane.

Rezultati synon të matë elementet kryesore që janë përcaktuar më Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe legjislacionin sekondar, në veçanti me Udhëzimin Administrativ të MPL. Elementet që e pasqyrojnë më së miri transparencën e punës së komunave për këtë rezultat janë: publikimi i njoftimeve për pjesëmarrje të qytetarëve në takimet publike të kryetarit, konsultimet publike në raport me aktet e miratuara nga Kuvendi Komunal, në veçanti konsultimi për kornizën afatmesme buxhetore dhe buxhetit komunal, si dhe publikimi i raporteve të konsultimeve publike siç parashihet me Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale për Konsultim Publik. Ky rezultat po ashtu përfshin edhe një tregues që matë nivelin e themelimit dhe funksionimit të këshillave lokal si trupa të rëndësishëm për konsultim publik të komunës.

Se deri në çfarë shkalle është arritur rezultati 3.1. e kuptojmë nëpërmjet matjes së treguesve 3.1.1; 3.1.2; 3.1.3, 3.1.4, 3.1.5, 3.1.6, 3.1.7 dhe treguesit 3.1.8.

### Treguesi 3.1.1 - Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së publikimit të njoftimeve për dy takimet publike të kryetarit të komunës (obligative), së paku 14 ditë para datës së takimit.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë përqindjen e arritjes për publikimin në hapësirat e vendosjes së njoftimeve publike, dhe hapësirën e komunës në rrjetet sociale brenda afatit kohor (14 ditë para takimit) të 2 takimeve publike, përkatësisht mat ndarazi përmbushjen e afateve kohore për çdonjërin nga dy takimet publike obligative. Treguesi nuk matë cilësinë e njoftimit, si dhe numrin e njoftimeve të postuara në rrjetet sociale. Po ashtu nuk matë numrin e njoftimeve për takime publike, nëse janë mbajtur më shumë së dy takime publike.

#### Sqarime të hollësishme

Kuadri ligjor<sup>17</sup> i obligon kryetarin e komunës për të mbajtur më së paku 2 takime në vit me qytetarë. Kryetari i komunës është i obliguar për të bërë njoftimin publik për takimet me qytetarë më së paku 14 ditë para datës së mbajtjes së takimit. Për nevojat e këtij treguesi, matja e publikimit të njoftimeve bëhet duke konsideruar publikim të njoftimit, përmbushjen e pikës 4 të nenit 10 të udhëzimit administrativ<sup>18</sup>. Përkatësisht, duhet të përmbushen afatet kohore duke vendosur njoftimin në hapësirat publike fizike dhe internet, duke komunikuar përmbajtjen e njoftimit dhe agjendën në gjuhët zyrtare të komunës. Me gjuhë zyrtare nënkuptohet, gjuhët zyrtare në nivel të Kosovës (Gj. Shqipe dhe gj. Serbe) si dhe gjuhë që kanë status të gjuhës zyrtare në territor të asaj komune si p.sh.. Gj. Turke, Boshnjake, etj.

Njoftimi me kohë i publikut mundëson pjesëmarrjen e qytetarëve si palë e interesit në mbledhjet e organizuara nga kryetari i komunës, të cilat nëse nuk është kërkuar në mënyrë specifike përmes procedurës

<sup>17</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

<sup>18</sup> Udhëzimi i Administrativ (MPL) 04/2018 për Transparencë në Komuna

së paraparë, janë të hapura për publik. Pjesëmarrja e qytetarëve në mbledhjet e organizuara nga kryetari i komunës mundësohet në bazë të nenit 68 të ligjit<sup>19</sup>.

Në këtë kontekst, treguesi ka për qëllim matjen e zbatimit të dispozitave ligjore për të siguruar transparencë përmes njoftimit me kohë të qytetarëve për takimet publike, përkatësisht, mat punën e autoriteteve komunale në përgatitjen dhe publikimin e njoftimit sipas afateve të përcaktuara me ligj.

Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për publikimin e njoftimeve për takimet publike me qytetarë 14 ditë para mbajtjes së 2 takimeve, i referohet vitit paraparak. Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë për mbajtjen e 2 takimeve publike nga ana e kryetarit të komunës, si dhe publikimet e njoftimeve në hapësirat publike për vendosjen e njoftimeve dhe faqja e komunës në rrjet social. Në kontekstin e njoftimeve dhe takimeve të mbajtura, shqyrtohen datat e mbajtjes së takimeve dhe datat e publikimit të njoftimit për takimet në fjalë, me qëllim të sigurimit të informacionit se sa është numri i ditëve në mes të publikimit të njoftimit dhe datës së mbajtjes së takimit publik. Kriteri i cili duhet të përmbushet me rastin e vendosjes së njoftimeve është po ashtu edhe komunikimi i njoftimit së bashku me agjendën, në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe gjuhët që kanë status zyrtar në nivel të komunës që raporton.

Në këtë mënyrë vlerësohet respektimi i afateve kohore për njoftim të qytetarëve, si hap themelor për të siguruar transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet publike të komunës, ku pjesëmarrja është parakusht në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies si elemente bazë të demokracisë së nivelit lokal.

Pjesëmarrja e qytetarëve në takime publike, nënkupton se qytetarët kanë mundësinë për tu informuar lidhur me punën e autoriteteve komunale, për paraqitjen dhe artikullimin e interesave që kanë, si dhe për të diskutuar/shqyrtuar lidhur me punën dhe planet e qeverisjes komunale si instancë e pushtetit lokal.

Me fjalën “vit” në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet viti paraparak, si vit kur aktualisht është dashur të jenë mbajtur 2 takimet publike dhe të jenë publikuar njoftimet për takimet publike.

Viti për autoritetet komunale fillon me 1 janar, dhe me ç’rast takimi i parë publik konsiderohet takimi i parë me qytetarë pas 1 Janarit të vitit përkatës, kurse takimi i dytë është ai i mbajtur para takimit të parë dhe para datës 31 Dhjetor të vitit të raportuar. Për nevojat e SMPK-së merret si mos-publikim në rrjet social të njoftimit për mbajtjen e takimit publik edhe nëse njoftimi për takim publik është publikuar në rrjet social në afat më të shkurtër se 14 ditë. Treguesi mat mjaft saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së ekzekutivit të komunës para qytetarëve, me ç’rast tërthorazi sigurohet pjesëmarrja dhe masat për përmirësimin e vazhdueshëm të llogaridhënies.

Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në komunë; si dhe në fushën Transparenca Komunale, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e komunës në raport me qytetarët e saj, sipas kërkesave ligjore.

---

<sup>19</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale

## Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. përqindja bazuar në plotësimin e kushtit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare për takimin e parë publik
2. përqindja bazuar në plotësimin e kushtit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare për takimin e dytë publik

Përcaktimi i vlerës së treguesit bëhet sipas kuantifikimit paraprak për raportimin e përmbushjes së dispozitës (14 ditë) të publikimit të njoftimit në rrjet social për takim publik dhe mbajtjes të takimit publik. 50% për një rast ku njoftimi është publikuar 14 ditë para mbajtjes së takimit publik, dhe 0% nëse nuk ka takim apo publikim.

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$\textit{Treguesi} = 50 * (\textit{secili takim i njoftuar me kohë})$$

[2\*50%] për dy takimet ku njoftimet janë publikuar 14 ditë para mbajtjes së takimeve publike.

Duhet të shqyrtohet afati në mes të datës së mbajtjes së takimit publik dhe datës së publikimit të njoftimit në rrjet social, përkatësisht nëse janë 14 ditë kalendarike apo më tepër. Publikimi i njoftimit të takimit publik duhet të korrespondojë me raportin apo procesverbalin për takimin publik të mbajtur, përkatësisht duhet të ketë artikulum të qartë për takimin e parë dhe takimin e dytë publik, dhe aktet korresponduese të njoftimeve për këto dy takime, duke filluar nga datat e mbajtjes si dhe nga pikat e rendit të ditës.

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën për informim të komunës, zyrën e kryetarit të komunës, dhe, faqen e komunës në rrjet social.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve dhe agjendës për takim publik në të gjitha gjuhët e parapara, rendit të ditës të takimit të publik si dhe në aktet e publikuara për punën e komunës.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 3.1.2 - Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike

## Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim të ngrit pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike komunale përmes promovimit, informimit dhe organizimit më efektiv nga komuna.

## Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve në konsultime publike si takimet e rregullta me qytetarë (minimum 2 në vit), dëgjimet buxhetore (minimum 2 në vit), dhe takimet konsultative për akte komunale dhe dokumente të politikave lokale. Shkalla e pjesëmarrjes maksimale për këtë tregues konsiderohet 3% e numrit të banorëve të komunës përkatëse bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë nga Agjencia për Statistika të Kosovës.

## Sqarime të hollësishme

Komunat janë të obliguara të mbajnë konsultime publike për rregullore, planifikime buxhetore si dhe plane tjera. Një tregues i mirë për cilësinë e këtyre konsultimeve është edhe niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve. Ky tregues e matë nivelin e pjesëmarrjes në komuna përkatëse krahasuar me numrin e banorëve. Niveli 3% i numrit të banorëve është marrë si nivel i mjaftueshëm i pjesëmarrjes për gjitha komunat, së paku për një periudhë të përkohshme.

Matja e pjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike ka për qëllim përmirësimin e proceseve të demokracisë lokale, duke siguruar gjithë përfshirjen dhe duke shtyrë përpara interesat për të përmirësuar përfshirjen e publikut. Përmes matjes së përfshirjes të qytetarëve në proceset e takimeve publike, sigurohet transparenca dhe llogaridhënia, si dhe shqyrtimi i çështjeve me interes publik të publikut.

Në kontekst të këtij treguesi, nuk paragjykohet numri i takimeve publike, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve dhe disgregimi i tyre në bazë gjinore mbledhet për të gjitha takimet publike të organizuara nga komuna.

Për nevojat e këtij treguesi, nuk është e rëndësishme agjenda dhe pikat e rendit të ditës së takimeve publike.

Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë për mbajtjen e takimit publik nga ana e komunës, veçmas për secilin takim, dhe regjistrat me evidencën e pjesëmarrësve, qoftë si listë qoftë si vlerësim në raport për takimin.

Treguesi nuk matë cilësinë e pjesëmarrjes, përkatësisht nuk matë kontributin e qytetarëve pjesëmarrës në takimet publike. Për nevojat e SMPK-së merret si mos-përmbushje të dispozitës nëse takimi publik nuk ka evidencë të pjesëmarrësve në përgjithësi. Në rastet e mos-përmbushjes së obligimit për evidentim, treguesit i caktohet vlera zero (0).

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.



## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. Numri i pjesëmarrësve në konsultimet publike të komunës gjatë vitit
2. Numri i banorëve në komunë

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \left( \frac{E\ dhëna\ 1}{E\ dhëna\ 2 * 3\%} * 100 \right)$$

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën për informim, sekretaria dhe arkivi i kuvendit komunal. Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve, rendit të ditës së konsultimeve publike.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 3.1.3 - Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun

## Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim të matë shkallën e realizimit të obligimeve të kuvendit komunal që i ka për konsultimin e publikut gjatë hartimit të akteve të përgjithshme dhe dokumenteve për politika lokale. Konkretisht treguesi matë performancën e komunës, respektivisht të kuvendit të komunës, se me rastin e miratimit të akteve komunale me interes të përgjithshëm a janë respektuar obligimet ligjore për konsultimin e publikut apo jo. Më saktë treguesit i intereson numri i akteve të përgjithshme dhe dokumenteve të politikave lokale për të cilat është konsultuar publiku.

## Çfarë matet?

Treguesi matë mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për përfshirjen e publikut në procesin e vendimmarrjes në organet komunale, por nuk matë përqindjen e qytetarëve të komunës që marrin pjesë në konsultim për hartimin e akteve komunale. Të gjitha takimet që mbahen me qytetarët për një akt komunal apo dokument për përgatitje të një politike lokale, llogaritet një konsultim dhe raportohet se akti komunal apo dokumenti i politikës publike është konsultuar dhe është bërë transparent para miratimit të tij me qytetarët. Në të ardhmen duhet të shikohet mundësia e zhvillimit dhe futjes në sistem të një treguesi që matë përqindjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto procese të rëndësishme për mirëqenien e tyre. Treguesi nuk arrin të matë thelbin e obligimit ligjor, shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

## Sqarime të hollësishme

Komunat obligohen të konsultohen me qytetarë para miratimit të këtyre akteve komunale: Statutit të Komunës, rregulloreve komunale dhe akteve tjera që parashihen me ligjet sektoriale si dhe për këto dokumente të politikave lokale: Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të komunës dhe kryetarit të Komunës, strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në fusha sektoriale, projekt-planet hapësinore, dokumentet tjera të parapara me legjislacion tjetër apo që komuna e vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik<sup>20</sup>. Konsultimi për projekt-buxhet dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore, edhe pse klasifikohen si dokumente të politikave lokale, nuk përfshihen në këtë tregues pasi përfshihen veçantë në treguesin e ardhshëm.

Konsultimi nënkupton edhe organizimin e takimeve në vendbanimet e ndryshme në tërë territorin e komunës përkatëse. Konsultimi konsiderohet i vlefshëm vetëm atëherë kur respektohen procedurat ligjore për konsultim. Procesi i konsultimit publik rregullohet me udhëzimin administrativ për standarde minimale të konsultimit publik të miratuar nga MPL.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 3.1.3 nevojiten të mblidhen dy lloj të dhënash përkatëse:

1. Gjithsej numri i akteve të miratuara me interes të përgjithshëm dhe dokumenteve të politikave lokale në kuvendin komunal dhe
2. Gjithsej numri i akteve të përgjithshme të miratuara në kuvendin komunal për të cilat është organizuar konsultim me publikun.

Treguesi llogaritet duke pjesëtuar numrin e akteve për të cilat është konsultuar publiku me numrin e përgjithshëm të akteve me interes të përgjithshëm të miratuara, shumëzuar me 100.

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në faqen zyrtare elektronike të komunës, sekretaria dhe arkivi i kuvendit komunal. Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve, rendit të ditës së konsultimeve dhe nga lista e akteve të miratuara dhe publikuara të komunës.

<sup>20</sup> Udhëzim Administrativ Nr. 06/2018 (MPL) për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 3.1.4 - Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal krahasuar me numrin e banorëve

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim të matë shkallën e përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me konsultimin e publikut gjatë hartimit të kornizës afatmesme buxhetore dhe buxhetit vjetor komunal<sup>21</sup> si dhe të ngrit performancën komunale në përfshirjen e sa më shumë qytetarëve në dëgjime.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë mjaftë zbatimin e këtij obligimi ligjor për përfshirjen e publikut në procesin e vendimmarrjes në organet komunale, si dhe matë numrin e dëgjimeve buxhetore për 10,000 banorë. Treguesi nuk arrin të matë thelbin e obligimit ligjor, shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje megjithatë sa më shumë dëgjime buxhetore nga komuna, sidomos në fshatra dhe lagje urbane, aq më shumë gjasë që të përfshihen qytetarët.

#### Sqarime të hollësishme

Për buxhetin komunal duhet të hartohen dy dokumente: 1) Korniza afatmesme buxhetore dhe buxheti komunal. Korniza afatmesme buxhetore fillimisht miratohet nga komiteti për politika dhe financa dhe përfundimisht nga kuvendi komunal dhe i dorëzohet Ministrisë së Financave deri më 30 korrik të vitit përkatës. Dokumenti i dytë – projekt buxheti komunal propozohet nga kryetari i komunës në kuvendin komunal deri më 1 shtator. Procedurat për konsultimin e kornizës afatmesme buxhetore dhe buxhetit vjetor të komunës janë të njëjta sikurse procedurat e konsultimit të akteve tjera të miratuara nga ana e organeve komunale.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

#### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të treguesit 3.1.4 nevojiten të mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i dëgjimeve për buxhetin vjetor komunal
2. Numri i konsultimeve publike për kornizën afatmesme buxhetore

<sup>21</sup> Ligji nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (neni 61.2). Udhëzim Administrativ (MPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna (Neni 6.1.2) dhe udhëzimin administrativ për transparencë komunale (neni 11.1)

### 3. Numri i banorëve të komunës

#### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{e\ dhëna\ 1 + e\ dhëna\ 2}{\frac{e\ dhëna\ 3}{10,00}} * 100$$

Shënim:

- Vlerësimi maksimal që mund të ipet është 100%.
- Për komunat me 10,000 apo më pak banorë, 100% konsiderohet atëherë kur mbahen dy apo më shumë dëgjime.

**Burimi kryesor i të dhënave** Burimi i të dhënave. Të dhënat gjinden në faqen zyrtare elektronike të komunës, në sekretarinë dhe arkivin e kuvendit komunal. Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve, rendit të ditës së konsultimeve dhe me aktet komunale të miratuara dhe publikuara të komunës për miratimin e kornizës afatmesme dhe të buxhetit komunal.

#### Treguesi 3.1.5 - Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të matë cilësinë e konsultimeve publike, përkatësisht efektivitetin e kërkesave dhe sugjerimeve në politikat dhe vendimet komunale. Komunat kanë obligim të dokumentojnë kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve dhe t'i shqyrtojnë seriozisht. Po ashtu, komunat kanë për obligim të japin sqarim kur një kërkesë e qytetarëve në konsultim publik nuk mund të akomodohet<sup>22</sup>.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë përqindjen e proceseve të konsultimeve publike të cilat pasohen me një raport brenda afatit kohor ku listohen kërkesat e qytetarëve dhe grupeve të interesit si dhe sqarimet për refuzimin e kërkesave që refuzohen. Ky tregues nuk matë numrin e konsultimeve publike dhe nuk dallon llojet e konsultimeve publike, por vetëm vlerëson nëse konsultimi publik ka qenë mirë i dokumentuar dhe dokumentimi është bërë publik në formë të kuptueshme.

#### Sqarime të hollësishme

Proces i konsultimit publik këtu konsiderohet çdo konsultim për buxhet, KAB, akt komunal, plan komunal dhe dokument të politikës lokal i cili zgjatë jo më pas se 30 ditë, siç e përcakton legjislacioni dytësor<sup>23</sup>. Konsultimi publik mund të jetë përmes takimeve publike apo përmes platformave elektronike. Këtu hyjnë ato proces të konsultimit publik të cilat kanë filluar në periudhën 1 janar dhe 31 dhjetor të vitit.

#### Kategoria

<sup>22</sup> Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna – Neni 5.5

<sup>23</sup> Po aty – Neni 18.1.

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të **pragut** dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Të dhënat:

1. Numri i proceseve për konsultime publike gjatë një viti;
2. Numri i konsultimeve publike për të cilat raporti është publikuar në ueb-faqe brenda 30 ditëve pas mbajtjes së konsultimit<sup>24</sup>

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \left[ \frac{E_{dhëna\ 2}}{E_{dhëna\ 1}} * 100 \right]$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Burimi i të dhënave për këtë tregues është faqja zyrtare e komunës. Verifikimi mund të bëhet në bazë të datës së regjistrimit të publikimit të dokumentit/eve.

## Treguesi 3.1.6 - Këshilla lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit

### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi ka për qëllim të ngris bashkëpunimin e strukturuar të institucioneve komunale me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane. Komunitat obligohen me legjislacion dytësor<sup>25</sup> të themelojnë një numër të caktuar të këshillave lokal dhe të sigurojnë kushte për funksionimin e tyre. Madje edhe neni 34 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për "Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane" inkurajon themelimin e këtyre trupave në komuna të cilët edhe mund të kryejnë aktivitete nën përgjegjësitë dhe kompetencat e komunave.

### Çfarë matet?

Ky tregues matë performancën e komunës në lidhje me themelimin dhe funksionalizimin e këshillave lokal, trupa tejet të rëndësishëm për konsultime publike dhe identifikim të çështjeve prioritare të lagjeve dhe fshatrave të komunës. Konkretisht, treguesi matë përqindjen e vendbanimeve që kanë të themeluar këshilla lokal dhe që kanë mbajtur së paku gjashtë (6) takime brenda vitit të vlerësimit. Mbajtja e gjashtë takimeve brenda vitit siguron funksionimin minimal të këtyre trupave dhe ndërlihet me numrin e takimeve për të cilat Kryetari i këshillit lokal kompensohet nga komuna (sipas nenit 12.3 të U.A. (MPL) Nr. 02/2019).

### Sqarime të hollësishme

<sup>24</sup> Po at y - Neni 17.5

<sup>25</sup> Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane.

Këshillat lokal janë trupa të zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Me legjislacion dytësor, komunat duhet të kenë një numër të caktuar të këshillave lokale varësisht sipas numrit të banorëve. Megjithatë sa më shumë këshilla lokal aq më mirë. Numri i këshillave lokal, të themeluar dhe funksional, krahasohet me numrin e vendbanimeve i cili përcaktohet me Statut të komunës

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të **prodhimit** dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Të dhënat:

1. Numri i vendbanimeve me këshilla lokal të themeluar në mandatin aktual
2. Numri i vendbanimeve me këshilla lokal të themeluar në mandatin aktual që kanë mbajtur së paku 6 takim brenda një viti
3. Numri i vendbanimeve në komunë

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 1}{E\ dhëna\ 3} * 80 + \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 3} * 20$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Burimi i të dhënave për këtë tregues janë Zyra për Informim e komunës si dhe Komisioni për koordinimin e themelimit të këshillave lokal, i cili kërkohet me udhëzim administrativ për bashkëpunimin e komunës me vendbanime. Verifikimi i numrit të takimeve të këshillave lokal bëhet përmes procesverbaleve të mbajtura nga këshillat lokal.

### Treguesi 3.1.7 - Intervenimet pas raportimeve të qytetarëve për mbeturina

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim rritjen e performancës komunale për të adresimin e ankesave të qytetarëve që bëjnë kërkesë online për largimin e mbeturinave në vende joadekuate.

## Çfarë matet?

Treguesi matë nivelin e përgjegjshmërisë së komunës në adresimin e kërkesave të qytetarëve për largim të mbeturinave si rezultat i raportimeve që vijnë nga vetë qytetarët. Është në kompetencë të komunave të bëjnë menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre. Jo gjithmonë grumbullimi i mbeturinave bëhet me kohë dhe në mënyrë të duhur.

## Sqarime të hollësishme

Ministria e Pushtetit Lokal është zotuar të integroj në intranet teknologjinë softuerike për raportime të qytetarëve që në Kosovë është zhvilluar përmes platformës ndreqe.com. Kjo teknologji softuerike mundëson që qytetarët të raportojnë lehtë dhe shpejt një problem me shërbim publik duke ofruar një fotografi të gjendjes dhe lokacionin e saktë. Intervenimet e komunës në grumbullimin e mbeturinave si rezultat i raportimeve online të qytetarëve e rrisin efikasitetin e shërbimeve publike pasi qytetarët duke raportuar lehtë dhe shpejt mund të ndihmojnë komunën të identifikoj problemet që paraqite por edhe të një gardian të mirëmbajtjes së ambientit. Komuna është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave në territorin e saj. Kjo bëhet qoftë përmes kompanive komunale apo regjionale.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet brenda vitit përkatës kalendarik. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy të dhëna:

1. Numri i raportimeve të qytetarëve për largim të mbeturinave
2. Numri i intervenime për largim të deponive nga raportimet e qytetarëve

## Formula e llogaritjes

$$Formula = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga kompanitë përkatëse për deponimin e mbeturinave. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e dokumenteve zyrtare (kërkesat) për largim të deponive ilegale të mbeturinave drejtuar komunës apo vetë kompanive regjionale për menaxhim të mbeturinave përkatëse.

**Treguesi 3.1.8 - Intervenimet pas raportimeve të qytetarëve për dëmtime në infrastrukturë**

## Qëllimi

Treguesi ka për qëllim rritjen e performancës komunale për të adresimin e ankesave të qytetarëve që bëjnë kërkesë online për dëmtime në infrastrukturë të komunës.

## Çfarë matet?

Treguesi matë nivelin e përgjegjshmërisë së komunës në adresimin e kërkesave të qytetarëve për sanim të gropave, intervenim në trotuare të dëmtuar, shpërthime në rrjet të kanalizimit, ujësjellësit dhe intervenim në dëmtime tjera në infrastrukturë të komunës. Përpos nivelit të intervenimeve karshi raportimeve ky tregues matë edhe gatishmërinë e komunës për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve të vet.

### Sqarime të hollësishme

Ministria e Pushtetit Lokal është zotuar të integroj në intranet teknologjinë softuerike për raportime të qytetarëve që në Kosovë është zhvilluar përmes platformës ndreqe.com. Kjo teknologji softuerike mundëson që qytetarët të raportojnë lehtë dhe shpejt një problem me shërbim publik duke ofruar një fotografi të gjendjes dhe lokacionin e saktë. Intervenimet e komunës për dëmtime në infrastrukturë dhe mirëmbajtje e rrisin efikasitetin e shërbimeve publike pasi qytetarët duke raportuar lehtë dhe shpejt mund të ndihmojnë komunën të identifikoj problemet që paraqite por edhe të një gardian të mirëmbajtjes së infrastrukturës komunale.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet brenda vitit përkatës kalendarik. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Të dhënat:

1. Numri i raportimeve për gropa në rrugë, dëmtime në rrjet të ujësjellësit, kanalizimit, trotuarë dhe kategori tjera
2. Numri i intervenimeve për gropa në rrugë, dëmtime në rrjet të ujësjellësit, kanalizimit, trotuarë dhe kategori tjera të raportuara nga qytetarët

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria e shërbimeve publike, drejtoria e urbanizmit dhe nga kompanitë përkatëse publike për menaxhimin e ujësjellësit (ujërave të zeza). Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e listave zyrtare për vendbanimet e përfshira në sistemin e kanalizimit, ujërat e zeza të cilave trajtohen apo pastrohen nga impiantet përkatës dhe raportet zyrtare dhe të protokolluara për ofrimin e këtij shërbimi nga drejtoria e shërbimeve publike të komunës përkatëse.



### Rezultati 3.2 - Sigurimi i llogaridhënies dhe respektimi i afateve ligjore në proceset e Kuvendit Komunal

Rezultati përfaqëson arritjen që e synon komuna në sigurimin e llogaridhënies dhe respektimit të afateve ligjore në çështjet në të cilat është i përfshirë Kuvendi Komunal si organ më i lartë. Autoritetet komunale janë të obliguara që të zbatojnë dispozitat ligjore lidhur me qeverisjen lokale, duke i nisur nga përpilimi dhe miratimi i buxhetit, si dhe raportet buxhetore 3 mujore dhe ato të kryetarit të komunës. Po ashtu autoritetet komunale janë të obliguara për sigurimin e llogaridhënies interne, me ç'rast ekzekutivi është i obliguar për të raportuar para kuvendit sipas ligjit, me qëllim të sigurimit të përfshirjes së palëve të interesit të përfaqësuara në formën e këshilltarëve në kuvend.

Rezultati përmban në veti produktet e veprimeve të komunës që kanë të bëjnë me zbatimin e obligimeve para kuvendit si dhe obligimeve të vet kuvendit me qëllim të sigurimit të llogaridhënies dhe transparencës, si dhe sigurimit të vendim marrjes në pajtim me interesat e qytetarëve të komunës.

Synimi kryesor i këtij rezultati është që të sigurohet llogaridhënia e ekzekutivit të komunës para kuvendit komunal, si dhe përfshirja me kohë e kuvendit komunal në çështje me interes për zhvillimin e politikave, si dhe aspektet e mbikëqyrjes financiare duke filluar me miratimin e buxhetit, e më pas edhe përfshirjen e kuvendit komunal në mbikëqyrjen e shpenzimit të buxhetit përmes paraqitjes së raporteve 3 mujore, si dhe raportimet e kryetarit para kuvendit komunal.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet nëpërmjet gjashtë treguesve: 3.2.1; 3.2.2; 3.2.3; 3.2.4; 3.2.5 dhe 3.2.6.

#### Treguesi 3.2.1 - Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal

##### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me përgatitjen dhe miratimin e dokumentit propozim i buxhetit vjetor komunal nga ana e kuvendit komunal.

##### Çfarë matet?

Treguesi matë përqindjen e arritjes për ta miratuar dokumentin e propozimit të buxhetit nga ana e kuvendit komunal brenda afatit të përcaktuar ligjor! Treguesi matë mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për sigurimin e koordinimit me planifikimin dhe ndarjen e buxheteve nga niveli qendror për nivelin lokal, me ç'rast tërthorazi sigurohet vazhdimësia e punës së komunës, financimi i aktiviteteve, investimeve, dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarë. Po ashtu sigurohet aktiviteti i planifikuar i komunës, i cili është arrit në bazë të një procesi të strukturuar të konsultimit me palët e interesit (proces demokratik) në nivel të kompetencave që kanë komunat. Kurse në mënyrë të drejtë për drejtë matë saktë përgjegjësinë e

autoriteteve komunale në fushën e financave publike lokale, kjo për shkak se buxheti i agregon dhe i pasqyron të gjitha fushat dhe aktivitetet e autoriteteve komunale.

### **Sqarime të hollësishme**

Akti i matjes së përmbushjes në vitin vijues fiskal i referohet vitit paraprak fiskal, ku planifikimi dhe miratimi i buxhetit duhet të bëhet në periudhën e specifikuar para vitit të cilit i referohet buxheti (n-1)! Në këtë mënyrë vlerësohet puna për përgatitjen dhe miratimin e buxhetit të vitit vijues fiskal, duke bërë matjen e respektimit të afateve kohore në vitin paraprak. Me vit në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet viti fiskal, përveç nëse nuk është specifikuar ndryshe.

Ku (n-1) nënkupton, n=viti në vijim, kurse n-1 nënkupton vitin paraprak (fiskal)!

Përshkrimi ligjor për procesin e përgatitjes dhe miratimit të dokumentit propozim i buxhetit vjetor komunal buron nga ligji i përgjithshëm për menaxhimin e financave publike<sup>26</sup>, kurse kompetenca buron nga ligji për vetëqeverisje lokale<sup>27</sup>. Përkatësisht treguesi ka për qëllim matjen e përmbushjes së dispozitës ligjore, me ç' rast dokumenti propozim i buxhetit komunal vjetor për vitin e ardhshëm fiskal duhet të prezantohet para kuvendit komunal më së voni me 1 Shtator, dhe të miratohet deri më datën 30 Shtator të vitit që i paraprinë. Në këtë mënyrë sigurohet artikulli i buxhetit përmes koordinimit me nivelin qendror, me procesin e planifikimit të buxhetit të Ministrisë së Financave, me ç' rast obligim ligjor i komunave është dorëzimi i propozim-buxheteve të miratuara nga kuvendet komunale deri më datën 30 Shtator.

Propozim buxheti i pa miratuar deri më datën 30 Shtator nga Kuvendi Komunal, për nevojat e SMPK-së merret si i pa-miratuar edhe nëse miratohet pas kësaj date.

Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, sigurimi i përfshirjes së KK me kohë në çështjet politike dhe ligjore; si dhe në fushën Transparenca Komunale, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve komunale në kompletimin dhe miratimin e propozim buxhetit në afatet e parapara ligjore, duke siguruar artikullim dhe koordinim me nivelin qendror të planifikimit dhe ndarjes së buxhetit, si dhe qartësi dhe qëndrueshmëri të funksionimit të komunës në periudhën e vitit aktualisht në vijim!

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### **Të dhënat**

---

<sup>26</sup> Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

<sup>27</sup> Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojitet një e dhënë, e cilat shënohet sipas kuantifikimit të dhënë më poshtë:

1. dorëzimi i buxhetit nga Kryetari i Komunës tek Kuvendi i Komunës para datës 1 shtator
2. miratimin nga Kuvendi i Komunës para datës 30 shtator

Përcaktimi i vlerës së treguesit bëhet sipas kuantifikimit paraprak për aktin e miratimit të dokumentit propozim i buxhetit vjetor të komunës, që është 100% nëse është miratuar para datës 30 Shtator (përfshirë edhe 30 Shtatorin) të vitit fiskal paraprak duke ju referuar vitit aktual (vijues) kur është duke u bërë raportimi.

#### **Formula e llogaritjes**

**Formula:** 70% për dokumentin e miratuar nga Kuvendi i Komunës deri më 30 shtator, dhe 0% nëse nuk ka dokument të miratuar para datës 30 Shtator.

30% për dokumentin e miratuar nga Kryetari i Komunës, dhe 0% nëse nuk ka dorëzuar para kuvendit deri me datën 1 Shtator.

#### **Burimi kryesor i të dhënave**

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në arkivë dhe sekretarinë e Kuvendit Komunal, si dhe në Ministrinë e Financave.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve të miratuara dhe të protokolluara, njoftimeve, rendit të ditës së konsultimeve dhe me aktet komunale të miratuara dhe publikuara të komunës për miratimin e dokumentit të propozim buxhetit komunal, si the në aktet e komunikuar për miratimin e propozim buxhetit në Ministrinë e Financave.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### **Treguesi 3.2.2 - Diskutime për raportet tre-mujore buxhetore nga Kuvendi Komunal**

#### **Qëllimi**

Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me prezantimin dhe diskutimin para kuvendit komunal të raporteve financiare 3 mujore. Raportet e buxheteve duhet të paraqiten për diskutim në baza 3 mujore (raporte 3 mujore) nga kuvendi komunal, përkatësisht raportet duhet të paraqiten para kuvendit nga ana e kryetarit të komunës.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë përqindjen e arritjes për të sjellë para kuvendit komunal tërësinë e 4 raporteve 3 mujore për buxheti komunal, brenda afateve të përcaktuara ligjore!

Treguesi matë mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për sigurimin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së ekzekutivit të komunës para kuvendit komunal, me ç' rast tërthorazi sigurohet vazhdimësia e punës së komunës, financimi i aktiviteteve, investimeve, dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarë. Po ashtu sigurohet aktiviteti i planifikuar i komunës, i cili është arritë në bazë të një procesi të strukturuar të konsultimit me palët e interesit (proces demokratik) në nivel të kompetencave që kanë komunat. Kurse në mënyrë të drejtë për drejtë matë saktë përgjegjësinë e autoriteteve komunale në fushën e financave publike lokale, kjo për shkak se zbatimi i buxhetit i pasqyron të gjitha fushat dhe aktivitetet e autoriteteve komunale në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve, dhe me këtë siguron qëndrueshmërinë financiare të komunës.

### **Sqarime të hollësishme**

Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për diskutime të raporteve 3 mujor të buxhetit para kuvendit komunal, i referohet vitit paraprak fiskal. Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë se kryetari ka paraqitë raportet e buxhetit para kuvendit komunal për çdo 3 mujor paraprak, më së largu 30 ditë nga përfundimi i 3 mujorit për të cilin raportohet, në pajtim me dispozitën ligjore<sup>28</sup>. Rrjedhimisht, kërkohet matja për paraqitjen e 4 raporteve për buxhet komunal brenda 1 viti fiskal, para kuvendit komunal për diskutim.

Në këtë mënyrë vlerësohet puna për përgatitjen dhe diskutimin e 4 raporteve 3 mujore të buxhetit, rrjedhimisht prezantimin për diskutim të punës në menaxhimin e buxhetit të vitit paraprak. Paraqitja para kuvendit, nënkupton se me rastin e paraqitjes kuvendi ka mundësi dhe obligim për të diskutuar dhe për të vepruar në kuadër të obligimeve që ka kuvendi komunal si organi më i lartë i komunës lidhur me punën e kryetarit dhe pjesës ekzekutive në zbatimin e buxhetit. Respektivisht, kuvendi komunal ka mundësi për të shqyrtuar 4 herë në vit, në baza të rregullta 3 mujore, performancën e organeve komunale në zbatimin e buxhetit apo përgjegjshmërinë e organeve në menaxhimin e financave të komunës.

Me vit në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet viti fiskal, përveç nëse nuk është specifikuar ndryshe. Ku (n-1) nënkupton, n=viti në vijim, kurse n-1 nënkupton vitin paraprak (fiskal)!

Përshkrimi ligjor për procesin e përgatitjes dhe raportimit para kuvendit komunal të dokumentit raport 3 mujor të buxhetit, si dhe përmbajtja dhe organizimi i raportit, burojnë nga ligji i përgjithshëm për menaxhimin e financave publike<sup>29</sup>, kurse kompetenca buron nga ligji për vetëqeverisje lokale<sup>30</sup>. Përkatësisht treguesi ka për qëllim matjen e përmbushjes së dispozitës ligjore, me ç' rast dokumenti raporti i buxhetit komunal 3 mujor për periudhën paraprake (3 mujore) fiskale duhet të prezantohet para kuvendit komunal më së voni 30 ditë pas përfundimit të 3 mujorit për të cilin raportohet. Në këtë mënyrë sigurohet koordinimi dhe qëndrueshmëria e buxhetit në mes të aktiviteteve të komunës, të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe me nivelin qendror, përmes raportimit në Ministrinë e Financave. Përkatësisht, dispozita ligjore obligon kryetarin e komunës, që me rastin e paraqitjes së raportit 3 mujor të buxhetit para kuvendit të dorëzojë një kopje të raportit edhe pranë Ministrisë së Financave në afatin e njëjtë kohor (më së largu 30 ditë pas përfundimit të 3 mujorit).

28 Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

29 Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

30 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

Viti fiskal për autoritetet komunale fillon me 1 janar, dhe afatet raportuese për 3 mujorët e buxhetit si në vijim: 31 Janar, 30 Prill, 31 Korrik, 31 Tetor.

Raportet e 3 muajve të buxhetit të paraqitura në kuvend pas afateve (datave) sipas periudhave përkatëse, për nevojat e SMPK-së merren si të pa-raportuara para kuvendit edhe nëse kryetari i raporton pas këtyre date.

Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, sigurimi i përfshirjes së KK me kohë në çështjet politike dhe ligjore; si dhe në fushën Transparenca Komunale, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve komunale në përgatitjen dhe zbatimin e llogaridhënies para kuvendit komunal, sipas afateve ligjore.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten katër të dhëna:

1. përqindja bazuar në raportimin e katërt – tremujori 4 para datës 31 Janar
2. përqindja bazuar në raportimin e parë – tremujori 1 para datës 30 Prill
3. përqindja bazuar në raportimin e dytë – tremujori 2 para datës 31 Korrik
4. përqindja bazuar në raportimin e tretë – tremujori 3 para datës 31 Tetor

### Formula e llogaritjes

Përcaktimi i vlerës së treguesit bëhet sipas kuantifikimit paraprak për aktet e raportimeve të dokumentit raport 3 mujor i buxhetit të komunës, që është 25% për raportet e paraqitura para datave përkatëse për secilën nga katër raportimet.

**Formula:**

$$\text{Treguesi} = 25 \times (\text{secilin raport të paraqitur})$$

0% nëse nuk ka dokument të paraqitur para datave përkatëse.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e kryetarit të komunës, arkivë dhe sekretarinë e Kuvendit Komunal, komisioni i kuvendit komunal për ekonomi dhe financa, faqen zyrtare të internetit të komunës si dhe në Ministrinë e Financave. Dokumenti prej të cilit merren të dhënat për përmbushjen e kërkesës për raportim, duhet të jetë dokument zyrtar në kuptimin që duhet të jetë i protokolluar.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve të miratuara dhe të protokolluara, njoftimeve, rendit të ditës së konsultimeve dhe me raportet 3 mujore të buxhetit të komunës, si dhe në aktet e komunikuar për punën e kuvendit lidhur me raportin 3 mujor të buxhetit, po ashtu edhe nga kopja e raportit 3 mujor i buxhetit i dorëzuar në Ministrinë e Financave.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 3.2.3 - Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit *ligjor* të organeve komunale në lidhje me prezantimin dhe diskutimin para kuvendit komunal të rezultateve të performancës së komunës të SMPK. Paraqitja e raportit SMPK dhe diskutimi në kuvendin komunal është obligim ligjor përmes rregullore për SMPK-në i cili kërkon që raporti vjetor i performancës, sipas SMPK-së, të prezantohet para kuvendit komunal<sup>31</sup>.

#### Çfarë matet?

Këtu matet nëse komuna përkatëse e ka shtruar për diskutim në kuvend komunal raportin e performancës komunale të vitit paraprak deri me 30 shtator. Treguesi matë mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për sigurimin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së ekzekutivit të komunës para kuvendit komunal, me ç'rast tërthorazi sigurohet cilësia dhe masat për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve, përkatësisht pasqyrohet në nivel të kuvendit komunal rezultati i punës së ekzekutivit të komunës kundrejt niveleve historike të shërbimeve të ofruara nga komuna si dhe kundrejt performancës së komunave të tjera të Kosovës. Po ashtu sigurohet shtytja për diagnostikim dhe planifikim të aktiviteteve dhe resurseve të komunës, sipas prioriteteve, duke shfrytëzuar rezultatet e matjes nga SMPK për të alokuar resurset në bazë të bashkërendimit në mes të nevojave të qytetarëve, strategjisë afatgjatë të komunës, dhe objektivave taktik dhe operacional të menaxhimit të zhvillimit. Kurse në mënyrë të drejtë për drejtë matë saktë përgjegjësinë për arritjet dhe ngecjet e autoriteteve komunale në fushën e secilës nga kompetencat që korrespondojnë sipas fushave të SMPK-së, kjo për shkak se treguesit e fushave japin informacion për kuvendin komunal për nivelin e performancës së autoriteteve komunale për vitin paraprak, duke hapur mundësinë për kuvendin për të ndërmarrë masa përkitazi për çdo nivel me qëllim të adresimit të ngecjeve apo rialokimit e resurseve nga treguesit që kanë arritë nivelet e kërkuara. Përmes sigurimit të paraqitjes në kuvend komunal raporti i SMPK-së sigurohet lidhja e qëndrueshme në mes të vendimmarrjes së nivelit politik dhe atij ekzekutiv, me qëllim të formulimit dhe sigurimit të zbatimit të politikave në interes të përmirësimit të performancës së autoriteteve komunale. Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, sigurimi i përfshirjes së KK me kohë në çështjet politike dhe ligjore; si dhe në fushën Transparenca Komunale, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve komunale në paraqitjen e rezultateve të SMPK-së dhe zbatimin e llogaridhënies para kuvendit komunal, sipas afateve ligjore.

#### Sqarime të hollësishme

<sup>31</sup> Rregullorja Nr. 02/2017 (MPL) për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave – Neni 7.1.8

Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për diskutim të raportit të SMPK para kuvendit komunal, i referohet vitit paraprak pasi që vet raporti i SMPK për vitin vijues i referohet të dhënave të mbledhura për vitin paraprak. Për matjen e këtij treguesi kërkohet dëshmia se raporti i SMPK-së është paraqitë si pikë e rendit të ditës para kuvendit komunal, më së paku deri para datës 30 Shtator. Rrjedhimisht, kërkohet matja për paraqitjen e raportit të SMPK-së brenda vitit vijues kur është publikuar raporti, respektivisht prezantimi i raportit të SMPK-së para kuvendit komunal për diskutim. Në këtë mënyrë vlerësohen arritjet e komunës të paraqitura si rezultat në kuadër të SMPK, rrjedhimisht prezantimin për diskutim të punës në menaxhimin shërbimeve dhe aktiviteteve të autoriteteve të komunës. Paraqitja para kuvendit, nënkupton se me rastin e paraqitjes kuvendi ka mundësi dhe obligim për të diskutuar dhe për të vepruar në kuadër të obligimeve që ka kuvendi komunal si organi më i lartë i komunës lidhur me punën e kryetarit dhe pjesës ekzekutive në përmirësimin apo përqendrimin në fusha, rezultate, dhe tregues përkatës. Respektivisht, kuvendi komunal ka mundësi për të shqyrtuar një herë në vit, në bazë të rregullt, performansën e organeve komunale në zbatimin e mandatit në interes të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët. Me vit në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet viti paraprak, si vit kur është matë paraqitja e diskutimit, duke implikuar se vet performansa e paraqitur në raportin e SMPK-së i referohet n-2, periudhës dy vite më parë.

Korniza ligjore për procesin e prezantimit dhe diskutimit para kuvendit komunal të dokumentit të SMPK-së, burojnë nga rregullorja Nr. 02/2017 (MPL), ku rregullohet edhe aspekti i strukturës raportuese së bashku me obligimet e komunës për mbledhje, verifikim, dhe raportim të të dhënave sipas orareve të përcaktuara kohore. Përkatësisht treguesi ka për qëllim matjen e përmbushjes së dispozitës ligjore, me ç' rast dokumenti raporti i publikuar i SMPK-së për periudhën paraprake (1 vjeçare) duhet të prezantohet para kuvendit komunal më së voni deri më datën 30 shtator të viti kur është publikuar raporti. Rrjedhimisht, prezantimi para kuvendit dëshmohet si pikë e rendit të ditës, në procesverbalet e miratuara dhe të protokolluara të kuvendit komunal. Viti për autoritetet komunale fillon me 1 janar, dhe mbaron më 31 Dhjetor. Për nevojat e SMPK-së merret si e pa-raportuar para kuvendit edhe nëse raporti i SMPK-së paraqitet për diskutim pas datës 30/shtator të vitit të publikimit.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojitet vetëm një e dhënë:

1. përqindja bazuar në procesverbalin e kuvendit komunal – me pikë të rendit të ditës diskutimi i raportit të SMPK-së para datës 30 shtator

Përcaktimi i vlerës së treguesit bëhet sipas kuantifikimit paraprak për aktin e raportimit të punës së kuvendit me pikën e rendit të ditës, diskutimi i dokumentit raportit të SMPK-së, që është 100% për raportin e punës së kuvendit komunal para datës 30 shtator.

### Formula e llogaritjes

**Formula:** 100% për raportin e SMPK të paraqitur për diskutim në kuvend komunal, dhe 0% nëse nuk ka dokument të paraqitur para datës 30 shtator.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e kryetarit të komunës, arkivë dhe sekretarinë e Kuvendit Komunal, zyrtari komunal për koordinim të SMP-K, faqen zyrtare të internetit të komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve, rendit të ditës të takimit të kuvendit komunal si dhe në aktet e publikuara për punën e kuvendit. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

**Treguesi 3.2.4 - Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të re komandimeve në Kuvendin Komunal**

### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të nxit komunitat që të shqyrtojnë në kuvend komunal raportin e jashtëm të auditorit me qëllim që të përmirësohet qeverisja dhe

### Çfarë matet?

Ky tregues ka për qëllim të mat shkallën e prezantimit të raporteve të auditimit të jashtëm (ZKA) duke përfshirë planin e veprimit për gjetjet, dhe shtruarjen për diskutim në kuvendin komunal.

Treguesi mat nëse raporti i jashtëm i auditimit i është dorëzuar në kuvendin komunal për diskutim në vitin e vlerësuar (d.m.th. raporti i auditimit të jashtëm i vitit 2018 duhet të diskutohen nga kuvendi komunal në vitin 2019). Ky tregues mat përqindjen e përmbushjes së raportit të auditimit të diskutuara nga kuvendi komunal brenda afatit kohor të kërkuar.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Sqarime të hollësishme

### Të dhënat

Të dhënat:

1. Diskutimi i raportit të Auditorit të jashtëm në Kuvend Komunal



## 2. Diskutimi i planit të veprimit

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = E\ dhëna\ 1 * 50 + E\ dhëna\ 2 * 50$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e kryetarit të komunës, arkivë dhe sekretarinë e Kuvendit Komunal, zyrtari komunal për koordinim të SMP-K, faqen zyrtare të internetit të komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve, rendit të ditës të takimit të kuvendit komunal. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 3.2.5 - Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Kuvendin Komunal

#### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të nxit komunat që të shqyrtojnë në kuvend komunal raportin e brendshëm të auditorit me qëllim që bëhen përmirësime për auditimin e jashtëm.

#### Çfarë matet?

Ky tregues ka për qëllim të mat shkallën e prezantimit të raporteve të auditimit të brendshëm duke përfshirë planin e veprimit për gjetjet, dhe shtruarjen për diskutim në kuvendin komunal.

Treguesi mat nëse raporti i brendshëm i auditimit i është dorëzuar në kuvendin komunal për diskutim në vitin e vlerësuar (d.m.th. raporti i auditimit të jashtëm i vitit 2018 duhet të diskutohen nga kuvendi komunal në vitin 2019). Ky tregues mat përqindjen e përmbushjes së raportit të auditimit të diskutuara nga kuvendi komunal brenda afatit kohor të kërkuar.

#### Sqarime të hollësishme

Secila komunë duhet të ketë numër të mjaftueshëm të auditorëve të brendshëm sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Nr. 06/021). Komunat duhet të bëjnë raport të brendshëm të auditimit i cili shërben për të forcuar kontrollin e brendshëm financiar dhe të vihen në vijë proceset e menaxhimit financiar. Ky proces duhet të ndodh si parapërgatitje për auditimin e jashtëm që bëhet nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Në raportin e brendshëm të auditorit duhet të prezantohet edhe niveli i përmbushjes së rekomandimeve të auditorit të brendshëm nga vitet paraprake.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

1. Diskutimi i raportit të Auditorit të brendshëm në Kuvend Komunal
2. Diskutimi i planit të veprimit

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = E\ dhëna\ 1 * 50 + E\ dhëna\ 2 * 50$$

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e kryetarit të komunës, arkivë dhe sekretarinë e Kuvendit Komunal, zyrtari komunal për koordinim të SMP-K, faqen zyrtare të internetit të komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve, rendit të ditës të takimit të kuvendit komunal. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 3.2.6 - Mbledhje të Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës

### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së pjesëmarrjes të kryetarit të komunës në seancat e kuvendit të komunës. Kuadri ligjor e obligon kryetarin për të raportuar para kuvendit së paku dy herë në vit lidhur me çështjet ekonomike-financiare të komunës, si dhe për zbatimin e planeve investuese. Po ashtu kryetari është i obliguar për tu paraqitur në seancat e kuvendit sa here kuvendi e kërkon këtë nga kryetari.

Ligji po ashtu e sanksionon numrin minimal të mbledhjeve të kuvendit komunal, në më së paku 10, kurse takimet mbi këtë minimum janë në diskrecion të kuvendit.

Në këtë kontekst, treguesi ka për qëllim matjen e pjesëmarrjes së kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit për të cilat është i obliguar, si për nga numri minimal i paraqitjes para kuvendit, ashtu edhe për seancat në të cilat është i ftuar për pjesëmarrje. Për qëllim të matjes së prezencës së kryetarit, për nevojat e këtij treguesi, baza për pjesëmarrjen e kryetarit në takimet e kuvendit komunal është marrë numri 10, si numri obligativ i seancave të kuvendit.

### Çfarë matet?

Treguesi matë përqindjen e arritjes për pjesëmarrje të kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit komunal, duke u nisur nga paragjykimi për mbajtjen e më së paku 10 takime të rregullta të kuvendit

komuna, ku në llogaritje të pjesëmarrjes hyjnë edhe 2 raportimet obligative të kryetarit të komunës para kuvendit.

Treguesi nuk matë cilësinë e pjesëmarrjes së kryetarit në mbledhjet e kuvendit komunal, përkatësisht nuk matë kontributin që i jep kryetari i komunës ndaj kuvendit komunal me rastin e pjesëmarrjes në mbledhje, duke mos paragjykuar cilësinë e pjesëmarrjes, nëse ka marrë fjalën apo jo.

### **Sqarime të hollësishme**

Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për pjesëmarrje të kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit komunal, i referohet vitit paraprak. Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë për numrin e mbledhjeve të mbajtura të kuvendit komunal, dhe dëshmitë për pjesëmarrjen e kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit të komunës.

Në këtë mënyrë vlerësohet respektimi i përfaqësuesve të qytetarëve të komunës nga ana e kryetarit të komunës, si hap thelbësor në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Pjesëmarrja e kryetarit të komunës duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, çon në përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve në interes të qytetarëve nga ana e autoriteteve komunale. Paraqitja para kuvendit, nënkupton se kuvendi ka mundësi dhe obligim për të diskutuar/shqyrtuar dhe për të vepruar në kuadër të obligimeve që ka si organi më i lartë i komunës lidhur me punën e kryetarit në përmirësimin apo përkeqësimin në shërbimet për qytetarë.

Me fjalën “vit” në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet viti paraprak, si vit kur aktualisht ka marrë pjesë apo jo, kryetari i komunës në mbledhjet e kuvendit komunal.

Viti për autoritetet komunale fillon me 1 janar, dhe me c'rast mbledhja e parë e kuvendit konsiderohet mbledhja e parë pas 1 Janarit të vitit përkatës, kurse mbledhja e fundit e vitit është ajo e mbajtur para datës 31 Dhjetor të vitit të raportuar. Për nevojat e SMPK-së merret si mos-pjesëmarrje në mbledhjet e kuvendit edhe nëse kryetari i komunës raporton përmes dorëzimit të raportit të shkruar, ku kryetari nuk është prezent personalisht në mbledhjen/et e kuvendit komunal.

Treguesi matë mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për sigurimin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së ekzekutivit të komunës para kuvendit komunal, me ç' rast tërthorazi sigurohet cilësia dhe masat për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve, përkatësisht pasqyrohet në nivel të kuvendit komunal rezultati i punës së ekzekutivit të komunës.

Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, sigurimi i përfshirjes së KK me kohë në çështjet politike dhe ligjore; si dhe në fushën Transparenca Komunale, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e kryetarit të komunës në paraqitjen e tij/saj para kuvendit komunal, sipas kërkesave ligjore.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të

raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojitet një e dhënë:

1. numri i mbledhjeve të kuvendit ku ka marrë pjesë kryetari i komunës
2. Numri i mbledhjeve të kuvendit të mbajtura (të rregullta dhe të jashtëzakonshme)

Përcaktimi i vlerës së treguesit bëhet sipas formulës paraprake për aktin e raportimit të numrit të pjesëmarrjeve të kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit. Këtu mblidhen pjesëmarrjet obligative minimale (2- në vit) dhe mbledhjet e kuvendit komunal ku edhe formalisht dokumentohet pjesëmarrja e kryetarit të komunës. Treguesi paraqet përqindjen e pjesëmarrjes së kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit të komunës, në kontekstin e 10 takimeve të kuvendit komunal si numër minimal i takimeve të obliguara të kuvendit.

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 1}{E\ dhëna\ 2} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Të dhënat gjinden në zyrën e kryetarit të komunës, arkivë dhe sekretarinë e Kuvendit Komunal, faqen zyrtare të internetit të komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve të protokolluara të takimeve, rendit të ditës të takimit të kuvendit komunal si dhe në aktet e publikuara për punën e kuvendit.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Rezultati 3.3 - Përgjegjshmëria në prokurim dhe kontraktim

Rezultati përfaqëson arritjen që e synon komuna në përgjegjshmërinë e Zyrës së Kryetarit për obligime ndaj prokurimit publik, pagesave dhe rekomandimeve të Auditorit të jashtëm. Autoritetet komunale janë të obliguara me ligj që të përpilojnë një plan të prokurimit ku duhet të planifikojnë projektet, shërbimet si dhe kostot për këto secilin projekt e shërbim në këtë plan. Autoritetet komunale po ashtu janë të obliguara me ligj që brenda 30 ditëve të bëjnë pagesat për të gjitha detyrimet financiare ndaj kontraktuesëve. Më tutje autoritetet publike kanë përgjegjësi të zbatojnë rekomandimet e auditorit të jashtëm, Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ky rezultat përmban në veti zbatimin e këtyre tri detyrimeve ligjore që kryesisht hyjnë në fushën e prokurimit dhe kontraktimit komunal. Synimi kryesor i këtij rezultati është që të sigurohet llogaridhënia e ekzekutivit të komunës para kontraktuesve dhe para publikut i cili merito qeverisje të mirë dhe efikase.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet nëpërmjet tre treguesve: 3.3.1; 3.3.2; dhe 3.3.3.

### Treguesi 3.3.1 - Niveli i zbatimit të planit të prokurimit

#### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të ngrit nivelin e zbatimit të planeve të prokurimit komunale si proces tejet i rëndësishëm në drejtim të kontraktimeve për projekte komunale dhe shërbime komunale.

#### Çfarë matet?

Ky tregues synon të matë performancën komunale në përmbushjen e planit përfundimtar të prokurimit të cilën e planifikon atë vit. Treguesi mat realizimin sipas shumës së shpenzuar kundrejt asaj të planifikuar në fillim të vitit dhe jo realizimin e aktiviteteve, edhe pse këto janë të ndërlidhura ngushtë.

#### Sqarime të hollësishme

Plani i prokurimit komunal duhet të përpilohet dhe publikohet në tre muajt e parë të vitit. Ligji për Prokurimin Publik e kërkon një plan të tillë dhe neni 8.1 i këtij ligji kërkon që secili autoritet publik, përfshirë këtu institucionin komunal, të përgatisë dhe të paraqes në Agjencinë Qendror për Prokurim (AQP) një planifikim vjetor fillestar për prokurim. Ndërsa 15 ditë pas miratimit të buxhetit të shtetit autoriteti publik, në këtë rast institucioni i komunës, duhet të përgatisë dhe dorëzoj në AQP planin përfundimtar të prokurimit. Plani duhet të përmbaj: 1.1. në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; 1.2. në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokuroj gjatë vitit fiskal; dhe 1.3. në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal<sup>32</sup>. Është e rekomandueshme që plani edhe të konsultohet para miratimit me qëllim që ai të bëhet sa më i realizueshëm.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të

<sup>32</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Miratuar 19.09.2011.

raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

#### Të dhënat

1. Vlera financiare e shpenzuar përmes prokurimit
2. Vlera financiare e planit të prokurimit

#### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 1}{E\ dhëna\ 2} * 100$$

#### Burimi kryesor i të dhënave

Të dhënat gjinden tek njësia për prokurim publik të komunës dhe drejtoria përkatëse për financa. Të dhënat verifikohen nëpërmjet planit final të prokurimit të publikuar dhe të protokolluara si dhe raportit të realizimit të planit të prokurimit.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

#### Treguesi 3.3.2 - Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve

#### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të përmirësoj shkallën e pagesave të detyrimeve komunal ndaj operatorëve ekonomik sipas afatit ligjor.

#### Çfarë matet?

Ky tregues matë shkallën e pagesave që komuna i ka bërë brenda 30 ditëve nga dita e faturuar. Pra matet përgjegjshmëria komunale për pagimin e detyrimeve për kompani që kryejnë punë për komunën.

#### Sqarime të hollësishme

Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (Nr. 03/L-048) në Nenin 39.1 kërkon që Zyrtari Financiar i çdo organizate buxhetore, përfshirë këtu komunën, është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me ekzekutimit të obligimeve financiare në raport me obligimet për pagesa, duke pasur si kriter afatin 30 ditor për shlyerjen e detyrimeve. Ku vlerësimi për këtë tregues NUK merret prej mostrave të shqyrtuara gjatë procesit të auditimit por këtu vlerësohen

të gjitha pagesat e bëra përmes sistemit Informativ për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit SIMFK (freebalance). Përkatësisht, vlera e arritur e përqindjes për këtë tregues vjen nga akti i ekzekutimit të pagesave brenda 30 ditëve sipas ligjit i referohet detyrimeve të arritura për pagesë.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

Të dhënat:

1. Numri i pergjithshem i pagesave
2. Numri i pagesave që i plotësojnë kërkesat ligjore për pagesë brenda 30 ditëve

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

Të dhënat gjinden tek drejtoria përkatëse për financa dhe zyrtari kryesor për pagesa. Të dhënat verifikohen nëpërmjet sistemi Informativ për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit SIMFK (freebalance).

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 3.3.3 - Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit

### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është që të fuqizohet menaxhimi financiar i komunës në bazë të gjetjeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit për komunën përkatëse.

### Çfarë matet?

Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me zbatimin dhe adresimin e plotë të rekomandimeve të nivelit të lartë dhe të mesëm të paraqitura në

formë eksplicite në raportin e ZKA. Në raportin e auditimit të ZKA (n-2), i cili i referohet vitit fiskal (n-3), paraqiten rekomandimet për zbatim apo adresim, të cilat duhet të jenë të zbatuara dhe adresuara në formë të plotë në vitin (n-1). Pra, matja është për përmbushjen e rekomandimeve të lëshuara nga ZKA dy vite më herët për komunën përkatëse.

### Sqarime të hollësishme

Çdo vit Zyra Kombëtare e Auditorit bënë auditimin e jashtëm të komunave të Kosovës. ZKA-ja bënë auditimin e komunave në bazë të pasqyrave financiare dhe shqyrtojnë: Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit; Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi; Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. ZKA çdo vit lëshon rekomandime për komunat të cilat pritet t'i adresojnë në vijim. Po ashtu ZKA shqyrton edhe shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të viteve të mëhershëm.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Të dhënat:

1. Përqindja e implementimit të rekomandimeve të ZKA

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$\text{Treguesi} = E \text{ dhëna } 1 * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e kryetarit të komunës, drejtorinë përkatëse për financa por edhe në ueb-faqen e Zyrës Kombëtare të Auditorit.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet Raportit të Jashtëm të Auditimit për komunën përkatëse. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Rezultati 3.4 - Sigurimi i masave antikorruption në administratën e komunës



Rezultati përfaqëson arritjen që e synon komuna në sigurimin e masave antikorrupsion dhe për integritetin institucional. Autoritetet komunale janë të obliguara që të zbatojnë dispozitat ligjore lidhur me qeverisjen lokale, si dhe ligjin për shërbimin civil të Kosovës. Ku në aspektin e antikorrupsionit autoritetet komunale janë të obliguara për sigurimin e llogaridhënies interne, përkatësisht para Kuvendit Komunal lidhur me arritjet vjetore për zbatimin e planit të integritetit si masë parandaluese për korrupsion. Po ashtu autoritetet komunale janë të obliguara për të zbatuar ligjin për Shërbimin Civil në raport me zyrtarët komunal të prekur nga organet e gjyqësorit.

Rezultati përmban në veti produktet e veprimeve të ekzekutivit të komunës që kanë të bëjnë me zbatimin e obligimeve për raportim para kuvendit si dhe obligimeve në raport me zyrtarët komunal të prekur nga organet e gjyqësorit.

Synimi kryesor i këtij rezultati është që të sigurohet llogaridhënia e ekzekutivit të komunës para kuvendit komunal, si dhe para organeve gjyqësore.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet nëpërmjet dy treguesve: 3.4.1 dhe 3.4.2.

### **Treguesi 3.4.1 - Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal**

#### **Qëllimi**

Ky tregues ka për qëllim matjen e përmbushjes së obligimit nga ana e zyrtarëve përgjegjës të komunës, për të raportuar rregullisht punën mbi zbatimin e planit të integritetit, me ç' rast sigurohet transparenca dhe llogaridhënia për masat anti-korruptive të parapara me planin e integritetit si instrument parandalues i korrupsionit. Përkatësisht për të matë zbatimin e kërkesës për raportim të planeve të integritetit të komunës që buron nga Plani i Veprimtimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi për sigurimin e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së ekzekutivit të komunës para kuvendit komunal, me ç' rast tërthorazi sigurohet cilësia dhe masat për përmirësimin e vazhdueshëm në fushën e anti korrupsionit. Po ashtu, sigurohet shtytja për planifikim dhe buxhetim të aktiviteteve dhe resurseve të komunës, në bazë të përcaktimeve të paraqitura në planin bazë të integritetit si kornizë e veprimeve në fushën e anti korrupsionit në nivel të komunës. Përmes sigurimit të paraqitjes në kuvend komunal raporti vjetor i aktiviteteve për zbatimin e planit të integritetit, sigurohet lidhja e qëndrueshme në mes të vendimmarrjes së nivelit politik dhe atij ekzekutiv, me qëllim të formulimit dhe sigurimit të zbatimit të politikave në interes të përmirësimit të performancës së autoriteteve komunës në aspektin e integritetit.

#### **Sqarime të hollësishme**

Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për prezantim dhe diskutim të raportit vjetor për implementimin e planit të integritetit para kuvendit komunal, i referohet vitit paraprak pasi që vet aktivitetet vjetore në kuadër të planit të integritetit për vitin vijues i referohen vitin paraprak. Për matjen e këtij treguesi kërkohet

dëshmia se raporti vjetor i aktiviteteve në kuadër të zbatimit të planit të integritetit është paraqitë si pikë e rendit të ditës para kuvendit komunal, më së paku deri para seancës së fundit të kuvendit brenda vitit të punës së kuvendit. Rrjedhimisht, kërkohet matja për paraqitjen e raportit vjetor të aktiviteteve në kuadër të zbatimit të planit të integritetit, respektivisht prezantimi i raportit vjetor para kuvendit komunal për diskutim.

Në këtë mënyrë vlerësohen arritjet vjetore të komunës në kuadër të zbatimit të planit të përgjithshëm të integritetit, rrjedhimisht prezantohen për diskutim dhe llogaridhënie të punës në menaxhimin e aktiviteteve nga ana e autoriteteve të komunës në kuadër të planit të integritetit si instrument për parandalimin e korrupsionit. Paraqitja para kuvendit, nënkupton se me rastin e paraqitjes kuvendi ka mundësi dhe obligim për të diskutuar dhe për të vepruar në kuadër të obligimeve që ka kuvendi komunal si organi më i lartë i komunës lidhur me punën e kryetarit dhe pjesës ekzekutive në përmirësimin apo përkeqësimin në fushat e parapara nga plani i përgjithshëm i integritetit. Respektivisht, kuvendi komunal ka mundësi për të shqyrtuar një herë në vit, në bazë të rregullt, performansën e organeve komunale në zbatimin e mandatit në interes të përmirësimit të aspekteve që lidhen me aktivitetet kundër korrupsionit dhe në dobi të qytetarëve.

Me vit në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet viti paraprak, si vit kur është matë paraqitja e raportit dhe diskutimit, duke implikuar se vet raporti vjetor i paraqitur i referohet n-2, periudhës dy vite më parë.

Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, Sigurimi i masave antikorrupsion në administratën e komunës; si dhe në fushën Transparenca Komunale, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve komunale në zbatimin e praktikave antikorrupsion dhe integritet.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojitet vetëm një e dhënë:

1. përqindja bazuar në procesverbalin e kuvendit komunal – me pikë të rendit të ditës diskutimi i raportit vjetor për zbatimin e planit të integritetit para datës 31 Dhjetor

Përcaktimi i vlerës së treguesit bëhet sipas kuantifikimit paraprak për aktin e raportimit të punës së kuvendit me pikën e rendit të ditës, prezantimi për diskutim i dokumentit raportit vjetor për zbatimin e planit të integritetit, që është 100% për raportin e punës së kuvendit komunal para datës 31 Dhjetor.

### **Formula e llogaritjes**

**Formula:** 100% për raportin vjetor për zbatimin e planit të integritetit të paraqitur për diskutim në kuvend komunal, dhe 0% nëse nuk ka dokument të paraqitur para datës 31 Dhjetor.

### **Burimi kryesor i të dhënave**

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e kryetarit të komunës, arkivë dhe sekretarinë e Kuvendit Komunal, zyrtari komunal për koordinim të planit të integritetit, faqen zyrtare të internetit të komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve, rendit të ditës të takimit të kuvendit komunal si dhe në aktet e publikuara për punën e kuvendit.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## **Treguesi 3.4.2 - Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre**

### **Qëllimi**

Ky tregues ka për qëllim matjen e përmbushjes së obligimit nga ana e zyrtarëve përgjegjës të komunës, për të suspenduar zyrtarët e komunës të cilët ballafaqohen me aktakuzë për shpërdorim detyre para gjykatave kompetente të Kosovës. Përkatësisht për të matë zbatimin e kërkesës që buron nga neni 69, pika 1 e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

### **Çfarë matet?**

Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për suspendimin e zyrtarëve komunal të përfshirë në proces gjyqësor kundër tyre, me 50% të pagës, i referohet vendimeve të autoriteteve komunale për të zbatuar dispozitën ligjore për të akuzuarit gjatë vitit për të cilin raportohet. Për matjen e këtij treguesi kërkohet dëshmia se cilët janë zyrtarët e akuzuar të komunës, dhe aktet e zbatuara për suspendim, në përmbushje të afateve kohore të parapara në mes të datës së ngritjes së aktakuzës dhe datës së hyrjes në fuqi të suspendimit me 50% të pagës; brenda vitit të punës së komunës (viti kalendarik). Rrjedhimisht, kërkohet matja për vendosjen e masës së suspendimit të zyrtarëve të përfshirë në proces penal në kuadër të listës së zyrtarëve komunal të përfshirë në proces penal lidhur me ushtrimin e funksionit zyrtar. Në këtë mënyrë vlerësohen arritjet vjetore të komunës në kuadër të zbatimit të aktiviteteve për sundimin e ligjit, duke siguruar pa anshmëri në proceset ligjore për shpërdorim të mundshëm të postit zyrtar nga ana e zyrtarëve komunal, e të cilët gjenden në proces penal të iniciuar kundër tyre për akuzë lidhur me ushtrimin e funksionit zyrtar. Respektivisht, autoritetet komunale kanë për obligim zbatimin e pikës për suspendim të zyrtarëve të akuzuar, ku nga komuna kërkohet zbatimi i mandatit në interes të përmirësimit të aspekteve që lidhen me aktivitetet në dobi të sundimit të ligjit dhe kundër korrupsionit dhe në dobi të qytetarëve. Me vit në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet viti paraprak, përkatësisht viti për të cilin raportohet!

### **Sqarime të hollësishme**

Korniza ligjore për procesin e vendosjes së masës së suspendimit, buron nga pika 1 e nenit 69 i ligjit<sup>33</sup>, ku rregullohet edhe aspekti i afateve dhe formës së masës së për suspendim. Përkatësisht treguesi ka për qëllim matjen e përmbushjes së dispozitës ligjore, me ç' rast akti i suspendimit për zyrtarët e kërkuar (me aktakuzë para gjykatave të Kosovës) duhet të merret dhe të hyjë në fuqi menjëherë! Rrjedhimisht, zyrtari i

<sup>33</sup> Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

komunës duhet që deri më afatin e paraparë sipas ligjit, në evidencën e zyrës së personelit të kategorizohet si i suspenduar me 50% të pagës. Ku kategorizimi në zyrën e personelit të komunës dëshmohej si njoftim i protokolluar dhe i regjistruar në evidencë, përkatësisht të ekzistojë në komunikimet dhe evidencën zyrtare shënimi për masën e suspendimit dhe efektet në aspektin e ndalesës për ushtrimin e aktivitetit të zyrtarit dhe masën e marrë ndaj pagës (ulje 50%). Për nevojat e SMPK-së merren si të pa zbatuara masat e suspendimit të cilat janë marrë pas tejkalimit të afateve të parapara ligjore, si dhe nëse masa e suspendimit nuk është zbatuar në plotësi deri në afatin e paraparë.

Treguesi matë mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për sigurimin e paanshmërisë gjatë proceseve të organeve të drejtësisë në raport me zyrtarët e komunës dhe pretendimeve kundër tyre, me ç' rast drejtpërdrejt sigurohet mbështetja për transparencë dhe sundim të ligjit në pjesën që i takon autoriteteve komunale, dhe tërthorazi sigurohet transparenca dhe llogaridhënia në fushën e anti korrupsionit. Po ashtu, sigurohet shtytja për zbatimin e masave për suspendim në rastet e aktakuzave kundër zyrtarëve të komunës, me ç' rast sigurohet përkushtimi ndaj integritetit dhe transparencës të autoriteteve komunale në rastet e aktakuzave ndaj zyrtarëve të saj. Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, Sigurimi i masave antikorrupsion në administratën e komunës, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve komunale në zbatimin e praktikave antikorrupsion dhe integritet.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. numri i zyrtarëve komunal të akuzuar nga organet e drejtësisë për shpërdorim detyre
2. numri i zyrtarëve komunal të akuzuar të cilët janë suspenduar me masë efektive në pajtim me dispozitat e kërkuara për suspendim

### **Formula e llogaritjes**

**Formula:**

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

Llogaritja:

- Komunat që nuk kanë zyrtarë komunal të akuzuar nga organet e drejtësisë marrin 100%.
- Komunat që kanë të akuzuar dhe nuk kanë suspenduar asnjë, marrin 0%;
- Komunat që kanë të akuzuar dhe kanë suspenduar së paku një, përdoret formula e më poshtme.

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e përfaqësuesit ligjor të komunës, zyrën e kryetarit të komunës, dhe në zyrën e personelit. Po ashtu të gjitha komunikimet zyrtare gjenden edhe në arkivë të komunës. Përfaqësuesi ligjor i komunës në një numër të komunave është në zyrën ligjore të komunës, i njohur si avokati i komunës. Në disa komuna, njoftimet nga gjykata adresohen në zyrën e kryetarit të komunës. Në këtë kontekst, burimi i informatave për zyrtarët e suspenduar duhet të identifikohet nga ana e zyrtarit të zyrës së personelit i cili raporton për këtë tregues! Të dhënat verifikohen nëpërmjet njoftimeve zyrtare nga ana e gjykatës, vendimeve nga kryetari i komunës, dhe evidencës në zyrën e personelit. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Rezultati 3.5 - Sigurimi i trajtimit të barabarte në kuadrin e menaxhimit të burimeve njerëzore

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës në sigurimin e trajtimit të drejtë dhe barabartë në kuadrin e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e komunës. Rezultati gjithashtu synon të ndihmojë komunën në ofrimin e kushteve të drejta dhe të barabarta, përkatësisht me qëllim të eliminimit të diskriminimit dhe të përmirësimit të performancës së zyrtarëve të komunës.

Rruga për arritjen e sigurimit të rezultatit behët përmes matjes së shkallës së implementimit të instrumenteve ligjore si zbatimi i vlerësimit të punës dhe zbatimi i skemës për sistemimin e rezultateve; po ashtu edhe përmes vlerësimit të shkallës së zbatimit të sistemit informativ dhe instrumenteve përkatëse gjatë procedurave të punësimit, dhe përfundimisht përmes llogaridhënies interne të ekzekutivit të komunës – zyrës së personelit para kuvendit komunal si organ më i lartë. Përmes këtyre treguesve synohet arritja e rezultatit, respektivisht ngritja e standardit të cilësisë, performancës në punë, dhe integritetit institucional brenda vet institucionit të komunës, the tërthorazi ngritje të cilësisë dhe performancës së shërbimeve që komuna ju ofron qytetarëve.

Arritja e rezultatit matet me këta tre tregues 3.5.1, 3.5.2 dhe 3.5.3.

### Treguesi 3.5.1- Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim matjen e përbushjes së obligimit të komunës, për të siguruar vlerësimin e punës së stafit të komunës në pajtim me dispozitat ligjore<sup>34</sup>.

#### Çfarë matet?

Treguesi mat shkallën e punëtorëve që iu është kryer vlerësimi i punës. Matja e përbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatit, Sigurimi i trajtimit të barabartë në kuadrin e menaxhimit të burimeve njerëzore; dhe kontribuon në fushën për Përgjegjshmëri komunal për arritjet dhe përgjegjshmërinë e komunës në raport me vlerësimin e punës së stafit sipas skemës në fuqi.

#### Sqarime të hollësishme

<sup>34</sup> Udhëzues Nr. 01/2014 (MAP) për Zbatimin e Procesit të Vlerësimit të Punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kuadri ligjor<sup>35</sup> përcakton kornizën për vendosjen e sistemit të rregullt të vlerësimit të punës së shërbyesve civil, përkatësisht vlerësimin e gjithë shërbimit civil në të gjitha nivelet institucioneve të Republikës së Kosovës.

Për nevojat e këtij treguesi duhet të merren parasysh vetëm raportet finale të vitit paraprak, për të cilin është dorëzuar raporti nga ana e komunës në Ministrinë e Administratës Publike. Gjegjësisht, treguesi mbështetet në kriterin e zbatimit të skemës së vlerësimit, duke shqyrtuar raportin e vlerësimit, ku shikohet respektimi i kufizimeve për sistemimin e vlerësimeve. Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë, përkatësisht pjesa e raportit në të cilën paraqitet ndarja sipas skemës së kërkuar, ku duhet të paraqiten të ndara grupet e vlerësimeve. Treguesi nuk matë cilësinë e raportit të vlerësimit në përgjithësi, por vetëm respektin e kriterit të sistemimit. Për nevojat e SMPK-së merret si mos-përmbushje të dispozitës nëse raporti i vlerësimit të punës së stafit nuk e përmban kategorizimin e vlerësimeve sipas skemës së kërkuar, dhe treguesit i caktohet vlera zero (0).

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna, të cilat shënohen sipas përcaktimit të paraqitur më poshtë.

1. Numri i zyrtarëve publik
2. Numri i zyrtarëve për të cilët është realizuar vlerësimi i punës

Përcaktimi i vlerës së treguesit bëhet sipas kuantifikimit paraprak për raportimin e përmbushjes dispozitës dhe për sistemimin e rezultateve të vlerësimit të punës së stafit të komunës. Përcaktimi i vlerës bëhet duke u siguruar në dy pika, (1) zbatimi i skemës për sistemin e rezultateve të vlerësimit, (2) zbatimi i vlerave maksimale për ndarjen në tri kategoritë e definuara. Me ç' rast ndahen 50% për plotësimin e pikës së parë (zbatimi i skemës për sistemimin e rezultateve), dhe 50% për plotësimin e pikës së dytë (respektimi i vlerave maksimale për ndarje në secilën kategori). Në rast të mos përmbushjes së njërës dispozitë, ndahet vlera 0% për secilën pikë veçmas!

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$\text{Treguesi} = \frac{E \text{ dhëna } 1}{E \text{ dhëna } 2} * 100$$

Burimi kryesor i të dhënave

---

<sup>35</sup> Rregullore Nr. 19/2012 (MAP) për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nënpunësve Civil.

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në drejtorinë e administratës në komunë, zyrën e personelit, Ministria e Administratës Publike, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet raporteve të dorëzuara në Ministrinë e Administratës Publike

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### **Treguesi 3.5.2 - Vende të hapura të punës që janë procesuar përmes SIMBNj**

#### **Qëllimi**

Ky tregues ka për qëllim matjen e përmbushjes së obligimit të komunës, për të procesuar çdo pozite për punësim në shërbim civil në komunë, përmes Sistemit Informativ të Burimeve Njerëzore (SIMBNj). Matja e këtij treguesi bëhet me për të siguruar vlerësimin e zbatimit të kërkesës ligjore nga ana e autoriteteve të komunës në pajtim me dispozitat ligjore<sup>36</sup>. Kuadri ligjor<sup>1</sup> përcakton kornizën për vendosjen e sistemit të rregullt për menaxhimin e procesit të punësimit nga ana e autoriteteve komunale, përkatësisht duke regjistruar vendet e punës dhe aktet e punësimit përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNj).

#### **Çfarë matet?**

Treguesi mat mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për evidentimin e punësimeve në SIMBNj. Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatit, Sigurimi i trajtimit të barabartë në kuadrin e menaxhimit të burimeve njerëzore; dhe kontribuon në fushën Të drejtat e njeriut, shërbimet sociale dhe familjare, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e komunës në raport me pikën e theksuar të vendimit të qeverisë, të cekur më lartë.

#### **Sqarime të hollësishme**

Komunat si njësi autonome të nivelit lokal të qeverisjes, janë të obliguara për të zbatuar vendimet e qeverisë, në kontekst të këtij treguesi është relevant vendimi qeverisë 04/89 pika 4. Për qëllim të matjes së këtij treguesi, kriter referent është zbatimi i dispozitës ligjore lidhur me regjistrimin e aktiviteteve nga zyra e personelit, përkatësisht evidentimi i punësimeve, respektivisht proceseve të punësimit nga ana e autoriteteve komunale përmes SIMBNj. Matja e të punësuarve për këtë tregues i referohet të gjithë të punësuarve si shërbyes civil, punësimi i të cilëve menaxhohet nga ana e zyrës së personelit të komunës.

Gjithë të punësuarit brenda periudhës së vitit për të cilin raportohet, të cilët kanë formuar marrëdhënie të punës me autoritetet komunale dhe ex-oficio kanë marrë thirrjen shërbyes civil, duhet të jenë regjistruar në SIMBNj. Kjo për shkak se në këtë mënyrë përmes detyrimit të regjistrimit në sistem të mbikëqyrur dhe të nënshtruar hierarkisë nën Ministrinë e Administratës Publike, sigurohet llogaridhënia dhe transparencja interne vertikale, si dhe sigurohet respektimi i procedurave ligjore për shpalljen dhe punësimin e kandidatëve më meritore. Në anën e drejtorisë së administratës dhe zyrës së personelit, imponohet detyra

<sup>36</sup> Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës 04/98 për aprovimin e klasifikimit të vendeve të punës të nëpunësve civil

për të zbatuar më përpikëri normat e kërkuara për procedurat e punësimit, duke pasur parasysh edhe përshkrimet e punës, njoftimet, shpalljet, dhe proceset e kërkuara për rekrutim të shërbyesve civil në përgjithësi. Zbatimi i dispozitave për evidentimin e të gjitha pozitave të punësimit, siguron mekanizëm i cili motivon përmirësimin e vazhdueshëm të performancës, duke pamundësuar arbitraritetin dhe relativizmin e detyrës për zbatimin e përpiktë të rregullave dhe parimeve gjatë punësimit nga ana e autoriteteve komunale. Tërthorazi, shtytja nga matja e këtij treguesi krijon motiv për zbatimin të plotë të dispozitave ligjore, dhe në mënyrë indirekte çon në përmirësimin e cilësisë së stafit të komunës, përkatësisht në përmirësimin e shërbimeve në dobi të qytetarëve të komunës.

Për nevojat e këtij treguesi duhet të merren parasysh vetëm raportet finale të vitit paraprak, për të cilin është dorëzuar raporti nga ana e komunës në Ministrinë e Administratës Publike. Gjegjësisht, treguesi mbështetet në kriterin e zbatimit të dispozitës për evidentimin e të gjitha punësimeve nga ana e autoriteteve komunale. Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë, përkatësisht pjesa e raportit në të cilën paraqitet numri i të punësuarve të rinj gjatë vitit në tërësi, si dhe të dhënat mbi numrin e të punësuarve të rinj sipas ekstraktit të marrë nga SIMBNJ. Treguesi nuk matë cilësinë e procesit të punësimit në përgjithësi, por vetëm respektimin e kriterit për evidentimin e të punësuarve të rinj në SIMBNJ. Për nevojat e SMPK-së merret si mos-përmbushje të dispozitës nëse raporti i zyrës së personelit të komunës nuk e përmban numrin e përgjithshëm të të punësuarve gjatë vitit, dhe treguesit i caktohet vlera zero (0).

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojite dy të dhëna:

1. numri i përgjithshëm i punësimeve të shërbyesve civil gjatë vitit në strukturat komunale
2. numri i përgjithshëm i të punësuarve në shërbim civil gjatë vitit në strukturat komunale sipas SIMBNJ

Treguesi paraqet përqindjen e të punësuarve të regjistruar në SIMBNJ në raport me numrin e të punësuarve në shërbim civil në përgjithësi gjatë periudhës 1 vjeçare.

### Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave



**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e personelit, Ministria e Administratës Publike, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës. Të dhënat verifikohen nëpërmjet raporteve të dorëzuara në Ministrinë e Administratës Publike, sistemi SIMBNJ – MAP.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 3.5.3 - Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore

#### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të rritet zbatimi i legjislacionit për kontraktimin e stafit për shërbime të veçanta në administratën komunale.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë numrin e kontratave për shërbime të veçanta në komunë për vitin raportues dhe shkallën e tyre që i'u kanë përmbajtur legjislacionit që i rregullon ato. Ky tregues ka për qëllim matjen e shkallës së përmbushjes së obligimit ligjor të organeve komunale në lidhje me përdorimin e marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV) në pajtim me legjislacionin, si ligji për Shërbim civil, ligji për Marrëdhëniet detyrimore si dhe rregullorja për Emërimin e shërbyesve civil.

#### Sqarime të hollësishme

Ligji për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës thotë që “Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit” (Neni 12, pika 4). Treguesi mat se sa prej kontratave të këtij lloji nuk e kanë tejkaluar periudhën 6 mujore dhe sa prej tyre iu janë përmbajtur Ligjit për Detyrimet.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

#### Të dhënat

Të dhënat:

1. Numri i kontratave që i plotësojnë kërkesat ligjore
2. Numri i kontratave për marrëveshje për shërbime të veçanta

#### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 1}{E\ dhëna\ 2} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e personelit, dhe zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës. Të dhënat verifikohen nëpërmjet kontratave për shërbime të veçanta.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

#### FUSHA 4 - BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE

Emri i fushës është "Barazia në Punësim, Shërbimet Sociale dhe Familjare". Kjo fushë mbulon vetëm të drejtat sociale dhe ekonomike të qytetarëve, si dhe shërbime sociale dhe familjare që ofrohen nga komunat.

Mirëqenia sociale është kompetencë vetanake komunale e përcaktuar me nenin 17 (k) të ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, ku parashihet ofrimi i shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cenueshmit, strehimi familjar, përkujdesja fëmijërore, përkujdesja për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e qendrave përkujdesje, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale. Kjo fushë është shumë e gjerë dhe rregullohet me shumë politika dhe akte normative.

Mirëqenia sociale dhe familjare është e sanksionuar si kompetencë komunale edhe me nenin 6 të ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare si dhe me aktet tjera normative relevante. Elementet e shërbimeve sociale dhe familjare që mbulohen nga MPMS nuk përfshihen në këtë fushë.

Të drejtat e njeriut po ashtu janë kompetencë vetanake komunale e përcaktuar me nenin 17 (i) të ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, ku parashihet promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Për më tepër neni 4.2 i po të njëjtit ligj potencon se të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve. Matja e performancës së komunave për të drejtat e njeriut, mirëqenien sociale dhe familjare janë shumë të rëndësishme për komunat me qëllim të identifikimit të përparësive dhe dobësive të shënuara në ofrimin e këtyre shërbimeve dhe marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e problemeve shumë të ndjeshme të kësaj fushe. Për MPL ka rëndësi në identifikimin e veprimeve të përbashkëta me ministritë e linjës, komunat dhe palët tjera të interesit për zgjidhjen e problemeve dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e mirëqenies sociale nga organet e vetëqeverisjes lokale. Gjithashtu rezultatet e performancës së komunave janë të lidhura drejtpërdrejt me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për monitorimin e zhvillimeve të kësaj fushe për të ridefinuar prioritetet për të ardhmen (Rregullorja nr. 02/2011 e MPMS).

Prandaj përmes kësaj fushe tentohet të matet barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi i qytetarëve si dhe ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare për qytetarët në nevojë.

Kjo fushë matet me dy rezultate dhe 4 tregues, të përshkruar më poshtë.

#### Rezultati 4.1 - Sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës për krijimin e një mjedisi jetësor që i trajton në mënyrë të barabartë apo pa diskriminim të gjithë qytetarët, në veçanti grupet e margjina lizuara dhe në nevojë të shoqërisë. Rezultati gjithashtu synon të sjellë produktet e veprimeve të komunës në trajtimin e barabartë të personave me aftësi të kufizuar dhe nxitjen në punësim të personave jo-shumicë.

Ky rezultat konkretisht përfshin arritjet në punësimin e personave me aftësi të kufizuar në institucionet komunale, dhe të trajtimit të barabartë të komuniteteve në aspektin e punësimit.

Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohen grupet e caktuara të shoqërisë që kanë nevojë për përkrahje institucionale në mënyrë që të jenë sa më të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë. Arritja e rezultatit matet me treguesin 4.1.1, dhe 4.1.2.

### Treguesi 4.1.1 - Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim të matë përqindjen e punonjësve komunal me nevoja të veçanta, sipas përkatësisë gjinore, në raport me numrin total të punonjësve në të gjitha institucionet nën menaxhim të drejtpërdrejtë të komunës dhe që paguhen nga buxheti komunal, të punësuar gjatë një viti kalendarik. Në këtë tregues nuk përfshihen gjykatat, policia, spitalet regjionale, ndërmarrjet regjionale apo qendrore, apo çfarëdo institucioni tjetër publik që nuk është nën menaxhim të drejtpërdrejtë të komunës.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë performancën e komunës në trajtimin e personave me aftësi të kufizuara, që përfshinë: invalidët e luftës, invalidët civil të luftës, personat e lindur me të meta fizike, shqisore apo mendore dhe personat të cilët si shkas i fatkeqësisë apo i sëmundjes kanë të meta fizike, mendore apo shqisore, por që mund të kryejnë punë të caktuara. Për të përcaktuar nëse një person është me aftësi të kufizuara dhe nivelin e aftësive të kufizuara, duhet mbështetur në vlerësimin e komisionit profesional në zyrën rajonale kompetente të DAPK.

#### Sqarime të hollësishme

Matja është shumë e rëndësishme dhe e ndërlidhur drejtpërdrejtë me politikat komunale të punësimit në përputhje me nenin 19.2 i ligjit nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi, i cili potencon se të gjithë janë të barabartë në punësim, ku punëdhënësit duhet të ndërmarrin masa të duhura që t'i mundësojnë personit me aftësi të kufizuara të ketë qasje, të marrë pjesë apo të avancohet në punësim, nëse kjo masë përbën ngarkesë joproporcionale për punëdhënësin. Po ashtu neni 12 i ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara kërkon që çdo institucion publik të ketë të punësuar një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punonjës (apo 2% e të punësuarve). Matja e këtij treguesi është prioritet ligjor kur kemi parasysh se shumica e institucioneve publike nuk kanë përmbushur këtë obligim.

Treguesi ofron informata për ndikim pozitiv që tregon humanitetin, integrimin e personave me aftësi të kufizuara në jetën institucionale dhe shoqëri, statusin e familjeve, trajtimin e barabartë, performancën e komunave, etj. Prandaj treguesi është relevant për matjen e rezultatit dhe për qëllimet e SMP sepse do të informoj se në çfarë mase personat me aftësi të kufizuara janë të punësuar në institucionet komunale, e që tërthorazi informon për mbrojtjen e tyre nga diskriminimi në punësim, si dhe për përfshirjen dhe integrimin e tyre social si dhe në jetën institucionale publike. Ndarja e të dhënave në baza gjinore siguron plotësim të treguesve tjerë të propozuar për rezultatin përkatës.

Treguesi është edhe ekonomikisht i dobishëm, sepse me punësimin e personave me aftësi të kufizuara mund të largojë një numër të tyre nga lista e ndihmës sociale, nga strehimi kolektiv, etj. Prandaj, ky tregues është konsistent dhe plotëson treguesit tjerë të këtij rezultati, që së bashku mund të ofrojnë një pasqyrë më të gjerë të mirëqenies socio-ekonomike në komunë. Problemi është se treguesi nuk matë përqindjen e

punësimi të personave me aftësi të kufizuar nga numri i përgjithshëm i tyre për të kuptuar se cila është përqindja trajtimit të barabartë të tyre me të tjerët, që është njëri prej qëllimeve thelbësore. Për këtë matje mungojnë të dhënat.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet vit pas viti. Për këtë tregues raportohet gjithsej numri i të punësuarve në dhjetor të vitit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Për informimin e plotë të këtij treguesi nevojiten të mblidhen 3 lloje të të dhënave:

1. Numri i përgjithshëm i personave me nevoja të veçanta të punësuar në të gjitha institucionet komunale,
2. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në të gjitha institucionet komunale;
3. Numri i femrave me nevoja të veçanta të punësuar në institucionet komunale (kjo e dhënë mblidhet për analizë në raportin e performancës, por nuk llogaritet në formulën e treguesit)

### Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = \left( \frac{E\ dhëna\ 1 * 50}{E\ dhëna\ 2} \right) * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga zyra e personelit për administratën komunale, Drejtoria e arsimit për institucionet arsimore të nivelit parauniversitar, Drejtoria e shëndetësisë për institucionet shëndetësore të nivelit primar, Drejtoria përgjegjëse për shërbime sociale për qendrat për punë sociale dhe institucionet e tyre vartëse (shtëpitë e pleqve për strehim rezidencial), Drejtoria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport për institucionet e kulturës, rinisë dhe sportit (teatrot, bibliotekat, etj.), Drejtoria përgjegjëse për shërbime publike për ndërmarrjet komunale (p.sh. tregu, stacionet e autobusëve, ndërmarrjet banesore, trafiku urban, hortikultura, etj.)

Problemi është mbledhja e të dhënave për të punësuarit me aftësi të kufizuar jashtë administratës komunale, ku zyra e personelit nuk e menaxhon bazën e tyre të të dhënave. Gjithashtu procedurat e punësimit nuk ofrojnë të dhëna për identifikimin e konkurrentëve me aftësi të kufizuar, e as listat e pagave, që e vështirëson procesin e mbledhjes së të dhënave.

Verifikimi i të dhënave nga lista e pagave mujore gjatë një viti kalendarik dhe nëpërmjet kontratave të punës si dhe raporteve të vlerësimit të nivelit të aftësisë së kufizuar të punonjësve në fjalë. Në të ardhmen, ky tregues mund të ndërtohet më tej me përfshirjen e cilësisë së punësimit (punësimi në nivele të vendimmarrjes) dhe të ndërlidhet me buxhetin e pagave dhe ndikimin që kjo mund të ketë në familje dhe shoqëri.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

#### Treguesi 4.1.2 - Të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë

##### Qëllimi

Ky tregues synon të matë shkallën e përfshirjes së komuniteteve pakicë në numrin e përgjithshëm të të punësuarve në institucionet komunale. Treguesi ka për qëllim të ndihmojë komunat në realizimin e përfaqësimit proporcional të komuniteteve në punësim në institucionet komunale.

##### Çfarë matet?

Ky tregues matë performancën e komunës nga pikëpamja e respektimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi në punësim për anëtarët e komuniteteve pakicë në komunën përkatëse. Komunat në të cilat komunitetet jo-shumicë përbëjnë më PAK se 1% të popullatës (sipas regjistrimit të fundit të popullësisë) nuk vlerësohen por marrin mesataren e komunave të Kosovës me qëllim që mos penalizimit;

##### Sqarime të hollësishme

Punësimi proporcional i komuniteteve pakicë në institucionet komunale fuqizon barazinë ekonomike dhe integrimin e tyre në shoqëri, si dhe mundëson adresimin adekuat të çështjeve të komuniteteve pakicë në kuadër të politikave komunale.

Treguesi matë saktë thelbin e qëllimit të matjes së performancës së komunave në këtë pikë pamje. Matja është shumë e rëndësishme dhe e ndërlidhur drejtpërdrejtë me politikat komunale të punësimit në përputhje me nenin 11. Pika 11.2 e Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil kërkon që institucionet në nivelin komunal të rezervojnë numrin e vendeve të punës proporcionalisht me përfaqësimin e komuniteteve të komunës së dhënë.

##### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet vit pas viti. Për këtë tregues raportohet gjithsej numri i të punësuarve në dhjetor të vitit raportues.

##### Të dhënat

**Të dhënave.** Të dhënat janë të disponueshme për informimin e plotë të treguesit dhe duhet të mblidhen 5 lloje të të dhënave:

1. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet komunale
2. Numri i përgjithshëm i të punësuarve nga komunitetet pakicë
3. Numri i përgjithshëm i femrave të punësuar nga komunitetet pakicë (mblidhet e dhëna për analizë në raportin e performancës, por nuk futet për llogaritje në formulë të treguesit)
4. Numri i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në komunë sipas ASK. (mblidhet e dhëna për analizë në raportin e performancës, por nuk futet për llogaritje në formulë të treguesit)
5. Numri i banorëve në komunë

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \left[ \left( \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} \right) / \left( \frac{e \text{ dhëna } 4}{e \text{ dhëna } 5} \right) * 100 \right]$$

Llogaritja:

- Komunat në të cilat komunitetet jo-shumicë përbëjnë më PAK se 1% të popullatës (sipas regjistrimit të fundit të popullësisë) nuk vlerësohen por marrin mesataren e komunave të Kosovës me qëllim që mos penalizimit;
- Komunat në të cilat komunitetet jo-shumicë përbëjnë më SHUMË se 1% të popullatës (sipas regjistrimit të fundit të popullësisë), përdoret formula e më poshtme.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** mblidhen nga Zyra e personelit për administratën komunale, Drejtoria e arsimit për institucionet arsimore të nivelit parauniversitar, Drejtoria e shëndetësisë për institucionet shëndetësore të nivelit primar, Drejtoria përgjegjëse për shërbime sociale për qendrat për punë sociale dhe institucionet e tyre vartëse (shtëpitë e pleqve për strehim rezidencial), Drejtoria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport për institucionet e kulturës, rinisë dhe sportit (teatrot, bibliotekat, etj.), Drejtoria përgjegjëse për shërbime publike për ndërmarrjet komunale (p.sh. tregu, stacionet e autobusëve, ndërmarrjet banesore, trafiku urban, hortikultura, etj.). Problem është mbledhja e të dhënave për të punësuarit që janë jashtë administratës komunale, ku zyra e personelit nuk e menaxhon bazën e tyre të të dhënave. Gjithashtu procedurat e punësimit nuk ofrojnë të dhëna për identifikimin e konkurrentëve sipas përkatësisë etnike, por në këtë drejtim mund të ndihmojnë statistikave brendshme, të miratuara nga institucionet përgjegjëse në komunë.

Të dhënat mund të mblidhen në bazë të komuniteteve ku ata janë pakicë: shqiptarë, serbë, boshnjakë, turq, romë, ashkalinj, egjiptas, goran, kroat, malazet etj.

Verifikimi i të dhënave bëhet nga lista e pagave mujore gjatë një viti kalendarik, nëpërmjet kontratave të punës dhe statistikave zyrtare, të miratuara nga institucionet përgjegjëse të formës përfundimtare (të protokolluara).

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Rezultati 4.2 - Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës në ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale dhe për mbrojtjen e familjes. Rezultati gjithashtu synon të ndihmojë komunën në ofrimin e kushteve bazike për

jetesë për qytetarët në nevojë (si banimi dhe mbrojtja e fëmijëve pa përkujdesje), përmes së cilit synohet të arrihet ngritja e standardit jetësor dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara në shoqëri.

Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohen grupet e caktuara të shoqërisë që kanë nevojë për përkrahje institucionale në mënyrë që të jenë sa më të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë. Kjo kompetencë është decentralizuar nga niveli qendror dhe po përcillet me probleme të theksuara të cilat komuna duhet t'i zgjidhë. Duke qenë se numri më i madh i popullatës është i pa punë dhe një kategori tjetër e dalë nga lufta e vitit 1999 është gjithashtu e pa aftë pa punë, po i rritë kërkesat për ofrimin e ndihmës sociale dhe familjare. Kjo gjendje e rëndë e popullatës e ka bërë këtë rezultat prioritet të komunave të Republikës së Kosovës.

Arritja e rezultatit matet me treguesin 4.2.1 dhe 4.2.2.

### **Treguesi 4.2.1 - Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social**

#### **Qëllimi**

Ky tregues synon të matë efektivitetin e komunës në sigurimin e banimit për familjet në nevojë por edhe krijimin e kushteve për familjet përfituese të lëshojnë banimin social

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë performancën e komunës nga pikëpamja e ndërtimit të kapaciteteve për të siguruar strehimin e të gjitha familjeve në nevojë. Në fakt treguesi matë shkallën e përfshirjes së familjeve të regjistruara që kanë nevojë për strehim në komunën përkatëse. Gjithashtu matet sa nga familjet në banim social lirohen nga banimi social si rezultat i krijimit të kushteve.

#### **Sqarime të hollësishme**

Treguesi është i ndërlidhur me planet e komunave dhe buxhetin për ndërtim të banesave sociale. Përqindja e familjeve për të cilët është ofruar banim tregon një ndryshim të caktuar pozitiv në shoqëri. Kjo është shumë e rëndësishme për të gjithë qytetarët sepse sigurohet banimi për njerëzit në nevojë, largohen familjet nga rruga dhe kështu zvogëlohet barra familjare për përkrahje, zvogëlohen pabarazitë sociale dhe kontribuon në zbutjen e problemeve sociale dhe shëndetësore. Me sigurim të banimit gjendja sociale e familjes përmirësohet, në pikëpamjen e ofrimit të kushteve bazike për jetë.

Treguesi mund të prodhojë edhe ndikim negativ, sepse sigurimi i banimit në strehimore kolektive mund të shkaktojë probleme sociale (dhuna në familje, fëmijët me sjellje asociale, përdorimi i narkotikëve, etj.) të cilat mund të ndikojnë negativisht në familjet (sidomos fëmijët e tyre) të cilat nuk kanë probleme të tilla. Përqendrimi i problemeve sociale në një vend mund të ndikoj negativisht në performancën komunale dhe gjendjen e përgjithshme në komunë. Prandaj, propozohet që ky tregues të zgjerohet për të përfshirë sigurimin e banimit edhe të formave të tjera. Për këtë arsye tregues përcjell edhe lëshimin e banimit social dhe sa po krijohen kushtet për lirim të banimit social.



Aktualisht shifrat pozitive në matjen e këtij treguesi tregojnë performancën pozitive të komunës përkatëse, por në të ardhmen shifrat negative do të duhej të tregojnë trendin pozitiv të performancës së komunës përkatëse. Zgjidhja e problemit nuk është rritja e numrit të familjeve të strehuara, por zvogëlimi i numrit të familjeve që kanë nevojë për strehim në komunën përkatëse. Treguesi matë thelbin e asaj që synohet të matet, por shumë pikëpamje apo faktorë të tërthortë që ndikojnë në këtë problematikë nuk mund të maten.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të ndikimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënave.** Të dhënat janë të disponueshme për informimin e plotë të treguesit dhe duhet të mblidhen 4 lloje të të dhënave:

1. Numri i përgjithshëm i familjeve të cilave iu është siguruar banimi social nga komuna,
2. Numri i familjeve të regjistruara në komunë që kanë nevojë dhe që i plotësojnë kushtet për banim social, gjatë vitit kalendarik
3. Numri i familjeve në banim social
4. Numri i familjeve në banim social që kanë lëshuar banimin social.

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \left( \frac{E\ dhëna\ 1}{E\ dhëna\ 2} + \frac{E\ dhëna\ 4}{E\ dhëna\ 3} \right) * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** të dhënat mblidhen nga Drejtoria përgjegjëse për strehim/banim, Drejtoria përgjegjëse për mirëqenie sociale, Drejtoria përgjegjëse për emergjenca dhe Drejtoria për shërbime publike, si dhe Komisioni për strehim/banim dhe Komisioni për komunitetin RAE aty ku ekziston dhe nuk është nën strukturën e një drejtorie të veçantë.

Verifikimi i të dhënave bëhet nga vendimet e organeve përgjegjëse komunale (drejtoria apo komisioni përkatës) për sigurim të banimit, numri i familjeve që kanë kërkuar banim nga komuna verifikohet nga protokollu ku regjistrohen kërkesat e tilla në drejtoritë/komisionet relevante komunale, dhe numri i familjeve që kanë të drejtë për sigurim të banimit nga komuna verifikohet nga vendimet e drejtorive/komisioneve relevante komunale të shënuar në paragrafin më lartë.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Qëllimi

Ky tregues synon të matë përpjekjet e komunës përkatëse në strehimin familjar si formë alternative e mbrojtjes sociale të fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare përmes vendosjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore në një familje tjetër.

### Çfarë matet?

Treguesi matë numrin e fëmijëve të strehuar në familje strehuese nga numri i përgjithshëm i kërkesave të fëmijëve për strehim familjar, gjatë një viti kalendarik. Për këtë tregues raporton komuna e cila ka bërë strehimin e fëmijës, pavarësisht nëse fëmija është nga komuna e njëjtë apo nga ndonjë komunë tjetër.

### Sqarime të hollësishme

Të drejtat dhe gjendja sociale e fëmijëve përbën një nga shërbimet e rëndësishme sociale dhe familjare të komunës. Trajtimi i fëmijëve po ashtu është një prej kategorive kyçe edhe në standardet minimale të shërbimeve sociale dhe familjare të cilat komuna ka obligim t'i zbatoj. Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe Udhëzimit Administrativ nr.13/2012 për Rregullimin e Strehimit Familjar, QPS është përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar dhe të lënë pas dore. QPS bënë rekrutimin, vlerësimin, trajnimin e familjeve potenciale për strehim familjar, bënë mbikëqyrjen e fëmijës së strehuar dhe të OJQ-ve që punojnë në strehim familjar. Pra, komuna është përgjegjëse për planifikim dhe ofrim të shërbimit, pavarësisht faktit se financimi i familjeve strehuese bëhet drejtpërdrejtë nga MPMS.

Ndikimi i këtij treguesi është se tregon për largimin e fëmijëve nga kushtet ku nuk kanë përkujdesje adekuate, sigurimin e strehimit të tyre për të realizuar të drejtat e tyre dhe t'i kthehen jetës adekuate fëmijërore. Treguesi është i rëndësishëm për vet fëmijët por edhe qytetarët në përgjithësi, sepse sigurimi i strehimit familjar mbron fëmijët nga kushtet e pavolitshme dhe ofron kushte bazike për zhvillim të tyre dhe të ardhme më të shëndoshë. Në të ardhmen, ky tregues mund të ndërtohet më tej duke marrë parasysh edhe buxhetin për të reflektuar efektivitetin, eficientën dhe vlerën për para.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet vit pas viti. Për këtë tregues raportohet gjithsej numri i të punësuarve në dhjetor të vitit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënave.** Të dhënat janë të disponueshme për informimin e plotë të treguesit dhe duhet të mblidhen 3 lloje të të dhënave:

1. Numri i kërkesave të fëmijëve në nevojë për strehim familjar
2. Numri i fëmijëve në nevojë të vendosur në familjet strehuese
3. Numri i fëmijëve në nevojë të vendosur në familjet strehuese brenda vitit
4. Numri i vajzave me nevojë të vendosur në familje strehuese (vetëm për mbledhje të dhënave)

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 70 + \frac{E\ dhëna\ 3}{E\ dhëna\ 2} * 30$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** të dhënat mblidhen nga QPS. Verifikimi i të dhënave bëhet nga baza e të dhënave në shërbimin për kujdesin e fëmijëve pa prindër dhe në regjistrat zyrtar në QPS.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## FUSHA 5 - KULTURË, RINI DHE SPORT

Emërtimi i fushës është "Kulturë, Rini dhe Sport". Kjo, në kuptimin e përgjithshëm nënkupton aktivitetet komunale kulturore, rinore dhe sportive dhe përfaqëson njërin prej kompetencave veta nake të komunës përkatëse. Fusha mbulon shërbimet e ofruara nga komunat që kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin.

Matja e performancës në këtë fushë përfshinë çfarëdo aktiviteti për të cilin komunat janë direkt (si organizator) ose indirekt (si bashkë-organizator) të përfshira. Ky është fushëveprimi i reflektimit dhe i matjeve në këtë fushë. Më tutje, Kultura, Rinia dhe Sporti trajtohen si të veçanta ku duhet të kihet parasysh shmangia e numërimit/llogaritjes së dyfishtë të aktiviteteve (p.sh. një aktivitet për të rinjtë mund të jetë edhe aktivitet sportiv, dhe duhet të përcillen përkufizimet që tregojnë qartë se në cilën prej këtyre fushave reflektohen të dhënat në këto raste).

Fusha është e matshme përmes rezultateve dhe treguese të përshkruar më poshtë. Sidoqoftë, matja mund të jetë e besueshme, por kjo, si dhe kosto e matjes, janë marrë parasysh edhe në përkufizimin dhe përcaktimin e rezultateve dhe treguesve që përcaktohen më poshtë. Gjatë tërë procesit të rishikimit janë marrë parasysh këto elemente para se të identifikohen rezultatet dhe treguesit, dhe përkufizimet më poshtë i plotësojnë këto parakushte.

Informatat e prodhuara nga matja e performancës së kësaj fushe janë të rëndësishme për punën e strukturave të pushtetit lokal në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore dhe në kohën e duhur për qytetarët apo grupet e ndryshme të interesit të prekur nga sektorët e mbuluar me këtë fushë. Po ashtu matja e performancës së komunave në ofrimin e këtyre shërbimeve ka rëndësi të madhe edhe për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për prioritzimin dhe harmonizimin e politikave të veta e që kanë të bëjnë me përkrahjen e komunave në menaxhim më efektiv të shërbimeve. Gjithashtu raportet e performancës mund të shfrytëzohen edhe nga palët e ndryshme të interesit dhe nga vetë qytetarët për qëllim të ndryshme planifikuese etj.

Arritjet e komunës në këtë fushë maten nëpërmjet 2 rezultateve kryesore që përfshijnë veprimet e komunës në fazën përgatitore dhe planifikuese për zhvillimin e aktiviteteve, veprimet gjatë aktiviteteve dhe veprimet pas ndodhjes së aktiviteteve. Në këtë mënyrë, nëpërmjet dy rezultateve synohet të matet cikli i plotë i ofrimit të shërbimeve në kulturë, rini dhe sport në nivelin lokal.

### Rezultati 5.1 - Ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive sportive

Rezultati përfaqëson arritjet e komunës për krijimin e kushteve të nevojshme për veprimtari sportive, me theks të veçantë ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e këtyre veprimtarive, të cilat konsiderohen të jenë efektiv në rast të përmbyshjes së treguesve të propozuar për këtë rezultat. Duke pas parasysh se në popullatën e vendit zotëron moshën e re, potencialisht për ushtrimin e këtyre veprimtarive, komunat e kanë prioritet krijimin e kapaciteteve apo të kushteve të nevojshme që pjesa më aktive e saj të ketë mundësinë e ndërtimit të shkathtësive fizike.

Rezultati përmbledhë produktet e veprimtarive të komunës përkatëse në krijimin e kushteve të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve shumë të rëndësishme për popullatën. Performanca e komunës përkatëse

, për arritjen e këtij rezultati, është e lidhur ngushtë me zhvillimin, miratimin, duke përfshirë edhe buxhetin e nevojshëm, dhe zbatimin e planit të komunës për ofrimin e mundësive për veprimtari sportive të popullatës së komunës përkatëse. Komuna është kompetente për planifikimin dhe zbatimin e projekte me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për ushtrimin e këtyre veprimtarive shumë të rëndësishme për qytetarët e vet, qoftë nëpërmjet sigurimit të buxhetit të nevojshëm, qoftë nëpërmjet përkrahjes së projekteve konkrete nga komuniteti i të rinjve të komunës përkatëse. Synimi kryesor i këtij rezultati është që të krijojë kapacitetet e nevojshme dhe të përkrahë ushtrimin e këtyre veprimtarive duke ndihmuar organizimin dhe zbatimin e tyre.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet përmes një treguesi kryesor.

### **Treguesi 5.1.1 - Hapsira për aktivitete të sportit për numër të banorëve**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim të matë shkallën e performancës së komunës përkatëse për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mjaftueshme infrastrukturore për ushtrimin e veprimtarive kulturore dhe rinore. Krijimi dhe administrimi i objekteve për veprimtari të kulturës dhe veprimtari të rinjve (si Qendra Rinore) është nën përgjegjësinë dhe kompetencën e komunës.

Treguesi është në funksion të plotë të përmbushjes së qëllimit të rezultatit 5.1, konkretisht matë performancën e komunës përkatëse në krijimin e kushteve (parakushteve) të nevojshme fizike (objekteve dhe hapësirave) për zhvillimin e veprimtarive kulturore dhe rinore. Krijimi i kushteve fizike për ushtrimin e këtyre veprimtarive apo ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme fizike, është i lidhur ngushtë me zbatimin e projekteve individuale dhe të atyre të përbashkëta, në partneritet me komunitetin apo donatorë të ndryshëm.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë nivelin e hapësirës për kulturë dhe rini, në metra katrorë, për banorë në komunë në mënyrë kumulative si dhe hapësirën e shtuar gjatë vitit për këto veprimtari. Treguesi matë vetëm hapësirat që janë nën menaxhim të komunës dhe mirëmbahen rregullisht nga komuna.

#### **Sqarime të hollësishme**

Hapësirë për kulturë konsiderohet hapësira e shtëpisë/ve të kulturës në komunë, hapësira e bibliotekave në menaxhim komunal, hapësira e klubeve të kulturës të cilat menaxhohen nga institucionet komunale. Ndërsa hapësirë për rini konsiderohet hapësira për Qendra Rinore në komuë si dhe ndonjë hapësirë për veprimtari nga të cilat përfitojnë të rinjtë dhe që është nën-menaxhimin e komunës. Këtu nuk përfshihen hapësirat për veprimtari sportive pasi për këtë është një tregues tjetër i veçant. Institucionet komunal kanë Drejtoritë komunal për kulturë, rini dhe sport dhe këto drejtori duhet të mbajnë evidencat e komunës për hapësira të këtyre veprimtarive. Më tutje, këto drejtori bëjnë plane për zhvillimin e hapësirave të këtyre veprimtarive dhe realizimi i zgjerimit të këtyre hapësirave në fund të vitit faktorizohet në formulë për llogaritjen e këtij treguesi.

#### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojite dy të dhëna:

1. Metra katrorë hapësira për veprimtari të sportit
2. Metra katrorë hapësira për veprimtari të sportit (nën menaxhimin e komunës apo Qendrës Rinore) të shtuar gjatë vitit
3. Banorë të komunës (sipas ASK-së)

## Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = \left[ \frac{E \text{ dhëna } 1}{E \text{ dhëna } 3} * 100 \right] + \left[ \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 50 \right]$$

Llogaritja:

- Nëse ndërtohet një metër katrorë hapësirë për veprimtari të sportit, vlerësimi del 100% për komunën;
- Për të vlerësuar edhe performancën vjetore, një pjesë e vlerës shtohet vlerës të përgjithshme për shkallën e hapësirës për sport që ndërtohet gjatë vitit raportues

## Burimi kryesor i të dhënave

Të dhënat mbliidhen nga njësia apo drejtoria përkatëse për kulturë, rini dhe sport (nga zyrtarët përgjegjës për secilën veprimtari). Verifikimi bëhet përmes kontratave të nënshkruara nga komuna për ndërtimin e hapësirave të këtyre veprimtarive.

## Rezultati 5.2 - Rritja e numrit të veprimtarive kulturore, rinore e sportive dhe e pjesëmarrjes së qytetarëve

Rezultati përfaqëson arritjet e komunës përkatëse për krijimin e kushteve të nevojshme për rritjen e numrit dhe llojeve të veprimtarive sportive, kulturore dhe rinore, me theks të veçantë rritjen e numrit të pjesëmarrësve të qytetarëve në veprimtaritë e ndryshme kulturore, rinore e sportive. Arritja e këtij rezultati është i lidhur ngushtë me rezultatin e parë 5.1 apo me ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme fizike dhe

burimeve tjerë për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme nga një numër më i madh i qytetarëve të komunës përkatëse. Me anën e këtij rezultati matet thelbi i performancës së komunës përkatëse për këtë fushë. Ndërtimi i kapaciteteve nuk ka asnjë kuptim, nëse nuk rritet numri, llojet e veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive dhe pjesëmarrja e qytetarëve në këto veprimtari.

Rezultati përmbledhë produktet e veprimtarive të komunës përkatëse në krijimin e kushteve të nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve shumë të rëndësishme për popullatën. Performanca e komunës përkatëse , për arritjen e këtij rezultati, është e lidhur ngushtë me ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e llojeve dhe e numrit të veprimtarive të ndryshme sportive, për ushtrimin e llojeve dhe e numrit të veprimtarive të ndryshme kulturore dhe rinore, si dhe rritjen e numrit të pjesëmarrjes së qytetarëve në secilën prej këtyre veprimtarive. Kapacitetet e njëjta fizike të komunës përkatëse mund të shfrytëzohen për veprimtari të ndryshme dhe ofrimi i shërbimeve për këtë fushë duhet kuptuar si ofrim i integruar i shërbimeve. Kjo nënkupton se veprimtaritë kulturore dhe rinore mund të zhvillohen në objekte të përbashkëta, sikur edhe veprimtaritë rinore së bashku me ato sportive. Shumë veprimtari sportive, janë edhe veprimtari rinore dhe po ashtu shumë veprimtari kulturore janë edhe veprimtari rinore dhe anasjelltas. Që të raportohet sa më saktë se e cilës fushë llogaritet dhe raportohet veprimtaria përkatëse e zhvilluar, merret për bazë njësia përkatëse organizuese, p.sh. nëse një veprimtari rinore ka karakter sportiv, por organizohet nga njësia përkatëse për rini apo në bazë të një projekti për rini, raportohet si veprimtari rinore.

Numri i veprimtarive nënkupton numrin e përgjithshëm të organizimeve dhe bashkë-organizimeve të veprimtarive sportive, kulturore dhe rinore nga komuna. Numri i pjesëmarrjes nënkupton qytetarët që pranojnë shërbimin dhe marrin pjesë në veprimtaritë e organizuara dhe bashkë-organizuara me komunën përkatëse. Pjesëmarrje nënkupton marrja pjesë në veprimtaritë e ndryshme kulturore, rinore dhe sportive. Komuna është përgjegjëse për ofrimin e përkrahjes për organizimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme për veprimtari kulturore, rinore dhe sportive dhe monitorimin e zbatimit të tyre me qëllim të krijimit të kushteve për përfshirje të barabartë të qytetarëve dhe komuniteteve në këto veprimtari. Synimi kryesor i këtij rezultati është që të krijojë kushte të barabarta për të gjitha llojet e veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet nëpërmjet dy treguesve kryesor.

### **Treguesi 5.2.1 - Aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit të organizuara me buxhet komunal**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim të matë performancën e komunës përkatëse në realizimin e veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive. Në bazë të kërkesave të qytetarëve (duke përfshirë edhe projektet individuale dhe të përbashkëta) dhe potencialit për ushtrimin e këtyre veprimtarive nga ana e qytetarëve, komuna organizon apo bashkë-organizon ose ndihmon apo përkrahë veprimtaritë e ndryshme kulturore, rinore dhe sportive.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë të gjitha ato veprimtari sportive, kulturore dhe rinore të cilat zhvillohen nga komuna apo në njëjërën apo tjetrën formë janë të përkrahura dhe të monitoruara dhe mbahen të dhëna apo raportohet për këto veprimtari nga komuna. Këtu nuk mund të maten ato veprimtari të cilat zhvillohen nën organizimin e bartësve privat dhe në objekte private për të cilët nuk janë të obliguar që të marrin leje apo ta informojnë

komunën. Nëse komunat përkatëse nuk kanë mbajtur të dhëna për të gjitha veprimtaritë kulturore, rinore dhe sportive, atëherë është përgjegjësi e tyre dhe e zyrtarëve përgjegjës për këto veprimtari që të zhvillojnë, të përkrahin, të promovojnë veprimtaritë e ndryshme kulturore, rinore dhe sportive dhe të raportojnë për të gjitha me qëllim të përfshirjes së një numri sa më të madh të qytetarëve në këto lloje veprimtarish shumë të rëndësishme për jetën e qytetarëve.

Treguesi është në funksion të plotë të përmbushjes së qëllimit të rezultatit 5.2, konkretisht matë performancën e komunës përkatëse në nivelin zbatues. Me kërkesën e SMPK për raportimin e realizimit të veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive, në të njëjtën kohë, matë edhe llojet e ndryshme të këtyre veprimtarive.

### **Sqarime të hollësishme**

Realizimi i veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive nënkupton realizimin apo zbatimin e të gjitha llojeve të veprimtarive, ngjarjeve dhe projekteve me karakter kulturor, rinor dhe sportiv që organizohen dhe zhvillohen nga komuna, që organizohen dhe zhvillohen në partneritet të komunës me qytetarët ose që organizohen dhe zhvillohen nga qytetarët nën përkrahjen e komunës.

Këtu hyjnë të gjitha llojet e veprimtarive kulturore në fushën e muzikës, të dramës dhe humorit, recitalit, të artit figurativ, të trashëgim kulturore, të librit, të filmit dhe të gazetarisë (Ligji Nr. 04/L-106 për Teatrot, Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, Ligji Nr. 04/L-164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe të Ansambleve tjera, neni 16 dhe neni 23), që zhvillohen në kuadër të institucioneve publike apo private (shkolla, universitete, teatro, kinema, biblioteka, salla të sporteve publike dhe private, hotele dhe restorante dhe hapësira tjera publike dhe private) dhe që organizohen ose përkrahen nga komuna përkatëse. Të gjitha ato veprimtari kulturore të cilat organizohen apo që marrin pjesë të rinjtë, duke shtuar edhe veprimtaritë tjera në fushën e mbrojtjes së mjedisit, të turizmit, shëtitjeve (ekskursioneve) piknikut, kampingut dhe argëtimit, hyjnë në kuadër të veprimtarive rinore e që organizohen nga Qendra publike rinore e komunës përkatëse (Ligjin Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë). Veprimtaritë më të zhvilluara të këtij treguesi janë veprimtaritë sportive, të cilat përfshijnë: futbollin, basketbollin, volejbollin, hendbollin, pingpongun, tenisën, shahun, atletikën, boksën, karatenë, notin, skijimin, gjimnastikën, lojërat e fëmijëve, çiklizmin, palestrimin, automobilizmin, olimpiadat e ndryshme etj. (Ligjin Nr.04/L-075 për Sportin).

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten 2 lloje të të dhënave, në dy grupe - të planifikuara:



1. Numri i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive të organizuara me buxhet komunal këtë vit
2. Numri i banorëve në komunë

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \left[ \frac{E\ dhëna\ 1}{\frac{E\ dhëna\ 2}{100,000}} \right]$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga njësia apo drejtoria përkatëse për kulturë, rini dhe sport (nga zyrtarët përgjegjës për secilën veprimtari). Verifikimi i të dhënave bëhet duke përdorë dokumentet zyrtare apo raportet për realizimin e veprimtarive përkatëse të hartuara nga zyrtarët përgjegjës për këto veprimtari.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 5.2.2 - Pjesëmarrja e qytetarëve sipas veprimtarive për kulturë, rini dhe sport

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të matë performancën e komunës përkatëse sa i përket numrit të qytetarëve që marrin pjesë në veprimtaritë kulturore, rinore dhe sportive. Në bazë të kushteve fizike (hapësirave dhe objekteve), kërkesave të qytetarëve (duke përfshirë edhe projektet individuale dhe të përbashkëta) dhe potencialit për ushtrimin e këtyre veprimtarive nga ana e qytetarëve, komuna krahas monitorimit të realizimit të planit për veprimtari kulturore, rinore dhe sportive, mbanë regjistra për numrin e qytetarëve që marrin pjesë në secilën veprimtari përkatëse veç e veç.

#### Çfarë matet?

Përqindja e pjesëmarrjes së qytetarëve sipas veprimtarive për kulturë, rini dhe sport nënkupton përqindjen e pjesëmarrësve të qytetarëve në veprimtaritë kulturore nga numri i përgjithshëm i qytetarëve që kanë marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë kulturore, rinore dhe sportive. Kjo nënkupton njëllëj edhe veprimtaritë për rini dhe sport. Treguesi synon të matë, përpos numrit të pjesëmarrjes, shprehur në përqindje sipas veprimtarive përkatëse, edhe trendin e rritjes apo zvogëlimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në këto veprimtari nëpër vite.

## Sqarime të hollësishme

Treguesi është i pamatshëm nëse komuna nuk udhëheq regjistra apo krijimin e bazës së të dhënave për numrin e pjesëmarrësve apo të qytetarëve që marrin pjesë në secilin prej këtyre veprimtarive përka tëse. Megjithatë është mjaftë e vështirë që të bëhet llogaritja e saktë e numrit të pjesëmarrësve në këto veprimtari. Për llogaritje sa më të saktë komuna përdorë kriteret përkatëse standarde (numri i pjesëmarrësve për metër katror sipërfaqe, numër të ftesave për pjesëmarrje, numër të ulëseve në sallat përkatëse, numri i të regjistruarve për veprimtari përkatëse etj.) që vlejné për të gjitha veprimtaritë. Komuna është përgjegjës që të marrë të gjitha masat për të kuptuar se sa qytetarëve iu ofron shër bime në këtë fushë apo sa qytetar i shfrytëzojnë shërbimet e komunës në këtë fushë për secilën veprimtari veç e veç. Një qëllim tjetër i matjes me anën e këtij treguesi është edhe motivimi apo nxitja e komunave përkatëse për ndërtimin e kapaciteteve për planifikim dhe realizim të këtyre punëve të cilat nuk janë realizuar deri tani dhe që është obligative të kryhet apo edhe janë zhvilluar por nuk janë pasqyruar në punët e kryera të komunës.

Treguesi është në funksion të plotë të përmbushjes së qëllimit të rezultatit 5.2, konkretisht matë thelbin e performancës së komunës përkatëse. Të dhënat e vitit të parë të matjes, shërbejnë si bazë referuese (krahasuese) për vitet tjera, për të kuptuar trendin e rritjes apo zvogëlimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në këto lloj veprimtarish. Këtu nuk mund të matet pjesëmarrja e qytetarëve në ato veprimtari të cilat zhvillohen nën organizimin e bartësve privat dhe në objekte private për të cilët nuk janë të obliguar të marrin leje apo ta informojné komunën.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten 5 lloje të të dhënave:

1. numri i pjesëmarrësve në veprimtaritë kulturore
2. numri i pjesëmarrësve në veprimtaritë rinore
3. numri i pjesëmarrësve në veprimtaritë sportive
4. gjithsej pjesëmarrës në të gjitha veprimtaritë
5. gjithsej numri i banorëve në komunën përkatëse

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E \text{ dhëna 4}}{E \text{ dhëna 5}} * 100$$

Llogaritja:

1. Për komnat ku % del më e madhe së 100% (raste kur pjesëmarrës ka më shumë se sa banorë), % të rezultoj me 100% për arsye të metodologjisë.

Për matjen e treguesit llogariten vetë e dhëna 4 dhe 5, ndërsa e dhëna 1, 2, 3 mblidhet për analiza specifike në raportin e performancës.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga njësia apo drejtoria përkatëse për kulturë, rini dhe sport (nga zyrtarët përgjegjës për secilën veprimtari). Verifikimi i të dhënave bëhet me shikimin e regjistrave apo bazën e të dhënave në drejtorinë përkatëse për kulturë, rini dhe sport, të dërguar nga të gjitha orga nizatit apo organizatorët e veprimtarive përkatëse kulturore, rinore dhe sportive. Komuna, respektivisht zyrtari përgjegjës, paraprkisht e qarkullon një formular përkatës për regjistrimin dhe raportimin numrit të pjesëmarrësve në veprimtaritë përkatëse, të cilin organizatorët apo edhe monitoruesit e komunës e komunës e plotësojnë për secilën veprimtari dhe e kthejnë në drejtorinë përkatëse. Nga këto të dhëna, zyrtarët përgjegjës hartojnë raportet zyrtare vjetore për numrin e pjesëmarrësve apo të qytetarëve në veprimtaritë përkatëse, duke theksuar edhe numrin e personave me aftësi të veçantë. Për shkallën e zbatimit apo realizimit të planit për veprimtari kulturore, rinore dhe sportive, përdoren dokumentet zyrtare apo raportet për realizimin e veprimtarive përkatëse të hartuara nga zyrtarët përgjegjës për këto veprimtari.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## FUSHA 6 - MENAXHIMI I FATKEQËSIVE

Emërtimi i fushës është “Menaxhimi i Fatkeqësive”. Menaxhimi i fatkeqësive në kuptimin e përgjithshëm nënkupton menaxhimin e fatkeqësive në nivelin komunal dhe përfaqëson njërën prej kompetencave vetanake të komunës përkatëse. Menaxhimi i fatkeqësive në kuptimin e ngushtë nënkupton planifikimin, organizimin dhe udhëheqjen e sistemit të organizuar të komunës për tu përgjigjur ndaj dukurive të shkaktuara nga fuqitë e pakontrolluara dhe nga fuqitë tjera, të cilat e rrezikojnë shëndetin, jetën e njerëzve dhe pronën e tyre, pasurinë e trashëgimisë kulturore, pasurinë e trashëgimisë natyrore, mjedisin jetësor dhe botën shtazore e bimore në atë masë që për kontroll dhe mbizotërim është e nevojshme të përdoren forcat, masat dhe mjetet e posaçme për shpëtim<sup>37</sup>.

Matja e performancës në këtë fushë përfshinë mbrojtjen e njerëzve dhe të pasurisë së tyre private dhe publike, si: mbrojtja nga zjarret, tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortekët e bores, thatësira, shpërthimi i sëmundjeve infektive, shkatërrimet e digave dhe aksidentet e ndryshme ekologjike<sup>38</sup>.

Informatat e prodhuara nga matja e performancës së kësaj fushe janë të rëndësishme për punën e strukturave të pushtetit lokal në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore dhe në kohën e duhur për qytetarët apo grupet e ndryshme të interesit të prekur nga fatkeqësitë përkatëse. Po ashtu matja e performancës së komunave në ofrimin e këtij grupi të shërbimeve ka rëndësi të madhe edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për priorizimin dhe harmonizimin e politikave të saj që kanë të bëjnë me përkrahjen e komunave në menaxhim më efektiv të fatkeqësive dhe mbrojtjen e qytetarëve nga rreziku i tyre. Gjithashtu raportet e performancës mund të shfrytëzohen edhe nga palët e ndryshme të interesit dhe nga vetë qytetarët për të ndërmarrë masat e nevojshme paraprake për ato lloje të fatkeqësive që mund të parandalohen.

Arritjet e komunës në fushën e Menaxhimit të fatkeqësive maten nëpërmjet 2 rezultateve kryesore që përfshijnë veprimet e komunës në fazën parandaluese të fatkeqësive, veprimet gjatë fatkeqësisë dhe veprimet pas ndodhjes së fatkeqësisë. Në këtë mënyrë, nëpërmjet një rezultati synohet të matet cikli i plotë i ofrimit të shërbimeve në mbrojtje të qytetarëve nga fatkeqësitë e ndryshme në nivelin lokal.

### Rezultati 6.1 - Mbrojtja e qytetarëve dhe e pasurisë së tyre nga fatkeqësitë

Përfaqëson arritjen kryesore që e synon komuna në mbrojtjen e qytetarëve dhe të pasurisë së tyre nga fatkeqësitë e ndryshme të shkaktuara nga dukuritë natyrore dhe nga vetë njeriu. Rezultati përfshinë në veti produktet e veprimeve parandaluese të komunës përkatëse për zvogëlimin e shkallës së rrezikut të fatkeqësive të lidhura me ciklet e dukurive natyrore të përsëritura gjatë vitit dhe rezultatet e veprimit të organeve përkatëse komunale gjatë kohës së ndodhjes së fatkeqësisë.

Synimi kryesor i këtij rezultati është që të bëjë parandalimin e fatkeqësive që janë të parandalueshme, të zvogëlojë shkallën e rrezikut për jetën e qytetarëve dhe të pasurisë së tyre dhe ta rrisë shkallën e shpëtimit

<sup>37</sup>Ligji nr. 02/1-68 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë natyrore dhe nga Fatkeqësitë e tjera

<sup>38</sup>Ligji nr. 02/1-68 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë natyrore dhe nga Fatkeqësitë e tjera

gjatë reagimit për shpëtim në fatkeqësi. Me arritjen e këtij rezultati, qytetarët dhe pasuria e tyre mbrohen në mënyrë më efektive duke zvogëluar shkallën e rrezikut dhe vlerën e dëmeve në minimum. Rezultati ndikon në kursimin e mjeteve financiare dhe mbrojtjen e pasurisë së qytetarëve nga fatkeqësitë, kur dihet se Komunat dhe Qeveria e Republikës së Kosovës aktualisht reagojnë në masën më të madhe vetëm pas ndodhjes së fatkeqësive, ku shpenzohen mjete të konsiderueshme financiare.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet nëpërmjet dy treguesve kryesor: treguesi 6.1.1 dhe treguesi 6.1.2.

### **Treguesi 6.1.1 - Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim të matë shkallën e përgatitjes së komunës përkatëse në parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë e parashikueshme. Në bazë të vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë, komunat janë të obliguara ta kenë planin vjetor komunal për menaxhimin e fatkeqësive.

#### **Çfarë matet?**

Ky tregues matë nivelin e realizimit të planit që e përpilon vetë komuna për menaxhimin e fatkeqësive. Ky plan duhet të ketë të planifikuar për fatkeqësi natyrore të ndryshme që mund të ndodhin.

#### **Sqarime të hollësishme**

Në bazë të planit, komunat janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë e parashikueshme, si: rregullimi i shtretërve të lumenjve, ngritja e orgji-naturave përreth lumenjve, hapjen e kanaleve kulluese, ripyllëzimin e sipërfaqeve të shpyllëzuara, masat biologjike për asgjësimin e sëmundjeve endemike, dezinfektimi i vendbanimeve, vendosja e mbrojtësve nga ortekët e borës, gjendja e rregullt e mjeteve motorike për hapjen e rrugëve nga bora, sasia e mjaft ueshme e kripës industriale dhe e zhavorrit, ndërtimi i mbrojtësve të rrugës dhe mirëmbajtja e tyre, ndërtimi i mbrojtësve të rrugës nga rrëshqitja e dheut dhe e gurëve (mure betoni, rrjeta metalike), shenjzimi i rrugëve për shpejtësinë e lejuar të mjeteve motorike dhe i vendkalimeve për këmbësorë, ndërtimi i trotuareve për gjatë rrugëve, ndërtimi i shtigjeve për biçikleta, pajisja e vendkalimeve në udhëkryqet urbane me shenja zëruese për të verbrit, provimi i shenjave (alarmit) për gjendje të rrezikut të përgjithshëm, rregullimi i vendstrehimeve për qytetarët në raste të rrezikut.

Treguesi është në funksion të plotë me përmbushjen e qëllimit të rezultatit 6.1, konkretisht matë performancën e komunës përkatëse në nivelin planifikues dhe zbatues. Me kërkesën e SMPK për raportimin e realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive, në të njëjtën kohë, kërkohet posedimi i planit për menaxhimin e fatkeqësive dhe zbatimi i tij.

#### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

#### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten 2 lloje të të dhënave:

1. numri i veprimeve të planifikuara me planin për menaxhimin e fatkeqësive dhe
2. numri i veprimeve të realizuara nga plani për menaxhimi të fatkeqësive gjatë vitit përkatës që raportohet.

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga njësia për mbrojtje nga fatkeqësitë në komunë në kuadër të drejtorisë për shërbime publike, njësia për shërbimin e zjarrfikësve (shërbimin e emergjencave), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME). Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive të miratuar nga kuvendi komunal dhe i formës përfundimtare zyrtare. Për shkallën e zbatimit apo realizimit të planit për menaxhimin e emergjencave shfrytëzohet raporti vjetor i shërbimit për menaxhimin e fatkeqësive në komunën përkatëse.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 6.1.2 - Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë

### Qëllimi

Treguesi 6.1.2 ka për qëllim të matë shkallën e reagimit apo të intervenimit të ekipeve përkatëse për shpëtim të komunës prej momentit të lajmërimit të fatkeqësisë e deri te përfundimi i intervenimit.

### Çfarë matet?

Treguesi matë të gjitha llojet e intervenimeve të shpëtimit ndaj të gjitha llojeve të fatkeqësive që rrezikojnë jetën e qytetarëve, të pasurisë së tyre dhe pasurisë publike. Treguesi matë intervenimet e ekipeve për shpëtim të komunës përkatëse ndaj këtyre fatkeqësive: zjarreve, vërshimeve, erërave të forta, izolimit nga bora, tërmeteve, rrëshqitjes së dheut, ortekëve të borës, thatësirave, shpërthimit të sëmundjeve infektive, shkatërrimit - thyerjes së pendëve të ujërave akumulues, dhe aksidenteve të ndryshme ekologjike. Ky tregues hynë në grupin e tregueseve të pragut.

### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë mjaftë saktë ofrimin e shërbimeve të komunës për qytetarët në rrezik nga fatkeqësitë e ndryshme të listuara në paragrafin paraprak, nga pikëpamja e reagimit ndaj rreziqeve, por jo në aspektin e efektit të reagimit ndaj rreziqeve. Nëpërmjet këtij treguesi mund të kuptojmë numrin e reagimeve apo intervenimeve për mbrojtje nga fatkeqësitë e ndryshme, por nuk mund të kuptojmë shumë për efektin e intervenimit mbrojtës apo për shkallën e shpëtimit nga rreziqet e shkaktuara. Në të ardhmen mund të përmirësohet shkalla e matjes në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe financiare të komunës.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënat.** të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të dhënave:

1. numri i përgjithshëm i fatkeqësive në komunë dhe
2. numri i fatkeqësive për të cilat ekipet kanë intervenuar në vendin e ngjarjes.

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga njësia për mbrojtje nga fatkeqësitë në komunë në kuadër të drejtorisë për shërbime publike, njësia për shërbimin e zjarrfikësve (shërbimin e emergjencave), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME). Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive të miratuar nga kuvendi komunal dhe i formës përfundimtare zyrtare (i protokolluar). Për shkallën e zbatimit apo realizimit të planit për menaxhimin e emergjencave shfrytëzohet raportit vjetor i shërbimit për menaxhimin e fatkeqësive në komunën përkatëse.

## FUSHA 7 PLANIFIKIMI HAPËSINOR KOMUNAL

Emërtimi i fushës është “Planifikimi Hapësinor Komunal”. Menaxhimi i planifikimit hapësinor në kuptimin e përgjithshëm të fjalës nënkupton menaxhimin e planifikimit hapësinor në nivelin lokal - komunal dhe përfaqëson njërin prej kompetencave vetanake të komunës përkatëse. Planifikimi hapësinor në kuptimin e ngushtë të fjalës nënkupton zhvillimin hapësinor komunal (ZHHP) nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor si: Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), Harta Zonale e Komunës (HZK) dhe Planet Rregulluese të Hollësishme (PRrH) për të siguruar veprimtarinë e jetës institucionale dhe shoqërore në mënyrë të organizuar.

Plani Hapësinor Komunal përfshinë planifikimin urban dhe rural, si dhe ndërtimin e planifikuar urban dhe rural. Fusha e planifikimit hapësinor komunal është e rëndësishme për nga aspekti i shfrytëzimit të burimeve aktuale dhe të potencialeve të komunës, duke i dhënë kahe zhvillimit ekonomik dhe shoqëror përmes rregullimit të fushës së shfrytëzimit të territorit brenda komunës. Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) në këtë kontekst paraqet pikën fillestare e cila e orienton zhvillimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK) dhe në bazë të së cilës pastaj zhvillohen Planet Rregulluese të Hollësishme (PRrH). Bazuar në ligjin për Planifikim Hapësinor<sup>39</sup>, PZHK merr për bazë kriteret demografike, shfrytëzimin e burimeve dhe zhvillimin ekonomik në bashkërenditje me strategjitë sektoriale të nivelit qendror, infrastrukturën ekzistuese teknike dhe sociale, rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe ndotjet, aspektin e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore, dhe atë të vendbanimeve joformale. Udhëzimi administrativ i MMPH 11/2015, në nenin 15 pikën 3 në mënyrë eksplicite e thotë, “Autoriteti komunal është përgjegjës për planifikim dhe menaxhimin hapësinor, bashkërendon aktivitetet e zbatimit dhe monitorimit të PZHK”.

Mbi këtë tërësi kriteresh zhvillohet kuadri rregullativ në formën e Hartës Zonale të Komunës (HZK) dhe Planit Rregullativ të Hollësishëm (PRrH), që kanë për fushëveprim rregullimin e ndërtimeve, qoftë për çështje të banimit, biznesit, industrisë, infrastrukturës, të ndërtimit për interes publik apo edhe të mbrojtjes. Matja e performancës në këtë fushë përfshinë matjen e arritjeve në përmbushjen e dispozitave të cilat dalin nga ky kuadër ligjor, të zbatuara nëpërmjet lejeve të ndërtimit, duke pasur parasysh se lejet lëshohen në pajtim me tërësinë e dispozitave të cilat rrjedhin nga instrumentet e lartpërmendura.

Informatat e gjeneruara nga matja e performancës në këtë fushë mund të ketë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin dhe priorizimin e kapaciteteve planifikuese komunale për rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të planifikuara komunale. Rezultatet e performancës gjithashtu mund të informojnë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe akterët e tjerë në lidhje me punën e bërë në fushën e planifikimit hapësinor në komunën përkatëse.

Arritjet e komunave në fushën e Planifikimit Hapësinor Komunal maten nëpërmjet dy rezultateve kryesore.

---

<sup>39</sup> Ligji nr. 04/I-174 për Planifikimin Hapësinor



## Rezultati 7.1 - Planifikim i qëndrueshëm komunal

Paraqet arritjen që pushteti lokal synon ta arrijë në sigurimin e zhvillimit të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm në fushën e Planifikimit Hapësinor në përputhje me kriteret e përcaktuara përmes instrumenteve PZHK dhe HZK.

Rezultati përmbledh veprimet e zhvilluara të autoriteteve komunale në krijimin dhe miratimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës. Rregullimi i mëtejshëm nëpërmjet PRrH apo dhënia e kushteve dhe më pas lëshimi i lejeve ndërtimore bëhet në pajtim me tërësinë e kriterëve mbi të cilat janë zhvilluar instrumentet përkatëse, respektivisht sigurohet se aktivitetet ndërtimore zhvillohen në pajtim me interesat e komunës të normuara në kuadrin rregullativ. Konkretisht, LIGJI NR. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor në nenin 17 pikën 3, thotë se “Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet ndërtimore”. Ky rezultat, përmes përmbushjes së nevojave të qytetarëve, bizneseve dhe palëve të tjera legjitime për ndërtim, çon në alokimin e investimeve në mënyrë transparente dhe të planifikuar dhe në pajtim me interesat private dhe publike në fushën e ndërtimeve. Kjo u hap rrugë mundësive të shfrytëzimit të tokës, respektivisht hapësirës dhe burimeve të tjera mjedisore apo edhe infrastrukturës në mënyrë të planifikuar dhe në interes të qytetarëve dhe bizneseve në formë të rregulluar, transparente dhe të qëndrueshme.

Matja e shkallës së arritjes së këtij rezultati bëhet nëpërmjet treguesit 7.1.1

### Treguesi 7.1.1 - Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme)

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të rrit performancën në planifikimin hapësinor të komunës dhe që territori komunal të jetë sa më i planifikuar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligje të Kosovës dhe nevoja të komunës.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e mbulimit të territorit të komunës përkatëse me Plane Rregulluese të Hollësishme (PRrH) ose me harta zonale, me çka ofrohen mundësi të mira për ndërtim të planifikuar të vendbanimeve nga ana e qytetarëve dhe e objekteve tjera institucionale, profesionale, banesorë, sportive, kulturore etj. nga palët tjera të interesit.

#### Sqarime të hollësishme

Në bazë të vlerësimit të kriterëve demografike, shfrytëzimin e resurseve dhe zhvillimin ekonomik në bashkërenditje me strategjitë sektoriale të nivelit qendror, infrastrukturën ekzistuese teknike dhe sociale, rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe ndotjet, zhvillimin e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore, dhe atë të vendbanimeve joformale, komunat janë të obliguara që ta zhvillojnë Hartën Zonale të Komunës (HZK). Në bazë të HZK, PRrH, Ligjit 04/L-174, PZHK, komuna menaxhon procesin e planifikimit në territorin e saj.

Rendimentet e këtij treguesi demonstrojnë në mënyrë komulative për shkallën e arritjeve në zbatimin e planifikimit hapësinor komunal.

Treguesi 7.1.1 matë performancën e komunës përkatëse për shkallën e planifikimit të territorit me PRrH, respektivisht shkallën e përgatitjes së komunës, por jo edhe për shkallën e zbatimit të PRrH. Megjithatë, PRrH si kusht i domosdoshëm është në funksion të plotë me përmbushjen e qëllimit të rezultatit, pasi që kërkohet posedimi i Planit Rregullues të Hollësishëm dhe rrjedhimisht pastaj zbatimi i tij, i cili synohet të matet me rezultatin 7.2.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej sipërfaqja e rregulluar në hektar me PRrH gjatë të gjitha viteve.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. gjithsej sipërfaqja e territorit të komunës në hektar (ha) dhe
2. gjithsej sipërfaqja e territorit të komunës e planifikuar me PRrH në hektar (ha) (jo me Plan Zhvillimor)

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 100$$

këtu duhet të mblidhen informatat për sipërfaqen e tërësishme të mbuluar me Plane Rregulluese të Hollësishme, ku sipërfaqja në njësi [hektarë] paraqet shumën e sipërfaqeve të të gjitha PRrH në fuqi. Numri i fituar për sipërfaqen e mbuluar me PRrH pastaj futet në fushën përkatëse të sistemit elektronik

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga drejtoria përgjegjëse për çështjet e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet me Planet Rregulluese të Hollësishme të miratuara dhe në fuqi, respektivisht të formës zyrtare përfundimtare (të protokolluara). Këtu duhet pasur parasysh edhe çështjen e afatit të skadencës të PRrH, ku planet me afat të skaduar nuk duhet të merren parasysh në llogaritje. Udhëzimi administrativ për PRrH është në draftim, dhe së shpejti pritet të publikohet, ku prej këtij udhëzimi do të merren informata lidhur me çështjet e raportimit, ku pritet se të dhënat mund të

merren nga pika e njëjtë e raportimit të Drejtorisë përkatëse për linjën e raportimit vertikal drejt Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Rezultati 7.2 - Ndërtim i planifikuar komunal

Pasqyron arritjet e komunës përkatëse në menaxhimin e zbatimit të ligjit dhe planeve tjera përkatëse që rregullojnë ndërtimet në vendbanimet urbane dhe rurale. Rezultati përfshinë përpjekjet e pushtetit lokal në sigurimin e mekanizmave ligjor dhe administrativ për zhvillimin dhe zbatimin e qëndrueshëm të kritereve të përcaktuara me HZK dhe PRRH në fushën e ndërtimit dhe zhvillimit komunal.

Rezultati përmbledh veprimet e zhvilluara të autoriteteve komunale në zbatimin e planit zhvillimor komunal (PZHK), të Planit Rregullues Komunal (PRRK) dhe pastaj edhe të Hartës Zonale të Komunës, dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme. Performanca e komunës përkatëse është e ndërlidhur me shkallën e respektimit procedurave për dhënien e kushteve për ndërtim dhe lëshimin e lejeve ndërtimore në pajtim me tërësinë e kritereve mbi të cilat janë zhvilluar instrumentet përkatëse urbanistike, respektivisht sigurimin e veprimeve ndërtimore në përputhje me interesin publik të normuara në kuadrin rregullativ komunal (Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenin 17 pikën 3 thotë se “Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet ndërtimore”).

Nëpërmjet përmbushjes së këtij rezultati, synohet të përmbushen nevojat e qytetarëve, bizneseve dhe palëve të tjera të interesit për ndërtim. Drejtpërdrejt apo tërthorazi ndihmon dhe orienton ndërtimin e planifikuar komunal dhe parandalon ndërtimet e paligjshme. Nëpërmjet këtij rezultati mundësohet shfrytëzimi i planifikuar i tokës, respektivisht hapësirës dhe i burimeve tjera mjedisore e infrastruktur ore në interes të qytetarëve, institucioneve publike dhe bizneseve. Kështu promovohet transparenca, ndërtimi i planifikuar dhe i qëndrueshëm komunal. Që kjo të ndodhë komuna duhet t’i përmbushë detyrimet ligjore dhe administrative të cilat provohen nëpërmjet veprimeve praktike sipas treguesve në vazhdim.

Matja e shkallës së arritjessë këtij rezultati bëhet nëpërmjet treguesve 7.2.1, 7.2.2, dhe 7.2.3.

### Treguesi 7.2.1 - Kërkesa të shqyrtuara për leje të ndërtimit

#### Qëllimi

Qëllimi i treguesit është të rrit përgjegjshmërinë komunale në adresimin e kërkesave për leje të ndërtimit, si leje teje të rëndësishme për fillim të ndërtimeve sipas planeve hapësinore dhe kushteve të ndërtimit.

## Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së obligimeve qytetare në raport me ligjin dhe planet komunale për ndërtim të objekteve. Matja e obligimit ligjor nga qytetarët bëhet në bazë të kërkesave drejtuar organeve kompetente të komunës përkatëse për leje të ndërtimit, qoftë në qytet a po në fshat.

## Sqarime të hollësishme

Treguesi i trajton të gjitha kërkesat pavarësisht nëse ato janë apo nuk janë në përputhje me kushtet e parapara për leje të ndërtimit. Po ashtu treguesi nuk ka për qëllim matjen e afateve kohore për miratimin e kërkesave apo kthimin e përgjigjeve ndaj palëve parashtruese. Kjo nuk do të thotë se komuna nuk duhet t'ua kthejë përgjigjet parashtruesve të kërkesave sipas afateve të përcaktuara me ligj (Ligji për ndërtim<sup>40</sup>, nenin 17, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.2). Shkalla e miratimit të kërkesave për leje të ndërtimit tregon për kapacitetet dhe efikasitetin e komunës në menaxhimin me sukses të zbatimit të ligjit dhe planeve komunal në ndërtimin e planifikuar në territorin e komunës përkatëse. Treguesi është prioritet i komunave dhe i nivelit qendror duke u bazuar në gjendjen faktike të numrit shumë të madh të ndërtimeve pa leje për shkak të kapaciteteve të ulëta të komunave në menaxhimin profesional dhe ligjor të kësaj fushe.

Treguesi 7.2.1 demonstroi performancën e komunës përkatëse apo shkallën e kompetencës së autoriteteve komunal për menaxhim të ndërtimit të planifikuar, përkatësisht për miratimin e kërkesave për ndërtim në përputhje me parametrat ligjor dhe profesional përkatës. Treguesi matë saktë atë çfarë synon të matë. Treguesi nuk matë zbatimin e kushteve teknike të lejes së ndërtimit. Megjithatë, miratimi i kërkesave apo lëshimi i lejeve të ndërtimit, si kusht i domosdoshëm, është në funksion të plotë të përmbushjes së qëllimit të rezultatit për ndërtim të planifikuar komunal apo lokal, sepse në këtë fazë të matjes leja e ndërtimit nënkupton edhe zbatimin e saj të plotë.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen tri lloje të të dhënave:

1. Gjithsej numri i kërkesave të paraqitura për leje ndërtimi gjatë vitit raportues
2. Gjithsej numri i kërkesave të shqyrtuara për leje ndërtimi gjatë vitit raportues
3. Përqindja e kërkesave nga gra për ndërtesat e kategorisë I (shtëpi familjare) - (vetëm për mbledhje të të dhënave)

## Formula e llogaritjes

---

<sup>40</sup>Ligji Nr. 04/L – 110 për Ndërtim

Formula:

$$Treguesi = \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 100$$

Treguesi është në harmoni apo në përputhje të plotë me treguesin 7.2.2, dhe 7.2.3 duke mundësuar matje të integruar të performancës për këtë fushë në komunë. Nuk përjashtohet mundësia që treguesi të ketë përmbushje mbi shkallën 100%. Kjo vjen si mundësi e një numri të kërkesave të regjistruara në vitin paraprak, por që shqyrtohen në vitin raportues të të dhënave. Për të kuptuar këtë numër është shtuar një e dhënë që tregon për numrin e kërkesave të pashqyrtuara nga viti paraprak.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga Drejtoria përgjegjëse për çështjet e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor. E dhëna e parë merret dhe mund të verifikohet nga protokoli i cili i regjistron kërkesat para shqyrtimit profesional. E dhëna e dytë, numri i lejeve të miratuara merret dhe mund të verifikohet nga protokoli i lejeve të miratuara për ndërtim, pas miratimit dhe dorëzimit të lejeve tek palët parashtruese [UA-MMPH-24-2015] neni 42, paragrafi 2).

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 7.2.2 - Ndërtesa të reja të inspektuara

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse që ka të bëjë me zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit dhe të zhvillimit të komunës. Për këtë qëllim treguesi demonstroi veprimet e organeve përgjegjëse të komunës, shërbimit të inspektimit, për shkallën e zbatimit të ligjshmërisë gjatë ndërtimeve të reja.

### Çfarë matet?

Treguesi matë nivelin e inspektimit komunal, si pjesë kyçe e hallkës së ndërtimit me kushte parapërcaktues, ndaj ndërtesave që janë në ndërtim e sipër në komunë.

### Sqarime të hollësishme

Ky tregues nuk paragjykon statusin ligjor të ndërtesave të reja, nëse kanë apo jo leje të ndërtimit, por ka për qëllim të matë nëse janë inspektuar të gjitha ndërtimet e reja të cilat janë regjistruar në Drejtorinë

Komunale të Financave dhe të Pronës për vitin kalendarik të raportimit (Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Financave 03/2011). Konkretisht matë shkallën e inspektimit të të gjitha ndërtesave për të cilat paguhet taksa e tatimit në pronë, duke marrë parasysh se pate apo nuk pate leje të ndërtimit, ndërtimi i objektit regjistrohet dhe tatimohet nga organet përkatëse në komunë. Inspektorati komunal kryen vizita sipas detyrës zyrtare në objektet e reja ndërtimore, dhe atë në numër dhe proporcion me kapacitetet që posedon. Inspektimi bazohet në numrin e ndërtimeve të regjistruara në njësinë për tatimin në pronë.

Treguesi 7.2.3 e informon komunën dhe palët tjera të interesit për performancën e inspektoratit të ndërtimit në raport me vëllimin e ndërtimit në territorin e komunës, përkatësisht, treguesi e informon rezultatin për performancën e komunës për të inspektuar ndërtimet në raport me aktivitetet ndërtimore në përgjithësi. Ky tregues e informon rezultatin në mënyrë të tërthortë, duke e formuar kua drin e informacionit lidhur me konsistencën e autoriteteve në përcjelljen e ndërtimeve. Kjo informatë është e rëndësishme edhe për qytetarët e komunës, për të parë se çfarë është performanca e komunës në zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit.

Treguesi e ndihmon komunën për të vlerësuar kapacitetet monitoruese dhe inspektuese komunale në raport me dinamikën e ndërtimit dhe për mbrojtjen e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit. Ky tregues i jep siguri qytetarëve për punën e komunës në menaxhimin e ndërtimeve në përputhje me dispozitat që buronjnë nga PZHK dhe HZK, si dhe nga PRrH në interes të komunës dhe qytetarëve. Kjo për shkak se numri i vizitave në raport me numrin e objekteve-ndërtimeve të ndërtuara tregon për mundësinë e evitimit të ndërtimeve pa leje. Norma e vizitave të veprave ndërtimore në përgjithësi tregon për përgatitjen-kapacitetet dhe nivelin e performancës së Drejtorisë së Inspektionit Komunal, seksionit të ndërtimit, për inspektim të veprave ndërtimore në përgjithësi qoftë me apo pa leje ndërtimi. Treguesi matë relativisht saktë. Megjithatë përvoja tregon se jo të gjitha ndërtimet në territorin e komunës mund të inspektohen dhe të vihet në zbatim ligj për këtë veprimtari.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. numri i përgjithshëm i objekteve ndërtimore të reja në vitin e raportimit
2. numri i përgjithshëm i objekteve të reja të inspektuara gjatë vitit të raportimit.

Llogaritja bëhet në bazë të formulës së thjeshtë: pjesëtimi i të dhënës së dytë me të dhënën e parë, shumëzuar me 100.

## Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 100$$

Në rastet kur ndërtimet e reja janë inspektuar në vitin raportues, por ndërtimi përkatës është regjistruar në regjistrat e tatimit në pronë një vit më parë, atëherë llogaritja e inspektimeve për vitin raportues nuk përputhet me regjistrat e tatimit në pronë.

### Burimi kryesor i të dhënave

Burimi i të dhënave. Të dhënat mblidhen nga drejtoria përgjegjëse për administrimin e tatimit në pronë dhe drejtoria e urbanizimit (e dhëna e parë) dhe drejtoria përgjegjëse për inspektim të ndërtimit (e dhëna e dytë).

Verifikimi i të dhënave bëhet nga regjistrat zyrtar të pronave të qytetarëve apo të institucioneve të regjistruara nga drejtoria përkatëse për regjistrimin e pronave, nga regjistri i kërkesave për leje të ndërtimit dhe nga raportet zyrtare të inspektimeve të bëra nga drejtoria përkatëse e inspektimit të ndërtimit. Në bazë të dokumenteve zyrtare numërohen rastet e shënuara në protokollet përkatëse sipas datës së protokollimit, duke numëruar rastet prej datës së fillimit të vitit (ose fillimit të periudhës raportuese për SMP) deri në datën përfundimtare të vitit (ose të periudhës raportuese për SMP). Numri i vlefshëm i objekteve të inspektuara llogariten vetëm ato objekte për të cilat ka vendim për inspektim nga trupi inspektues, ndërsa rastet e vizitave të cilat janë në proces të shqyrtimit nuk merren parasysh në momentin e mbledhjes së informatave.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 7.2.3 - Objekte të reja me leje të ndërtimit

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të matë se sa ndërtime të reja të inspektuara janë në përputhje me ligjin dhe planet komunale apo që kanë dhe e zbatojnë lejen e ndërtimit. Pra përkufizimi i treguesit “% e ndërtesave të reja me leje të ndërtimit” nënkupton se ndërtuesi i ka respektuar (zbatuar) kushtet dhe procedurat e parapara me leje të ndërtimit.

#### Çfarë matet?

Treguesi bën matjen e shkallës së përmbushjes së dispozitave ligjore të parapara me Ligjin e Ndërtimit<sup>41</sup> dhe Ligjin për Inspektorat (neni 6, paragrafi 1.2 dhe 4), nga ana e ndërtuesve në territor të komunës. Praktikisht treguesi bën matjen e shkallës së ndërtimeve të reja që kanë leje të ndërtimit në raport me numrin e përgjithshëm të ndërtimeve të reja të inspektuara në territorin e komunës.

### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë mjaftë saktë për numrin e ndërtesave të inspektuara nga komuna, por në bazë të përvojave dhe të kapaciteteve aktuale, jo të gjitha ndërtimet e reja mund të inspektohen dhe rrjedhimisht jo të gjitha ndërtesat e reja mund të maten saktë se a kanë leje të ndërtimit apo jo. Treguesi nuk e paragjykon statusin e ndërtesave të reja të cilat nuk janë inspektuar se janë në kundërshtim me ligjin dhe nuk përjashton mundësinë që ndërtesat e pa inspektuara nuk kanë leje të ndërtimit. Treguesi në këtë fazë të zhvillimit të SMPK matë atë që mund të matet saktë dhe ajo është numri apo përqindja e ndërtesave me leje të ndërtimit nga numri i përgjithshëm i ndërtesave të inspektuara nga komuna. Informatat e treguesit 7.2.1, 7.2.3 dhe të këtij treguesi na dhënë të kuptojmë nëse komuna përkatëse po bën ndërtim të planifikuar apo jo.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i përgjithshëm i objekteve të reja gjatë vitit të raportimit
2. Numri i përgjithshëm i objekteve të reja të inspektuara gjatë vitit të raportimit dhe
3. Numri i objekteve të reja me leje të ndërtimit nga objektet e inspektuara

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100$$

Treguesi është në harmoni apo në përputhje të plotë me dy treguesit tjerë të këtij rezultati dhe masin në mënyrë të integruar në kuadër të rezultatit.

---

<sup>41</sup>Ligji Nr. 04/L – 110 për Ndërtim



## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat mblidhen nga drejtoria përgjegjëse për çështjet e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor dhe nga drejtoria e inspektimit në komunë.

Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet raporteve zyrtare të inspektimit të objekteve të reja, regjistrave të kërkesave për leje të ndërtimit, regjistrave apo protokolleve për pajisjen me leje përkatëse të ndërtimit për objektet përkatëse, duke numëruar rastet prej datës së fillimit të vitit (ose fillimit të periudhës raportuese për SMPK) deri në datën përfundimit të vitit (ose të përfundimit të periudhës raportuese për SMPK).

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## FUSHA 8 HAPËSIRAT PUBLIKE

Emërtimi i fushës është “Hapësirat Publike Komunale”. Performanca e komunës në menaxhimin e hapësirave publike, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, nënkupton menaxhimin e hapësirave publike në nivelin lokal - komunal dhe përfaqëson njëri prej kompetencave vetanake të komunës përkatëse. Hapësira publike, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nënkupton hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve”. Komunat janë kompetente për “ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike” (Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale, nenit 7, pika p).

Hapësirat publike përfshijnë parqet, sheshet, hapësirat e gjelbra dhe ato rekreative. Parqet, hapësirat e gjelbra dhe rekreative janë të përkufizuara në planet përkatëse urbane komunale dhe dokumentet e tjera komunale, dhe si të tilla paraqesin pjesë të rëndësishme të ekosistemeve të qyteteve dhe fshatrave për qytetarët dhe komunën përkatëse.

Kjo fushë është rezultat integritetit të dy fushave të veçanta të SMPSHK të rishikuar: fushës së parqeve dhe fushës së shesheve. Duke qenë se këto dy fusha kanë një lidhje organike, si për nga ndërtimi po ashtu edhe për nga funksioni, janë integruar në një fushë të vetme mjaftë me prioritet për komunat e Republikës së Kosovës. Me ndërtimin e hovshëm, kryesisht në mënyrë të pa planifikuar gjatë periudhës së kaluar 20 vjeçare, hapësirat publike janë zvogëluar deri në masën kritike. Me matjen e performancës së komunave në këtë fushë, MPL dhe palët tjera të interesit, po synojnë që të ruhet hapësira ekzistuese publike dhe zgjerimi i saj në përputhje me standardet e pranueshme për jetë të shëndetshme dhe me dinjitet të qytetarëve.

Zbatimi i kësaj kompetence është e ndërlidhur me struktura përkatëse organizative të komunës, të cilat përmbushin obligimet ligjore në funksion të krijimit të një mjedisi të mjaftueshëm dhe cilësor për jetë normale të qytetarëve të komunës përkatëse.

Informatat e gjeneruara nga matja e performancës në këtë fushë mund të ketë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin dhe prioritizimin e kapaciteteve planifikuese dhe zbatuese komunale për ruajtjen, zgjerimin, rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirave publike nga ana e qytetarëve. Rezultatet e performancës gjithashtu mund të shfrytëzohen nga MPL, MMPH dhe palët tjera të interesit për përkrahjen e komunave dhe iniciativave qytetare për krijimin e hapësirave të mjaftueshme publike dhe sa më të shëndetshme për jetën e qytetarëve

Arritjet e komunës përkatëse në krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike maten nëpër mjet një rezultati kryesor.

## Rezultati 8.1 - Hapësirë publike e mjaftueshme për një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt

Rezultati paraqet arritjet e komunës në krijimin e një hapësire të mjaftueshme dhe të pasur me sipërfaqe të gjelbra, që rrisin cilësinë e mjedisit jetësor të qytetarëve të komunës përkatëse. Duke pasqyruar se ndërtimet e reja gjatë viteve të fundit janë bërë, kryesisht, në llogari të sipërfaqeve të gjelbra, të hapësirave tjera publike dhe të mos respektimit të standardeve për sipërfaqet e gjelbra gjatë ndërtimeve të reja për kokë banori, marrja e masave për ruajtjen dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe hapësirave tjera publike për një jetë sa më normale të qytetarëve nga ana e komunave është prioritet themelor i punës së tyre.

Rezultati përmbledhë produktet e veprimeve të komunës përkatëse për një mjedis të shëndetshëm dhe sigurtë, si nga pikëpamja e menaxhimit të mjedisve natyrore ose të atyre të krijuara. Performanca e komunës përkatëse, për arritjen e këtij rezultati, është e lidhur ngushtë me krijimin, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra, të shesheve dhe hapësirave tjera për lëvizje dhe veprimtari të ndryshme të qytetarëve. Komuna është kompetente për planifikimin dhe zbatimin e projekte me qëllim të krijimit të kushteve më të mira mjedisore për qytetarët e vet, qoftë përmjet veprimeve për ruajtjen e ekosistemeve natyrore në vendbanime qoftë përmes krijimit të hapësirave të reja të gjelbëruara si pjesë të ekosistemeve urbane dhe rurale (Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, nenin 14). Duke qenë se krijimi i mjedisve të shëndetshme për qytetarët është prioritet jo vetëm i komunave, neni 37, paragrafi 1 i ligjit në fjalë, përcakton detyrimet e Qeverisë dhe të komunave për sigurimin e financave të nevojshme për realizimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit. Parqet dhe sipërfaqet e gjelbëruara, si pjesë e mbrojtjes së mjedisit, në veçanti paraqesin elemente kritike të vendbanimeve për të ofruar kushte për mjedis jetësor më cilësor, në kuptimin e sigurimit të cilësisë së ajrit, mbrojtjes nga zhurma, pluhuri, rrezatimi, por edhe hapësira për veprimtari sportive, kulturore, rinore për rekreacion dhe edukim mjedisor.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 8.1.1 - Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m<sup>2</sup> për kokë banori

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në mbrojtjen, ndërtimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra publike në territorin e komunës. Hapësirat publike të gjelbra përfshijnë parqet, kopshtet publike dhe hapësirat e gjelbra që janë në menaxhim të komunës dhe në shërbim të gjerë të qytetarëve, si dhe kopshtet dhe hapësirat e gjelbra të institucioneve publike të veçanta, si: shkollave, kopshteve të fëmijëve, qendrave të mjekësisë familjare dhe të ndërtesave kolektive.

#### Çfarë matet?

Hapësirat e gjelbra të institucioneve publike të veçanta, edhe pse nuk janë në shfrytëzim të përgjithshëm të drejtpërdrejt të qytetarëve, megjithatë janë në pronësi të komunës sipas vendimit përkatës të kuvendit të komunës, financohen nga komuna dhe janë në shfrytëzim të kategorive përkatëse të qytetarëve të komunës përkatëse. Pra hapësirë e gjelbër publike është e gjithë ajo sipërfaqe, e cila me vendim të veçantë të kuvendit të komunës dhe me plane rregulluese të komunës përcaktohet si park, kopsht dhe hapësirë e lirë e gjelbër. Këtu hynë edhe infrastruktura përcjellëse për ndriçim publik, pajisjen me sistemin për ujtiqe, me ujë të pijshëm, karriget për pushim etj. Në hapësira të gjelbra publike nuk përfshihen varrezat, memorialët apo zonat malore.

### Sqarime të hollësishme

Zgjerimi i hapësirave publike të gjelbëruara ka dy efekte të rëndësishme në përmirësimin e jetës së qytetarëve: thithjen e pluhurit dhe helmeve të ndryshme nga ajri dhe lirimi i oksigjenit në ajër. Këto dy efekte me kahe të ndryshme të veprimit, ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e qytetarëve nëpërmjet pastrimit të ajrit nga ndotja dhe duke e pasuruar atë me oksigjen të domosdoshëm për frymëmarrje të pastër. Performanca e komunës përkatëse në zgjerimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra publike është në përpjesëtim të drejtë me mjedisin e shëndetshëm për qytetarët.

Matja e saktë e treguesit është relativisht e ndërlikuar. Me qëllim të matjes sa më të plotë dhe në përputhje me synimet e matjes së SMPK (në përputhje me standardet ndërkombëtare sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë)<sup>42</sup>, treguesi përmban dy kriteret e matjes: njëri i bazuar në sipërfaqen e hapësirave të gjelbra publike në raport me sipërfaqen e gjithmbarshme të territorit të komunës në hektarë dhe tjetri i bazuar në sipërfaqen e hapësirave të gjelbra publike në raport me numrin e popullatës së komunës përkatëse. Pra treguesi matë performancën si sasi dhe të njëjtën të përkthyer në metra katror për kokë banori si cilësi.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo kumulative, përkatësisht raportohet gjithsej sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në hektar të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i popullatës në komunën përkatëse
2. Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në hektarë (ha)
3. Sipërfaqja e territorit të komunës në hektarë (ha)

### Formula e llogaritjes

Llogaritja bëhet në bazë të formulës së thjeshtë, sipas kriterit të parë: pjesëtimi i të dhënës së dytë me të dhënë të parë.

---

<sup>42</sup>[http://ëëë.ëho.int/hia/green\\_economy/indicators\\_cities.pdf](http://ëëë.ëho.int/hia/green_economy/indicators_cities.pdf)

$$Treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 10,000$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria për shërbime publike, njësia e pagesave në komunë, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për ruajtjen, ndërtimin dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbra publike dhe dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në hektarë sipërfaqe.

## Treguesi 8.1.2 - Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në mirëmbajtjen e hapësirave publike në nivel të komunës, respektivisht mirëmbajtjen e rregullt të hapësirave publike të përfshira në planin komunal vjetor të punës.

### Çfarë matet?

Treguesi matë veprimet e komunës për mirëmbajtjen e rregullt të parqeve, kopshteve, hapësirave të gjelbra dhe shesheve. Matja e performancës për këtë tregues përfshinë të gjitha aspektet e kuptimit të nocioneve park, kopsht, hapësirë e gjelbër (kuptimi i ngushtë) dhe shesh. Qëllimi i treguesit është që të ndihmojë komunën që të ndërtojë kapacitetet planifikuese dhe zbatuese afatgjata për ofrim të qëndrueshëm të shërbimeve qoftë në aspektin sasior, qoftë në atë cilësor. Pra me ndihmën e këtij treguesi synohet që të motivohen komunat në ndërtimin e sistemit të mirëmbajtjes për këto shërbime themelore të qytetarëve, por në të ardhmen të zbatohet edhe për shërbimet tjera që investimet publike mbrohen dhe racionalizohen me anë të mirëmbajtjes së tyre.

### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë mjaftë saktë për atë që synon të matë. Treguesi synon të matë mirëmbajtjen e rregullt të sipërfaqeve të hapësirave publike nga komuna në përputhje me atë çfarë veprimesh duhet përmbushur në përputhje me kuptimin e mirëmbajtjes (shih aneksi 1). Megjithatë treguesi matë më shumë aspektet sasiorë se sa aspektet cilësore të mirëmbajtjes, për shkak se nuk është e përcaktuar ende se çfarë është një mirëmbajtje cilësore. Si do që të jetë treguesi krijon një bazë të mirë të informatave për nxitjen e komunave për futjen në planin e tyre të rregullt të punës vjetore, mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe të investimeve publike me qëllim të ruajtjes së funksionimit të tyre për çfarë janë ndërtuar.

## Kategoria

Ky treguesi i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Sipërfaqja e hapësirave publike komunale në hektarë (ha)
2. Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht në hektarë (ha)

## Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria për shërbime publike, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në hektarë sipërfaqe.

## Treguesi 8.1.3 - Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në mbulueshmërinë e sipërfaqeve publike me ndriçim publik. Komunat janë përgjegjëse për ofrimin e hapësirave publike të sigurta për lëvizjet të qytetarëve

### Çfarë matet?

Hapësirat publike përfshijnë parqet, sheshet, hapësirat e gjelbra dhe ato rekreative. Parqet, hapësirat e gjelbra dhe rekreative janë të përkufizuara në planet përkatëse urbane komunale dhe dokumentet e tjera komunale, dhe si të tilla paraqesin pjesë të rëndësishme të ekosistemeve të qyteteve dhe fshatrave për qytetarët dhe komunën përkatëse.

### Sqarime të hollësishme

Për nevojat e këtij treguesi, ndriçimi publik definohet si sistem dhe strukturë e ndërtuar në brezin anësor të hapësirave publike apo stazave për ecje të njerëzve nëpër parqe me qëllim të ndriçimit të sipërfaqeve të hapësirave publike dhe stazave ku ecin këmbësorët dhe biçiklistët. Karakteristikë e sistemit të ndriçimit janë shtyllat dhe trupat ndriçues, ku trupat ndriçues të vendosur në lartësi ndriçojnë në kënde të cilat nuk

e pengojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe bëjnë ndriçimin e nevojshëm duke krijuar një mjedis të sigurt gjatë natës për publikun.

Treguesi ka rëndësi mjaftë të madhe sepse hapësirat publike janë esenciale për jetën moderne, veçanërisht në zonat urbane. Ndriçimi publik po ashtu është njësoj i rëndësishëm për parqe dhe hapësira të hapura publike sepse përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve dhe i bën ata të ndjehen të sigurt gjatë shfrytëzimit të hapësirave publike.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit (rendimentit) dhe përmbushet në mënyrë përmbljedhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbljedhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej metra katrorë hapësirë publike të pajisura me ndriçim publik të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Metra katrorë (m<sup>2</sup>) hapësira publike në komunën përkatëse
2. Metra katrorë (m<sup>2</sup>) hapësira publike të pajisura me ndriçim publik

### **Formula e llogaritjes**

$$Treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 100$$

Në rastet kur rruga ka të ndërtuar në të dy anët e saj sistemin e ndriçimit, gjatësia e rrugës përka tëse me ndriçim publik është më e madhe se sa gjatësia reale e rrugës.

### **Burimi i të dhënave**

Të dhënat mbledhen nga drejtoria për shërbime publike, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për ndërtimin/rregullimin e hapësirave publike dhe të ndriçimit publik dhe dokumenteve zyrtare të punëve të përfunduara me pranim teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në ndriçim publik.

## FUSHA 9 - INFRASTRUKTURA RRUGORE

Emërtimi i fushës është “Infrastruktura rrugore lokale”. Infrastruktura rrugore lokale nënkupton rrugët komunale dhe infrastrukturën përkatëse përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës<sup>43</sup> (Ligjit për Rrugët, neni 18.1). Me anën infrastrukturës rrugore komunale mundësohet lëvizja e lirë dhe e sigurt e qytetarëve dhe e mjeteve motorike. Kjo fushë përfshinë rrugët, trotualet dhe ndriçimin publik. Shtrirja e kompetencave po ashtu përcakton shtrirjen e fushës. Një rrugë është e ndërtuar në mënyrë funksionale kur është e shtruar, e gjerë për qarkullimin e dy mjeteve motorike me kahe të kundërt, e pajisur me trotuare në vendbanime, e pajisur me ndriçim, e pajisur me sinjalizim vertikal dhe horizontal, e pajisur me adresë, e pajisur me kanalizim për mbledhjen e ujërave atmosferik dhe të ujërave të zeza, për të shmangur vërshimin e tyre gjatë kushteve përkatëse atmosferike.

Informatat e prodhuara nga matja e performancës së kësaj fushe kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve komunale në fushën e infrastrukturës rrugore. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore përmirëson lidhjen e vendbanimeve dhe ndikon në rritjen e mundësive për aktivitet ekonomik, rrjedhimisht mundëson zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në nivel të komunës. Fusha e infrastrukturës rrugore është e rëndësishme për nga pikëpamja e shfrytëzimit më të mirë të burimeve dhe të potencialeve burimore të komunës. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore i ndihmon drejtpërdrejt zhvillimit ekonomik dhe në të njëjtën kohë mundëson edhe ofrimin e shërbimeve tjera të rëndësishme për qytetarët. Performanca e komunës në këtë fushë ka ndikim të madh dhe të drejtpërdrejt edhe për të gjitha ministritë tjera të linjës dhe të palëve të interesit. Asnjë veprimtari institucionale, njerëzore dhe shoqërore nuk mund të kryhet pa rrugë. Shpejtësia dhe cilësia e veprimtarive shoqërore bëhet edhe me mirë dhe më e sigurtë kur ato janë të shtruara, të pajisura me trotuare dhe të ndriçuara.

Rrugët lokale lidhen me rrugët rajonale dhe kombëtare duke krijuar sistemin rrugor për transportin e njerëzve dhe mallrave. Ndërtimi dhe funksionimi i sistemit rrugor bëhet në përputhje me Ligjin për rrugët dhe standardet ndërkombëtare për ndriçim<sup>44</sup>. Me ligj janë të përcaktuar përgjegjësitë e komunave për ndërtimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Mirëmbajtja funksionale e rrugëve është shumë me rëndësi dhe prioritet i nivelit lokal dhe qendror kur dihet se qëndrueshmëria e ndërtimit të tyre gjithnjë e më shumë është më e vogël. Në këtë pikëpamje mirëmbajtja e rrugëve nënkupton edhe mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale, vertikale dhe adresat e rrugëve.

Arritjet e komunave në fushën e infrastrukturës rrugore maten përmes dy rezultateve kryesore.

### Rezultati 9.1 - Infrastruktura rrugore lokale e zgjeruar, e shtruar dhe e mirëmbajtur

Rezultati paraqet arritjen e komunës në ndërtimin, zgjerimin (rritjen e numrit të rrugëve të shtruara) dhe mirëmbajtjen e rrugëve duke përfshi të gjitha vendbanimet në territorin e komunës. Rezultati pasqyron

<sup>43</sup>Ligji NR. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

<sup>44</sup>IEC Nr. 12/2, TC-4.6 1975 ndriçimi i rrugëve me qarkullim motorik; IEC Nr. 32, TC-4.6, 1976, ndriçimi publik i vendeve të posaçme; IEC Nr.33, TC-4.6 1976, mirëmbajtja e ndriçimit publik



produktet e veprimeve të komunës përkatëse në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në përputhje me planet e komunës për infrastrukturën rrugore dhe nevojat e qytetarëve.

Me ndihmën e këtij rezultati synohet të arrihet ndërtimi i të gjitha rrugëve që lidhin të gjitha vendbanimet në territorin e komunës përkatëse, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e rregullt të tyre. Me ndërtimin, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve qytetarët qarkullojnë më shpejtë, më sigurt dhe më lehtë në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të tyre të ndryshme. Komuna është përgjegjëse që taksat e qytetarëve t'i kthejë në investime dhe ofrim të shërbimeve për një jetë më të mirë për të gjithë, në veçanti të atyre që janë të rregullt në shlyerjen e obligimit të tyre ndaj shtetit.

Duke qenë se ndërtimi i rrugëve është shumë i rëndësishëm për veprimtaritë e ndryshme të qytetarëve, komuna dhe qeveria në këtë kohë i kanë dhënë prioritet këtij shërbimi dhe rezultatet e performancës së komunave përkatëse ndihmojnë shumë në vlerësimin dhe ndërtimin e kapaciteteve përkatëse të komunave në ofrimin sa më cilësor të këtij shërbimi për popullatën e komunave përkatëse. Ky rezultat ka ndikim të madh jo vetëm për nivelin lokal, por edhe për atë qendror për faktin se rrugët lokale lidhen dhe janë pjesë përbërëse e rrugëve rajonale dhe kombëtare dhe pa rrugë lokale mirë të ndërtuara dhe të mirëmbajtura, roli i sistemit rrugor do të përgjysohej.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e dy treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### Treguesi 9.1.1 - Rrugët lokale të shtruara

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në shtruarjen e rrugëve lokale-komunale me asfalt apo me kubëza në kilometra gjatësi, nga gjatësia totale e rrugëve lokale në kilometra. Ky tregues informon rezultatin drejtpërdrejt lidhur me arritjen e komunës për ndërtimin dhe zgjerimin infrastrukturës rrugore komunale, me ç' rast përmirësohet lidhja e vendbanimeve dhe e cilësisë së jetës së qytetarëve.

#### Çfarë matet?

Shtrimi i rrugëve nënkupton ndërtimin e trasesë së rrugës sipas standardeve të parapara për rrugët, të pajisura me gypa për derdhjen e veçantë të ujërave të zeza dhe të ujërave atmosferik, me gypa të ujësjellësit, me gypa për kabllot të rrymës, telefonit, internetit, të shtruara me asfalt, kubëza apo materie të fortë dhe të rrafshët për lëvizje të shpejtë të mjeteve motorike. Treguesi matë edhe zgjerimin e rrjetit të rrugëve apo shtrirjen e tyre deri në secilën pjesë të vendbanimit të qytetarëve. Konkretisht matë hapjen e rrugëve të reja shtrimin e tyre dhe të atyre ekzistuese që nuk kanë qenë të shtruara. Treguesi matë vetëm rrugët e shtruara për herë të parë. Për qëllim të matjes së këtij treguesi, shtesat e reja të rrugëve nuk konsiderohen si rrugë të reja.

## Sqarime të hollësishme

Me rritjen e përqindjes së rrugëve të shtruara, komuna përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve në aspektin e sigurisë, mundësive për zhvillimin e transportit publik, përmirësimi i qasjes në shërbime publike si shëndetësi, arsim, si dhe në punësim dhe zhvillim ekonomik lokal. Komuna, për çdo vjet ka mundësi që ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasoj dhe vlerësojë performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës përkatëse. Për matjen e drejt të këtij tregues, duhet të përcaktohen qartë rrugët rajonale dhe kombëtare, të cilat kalojnë nëpër territorin e komunës përkatëse, e të cilat nuk janë në kompetencë të autoritetit komunal dhe nuk maten. Kur komuna i ka të shtruara 100% rrugët në tërë territorin e vetë, ajo e raporton performancën e saj vjetore me 100%, derisa të hapet një rrugë e re për një vendbanim të ri apo të riparimit të rrugëve të dëmtuara ekzistuese më gjatë se një kilometër.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej kilometra rrugë të shtruara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë në territorin e komunës përkatëse
2. Kilometra rrugë të shtruara (gjithsej)
3. Kilometra rrugë të shtruara për herë të parë gjatë vitit

## Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \left( \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100 \right) + \left( \frac{\text{e dhëna 3}}{\text{e dhëna 2}} * 10 \right)$$

- Ipet një përqindje shtesë, deri në 10%, nëse kilometrat e shtuar në komunë janë bërë gjatë vitit raportues

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria për infrastrukturë, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për ndërtimin dhe shtrimin e rrugëve të reja apo të riparimit të rrugëve të dëmtuara më të gjata se një kilometër dhe dokumenteve zyrtare të punëve

të përfunduara me pranimitë teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët kryera në kilometra rrugë gjatësi.

### Treguesi 9.1.2 - Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve lokale, të shtruara dhe të pashtruara gjatë sezonës së verës.

#### Çfarë matet?

Treguesi e informon rezultatin 8.1. për të gjitha arritjet e komunës në realizimin e planit për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonës së verës, rregullimin dhe hapjen e pusetave për ujë atmosferik dhe të ujërave të zeza, rregullimin e shenjzimit vertikal dhe horizontal, mbushja dhe shtrimi i gropave në rrugë dhe meremetimet tjera në ruajtjen e funksionalitetit të rrugëve për qarkullim të lehtë dhe të sigurt për qytetarët. Matja për mirëmbajtjen e rrugëve përfshinë të gjitha veprimet e përshkruara më lartë për kilometër rrugë dhe jo mirëmbajtjen individuale përkatëse.

#### Sqarime të hollësishme

Me rritjen e përqindjes së rrugëve të mirëmbajtura, komuna përmirëson cilësinë e jetës së qyteta rëve nga pikëpamja e transportit më të lehtë, më të shpejtë dhe më të sigurt për transportin publik dhe atë privat dhe përmirëson qasjen në shërbime publike si shëndetësi, arsim, në punësim dhe zhvillim ekonomik lokal. Komuna, për çdo vjet ka mundësi që ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasoj dhe vlerësojë performancën vetenake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.

Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës përkatëse, por duhet referuar me saktësi se çka përfshinë përmbytja verore e rrugëve. Për matjen e drejt të këtij tregues, duhet të përcaktohen qartë rrugët rajonale dhe kombëtare, të cilat kalojnë nëpër territorin e komunës përkatëse, e të cilat nuk janë në kompetencë të autoritetit komunal dhe nuk maten, përveç nëse komuna me marrëveshje të veçantë me ministrinë përkatëse bën mirëmbajtjen e tyre.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit. Raportimi bëhet për të gjitha llojet e mirëmbajtjeve për kilometër rrugë (në mënyrë të integruar).

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë të cilat mirëmbahen rregullisht gjatë sezonës së verës

## 2. Kilometra rrugë në territorin e komunës përkatëse

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 1}}{\text{e dhëna 2}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria e shërbimeve publike, asaj për infrastrukturë, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për mirëmbajtje dhe rinovimin e rrugëve të dëmtuara gjatë vitit dhe dokumenteve zyrtare të punëve të përfunduara me pranimit teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në kilometra rrugë gjatësi.

### Treguesi 9.1.3 - Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve lokale, të shtruara dhe të pashtruara gjatë sezonës së dimrit.

#### Çfarë matet?

Treguesi e informon rezultatin 9.1. për të gjitha arritjet e komunës në realizimin e planit për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonës së dimrit që përfshin pastrimin e borës në kilometra rrugë gjatësi, shpërndarjen e kripës në rrugë, rregullimin dhe hapjen e pusetave për ujë atmosferik dhe të ujërave të zeza, rregullimin e shenjzimit vertikal dhe horizontal, mbushja dhe shtrimi i gropave në rrugë dhe meremetimet tjera në ruajtjen e funksionalitetit të rrugëve për qarkullim të lehtë dhe të sigurt për qytetarët. Matja për mirëmbajtjen e rrugëve përfshinë të gjitha veprimet e përshkruara më lartë për kilometër rrugë dhe jo mirëmbajtjen individuale përkatëse.

#### Sqarime të hollësishme

Me rritjen e përqindjes së rrugëve të mirëmbajtura, komuna përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve nga pikëpamja e transportit më të lehtë, më të shpejtë dhe më të sigurt për transportin publik dhe atë privat dhe përmirëson qasjen në shërbime publike si shëndetësi, arsim, në punësim dhe zhvillim ekonomik lokal. Komuna, për çdo vjet ka mundësi që ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasoj dhe vlerësojë performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.

Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës përkatëse, por duhet referuar me saktësi se çka përfshinë përmbytja dimërore e rrugëve. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve përfshinë mirëmbajtjen gjatë sezonës së dimrit duke filluar nga datat 15 Nëntor deri 15 Mars të vitit vijues. Për matjen e drejt të këtij tregues, duhet të përcaktohen qartë rrugët rajonale dhe kombëtare, të cilat kalojnë nëpër territorin e

komunës përkatëse, e të cilat nuk janë në kompetencë të autoritetit komunal dhe nuk maten, përveç nëse komuna me marrëveshje të veçantë me ministrinë përkatëse bën mirëmbajtjen e tyre.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit. Raportimi bëhet për llojet e mirëmbajtjeve dimërore për kilometër rrugë (në mënyrë të integruar).

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë për të cilat mirëmbahen rregullisht gjatë sezonit të dimrit (pastrimi i borës, hedhja e kripës etj.)
2. Kilometra rrugë në territorin e komunës përkatëse

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 1}}{\text{e dhëna 2}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike, asaj për infrastrukturë, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për mirëmbajtje dhe rinovimin e rrugëve të dëmtuara gjatë sezonës së dimrit dhe dokumenteve zyrtare të punëve të përfunduara me pranim teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në kilometra rrugë gjatësi.

## Rezultati 9.2 - Infrastruktura rrugore lokale e sigurt për qytetarët

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në sigurimin e infrastrukturë rrugore komunale, të sigurt për lëvizjen e qytetarëve. Infrastruktura rrugore e sigurt nënkupton ndërtimin e hapësirave dhe mjeteve tjera mbrojtëse dhe orientuese përgjatë rrugës, si: trotualet, ndriçimi, shenjëzimi dhe bresat fizik anësor përgjatë dhe rreth rrugëve që e ndihmojnë dhe e sigurojnë lëvizjen qytetarëve (këmbësorëve) pran rrugëve me qarkullim të mjeteve motorike. Në këtë pikëpamje veprimet janë të përqendruara në vendbanimet ku

ka qarkullim më të madh të qytetarëve (këmbësorëve), veçanërisht pranë shkollave ku ka lëvizje të fëmijëve.

Me rritjen e gjatësisë së rrugëve të shtruara paraqitet sfida e sigurimit të qytetarëve në rrugë, për shkak të rritjes së shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve në rrugët lokale. Duke pas parasysh këtë fakt autoritetet lokale janë të obliguara të marrin veprime të nevojshme përkatëse për të krijuar kushte për lëvizje të sigurt të qytetarëve në tërë territorin e komunës përkatëse. Ndërtimi i trotuareve, i ndriçimit publik, i shenjzimeve dhe i brezave anësore ndikon në masë të madhe në rritjen e sigurisë së qytetarëve dhe i të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion. Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është i lidhur me efikasitetin e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse. Rezultati ndihmon komunën përkatëse për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e pesë treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### Treguesi 9.2.1 - Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në ndërtimin dhe shtrimin e hapësirës anësore (shtegut) apo trotuareve përgjatë rrugëve për qarkullim të mjeteve motorike në zona urbane dhe vend banimet e banuara të fshatrave.

#### Çfarë matet?

Në të dy anët e rrugëve për qarkullim të mjeteve motorike duhet të ekzistojë edhe një hapësirë e lirë, optimalisht dy metra e gjerë për lëvizje të qytetarëve. Kjo hapësirë apo shteg për lëvizje të qytetarëve ndërtohet dhe shtrohet me kubëza apo asfalt në mënyrë që qytetarët të lëvizin më lehtë dhe më shpejtë. Sfidë për komunat është gjerësia e pamjaftueshme e hapësirës për krah rrugëve. Në të shumtën e rasteve trotuaret nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme për lëvizje të lirë të qytetarëve, janë shumë të ngushtë, dhe në këto raste qytetarët detyrohen të lëvizin në një pjesë të rrugës për qarkullim të mjeteve motorike dhe duke rrezikuar jetën e tyre në trafik. Megjithatë në kushtet aktuale, tretuar llogaritet shtegu prej 0.50 m e më gjerë në njërin anë apo në të dy anët e rrugës për qarkullim të mjeteve motorike dhe jo hapësirat tjera që nuk janë pjesë e rrugës për qarkullim të automjeteve. Kjo e bënë të dallojë trotuarin me sheshet dhe hapësirat publike tjera. Trotuari është hapësirë bri rrugës, teknikisht e ngritur më lartë se niveli i rrugës përkatëse dhe shërben për lëvizje dhe jo qëndrim. Rruga llogaritet se ka tretuar, edhe nëse trotuari është i shtruar vetëm në njërin anë të rrugës. Nëse rruga ka në të dy anët e saj tretuar, atëherë llogaritet gja tësia e trotuarit në kilometra në të dy anët e rrugës përkatëse. P.sh. nëse rruga është 10 km dhe ka trotuar në të dy anët e saj, gjatësia e trotuarit është 20 km.

## Sqarime të hollësishme

Ky tregues e informon rezultatin drejtpërdrejt lidhur me arritjen e komunës në ndërtimin pjesëve rrugore të cilat kanë të bëjnë me lëvizjen e sigurt të qytetarëve përgjatë infrastrukturës rrugore komunale. Treguesi matë relativisht saktë dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve gjatë lëvizjes apo veprimtarisë së tyre, por në fakt këto hapësira në të shumtën e rasteve, edhe pse janë të dedikuara vetëm për lëvizjen e qytetarëve, jo rrallë herë ato përdoren për parkimin e mjeteve motorike. Kjo i detyron këmbësorët që të zbresin në rrugë dhe të rritet rreziku i tyre gjatë lëvizjes në vendbanime të mëdha. Ky dimension apo shkalla e funksionalitetit të trotuareve nuk matet me këtë tregues. Në fakt edhe pse raportohet për ekzistimin e trotuareve, në pamundësi të shfrytëzimit në rastet e tilla, e bëjnë të paqëndrueshëm treguesin për funksionin që e ka.

Komuna, për çdo vjet ka mundësi ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasojë dhe vlerësojë performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej kilometra rrugë gjatësi me trotuare të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë gjatësi të shtruar
2. Kilometra rrugë të pajisura me trotuare në zona urbane dhe vendbanime në fshatra

## Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

Në rastet kur rruga ka të ndërtuar në të dy anët e saj trotuare, gjatësia e trotuareve është më e madhe se sa gjatësia e rrugës përkatëse.

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria për infrastrukturë, njësi e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për ndërtimin dhe shtrimin e trotuareve dhe dokumenteve zyrtare të punëve të përfunduara me pranim teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në kilometra trotuare gjatësi.

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në ndërtimin e ndriçimit publik përgjatë trotuareve apo rrugëve për qarkullim të mjeteve motorike. Për nevojat e këtij treguesi, ndriçimi publik definohet si sistem dhe strukturë e ndërtuar në brezin anësor të rrugës apo në sipërfaqet ndarëse të rrugëve me shumë shirita, me qëllim të ndriçimit të sipërfaqeve të rrugës si dhe trotuareve për lëvizje dhe veprimtari të ndryshme të qytetarëve.

### Çfarë matet?

Karakteristikë e sistemit të ndriçimit janë shtyllat dhe trupat ndriçues, ku trupat ndriçues të vendosur në lartësi ndriçojnë në kënde të cilat nuk e pengojnë komunikacionin dhe në anën tjetër në trotuare bëjnë ndriçimin e nevojshëm të tyre duke krijuar një mjedis të sigurt gjatë natës për publikun. Për nevojat e këtij treguesi, e në mungesë të normativave ligjore dhe teknike, në rastet kur rruga ka sistem të ndriçimit në njëërën anë, llogaritet rrugë me ndriçim publik. Sipërfaqja e ndriçuar, cilësia dhe mjaftueshmëria e sistemit të ndriçimit nuk matet me këtë tregues. Sistemi i ndriçimit në kontekstin e këtij treguesi teknikisht definohet vetëm në raport me rrugën, ku ndriçimi i shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklistë, parqeve ose shesheve të rregulluara nuk përfshihen në llogaritje, nëse nuk janë të asociuara me rrugë publike në kuptimin e shtrirjes paralele në brezin anësor.

### Sqarime të hollësishme

Ky tregues e informon rezultatin drejtpërdrejt lidhur me arritjen e komunës në ndërtimin e sistemit ndriçues i cili ka të bëjë me lëvizjen e sigurt të qytetarëve përgjatë infrastrukturës rrugore komunale. Treguesi matë saktë dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve gjatë lëvizjes apo veprimtarisë së tyre në rrugë. Problem është matja e saktë e gjatësisë së rrugëve të ndriçuara kur sistemi i ndriçimit është i ndërtuar në të dy anët e rrugës përkatëse. Nëse rruga ka ndriçim në të dy anët e saj, atëherë llogaritja e gjatësisë së rrugës së ndriçuar në kilometra bëhet për të dy anët e rrugës përkatëse. P.sh. nëse rruga është 10 km dhe ka ndriçim në të dy anët e saj, gjatësia e rrugës së ndriçuar është 20 km.

Komuna, për çdo vjet ka mundësi ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasojë dhe vlerësojë performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit (rendimentit) dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej kilometra rrugë gjatësi me ndriçim publik të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.



**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë të shtruara
2. Kilometra rrugë të pajisura me ndriçim publik

### Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 100$$

Në rastet kur rruga ka të ndërtuar në të dy anët e saj sistemin e ndriçimit, gjatësia e rrugës përka tëse me ndriçim publik është më e madhe se sa gjatësia reale e rrugës.

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria për infrastrukturë, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për ndërtimin dhe shtrimin e trotuareve dhe dokumenteve zyrtare të punëve të përfunduara me pranim teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në kilometra trotuare gjatësi.

## Treguesi 9.2.3 - Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në shenjëzimin e rrugëve lokale në raport me totalin e rrugëve në territorin e komunës.

### Çfarë matet?

Për nevojat e këtij treguesi, shenjëzimi i rrugëve nënkupton shenjëzimin vertikal dhe horizontal: të gjitha shenjat orientuese (duke përfshirë edhe adresat e rrugëve), informuese, të kujdesit, të rrezikut dhe të ndalimit (duke përfshirë edhe semaforët) në komunikacion, të vendosura vertikalisht në të dy kahjet e rrugës përkatëse dhe shenjëzimi horizontal i cili përfshin vijat kufizuese të shiritave të rrugës përkatëse, vijat e bardha përgjatë rrugës të cilat e ndihmojnë drejtuesin e mjetit motorik në trafik dhe vijat tërthore të cilat përcaktojnë vendin ku këmbësorët mund ta kalojnë rrugën përkatëse në mënyrë të sigurt. Për dallim nga treguesi 8.2.1 dhe 8.2.2, rruga është e shenjëzuar në kilometra gjatësi nëse shenjëzimi është i plotë në të dy kahet e rrugës përkatëse dhe gjatësia e rrugës me shenjëzim duhet të jetë e njëjtë me gjatësinë fizike të rrugës në kilometra.

### Sqarime të hollësishme

Ky tregues informon rezultatin drejtpërdrejt lidhur me arritjen e komunës në shenjëzimin e rrugëve i cili me funksionin e tij orientues dhe rregullues në trafik ndikon drejtpërdrejt në sigurimin e qytetarëve gjatë

lëvizjes dhe veprimtarisë së tyre në rrugë. Treguesi matë mjaftë saktë dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve gjatë lëvizjes apo veprimtarisë së tyre në rrugë. Problem është matja e plotë e të gjitha shenjave të vendosura në të dy krahët apo kahet e rrugës përkatëse, sepse mund të mos vendosen të gjitha shenjat në gjatësinë përkatëse të rrugës dhe duhet të raportohet se rruga në gjatësinë përkatëse është e shenjzuar.

Komuna, për çdo vjet ka mundësi ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasojë dhe vlerësojë performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej kilometra rrugë me sistem të shenjzimit të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë gjatësi në territorin e komunës
2. Kilometra rrugë gjatësi me sistem të shenjzimit (të shenjzuara)

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} \times 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria për infrastrukturë, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për ndërtimin e sistemit të shenjzimit dhe dokumenteve zyrtare të punëve të përfunduara me pranim teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët e kryera në kilometra rrugë gjatësi të shenjzuara.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës

## Treguesi 9.2.4 - Rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në ndërtimin e shtegut të biçikletave përgjatë rrugëve për qarkullim të mjeteve motorike në zona urbane.

### Çfarë matet?

Për nevoja të këtij treguesi shteg i biçikletave definohet si pjesa e rrugës apo hapësira që është e përcaktuar qoftë përmes shenjzimit apo ndarjes me strukturë të fortë nga rruga kryesore dhe e cila shfrytëzohet për lëvizje të lirë nga biciklistët. Kjo hapësirë apo shteg për lëvizje të biçiklistave ndërtohet dhe shtrihet qoftë e shtruar me asfalt apo kubëza të betonit dhe nuk duhet të përmbaj ndonjë pengesë apo strukturë tjetër në shteg që pengon lëvizjen e lirë.

### Sqarime të hollësishme

Shteg i biçikletave llogaritet gjerësia shtegut prej 1.5 metra apo më gjerë në njërën anë apo në të dy anët e rrugës për qarkullim të mjeteve motorike. Shtegu i biçikletave mund të jetë hapësira e shenjzuar me shenjzim horizontal në skaj të përgjatë gjatësisë së rrugës apo hapësira e përcaktuar ndërmjet rrugës dhe trotuarit. Rruga llogaritet se ka shteg të biçikletave edhe nëse shtegu është i shtruar vetëm në njërën anë të rrugës. Nëse rruga ka në të dy anët e saj shteg të biçikletave, atëherë llogaritet gjatësia e shtegu në kilometra në të dyja anët e rrugës përkatëse. P.sh nëse rruga është 5 km dhe ka shteg të biçikletave në të dy anët e saj, atëherë gjatësia e shtegut është 10 km. Zonë urbane këtu konsiderohet zona kadastrale e cila edhe Agjencioni për Statistika të Kosovës e konsideron si zonë urbane, pra zonën kadastrale të kryeqendrës së komunës.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej kilometra rrugë gjatësi me shteg të biçikletave të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

Të dhënat. Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë në zonat urbane të komunës
2. Kilometra rrugë në zona urbana me stazë të biçikletave

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria për infrastrukturë, njësia e pagesave në komunë dhe në drejtorinë përgjegjëse për urbanizim dhe planifikim hapësinor. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për ndërtimin e sistemit të shenjzimit dhe

dokumenteve zyrtare të punëve të përfunduara me pranimit teknik dhe të dokumenteve zyrtare të pagesave për punët kryera në kilometra rrugë gjatësi të shenjuara.

## Treguesi 9.2.5 - Rrugë lokale të riasfaltuara

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të ngris shkallën e performancës për mirëmbajtjen e rrugëve komunale përmes riasfaltimit për rrugët që vlerësohen se kanë nevojë për një intervenim të tillë.

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e kilometrave të riasfaltuar apo rikubëzuar në relacion me kilometra rrugë të vlerësuara për riasfaltim. Këtu përfshihet edhe rikubëzimi i rrugëve që kanë qenë të shtruara me kubëza e jo me asfalt. Këtu nuk përfshihen kilometra rrugë të cilat vetëm janë sanuar gropat apo riasfaltim të pjeshme. Pra ky tregues matë riasfaltimin e rrugëve në plotësi ku përfshihet gërryerja e rrugës, nivelizimi si dhe riasfaltimi apo rikubëzimi.

### Sqarime të hollësishme

Komunat janë përgjegjëse për të mirëmbajtur rrugët e tyre në territorin përkatës të komunës. Këtë e bëjnë përmes planifikimit të buxhetit kapital në mirëmbajtjen e rrugëve. Pas një kohë të shtrimit të rrugëve me asfalt apo me kubëza shfaqet nevoja për riasfaltim apo rikubëzim. Në disa rrugë mund të shfaqet nevoja për sanim të disa pjesëve të rrugës apo sanim të gropave. Ndërsa në disa rrugë amortizohen aq shumë sa që ka nevojë për rishtrim të rrugëve. Komunat duhet të bëjnë vlerësimin vjetor për rrugët dhe rrugicat komunale që kanë nevojë për riasfaltim apo rikubëzim. Atë vit duhet të buxhetohet për riasfaltim të atyre në vitin pasardhës.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej kilometra rrugë të shtruara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat:** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Kilometra rrugë të vlerësuara për riasfaltim
2. Kilometra rrugë të riasfaltuara

### Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

### **Burimi i të dhënave**

Të dhënat mblidhen nga drejtoria për shërbime publike përkatëse apo infrastrukturë dhe njësi e pagesave në komunë. Verifikimi i të dhënave bëhet nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të kontraktimit të punëve (kontratave) për rishtrimin e rrugëve dhe raportit për vlerësimin e rrugëve komunale.

## FUSHA 10 - TRANSPORTI PUBLIK

Emërtimi i fushës është: “Transporti publik komunal”. Transporti publik komunal (lokal) nënkupton ofrimin e transportit të qytetarëve, që me kushte të njëjta është i përshtatshëm për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit në bazë të akteve normative të cilat i miraton komuna<sup>45</sup>. Komuna është e obliguar që t’i përcaktojë politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit rrugor të sigurta, efikase dhe ekonomike brenda kufijve administrativë të komunës (Ligji për transportin rrugor, neni 6, paragrafi 1). Po ashtu komuna harton dhe aprovon planin e transportit rrugor lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës, varësisht nga rrethanat e krijuara, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me rrjetin e linjave ndër-urbane të aprovuar dhe publikuar nga Ministria (Ligji për transportin rrugor, neni 6, paragrafi 2). Gjithashtu në përputhje me nenin 17, paragrafi 6 të Ligjit për Transportin Rrugor, komuna është e obliguar ta rregullojë me akt të veçantë komunal transportin e rregullt urban dhe urban-periferik të udhëtarëve me autobus, si transport i udhëtarëve në qarkullimin rrugor publik. Përpos kësaj, komuna ka kompetencë ekskluzive për licencimin e shërbimeve publike në fushën e transportit lokal publik, duke përfshirë edhe taksitë (Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17 paragrafi – n).

Shtirja e përmbajtjes për matjen e performancës së kësaj fushe është e përcaktuar shumë qartë me rregullativën ligjore dhe me akte komunale përkatëse, si në paragrafin më lartë. Konkretisht fusha përfshin matjen e performancës së komunës përkatëse në përfshirjen e të gjitha vendbanimeve në transportin lokal mbi bazën e planit për transport publik komunal në mënyrë të sigurt. Transporti lokal publik është funksional atëherë kur të gjithë qytetarëve e të gjitha vendbanimeve u ofrohet mundësia e barabartë e transport publik të rregullt dhe të licencuar (të sigurt). Transporti publik komunal është funksional kur komuna siguron transport të rregullt për qytetarët e të gjitha vendbanimeve sipas linjave të planifikuara, për mbajtjen e të cilave angazhohen edhe kompanitë e licencuara publike ose private dhe zvogëlim maksimal i numrit të automjeteve individuale që përdoren për transportin e qytetarëve në vendbanimet urbane dhe rurale. Rritja e numrit të qytetarëve që udhëtojnë me transport publik tregon për shkallën e funksionimit të këtij shërbimi komunal.

Informatat e prodhuara nga matja e performancës së kësaj fushe ka një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve komunale në fushën e infrastrukturës rrugore dhe të transportit publik lokal. Kjo fushë është e ndërlidhur shumë me arritjet në fushën e infrastrukturës rrugore. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore përmirëson lidhjen e vendbanimeve me transport publik lokal dhe lehtëson qarkullimin e mjeteve motorike për transport të njerëzve dhe të mallrave, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e veprimeve ekonomike, arsimore, kulturore, sportive dhe shëndetësore. Shumë komuna në Republikën e Kosovës ballafaqohen me probleme të mëdha në menaxhimin e kësaj fushe. Dyndjet e mëdha drejt qendrave të mëdha dhe pamundësia e komunave përkatëse për transportin e qytetarëve sipas një orari që do t’iu mundësonte atyre arritjen me kohë në destinacionin e caktuar, ka ndikuar që të rritet numri i qytetarëve që udhëtojnë me automjete individuale private, duke rritur në mënyrë enorme numrin e mjeteve motorike në trafik dhe si rrjedhojë krijimin e shumë fyteve të ngushta, çrregullime në transportin publik, vonesa të mëdha, shpenzime të mëdha dhe ndotje e madhe në mjediset urbane. Për këto arsye dhe për arsye tjera, kjo fushë

<sup>45</sup>Ligji NR. 04/L-179 për Transportin Rrugor

është prioritet i madh për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës e po ashtu edhe për të gjitha ministrinë e linjës dhe të palëve të interesit. Performanca në këtë fushë matet nëpërmjet një rezultati.

### **Rezultati 10.1 - Ofrimi i transportit lokal publik për të gjitha vendbanimet e komunës**

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në ofrimin e transportit lokal publik dhe të sigurt për të gjitha vendbanimet e territorit të komunës përkatëse. Ofrim i transportit lokal publik nënkupton mundësinë që të gjithë qytetarët e të gjitha vendbanimeve në territorin e komunës përkatëse të transportohen me transport lokal (komunal) në mënyrë të sigurt deri në destinacionin e caktuar brenda territorit të komunës. Transporti lokal publik realizohet dhe menaxhohet në bazë të një plani të miratuar nga komuna për transport të rregullt komunal dhe masave tjera përcjellëse për transport sa më të sigurt për qytetarët.

Me rritjen e gjatësisë së rrugëve të shtruara dhe shtrirjes së tyre sa më të madhe në vendbanimet e komunës përkatëse, rritet edhe rreziku i jetës së qytetarëve në rrugë, për shkak të rritjes së shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve në rrugët lokale. Po ashtu angazhimi i kompanive private të transportit për mbulimin e nevojave për transport lokal publik, e obligon komunën që t'i zbatojë me përpikëri kriteret për licencim të këtyre kompanive pa përjashtuar as kompanitë publike të transportit. Transportin e sigurt të qytetarëve, prej një pike në pikën tjetër të territorit të komunës, e ndihmon gjithashtu edhe zbatimi dhe dëshmimi i kontrollit të rregullt teknik i mjeteve të transportit të qytetarëve. Duke pas parasysh këtë fakt autoritetet lokale janë të obliguara të marrin veprime të nevojshme përkatëse për të krijuar kushte për lëvizje të sigurt të qytetarëve, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, si: në vendosjen e shenjave për shpejtësinë e lëvizjes, shenjave për vendndalimin e automjeteve për transport publik dhe mirëmbajtjen e tyre, krijimin e hapësirave të nevojshme për vend ndalimin e automjeteve të transportit publik dhe ndërtimin e vendqëndrimeve (vend-pritjeve) për qytetarët e linjave përkatëse. Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është i lidhur me efikasitetin e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse. Rezultati ndihmon komunën përkatëse për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen. Arritja e këtij rezultati do të thotë, trafik më të qetë, më të sigurt dhe më ekonomik për qytetarët.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e tre treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

#### **Treguesi 10.1.1 - Realizimi i planit komunal për transport lokal publik**

##### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në zbatimin e planit komunal për transport lokal publik në përputhje me dispozitat e caktuara ligjore.

## Çfarë matet?

Për nevojat e këtij treguesi, zbatimi i planit komunal për transport lokal publik përfshinë shkallën e respektimit të linjave të përcaktuara me plan të transportit lokal publik, respektimi i vendnisjeve (pikat fillestare) dhe i destinaconeve fundore, vend ndaljet, oraret kohore sipas ditëve të javës dhe oraret sezonale, ashtu si janë të miratuara me plan të transportit lokal publik nga kuvendi komunal duke ju referuar periudhës kohore për të cilën është në fuqi. Plani komunal për transport lokal publik ka afat pesëvjeçar, duke kërkuar që të rishqyrtohet apo ndryshohet më së voni 1 herë në 5 vite (Ligji i transportit rrugor<sup>46</sup>). Mirëpo, komunat mund ta ripërtërijnë planin edhe më herët sipas nevojave dhe kërkesave që kanë, por janë të obliguara që ta monitorojnë zbatimin e tij në baza të rregullta.

## Sqarime të hollësishme

Treguesi është në funksion të plotë me përmbushjen e qëllimit të rezultatit 9.1, konkretisht matë performancën e komunës përkatëse në nivelin planifikues dhe zbatues. Me kërkesën e SMPK për raportimin e realizimit të planit komunal për transport lokal publik, në të njëjtën kohë, kërkohet posedimi i planit komunal për transport lokal publik dhe zbatimi i tij.

Treguesi informon rezultatin drejtpërdrejt, duke plotësuar informacionin lidhur me veprimet e komunës për të arritur përmbushjen e rezultatit të kërkuar.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas planit në vitin përkatës kalendarik. Për këtë tregues raportohet në mënyrë vjetore, përkatësisht raportohet gjithsej veprime të realizuara gjatë vitit përkatës kalendarik dhe të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten 2 lloje të të dhënave:

1. Numri i veprimeve të planifikuara me planin komunal për transport lokal publik dhe
2. Numri i veprimeve të realizuara nga plani komunal për transport lokal publik gjatë vitit përkatës që raportohet.

## Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 100$$

## Burimi i të dhënave

---

<sup>46</sup>Ligji NR. 04/L-179 për Transportin Rrugor



Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e planit komunal për transport lokal publik të miratuar nga kuvendi komunal dhe i formës përfundimtare zyrtare. Për shkallën e zbatimit apo realizimit të planit komunal për transport lokal publik shfrytëzohet raporti vjetor i drejtorisë së shërbimeve publike në komunën përkatëse.

### Treguesi 10.1.2 - Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse për shkallën e përfshirjes së vendbanimeve në transport publik në raport me totalin vendbanimeve të komunës.

#### Çfarë matet?

Ofrim i transportit lokal publik nënkupton mundësinë që të gjithë qytetarët e të gjitha vendbanimeve në territorin e komunës përkatëse të transportohen me transport lokal (komunal) në mënyrë të sigurt, sipas një orari të caktuar për linja të caktuara deri në destinacionin e caktuar brenda territorit të komunës. Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik komunal paraqet kusht të domosdoshëm ligjor dhe kriter i rëndësishëm i sigurimit të lirisë së lëvizjes dhe qasjes në shërbime publike.

#### Sqarime të hollësishme

Ky tregues informon rezultatin drejtpërdrejt lidhur me arritjen e komunës në sigurimin e përfshirjes të të gjitha vendbanimeve. Komuna, për çdo vjet ka mundësi ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues dhe për të gjithë të tjerët, dhe ta krahasojë dhe vlerësojë performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej numri i vendbanimeve të përfshira në transportin publik gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

#### Formula e llogaritjes

1. Numri i vendbanimeve në komunën përkatëse
2. Gjithsej vendbanime të përfshira në transportin lokal publik

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} \times 100$$

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike, kurse, lista me të gjitha vendbanimet prodhohet nga zyra e urbanizmit dhe ajo kadastrale, përkatësisht agjencinë kadastral ku gjenden të gjitha njësitë kadastrale të komunës me emërtim të vendbanimeve përkatëse. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e planit komunal për transport lokal publik të miratuar nga kuvendi komunal për përfshirjen e vendbanimeve në ofrimin e transportit lokal publik dhe i formës përfundimtare zyrtare. Për shkallën e përfshirjes së vendbanimeve në transportin lokal publik shfrytëzohet edhe raporti vjetor i drejtorisë së shërbimeve publike në komunën përkatëse.

### Treguesi 10.1.3 - Vendndalimet e shënjuara për automjetet e transportit publik

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në shenjëzimin e vend-ndalimeve të automjeteve për transport publik të përcaktuara me plan të transportit lokal publik (Ligji i transportit rrugor, neni 3 pika 1.6). Sipas kuptimit të këtij treguesi vendndalimi përfshinë “sipërfaqet e ndërtuara dhe të shënjuara posaçërisht, e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen, përkatësisht daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve”.

#### Çfarë matet?

Pajisja e vend ndaljeve me tërësinë e shenjëzimit paraqet kusht të domosdoshëm ligjor dhe kriter të rëndësishëm të sigurisë në komunikacion për të gjithë pjesëmarrësit në transportin lokal publik, në veçanti udhëtarët gjatë hyrjes dhe zbritjes. Shenjëzimi ndihmon edhe mjetet tjera motorike pjesëmarrës në trafik gjatë parakalimit, apo tejkalimit pranë vendndalimeve përkatëse.

#### Sqarime të hollësishme

Ky tregues matë mjaftë saktë dhe e informon rezultatin drejtpërdrejt lidhur me arritjen e komunës në ndërtimin e sistemit të shenjëzimit horizontal dhe vertikal të vend-ndaljeve për transportin publik komunal të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve pjesëmarrës në trafik dhe transport lokal publik. Komuna, për çdo vjet ka mundësi ta shqyrtojë arritjen e vetë për këtë tregues, dhe ta krahasojë dhe vlerësojë performancën vetanake ndër vite dhe po ashtu edhe me komunat tjera, duke rritë kështu kapacitetet menaxhuese, transparencën dhe llogaridhënien lidhur me politikat e zhvilluara dhe të zbatuara në këtë fushë.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet numri i vendndalimeve të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbliidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i vendndalimeve për automjete të transportit lokal publik në komunën përkatëse
2. Numri i vendndalime të pajisura me shenjëzim për automjetet e transportit lokal publik

### Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbliidhen nga drejtoria e shërbimeve publike, kurse lista me të gjitha shenjëzimet përkatëse mbliidhet nga njësia përkatëse e komunës për infrastrukturë rrugore në përputhje me dokumentin zyrtar komunal për pikat apo vend-ndaljet për automjetet e transportit lokal publik ( Ligji për transportin rrugor, neni 6, pika 5.8). Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e kontratave për ndërtimin dhe vendosjen e shenjëzimit për vendndalimet e mjeteve të transportit lokal publik në komunën përkatëse dhe nga dokumentet zyrtare të pagesave të bëra për punët e kryera për shenjëzim. Për shkallën e shenjëzimit të vendndalimeve për automjete të transportit lokal publik në transportin lokal publik shfrytëzohet edhe raportivjetor i drejtorisë së shërbimeve publike në komunën përkatëse për këtë punë.

## FUSHA 11 - PARKINGJET PUBLIKE

Emërtimi i fushës është: “Hapësira për parkim publik”. Hapësirat për parkim publik janë vende në pronësi publike dhe private, me një numër të caktuar të vendeve të parkimit, të ndërtuara me standardet e kërkuara dhe të caktuara për parkimin e mjeteve motorike. Për qëllim të matjes së performancës në këtë fushë, termi “publik” në kontekst të parkingjeve, nuk i referohet pronësisë, d.m.th. lokacionet apo parkingjet publike mund të jenë edhe në pronësi private dhe si të tilla të ofrojnë shërbime për publikun.

Me shtimin e numrit të automjeteve porritet edhe nevoja e krijimit të hapësirave të nevojshme për parkim nga ana e komunës përkatëse. Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkimin e mjeteve motorike është i domosdoshëm për lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe lëvizjen e lirë të mjeteve motorike. Mungesa e hapësirave të nevojshme dhe në afërsinë e nevojshme për parkim të mjeteve motorike, po shkakton problem të madh në trafikun urban. Numër i madh i mjeteve motorike pakohen në vende të ndaluara ose të pa lejuara për parkim (skaj rruge, hapësirat e gjelbra pranë rrugës dhe në trotuare), duke penguar trafikun rrugor dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkimin e mjeteve motorike përfshinë të gjitha hapësirat publike dhe private të destinuara apo të lejuara dhe të shenjëzuara në mënyrë vertikale dhe horizontale për parkim të mjeteve motorike të quajtura parkingje publike apo private dhe të gjitha vend-parkimet e lejuara dhe të shenjëzuara për parkim individual të mjetit motorik në pjesën e caktuar të rrugës apo të hapësirës publike. Hapësirat për parkim publik janë të mjaftueshme dhe funksionale kur komuna arrin të krijoj hapësirë për parkim të sigurt për të gjitha mjeteve motorike të qytetarëve, banorë të komunës përkatëse dhe një numri të llogaritur për mjete motorike të qytetarëve jo banor të komunës përkatëse.

Informatat e prodhuara nga matja e performancës në këtë fushë është i rëndësishëm jo vetëm për komunën, por edhe për sektorin privat dhe palët tjera të interesit. Matja e performancës në këtë fushë është e rëndësishme për planifikimin dhe zhvillimin e shërbimeve komunale në këtë fushë, për sektorin privat dhe palë të tjera të interesit në krijimin e hapësirave të mjaftueshme për parkimin e automjeteve motorike.

Arritjet e komunës përkatëse në fushën e menaxhimit të parkimit publik maten nëpërmjet një rezultati kryesor 11.1.

### Rezultati 11.1 - Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në ofrimin e hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike në mjediset urbane dhe lagjet e urbanizuara. Ofrim i hapësirave të mjaftueshme, goftë në pronën publike apo private, në funksion të shërbimit të parkimit të mjeteve motorike të qytetarëve të komunës përkatëse dhe jo vetëm. Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike

bëhet në përputhje me planin rregullativ urban dhe kapacitetet teknike të hapësirave rrugore dhe hapësirave tjera publike, me kusht që të mos pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve dhe qarkullimi i lirë i automjeteve në trafik. Kur këto hapësira i plotësojnë kushtet teknike dhe janë në përputhje me dokumentet zyrtare të planifikimit dhe të administrimit, komuna lëshon leje të punës për personat e autorizuar për menaxhimin e hapësirave për parkim të mjeteve motorike dhe po ashtu mbanë regjistrat e kapaciteteve të tyre dhe në të njëjtën kohë organizon monitorim për kapacitetet dhe shkallën e funksionalitetit të tyre.

Hapësirat për parkim të mjeteve motorike janë pjesë e sistemit rrugor dhe ndikojnë në cilësinë e infrastrukturës rrugore duke e zgjidhur problemin e ndaljes dhe qëndrimit të mjeteve motorike në pjesët e caktuara të hapësirave publike të dedikuara për veprimtari të ndryshme të qytetarëve. Numri i mjaftueshëm i vend-parkingjeve ndihmon në shkarkimin e trotuareve dhe pjesëve të caktuara të rrugëve nga parkimi i paligjshëm dhe ndikon në lirin e tyre për lëvizje dhe qarkullim të lirë të qytetarëve dhe mjeteve motorike, në veçanti për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit. Me rritjen e numrit të banorëve dhe automjeteve, sfidë e madhe e paraqitet sigurimi i hapësirave të mjaftueshme dhe të sigurta për parkim të mjeteve motorike. Komuna është e obliguar që t'i pajis parkingjet dhe vend-parkingjet me shenjzime horizontale dhe vertikale dhe të kërkojë mekanizma të sigurisë (roje fizike apo kamera të sigurisë) nga menaxherët e hapësirave për parkim.

Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është i lidhur me efikasitetin e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse. Rezultati ndihmon komunën përkatëse për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen. Arritja e këtij rezultati do të thotë, trafik më të qetë, më të sigurt dhe më të lehtë të qytetarëve në veprimtari të ndryshme dhe të përditshme të tyre.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e katër treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### **Treguesi 11.1.1 - Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në krijimin dhe licencimin e numrit të parkingjeve formale dhe të shenjzuara për parkimin e mjeteve motorike në nivel të komunës.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi jep informata lidhur me atë se sa parkingje për mjete motorike janë ndërtuar dhe të pajisur me leje të punës në territorin e komunës përkatëse, duke përfshirë të gjitha llojet e parkingjeve publike dhe private. Kur themi numri i parkingjeve nënkuptojmë parkingjet për shfrytëzim publik që i plotësojnë kushtet teknike dhe fizike për parkim të mjeteve motorike në përputhje me lejet e punës së tyre të lëshuar nga komuna (Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor<sup>47</sup>, kapitullin I neni 2, pika 2.7).

<sup>47</sup>Ligji NR. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor

## Sqarime të hollësishme

Parkingje numërohen të gjitha ato hapësira të cilat i plotësojnë kushte teknike, si: sipërfaqja e shtruar si pjesë e sistemit rrugor, hyrje daljet e rregulluara dhe të shenjzuara, përcaktimi i vendeve individuale të parkimit të automjeteve me vija të bardha, tabela orientuese për parkim, të pajisur me roje fizike apo kamera të sigurisë dhe që janë të pajisura me leje të punës për ofrim të shërbimit publik të parkimit të mjeteve motorike.

Treguesi matë me vështirësi numrin e plotë të parkingjeve, sepse një numër i hapësirave që përdoren për parkim të mjeteve motorike nuk janë në regjistrat e komunës përkatëse, po ashtu një numër i tyre është në pronësi private dhe nuk hyjnë në matje të performancës së komunës. Për këtë qëllim komuna obligohet që t'i regjistrojë të gjitha veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve për parkim publik të mjeteve motorike dhe të raportojë për numrin e plotë të parkingjeve në komunën përkatëse. Secila veprimtari e cila është me interes të publikut, duhet të shënohet në regjistrat e komunës. Me që vlera e këtij treguesi është numër, kjo krijon probleme në procesin e matjes. Problemi kryesor është baza e ndryshme krahasuese ndërmjet komunave të mëdha dhe atyre të vogla. Për këtë qëllim, matja e këtij treguesi duhet të bëhet duke i krahasuar komunat e të njëjtit grup, që do të thotë se komunat grupohen sipas karakteristikave të ngjashme në disa grupe. Po ashtu numri, si njësi matëse e këtij treguesi, paraqet problem edhe në krahasimin e tij me treguesit tjerë të fushave tjera. Si i tillë ky tregues matë në mënyrë individuale.

Në aspektin e performancës komunale, sigurimi i parkingjeve të mjaftueshme është kompetencë komunale të cilën komuna e ushtron përmes politikave dhe planeve, qoftë në krijimin e hapësirave përkatëse për parking nëpërmjet dhënies së lejeve dhe koncesioneve për parkingje publike të operuara nga ndërmarrje private. Përbushja e këtij treguesi ndikon në përbushjen e treguesve tjerë të këtij rezultati. Qëllimi përfundimtar i komunës në aspektin politik dhe përmirësimit të performancës është rregullimi, sigurimi dhe lehtësimi i trafikut, nëpërmjet lirit të trotuareve dhe i pjesëve të rrugëve nga parkimi kundërligjor i mjeteve motorike.

## Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përbushet në mënyrë përmbljedhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbljedhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej numri i përgjithshëm i parkingjeve të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përbushjen e treguesit mblidhet vetëm një e dhënë:

1. numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunë përkatëse

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga njësia përkatëse e komunës për infrastrukturë rrugore në përputhje me dokumentin zyrtar komunal për parkingjet publike (Ligji NR. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor). Verifikimi i të dhënave bëhet nga regjistrat zyrtar të lejeve të lëshuara për ofrimin e shërbimit të parkimit publik të mjeteve motorike në komunën përkatëse, të

kontratave koncensionale të komunës me partnerët privat dhe të raporteve monitoruese të parkingjeve publike.

## Treguesi 11.1.2 - Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në krijimin e numrit të mjaftueshëm të vend-parkimeve për parkim individual të mjeteve motorike në nivel të komunës.

### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e përgjithshëm të vend-parkimeve për parkim individual të mjeteve motorike në territorin e komunës përkatëse, duke përfshirë të gjitha vendparkimet në parkingje dhe jashtë parkingjeve, në pjesë të ndryshme të rrugëve dhe të hapësirave pranë rrugëve të lejuara për parkim. Kur themi numri i vendparkimeve nënkuptojmë të gjitha vendet formale apo të lejuara nga organet përgjegjëse të komunës për parkim individual të mjeteve motorike (Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor<sup>48</sup>, kapitullin I, neni 2, pika 2.7). Vendparkime numërohen të gjitha ato hapësira të cilat i plotësojnë kushtet teknike, si: sipërfaqja e shtruar si pjesë e sistemit rrugor dhe e shenjzuar horizontalisht dhe vertikalisht për parkim individual të mjeteve motorike.

### Sqarime të hollësishme

Treguesi synon të matë shkallën e plotësimi të nevojave të qytetarëve për parkim të mjeteve motorike, kur komuna përkatëse i ka të njohura kërkesat apo nevojat në bazë të numrit të mjeteve motorike të regjistruara në komunën përkatëse. Informatat e prodhuara ndihmojnë shumë për të gjitha palët e interesit në veçanti të komunës dhe ministrisë së linjës për prioritizimin e politikave në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për zgjidhjen e problemit të parkimit publik, që është mjaftë i theksuar në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Përmbushja e këtij treguesi ndikon në përmbushjen e treguesve tjerë të këtij rezultati. Qëllimi përfundimtar i komunës në aspektin politik dhe përmirësimit të performancës është rregullimi, sigurimi dhe lehtësimi i trafikut, nëpërmjet liritimit të trotuareve dhe i pjesëve të rrugëve nga parkimi kundërligjor i mjeteve motorike.

Treguesi matë me vështirësi numrin e plotë të vend-parkingjeve, sepse një numër i hapësirave që përdoren për parkim të mjeteve motorike nuk janë në regjistrat e komunës përkatëse dhe nuk hyjnë në matje të performancës së komunës përkatëse. Për këtë qëllim komuna obligohet që t'i regjistrojë të gjitha veprimtaritë e ofrimit të shërbimeve për parkim publik të mjeteve motorike dhe të raportojë për numrin e plotë të vend-parkimeve në komunën përkatëse. Secila veprimtari e cila është me interes të publikut, duhet të shënohet në regjistrat e komunës.

### Kategoria

<sup>48</sup>Ligji NR. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej numri i vend-parkimeve të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhet vetëm një e dhënë:

1. Numri i vend-parkimeve publike në komunën përkatëse
2. Numri i veturave që kanë regjistrim të vlefshëm në vitin e raportimit

### Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 1}{e \text{ dhëna } 2} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga njësia përkatëse e komunës për infrastrukturë rrugore në përputhje me dokumentin zyrtar komunal për parkingjet publike (Ligji NR. 02/L-70 Sigurinë në Komunikacionin Rrugor). Verifikimi i të dhënave bëhet nga regjistrat zyrtar të lejeve të lëshuara për ofrimin e shërbimit të parkimit publik të mjeteve motorike në komunën përkatëse, të kontratave koncensionale të komunës me partnerët privat, të regjistrave zyrtar për numrin e mjeteve motorike të regjistruara dhe të raporteve monitoruese të parkingjeve publike.

## Treguesi 11.1.3 - Vendparkimet e destinuar për taks

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në shkallën e përmbushjes së nevojave të veprimtarisë së mjeteve motorike të regjistruara si taks (taxi).

### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e përgjithshëm të vend-parkimeve të destinuar për taks në raport me numrin e mjeteve motorike të regjistruara dhe të licencuara për këtë veprimtari në komunën përkatëse. Kur themi përqindja e vend-parkimeve të destinuar për taks, nënkuptojmë numrin e përgjithshëm të vend-parkimeve të lejuara nga organet përgjegjëse të komunës vetëm për parkim të automjeteve të regjistruara si taks, nga numri i përgjithshëm i vend parkimeve në komunën përkatëse, në raport me numrin e përgjithshëm të taksive të licencuara nga komuna përkatëse.

### Sqarime të hollësishme

Informatat e prodhuara ndihmojnë shumë për lehtësimin e punës së qytetarëve të cilët ushtrojnë veprimtarinë e transportit publik apo të taksisë. Përcaktimi formal i numrit të vend-parkimeve që shfrytëzohen për taks është me rëndësi të madhe për të gjithë ata të cilët e ushtrojnë këtë veprimtari dhe



për komunën përkatëse për të kuptuar shkallën e përmbushjes së kërkesave bazuar në numrin e mjeteve motorike të regjistruara si taksi në komunë. Treguesi matë mjaftë saktë dhe në mënyrë të integruar me treguesit tjerë, duke e plotësuar njëri tjetrin në arritjen e rezultatit 10.1.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet gjithsej numri i vend-parkimeve të ndërtuara gjatë të gjitha viteve.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i mjeteve motorike të regjistruara dhe licencuara si taksi në komunë
2. Numri i vend-parkimeve formale të destinuara vetëm për taksi

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga njësia përkatëse e komunës për infrastrukturë rrugore në përputhje me dokumentin zyrtar komunal për parkingjet publike (Ligji NR. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor). Verifikimi i të dhënave bëhet nga regjistrat zyrtar të lejeve të lëshuara për ofrimin e shërbimit të parkimit publik të mjeteve motorike në komunën përkatëse, të kontratave koncensionale të komunës me partnerët privat dhe të raporteve monitoruese të parkingjeve publike, si dhe të regjistrave të mjeteve motorike që kanë regjistrim të vlefshëm për vitin e raportimit.

## Treguesi 11.1.4 - Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me nevoja të veçanta

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në shkallën e përmbushjes së nevojave të personave me nevoja të veçanta për parkim publik.

### Çfarë matet?

Kur themi përqindja e parkingjeve me vend-parkime të rezervuara për persona me nevoja të veçanta, nënkuptojmë numrin e përgjithshëm të parkingjeve të cilat i plotësojnë kushtet teknike të veçanta, të shenjzuara dhe të licencuara, për parkim të mjeteve motorike të personave me aftësi të kufizuar. Komuna është e obliguar që të rezervojë vend-parkime të veçanta në parkingjet publike për mjetet motorike të personave me aftësi të kufizuar në bazë të regjistrimit të këtyre mjeteve motorike të veçanta.

## Sqarimet të hollësishme

Informatat e prodhuara ndihmojnë shumë personat me nevoja të veçanta për qasje më të lehtë në trafik dhe në veprimtarinë e tyre të ndryshme. Po ashtu ndihmojnë komunën dhe palët e ndryshme të interesit në ofrimin e përkrahjes së këtyre personave në shkallën e mjaftueshme. Treguesi matë mjaftë saktë numrin e parkingjeve publike të cilat kanë të rezervuar vend-parkim për mjetet motorike të personave me aftësi të kufizuar, por nuk matë numrin e vend-parkimeve apo kapacitetin e parkingjeve publike për parkim të mjeteve motorike të personave me aftësi të kufizuar. Mbase në të ardhmen duhet të zhvillohet treguesi më tej dhe në përputhje me kapacitetet e komunës në ofrimin e këtij shërbimi të matet edhe ky këndvështrim i treguesit.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit (ndikimit) dhe përmbushet në mënyrë përmblendhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmblendhëse apo komulative, përkatësisht raportohet numri i përgjithshëm i parkingjeve me vend-parkime për persona me aftësi të kufizuar, për të gjitha vitet.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i parkingjeve publike
2. Numri i parkingjeve me vend-parkime të rezervuara për persona me nevoja të veçanta

## Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 100$$

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga njësia përkatëse e komunës për infrastrukturë rrugore në përputhje me dokumentin zyrtar komunal për parkingjet publike (Ligji NR. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor). Verifikimi i të dhënave bëhet nga regjistrat zyrtar të lejeve të lëshuara për ofrimin e shërbimit të parkimit publik të mjeteve motorike në komunën përkatëse, të kontratave koncensionale të komunës me partnerët privat, të raporteve monitoruese të parkingjeve publike, si dhe të regjistrave të mjeteve motorike që kanë regjistrim të vlefshëm të veçantë për persona me aftësi të kufizuar për vitin e raportimit.

## FUSHA 12 - UJË I PIJSHËM

Emërtimi i fushës është: “Furnizimi me ujë të pijshëm”. Ujë është elementi bazë i jetës, i zhvillimit ekonomik dhe i mirëqenies së njeriut. Sigurimi apo furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm është shërbimi më themelor që komuna përkatëse është e obliguar ta ofroj. Në bazë të gjitha analizave të bëra, territori i Republikës së Kosovës është i varfër me burime dhe kapacitete të ujit (Plani Hapësinor i Kosovës). Me shtimin e popullsisë dhe me shkatërrimin e pyjeve kapacitetet rezerve të ujët vazhdimisht janë duke u zvogëluar apo më mirë me thanë kemi tepër kur nuk na duhet (gjatë dimrit) dhe kemi shumë pak kur na duhet (gjatë verës). E gjithë kjo e bënë këtë fushë shumë prioritare për komunën dhe matja e performancës së saj gjithashtu është me rëndësi shumë të madhe për të kuptuar shkallën e përmbushjes së obligimeve të komunës përballë kërkesave shumë të mëdha të qytetarëve për ujë të pijshëm dhe sanitar.

Furnizimi me ujë të pijshëm përfshinë sigurimin e burimeve të nevojshme të ujit, ndërtimin e sistemit të ujësjellësit dhe përfshirja e të gjitha vendbanimeve dhe ekonomive familjare dhe biznesore në sistem. Ujë është pasuri shtetërore dhe menaxhohet vetëm nga institucionet shtetërore apo publike.

Uji si elementi themelor i përbërjes së organizmit të njeriut, cilësia e tij, ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e qytetarëve. Informatat e prodhuara nga matja e performancës në këtë fushë është i rëndësishëm jo vetëm për komunën, por edhe për sektorin privat dhe palët tjera të interesit. Matja e performancës në këtë fushë është e rëndësishme për planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga komuna në këtë fushë, për MMPH, sektorin privat dhe palë të tjera të interesit.

Arritjet e komunës përkatëse në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm maten nëpërmjet një rezultati kryesor 12.1.

### Rezultati 12.1 - Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në përfshirjen e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujësjellësit apo ujit të pijshëm. Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm do të thotë ndërtimi i ujësjellësit prej burimit të ujit të pijshëm e deri te secili vendbanim dhe secila ekonomi familjare apo biznesore. Ndërtimi i kapaciteteve për përfshirjen e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm bëhet në përputhje me planin rregullativ urban dhe kapaciteteve ujore dhe financiare të komunës apo të institucioneve qendrore. Kur komuna e ndërton sistemin e ujësjellësit në përputhje me planet përkatëse, ajo u mundëson të gjitha ekonomive familjare dhe biznesore lidhjen në ujësjellës nëpërmjet një njehsori për matjen e shpenzimit të ujit, i cili regjistrohet në kompaninë përkatëse publike për furnizim me ujë të pijshëm.

Përfshirja e qytetarëve në sistem për furnizim me ujë të pijshëm përfaqëson hallkën përfundimtare dhe më themelore të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Në këtë rezultat nuk hynë matja e performancës së komunës përkatëse për sasinë dhe cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit apo përfshirja sa më e madhe e qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm, zvogëlon mundësinë e rrezikimit

të shëndetit të qytetarëve nga ujë i papastër i burimeve të pakontrolluara dhe të pa trajtuara kimikisht. Me rritjen e numrit të banorëve dhe zvogëlimi i kapaciteteve ujore në territorin e komunave, sfida e madhe paraqitet sigurimi përfshirjes së të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm. Megjithatë komuna është e obliguar që të sigurojë burime të mjaftueshme të ujit dhe të ndaj mjete financiare për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit dhe përfshirjen secilës ekonomi familjare dhe biznesore në sistem, si kusht themelor për jetë, zhvillim ekonomik dhe mirëqenie.

Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është i lidhur me efikasitetin e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse. Rezultati ndihmon komunën përkatëse për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen në arritjen e këtij rezultati. Arritja e këtij rezultati do të thotë: përfshirje e të gjithë qytetarëve në sistemin për furnizim me ujë të pijshëm, sjellja e burimit të ujit në secilën shtëpi apo objekt biznesi, lehtësim dhe ekonomizim i shfrytëzimit të ujit për qëllime të ndryshme të veprimtarisë së qytetarëve.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e dy treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### **Treguesi 12.1.1 - Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në realizimin e projekteve të planifikuara për ndërtimin apo zgjerimin rrjetit të ri të sistemit të ujësjellësit dhe të renovimit apo mirëmbajtjes të sistemit ekzistues të ujësjellësit.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi jep informata për llojet e projekteve apo veprimeve të planifikuara dhe shkallën e realizimit të tyre në sistemin e ujësjellësit. Realizimi i planit nënkupton numrin e llojeve të punëve të përfunduara në raport me punët e planifikuara për vitin përkatës të raportimit.

#### **Sqarime të hollësishme**

Nga pikëpamja e performancës komunale, zbatimi i projekteve apo i punëve në rrjetin e ujësjellësit është në kompetencë të komunës përkatëse dhe të kompanive publike rajonale. Komunitat dhe kompanitë publike rajonale për menaxhimin e sistemit të ujit të pijshëm janë të obliguara që të sigurojnë burime të nevojshme për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit në territorin e komunës apo të komunave përkatëse.

#### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas planit në vitin përkatës kalendarik. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës fiskal dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i projekteve apo punë të planifikuara për rrjetin e ujësjellësit në vitin përkatës të raportimit
2. Numri i projekte apo punë të realizuara për vitin e raportimit në rrjetin e ujësjellësit

### Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga kompanitë përkatëse publike për menaxhimin e ujësjellësit në përputhje me planin vjetor të komunës dhe kompanisë publike për investimeve në rrjetin e ujësjellësit. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e kontratave për punët e kontraktuara në rrjetin e ujësjellësit dhe raportet zyrtare dhe të protokolluara për realizimin e punëve.

## Treguesi 12.1.2 - Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në përfshirjen e të gjitha ekonomive familjare, institucioneve dhe njësive biznesore në sistemin e ujit të pijshëm.

### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare, ekzistuese dhe të reja, numrin e përgjithshëm të institucioneve publike (institucione komunale, të dekoncentruar qendrore, qendrore, arsimore, shëndetësore, të kulturës, rinisë dhe sportive) dhe numrin e përgjithshëm të bizneseve (duke përfshirë këtu edhe veprimtaritë tjera të ngjashme) të përfshira në sistemin e ujësjellësit. Përfshirja nënkupton ndërtimin e sistemit të ujësjellësit prej pikës së furnizimit të vendbanimit përkatës deri tek ujëmatësi i secilës ekonomi përkatëse (familjare, publike, biznesore etj.). Përfshirja nënkupton edhe furnizimin e rregullt me ujë dhe jo vetëm shtrirjen e sistemit të ujësjellësit dhe kyçjen e ekonomive në te. Përmbushja e këtij treguesi përfshinë implikime buxhetore, sepse edhe pse ekonomitë shfrytëzuese të ujit të pijshëm, vetë i bartin shpenzimet për lidhjen e tyre me sistemin e ujësjellësit, zgjerimi i rrjetit të ujit ka implikime buxhetore.

### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë relativisht saktë performancën e komunës në këtë këndvështrim, edhe pse një numër i ekonomive të reja, mund të mos përfshihen në raportim të këtij treguesi. Për këtë qëllim komuna ose kompania përkatëse publike për menaxhimin e ujit të pijshëm obligohet që t'i regjistrojë të gjitha ekonomitë që furnizohen me ujë të pijshëm në komunën përkatëse, sepse me lëvizjen e popullatës statusi i ekonomisë familjare dhe publike apo biznese po ndryshon, gjë që sjellë edhe ndryshimin e numrit të tyre.

Në aspektin e performancës komunale, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit apo shkalla e përfshirjes së ekonomive përkatëse në sistemin e ujit të pijshëm është kompetencë e komunës, por në të njëjtën kohë kjo kompetencë në përgjithësi iu është bartur kompanive publike rajonale. Komunitat tërthorazi, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, marrin pjesë në menaxhimin e tyre së bashku me komunitat tjera që bëjnë pjesë në rajonin përkatës. Problemi është se këto kompani veprojnë në përputhje me Ligjin për kompanitë publike dhe sillen jo në përputhje të plotë me kërkesat e komunave përkatëse. Kjo po e zbehtë përgjegjësinë e komunave dhe adresimin e saktë të problemeve në ofrimin e këtij shërbimi themelor për qytetarët. Presim që në të ardhmen të bëhen përmirësimet përkatëse të Ligjit për kompanitë publike dhe të përcaktohen më qartë të drejtat dhe detyrimet e komunës, përballë këtij problemi.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet numri i përgjithshëm i ekonomive të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm, i realizuar për të gjitha vitet.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen tri lloje të të dhënave:

1. Numri i ekonomive familjare në komunë
2. Numri i familjare të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm
3. Numri i institucioneve publike në komunë
4. Numri i institucioneve publike të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm
5. Numri i ekonomive biznese e të ngjashme në komunë
6. Numri i ekonomive biznese (e të ngjashme) të përfshirë në sistemin e ujit të pijshëm

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\left[ \left( \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} \right) + \left( \frac{\text{e dhëna 4}}{\text{e dhëna 3}} \right) + \left( \frac{\text{e dhëna 6}}{\text{e dhëna 5}} \right) \right]}{3} * 100$$

Shuma e përqindjeve nga tri formulat na jep mesataren e përqindjes së përgjithshme të përfshirjes së ekonomive përkatëse në sistemin e ujit të pijshëm.

### **Burimi i të dhënave**

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike, drejtoria e urbanizmit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Qendra për regjistrimin e bizneseve dhe nga kompanitë përkatëse publike për menaxhimin e ujësjellësit. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e kontratave për punët e kontraktuara në rrjetin e ujësjellësit dhe raportet zyrtare dhe të protokolluara për realizimin e punëve.

### FUSHA 13 - KANALIZIMI

Emërtimi i fushës është: “Kanalizimi”. Ujë i pijshëm dhe ujë sanitar, pas përdorimit, mbledhin produktet e panevojshme të njeriut dhe i derdhen në sistemin e kanalizimit. Kanalizimi është i lidhur ngushtë me ujësjellësin, ujësjellësi i dërgon ujë të pastër secilës ekonomi shfrytëzuese, ndërsa kanalizimi e mbledhë ujin e ndotur dhe e largon atë nga vendbanimi duke siguruar higjienën publike. Në shumicën e vendeve të botës ujë i kanalizimit, i ndotur (ujërat e zeza), në fund të derdhjes së tij trajtohen apo pastrohen nga impiantet apo fabrikat e pastrimit të ujërave të zeza dhe nga ujërat e zeza fitohet prapë ujë i pijshëm i cili kalon në sistemin e ujësjellësit. Në këtë mënyrë krijohet një cikël i qarkullimit të ujit të pastër dhe të papastër dhe racionalizohet në maksimum përdorimi i ujit. Në këtë fazë të zhvillimit në vendin tonë nuk ka mjete të mjaftueshme buxhetore për trajtimin e ujërave të zeza dhe ato derdhen në rrjedha të lumenjve duke i ndotur ata. Kjo nuk është zgjidhja e duhur. Trajtimi i ujërave të zeza dhe i ujit industrial do të kishte dy efekte të mëdha pozitive: gjenerimin e kapaciteteve të ujët të pijshëm dhe mbrojtjen e lumenjve dhe të tokës nga ndotja. E gjithë kjo e bënë këtë fushë shumë prioritare për komunën dhe matja e performancës së saj gjithashtu është me rëndësi shumë të madhe për të kuptuar shkallën e përmbushjes së obligimeve të komunës përballë kërkesave shumë të mëdha të qytetarëve për largimin e ujërave të zeza (ndotura) nga mjedisi jetësor i qytetarëve, që në shumë vendbanime është bërë burim i sëmundjeve infektive dhe erërave kundërmuese, duke krijuar një jetë të padurueshme për qytetarët.

Kanalizimi përfshinë tërë rrjetin e kanaleve për mbledhjen e ujërave të zeza dhe të ujërave atmosferik, të cilat shtrihen nga secila ekonomi familjare, institucionale dhe biznesore, përgjatë sistemit të ujësjellësit dhe kryesisht përgjatë rrugëve të vendbanimeve përkatëse në një thellësi që nuk e pengojnë komunikacionin e deri te vendi i derdhjes. Për mbledhjen e ujërave atmosferikë nuk është zhvilluar tregues i veçantë ngase është i pamatshëm në të gjitha komunat, por në ato komuna ku ekziston raportohet së bashku me kanalizimin për mbledhjen e ujërave të zeza. Kjo fushë përfshinë konkretisht angazhimet e komunës dhe të kompanive përkatëse për menaxhimin e ujërave të zeza në ndërtimin e sistemit të kanalizimit, përfshirjen e të gjitha vendbanimeve dhe ekonomive familjare dhe biznesore në sistem, kontrollimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshëm të sistemit të kanalizimit nga mbyllja dhe rrjedhja e tij jashtë, përcaktimin e tarifës për pagimin e shërbimit me mbledhjen e ujërave të zeza dhe shlyerjen e obligimeve nga qytetarët të cilët janë shfrytëzues të sistemit kanalizimit. Ky është një shërbim shumë themelor dhe me ndikim të drejtpërdrejt në shëndetin e qytetarëve. Një numër i madh i vendbanimeve ende nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimit, duke i derdhur ujërat e zeza në sipërfaqet e tokës apo edhe në thellësinë e saj apo në gropat septike. Përfshirja e të gjitha ekonomive familjare dhe biznesore është prioritet për qytetarët, duke parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive.

Informatat e prodhuara nga matja e performancës në këtë fushë është i rëndësishëm jo vetëm për komunën (Ligji për vetëqeverisje lokale, nenin 17), por edhe për sektorin privat dhe palët tjera të interesit. Matja e performancës në këtë fushë është e rëndësishme për planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga komuna në këtë fushë, për MMPH, sektorin privat dhe palë të tjera të interesit.



Arritjet e komunës përkatëse në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm maten nëpërmjet tre rezultateve kryesore 13.1; 13.2.

### Rezultati 13.1 - Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në përfshirjen e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit. Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit do të thotë ndërtimi i kanaleve për mbledhjen e ujërave të zeza të secilës ekonomi përkatëse e deri te pika e derdhjes në lumë, gropë septike apo në impiant për trajtim të ujërave të zeza. Ndërtimi i kapaciteteve për përfshirjen e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit bëhet në përputhje me planin rregullativ urban dhe kapaciteteve financiare të komunës, kompanisë publike përkatëse dhe të institucioneve qendrore. Matja e performancës së komunës përkatëse në arritjen e këtij rezultati është e bazuar vetëm në lidhjen e ekonomisë përkatëse shfrytëzuese në sistem.

Përfshirja e qytetarëve në sistem të kanalizimit përfaqëson hallkën fillestare dhe themelore të ofrimit të shërbimit për këtë fushë. Zgjerimi i rrjetit të sistemit të kanalizimit apo përfshirja sa më e madhe e qytetarëve në sistem, zvogëlon mundësinë e rrezikimit të shëndetit të qytetarëve nga ujë i ndotur i prodhuar nga veprimtaritë e ndryshme jetësore të qytetarëve. Pra arritja e këtij rezultati ndikon drejtpërdrejtë në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve nga sëmundjet e ndryshme infektive. Me rritjen e numrit të banorëve dhe furnizimit jo të qëndrueshëm me ujë, në veçanti me sasi të pamjaftueshme, po rrisin mundësinë e përhapjes së sëmundjeve infektive dhe në të njëjtën kohë po e rrisin sfidën për organet kompetente të pushtetit lokal për ofrimin me cilësi të këtij shërbimi. Megjithatë komuna është e obliguar të ndaj mjete financiare për ndërtimin e sistemit të kanalizimit dhe përfshirjen secilës ekonomi familjare dhe biznesore në sistem, si kusht themelor për jetë të shëndetshme, zhvillim dhe mirëqenie.

Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është i lidhur me efikasitetin e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse. Rezultati ndihmon komunën përkatëse për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen në arritjen e këtij rezultati. Arritja e këtij rezultati do të thotë: përfshirje e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit, derdhjen e ujërave të zeza dhe atmosferike në pikat e caktuara shumë larg vendbanimeve, në rastin më të mirë trajtimi i tyre dhe largimin e shkaqeve për shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme infektive për qytetarët. Komponenti më e rrezikshëm për shëndetin e njeriut dhe ndotjen e mjedisit jetësor, është ndotja me detergjente të cilat janë të pazbërthyeshme biologjikisht dhe kimikisht.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e dy treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në realizimin e projekteve të planifikuara për ndërtimin apo zgjerimin rrjetit të ri të sistemit të kanalizimit dhe të renovimit apo mirëmbajtjes të sistemit ekzistues të kanalizimit.

### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për llojet e projekteve apo veprimeve të planifikuara dhe shkallën e realizimit të tyre në sistemin e kanalizimit. Realizimi i planit nënkupton numrin e llojeve të punëve të përfunduara në raport me punët e planifikuara për vitin përkatës të raportimit.

### Sqarime të hollësishme

Nga pikëpamja e performancës komunale, zbatimi i projekteve apo i punëve në rrjetin e kanalizimit është në kompetencë të komunës përkatëse dhe të kompanive publike rajonale. Komunitat dhe kompanitë publike rajonale për menaxhimin e sistemit të kanalizimit janë të obliguara që të sigurojnë burime të nevojshme për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit në territorin e komunës apo të komunave përkatëse.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas planit në vitin përkatës kalendarik. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i projekteve apo punë të planifikuara për rrjetin e kanalizimit në vitin përkatës të raportimit
2. Numri i projekteve apo punë të realizuara për vitin e raportimit në rrjetin e kanalizimit

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga kompanitë përkatëse publike për menaxhimin e ujësjellësit. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e kontratave për punët e kontraktuara në rrjetin e kanalizimit dhe raportet zyrtare dhe të protokolluara për realizimin e punëve.

## Treguesi 13.1.2 - Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në përfshirjen e të gjitha ekonomive familjare, institucioneve publike dhe njësive biznesore në sistemin e kanalizimit.

### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare, ekzistuese dhe të reja, numrin e përgjithshëm të institucioneve publike (institucione komunale, të dekoncentruar qendrore, qendrore, arsimore, shëndetësore, të kulturës, rinisë dhe sporteve) dhe numrin e përgjithshëm të bizneseve (duke përfshirë këtu edhe veprimtaritë tjera të ngjashme) të përfshira në sistemin e kanalizimit. Përfshirja nënkupton ndërtimin e sistemit të kanalizimit prej secilit vendbanim – ekonomi përkatëse shfrytëzuese e kanalizimit tek pika e derdhjes apo e trajtimit të ujërave të zeza dhe atmosferike larg vendbanimit përkatës.

### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë relativisht saktë performancën e komunës në këtë këndvështrim sepse realisht treguesi nuk ka mundësi ta faktojë numrin e ekonomive shfrytëzuese të kanalizimit të lidhura në sistem, për faktin se nuk shënohet me asnjë dokument dhe me asnjë mjetë matës kjo lidhje apo shfrytëzim i kanalizimit nga ekonomia përkatëse. Po ashtu një numër i ekonomive të reja, mund të mos përfshihen në raportim të këtij treguesi. Për lidhjen e ekonomisë shfrytëzuese të kanalizimit nuk kërkohet asnjë dokument e as ndonjë mjetë tjetër që e matë derdhjen e ujërave të zeza nga ekonomia përkatëse në sistemin e kanalizimit në vendbanimin përkatës.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative, përkatësisht raportohet numri i përgjithshëm i ekonomive të përfshira në sistemin e kanalizimit, i realizuar për të gjitha vitet.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen gjashtë lloje të të dhënave:

1. Numri i ekonomive familjare në komunë
2. Numri i familjare të përfshira në sistemin e kanalizimit
3. Numri i institucioneve publike në komunë
4. Numri i institucioneve publike të përfshira në sistemin e kanalizimit
5. Numri i ekonomive biznesore e të ngjashme në komunë
6. Numri i ekonomive biznesore (e të ngjashme) të përfshirë në sistemin e kanalizimit

### Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{\left[ \frac{(e\ dhëna\ 2)}{(e\ dhëna\ 1)} + \frac{(e\ dhëna\ 4)}{(e\ dhëna\ 3)} + \frac{(e\ dhëna\ 6)}{(e\ dhëna\ 5)} \right]}{3} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbledhen nga drejtoria e shërbimeve publike, drejtoria e urbanizmit dhe nga kompanitë përkatëse publike për menaxhimin e ujësjellësit. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e dokumenteve zyrtare për numrin e vendbanimeve të përfshira në sistemin e kanalizimit, sepse nuk ka dokumente zyrtare për verifikimin e lidhjes apo të përfshirjes së ekonomive përkatëse shfrytëzuese të kanalizimit në sistem.

### Rezultati 13.2 - Trajtimi i ujërave të zeza

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në përfshirjen e vendbanimeve në rrjetin e sistemit të kanalizimit për trajtimin e ujërave të zeza apo në procesin e përpunimit dhe pastrimit në fabrikat përkatëse apo impiante. Trajtimi i ujërave të zeza do të thotë kalimi i ujërave të zeza nëpër një numër të filtrave fizikë, biologjikë dhe kimikë në fabrikën për pastrimin e ujërave të zeza apo impiante dhe prodhimi i ujit të pastër biologjikisht dhe kimikisht para se të derdhet në lumenj apo të shfrytëzohet për qëllime të tjera në ekonominë familjare, institucionale apo biznesore. Ndërtimi i kapaciteteve për përfshirjen e të gjithë vendbanimeve në trajtimin e ujërave të zeza, bëhet në përputhje me kapaciteteve financiare të komunës, kompanisë publike përkatëse dhe të institucioneve qendrore. Matja e performancës së komunës përkatëse në arritjen e këtij rezultati është e bazuar në numrin e vendbanimeve, ujërat e zeza të cilave trajtohen apo pastrohen nga fabrikat përkatëse para derdhjes në lumenj ose të rishfrytëzimit për qëllimet paraprake të ndryshme, e edhe për pije.

Trajtimi i ujërave të zeza është arritja apo rezultati qendror dhe thelbësor i kësaj fushe. Përfshirja sa më e madhe e vendbanimeve në trajtimin e ujërave të zeza të tyre, zvogëlon mundësinë e rrezikimit të shëndetit të qytetarëve nga ujë i ndotur i prodhuar nga veprimtaritë e ndryshme jetësore të qytetarëve, në veçanti ujë i ndotur nga materiet jo të zbërthyeshme si detergjentet. Pra arritja e këtij rezultati ndikon drejtpërdrejtë në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve nga sëmundjet e ndryshme dhe nga ndotja e lumenjve dhe e mjedisit jetësor. Populli thotë: *“Çka të hedhësh në deti, e gjen në sofër”*

Ky rezultat do të arrihet shkallë-shkallë, gjatë viteve të ardhshme, sepse aktualisht kapacitetet e komunave janë në fazën fillestare, por të matshme. Duke pasur parasysh se përfaqëson një rezultat shumë themelor për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe të mjedisit jetësor nga ndotja, komuna është e obliguar të ndaj mjete financiare për ndërtimin e fabrikave (impianteve) për pastrimin apo trajtimin e ujërave të zeza të prodhuara nga vendbanimet e komunës përkatëse apo të komunave përkatëse, sepse trajtimi i ujërave të zeza mund të bëhet me investime të përbashkëta të më shumë komunave.

Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është i lidhur me efikasitetin e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse apo e dhe të disa komunave fqinje. Rezultati ndihmon komunën

përkatëse për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen në arritjen e këtij rezultati. Arritja e këtij rezultati do të thotë: përfshirje e gjithë sistemit të kanalizimit në trajtimin e ujërave të zeza dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit të qytetarëve si dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor nga ndotja.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e një treguesi kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### Treguesi 13.2.1 - Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtim të ujërave të zeza

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në trajtimin e ujërave të zeza nga të gjitha vendbanimet e territorit të saj.

#### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e vendbanimeve, ujërat e zeza të cilave përfshihen në procesin e trajtimit apo të pastrimit nga fabrikat përkatëse të pastrimit të ujërave të ndotura të prodhuara nga ekonomitë familjare, institucionale, industriale dhe biznesore.

Treguesi matë performancën e komunave në përmbushjen e këtij shërbimi për qytetarët, që ka filluar në disa komuna të vendit. Treguesi matë saktë performancën e komunave për këtë shërbim, sepse është lehtë e dokumentueshme se sa vendbanime janë të përfshira në trajtimin e ujërave të zeza. Mund të ndodhë që rrjete të caktuara të kanalizimit në territorin e komunës përkatëse, për shkaqe të pozitës gjeografike të mos përfshihen në trajtimin apo pastrimin e ujërave të zeza dhe kështu treguesi nuk na informon apo nuk e matë plotësisht këtë shërbim në kuadër të komunës përkatëse.

#### Sqarime të hollësishme

Në aspektin e performancës komunale, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit apo shkalla e përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e kanalizimit që mundëson trajtimin e ujërave të zeza, është kompetencë e komunës, por në të njëjtën kohë edhe e kompanive publike rajonale. Komunitetët tërthorazi, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, marrin pjesë në menaxhimin e tyre së bashku me komunat tjera që bëjnë pjesë në rajonin përkatës. Ofrimi i këtij shërbimi ka implikime të mëdha buxhetore, andaj komuna përkatëse së bashku me kompaninë përkatëse publike duhet ta prioritetizojnë këtë shërbim, së bashku me sigurimin e fondeve të nevojshme nga të hyrat vetanake, nga qeveria dhe donatorët.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet në mënyrë përmbljedhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbljedhëse apo komulative, përkatësisht raportohet numri i përgjithshëm i vendbanimeve të përfshira në trajtim të ujërave të zeza, i realizuar për të gjitha vitet.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbliidhen dy lloje të të dhënave:

1. numri i përgjithshëm i vendbanimeve në komunën përkatëse
2. numri i vendbanimeve të përfshira në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbliidhen nga drejtoria e shërbimeve publike, drejtoria e urbanizmit dhe nga kompanitë përkatëse publike për menaxhimin e ujësjetllësit (ujërave të zeza). Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e listave zyrtare për vendbanimet e përfshira në sistemin e kanalizimit, ujërat e zeza të të cilave trajtohen apo pastrohen nga impiantet përkatës dhe raportet zyrtare dhe të protokolluara për ofrimin e këtij shërbimi nga drejtoria e shërbimeve publike të komunës përkatëse.

### FUSHA 14 - MBETURINAT

Emërtimi i fushës është: “Menaxhimi i mbeturinave”. Menaxhimi i mbeturinave nënkupton aktivitetet e komunës përkatëse për zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe veprimet përkatëse në grumbullimin dhe deponimin e tyre në vendet dhe mënyrat përkatëse të cilat sigurojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor dhe të shëndetit të njeriut apo të qytetarëve. Menaxhimi i mbeturinave në kuptimin e ngushtë të fjalës nënkupton ndarjen, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe depozimin përfundimtar të mbeturinave, përfshirë monitorimin e vazhdueshëm në respektimin e metodologjive profesionale dhe ligjore në mbledhjen dhe deponimin e tyre. Nëse nuk zbatohen standardet profesionale në menaxhimin e mbeturinave, vendet ku deponohen ilegalisht ato mund të shndërrohen në vatra të rrezikshme për ndotjen e mjedisit dhe dëmtimin e shëndetit të qytetarëve. Komuna ka për obligim që të gjithë qytetarëve të vetë të ju ofroj shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Gjithashtu, komuna ka mandatin ekskluziv për menaxhimin e mbeturinave, caktimin e tarifave, faturimin dhe inkasimin (mbledhjen) e mjeteve për shërbimin e ofruar dhe përkthimin e tyre në investime për zgjerimin e infrastrukturës për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave me qëllim të sigurimit të higjienës publike në territorin e komunës përkatëse (Ligji 03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 17, pika f dhe Ligji Nr. 04/L -060 për Mbeturina, neni 15).

Menaxhimi i mbeturinave përfshinë grumbullimin e të gjitha llojeve të mbeturinave (letër, plastikë, qelq, hekur, dru, hi, tekstil, ushqim etj.), të prodhuara nga ekonomitë familjare, institucionale, komerciale (biznesore), si dhe deponimi i tyre në vendet e përshtatshme dhe sipas udhëzimeve profesionale për këtë qëllim jashtë vendbanimeve. Kjo fushë përfshinë konkretisht angazhimet e komunës dhe të kompanive përkatëse në menaxhimin e procesit të mbledhjes nga të gjitha ekonomitë përkatëse që prodhojnë mbeturina,

klasifikimin e tyre, transportin dhe deponimin e tyre në vendet e veçanta të ndërtuara në mënyrë specifike për deponimin e tyre në atë mënyrë që të zvogëlohet efekti i ndotjes së mjedisit dhe i shëndetit të qytetarëve. Ky është një shërbim shumë themelor dhe me ndikim të drejtpërdrejt në shëndetin e qytetarëve. Një numër i madh i vendbanimeve dhe i ekonomive, kryesisht familjare, ende nuk janë të lidhura me sistemin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave, duke i hedhur llojet e ndryshme të mbeturinave në sipërfaqet e tokës, kryesisht pranë rrugëve dhe nëpër lumenj, kanale e përroska. Hedhja e mbeturinave gjithandej në mjediset urbane dhe rurale, po e degradon mjedisin jetësor (në veçanti mbeturinat jodegradabile – biologjikisht jo të zbërthyeshme), po shndërrohet në vatra të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve dhe me pamjen e tyre të shëmtuar, po ndikojnë shumë keq në psikologjinë e qytetarëve vendas dhe të vizitorëve të huaj. Përfshirja e të gjitha ekonomive që janë prodhues të rregullt të mbeturinave, është prioritet për komunën dhe qytetarët, duke parandaluar përhapjen e sëmundjeve të ndryshme.

Matja e performancës në këtë fushë është e rëndësishme (Ligji për vetëqeverisje lokale, nenin 17), për planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga komuna përkatëse në këtë fushë, në veçanti për MMPH në zhvillimin e politikave më efektive për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, për rritjen e investimeve në sektorin privat dhe palë të tjera të interesit.

Arritjet e komunës përkatëse në fushën e menaxhimit të mbeturinave maten nëpërmjet tre rezultateve kryesore 14.1; 14.2 dhe 14.3.

#### **Rezultati 14.1 - Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave**

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në përfshirjen e të gjithë qytetarëve apo të të gjitha ekonomive që prodhojnë mbeturina në sistemin e grumbullimit të tyre. Synimi përfundimtarë është mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave nga i tërë territori i komunës përkatëse, por aktualisht ofrohet shërbimi vetëm në pikat përkatëse të grumbullimit pranë ekonomive përkatëse dhe jo mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave jashtë këtyre pikave. Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave do të thotë, ndërtimi i sistemit për mbledhjen e mbeturinave nga pikat e grumbullimit të secilës ekonomi prodhuese të mbeturinave dhe transporti i tyre deri te vendet e veçanta dhe të licencuara për deponimin e tyre. Sistemi për grumbullimin e mbeturinave përfshinë edhe planin kohor të grumbullimit dhe transportit të tyre nga ekonomitë përkatëse të prodhimit të mbeturinave.

Zgjerimi i sistemit për grumbullim të mbeturinave apo përfshirja sa më e madhe e qytetarëve në sistem, zvogëlon mundësinë e hedhjes së mbeturinave në vendet jashtë pikave të grumbullimit, zvogëlon deponitë e egra (ilegale) dhe hedhjen e mbeturinave në vendet e palejuara si në lumenj dhe kanale e përroska, si dhe mundëson ruajtjen e mjedisit jetësor dhe të shëndetit të qytetarëve. Me rritjen e numrit të banorëve, vendbanimeve të shpërndara, ndërtimeve të reja të paplanifikuara, po rrisin sasinë e mbeturinave dhe hedhjen e tyre të pakontrolluar, në veçanti të mbeturinave inerte që po degradojnë tokat pjellore dhe të banuara në vendbanimet urbane e paraurbane si dhe ato rurale. Të gjitha përpjekjet e deritashme kanë

rezultuar me suksese të kufizuara në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të hedhura në mënyrë të pakontrolluar, gjë e cila kërkon zhvillim të politikave më të rrepta nga pushteti lokal dhe MMPH në menaxhimin me sukses të mbeturinave. Megjithatë komuna është e obliguar të rrisë kapacitetet menaxhuese për grumbullimin e mbeturinave në tërë territorin e saj në mënyrë që të gjithë qytetarët e komunës përkatëse të trajtohen në mënyrë të barabartë në ofrimin e shërbimeve.

Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është e lidhur me efikasitetin e menaxhimit të burimeve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse. Rezultati ndihmon komunën përkatëse për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen në arritjen e këtij rezultati. Komuna në partneritet me kompanitë për menaxhimin e grumbullimit të mbeturinave dhe me qytetarët duhet të përcaktoj tarifat për mbulimin e ofrimit të këtij shërbimi. Komuna është e obliguar që të ndaj fonde përkatëse nga taksat e qytetarëve dhe nga fondet qendrore në angazhimin e kompanive publike apo private për pastrimin e tërë territorit të saj nga të gjitha llojet e mbeturinave dhe nga të gjitha vendet kudo që hedhen, si dhe të marrin masa ligjore për qytetarët, institucionet dhe bizneset të cilët nuk respektojnë ligjin për menaxhimin e mbeturinave. Me zbatimin e ligjit dhe udhëzimeve përkatëse profesionale edhe duke futë në përdorim gjobat përkatëse, rezultati është i arritshëm.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e dy treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

#### **Treguesi 14.1.1 - Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave**

##### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në realizimin e veprimeve të planifikuara për menaxhimin e mbeturinave në tërë territorin e saj (Ligji për mbeturinat, neni 15).

##### **Çfarë matet?**

Treguesi jep informata për të gjitha veprimet e ndërmarra nga komuna dhe operatori ekonomik për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuara me planin komunal. Realizimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave nënkupton numrin e llojeve të punëve të përfunduara nga lloji dhe numri i përgjithshëm i punëve të planifikuara për vitin përkatës të raportimit në menaxhimin e mbeturinave komunale, komerciale, të parrezikshme dhe inerte.

##### **Sqarime të hollësishme**

Nga pikëpamja e performancës komunale, miratimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave si dhe zbatimi i tij është përgjegjësi e komunës përkatëse (Ligji për Mbeturinat) nëpërmjet planit operativ të kompanive të licencuara për këtë veprimtari. Komunat dhe kompanitë relevante janë të obliguara që t'i zbatojnë obligimet ligjore nëpërmjet zbatimit të planit komunal përkatës për menaxhimin e mbeturinave duke siguruar kapacitetet e nevojshme administrative teknike, financiare dhe njerëzore duke siguruar pastrimin mjedisit jetësor në territorin e komunës apo të komunave përkatëse dhe mbrojtjen e shëndetit



publik. Nëpërmjet informatave të prodhuara nga matja e performancës, komuna ka mundësi që për çdo vit të bëjë rishikimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave sipas prioriteteve të përcaktuara.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kohës së përcaktuar me planin komunal për menaxhimin e mbeturinave, kryesisht brenda një viti. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Gjithsej veprime të planifikuara për menaxhimin e mbeturinave
2. Gjithsej veprime të realizuara (përfunduara) nga veprimet e planifikuara

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike, drejtoria përkatëse për mbrojtjen e mjedisit dhe nga kompanitë përkatëse publike dhe/apo private për menaxhimin e mbeturinave në përputhje me planin vjetor të komunës përkatëse për menaxhimin e mbeturinave. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e raportet zyrtare të drejtorisë për shërbime publike në krahasim me planin komunal për menaxhimin e mbeturinave për territorin e komunës apo të komunave përkatëse.

## Treguesi 14.1.2 - Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin për grumbullimin e mbeturinave

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në përfshirjen e të gjitha ekonomive familjare, institucionale, komerciale në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.

### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare, numrin e përgjithshëm të institucioneve publike (institucione komunale, të dekoncentruar rajonale, qendrore, arsimore, shëndetësore, të kulturës, rinisë dhe sporteve), numrin e përgjithshëm të bizneseve (komerciale) të përfshira apo që shfrytëzojnë sistemin komunal të grumbullimit të mbeturinave. Përfshirja nënkupton ndërtime të sistemit të grumbullimit dhe të mbledhjes së mbeturinave nga secili prodhues komunal (prodhuesi këtu e ka kuptimin e atij që prodhon mbeturina), komercial dhe transporti i tyre sipas kushteve të parapara teknike me licencë deri te vendet e caktuara për deponim të tyre. Aktualisht jo të gjitha ekonomitë prodhuese të mbeturinave janë të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave dhe nëpërmjet këtij

treguesi synohet që të përfshihen të gjitha ekonomitë përkatëse në territorin e komunave përkatëse në sistem. Sa më shumë ekonomi prodhuese të mbeturinave të përfshira, do të thotë, aq më pak mbeturina të pa menaxhuara nga komuna dhe kompania përkatëse.

### **Sqarime të hollësishme**

Treguesi matë relativisht saktë performancën e komunës për këtë shërbim nga ajo që synon, edhe pse një numër i ekonomive prodhuese të mbeturinave të reja apo i atyre që janë shumë të shpërndara, mund të mos përfshihen në raportim të këtij treguesi. Për këtë qëllim komuna, nëpërmjet kompanisë publike apo operatorit përkatës ekonomik, obligohet që t'i regjistrojë të gjitha ekonomitë përkatëse të cilave ua mundëson qasjen në shfrytëzimin e sistemit për grumbullimin e mbeturinave, duke i përditësuar regjistrat në baza mujore dhe vjetore, sepse me lëvizjen e popullatës numri i tyre ndryshon vazhdimisht. Treguesi në fakt nuk matë thelbin e asaj çfarë synojmë të masim – zvogëlimin në minimum të mbeturinave të pambledhura në territorin e komunës përkatëse. Edhe në vendbanimet, ekonomitë përkatëse janë të përfshira në mbledhjen e mbeturinave, prapë një sasi e mbeturinave hidhet në deponitë e egra dhe nuk mblidhen dhe menaxhohen nga komuna dhe operatorët ekonomik. Përfshirja apo rritja e numrit të ekonomive përkatëse në sistemin e grumbullimit të mbeturinave nuk siguron, ashtu si edhe po ndodhë, pastrimin e mbeturinave nga mjedisi jetësor. Në përputhje me rritjen e kapaciteteve në komuna, ky tregues duhet të zhvillohet dhe të matë thelbin e tij, pastrimin e territorit nga ndotja me mbeturina.

Në aspektin e performancës komunale, zgjerimi i shërbimit për grumbullimin e mbeturinave apo shkalla e përfshirjes së ekonomive prodhuese të mbeturinave në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, është kompetencë e komunës sipas Ligjit të ri për Mbeturina. Treguesi do të jetë i suksesshëm atëherë kur e zvogëlon në minimum sasinë e mbeturinave të pambledhura në tërë territorin e komunës përkatëse.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet në mënyrë përmblendhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmblendhëse apo komulative, përkatësisht raportohet numri i përgjithshëm i ekonomive të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, e realizuar për të gjitha vitet.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen e gjashtë lloje të të dhënave:

1. Numri i ekonomive familjare në komunë
2. Numri i ekonomive familjare të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave
3. Numri i përgjithshëm i institucioneve publike në komunë
4. Numri i përgjithshëm i institucioneve publike të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave
5. Numri i ekonomive komerciale dhe industriale në komunë
6. Numri i ekonomive komerciale të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave

## Formula e llogaritjes

$$Treguesi = \frac{\left[ \left( \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} \right) + \left( \frac{e \text{ dhëna } 4}{e \text{ dhëna } 3} \right) + \left( \frac{e \text{ dhëna } 6}{e \text{ dhëna } 5} \right) \right]}{3} * 100$$

Shuma e fituar nga tri formulat e prodhojnë përqindjen përkatëse të përbashkët për treguesin.

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtorja e shërbimeve publike, drejtorja përkatëse për mbrojtjen e mjedisit dhe nga kompanitë përkatëse. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e regjistrave zyrtar për ekonomitë prodhuese të mbeturinave që u ofrohet qasja në grumbullimin e mbeturinave në komunën përkatëse dhe raportet zyrtare dhe të protokolluara për ofrimin me rregull të shërbimit për ekonomitë përkatëse prodhuese të mbeturinave.

### Rezultati 14.2 - Ofrim i qëndrueshëm i shërbimeve në mbledhjen e mbeturinave

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në ofrimin e rregullt të shërbimit të mbledhjes së mbeturinave për të gjithë qytetarët. Ofrimi i qëndrueshëm me shërbim të mbledhjes së mbeturinave do të thotë mbledhja e mbeturinave sipas orarit të caktuar ditor apo javor nga pikat e grumbullimit të ekonomive prodhuese përkatëse në tërë territorin e komunës përkatëse. Ndërtimi i kapaciteteve për ofrim të qëndrueshëm të mbledhjes së mbeturinave është i lidhur ngushtë me kapacitetet menaxhuese dhe teknike të komunës, kompanive përkatëse në njërin anë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në shlyerjen e obligimeve në anën tjetër. Shlyerja e obligimeve nga ana e qytetarëve për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, siguron një pjesë themelore të të hyrave vetanake të komunave për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve të nevojshme për ofrim të qëndrueshëm të këtij shërbimi.

Ofrimi i qëndrueshëm apo i rregullt, sipas orarit i këtij shërbimi, është rezultati themelor dhe kryesor i kësaj fushe. Rezultati pasqyron arritjet e komunës përkatëse në mbledhjen e rregullt, me orar të mbeturinave nga pikëpamja kohore, por jo edhe për sasinë dhe cilësinë e mbledhjes së tyre. Cilësi në këtë rast është mbledhja e të gjitha mbeturinave. Zgjerimi i rrjetit të sistemit për grumbullimin dhe mbledhjen e mbeturinave apo përfshirja sa më e madhe e qytetarëve në sistem, zvogëlon mundësinë e rrezikimit të shëndetit të qytetarëve nga ndotja e mjedisit jetësor. Sa më e shpeshtë koha e mbledhjes së mbeturinave aq më shumë shpenzime bëhen nga kompania.

Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është e lidhur me efikasitetin e menaxhimit të buri meve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse, si në inkasimin e mjeteve nga qytetarët, po ashtu edhe të mjeteve tjera nga niveli qendror. Rezultati ndihmon komunën, kompaninë përkatëse, MMPH dhe palët tjera të

interesit për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen në arritjen e këtij rezultati. Arritja e këtij rezultati do të thotë: mbledhja e rregullt e mbeturinave nga pikat përkatëse të grumbullimit të ekonomive komunale, komerciale.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e dy treguesve kryesor, pa e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### Treguesi 14.2.1 - Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në mbledhjen e rregullt të mbeturinave nga pikat e grumbullimit të ekonomive përkatëse.

#### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e ditëve të planifikuara me orar për mbledhjen e mbeturinave nga pikat e grumbullimit dhe numrin e ditëve të realizuara për të gjitha pikat e grumbullimit të mbeturinave. Natyrisht se numri i ditëve për vendbanime të ndryshme është e ndryshme, por mblidhen ditët për të gjitha vendbanimet.

#### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë thelbin e asaj që duhet të arrihet me këtë rezultat. Treguesi matë relativisht saktë performancën e komunës në këtë këndvështrim. Problem është mbledhja e të dhënave mbi këtë bazë, por komunat dhe kompanitë përkatëse mbajnë oraret e planifikimit dhe të grumbullimit të mbeturinave. Nuk mund të matet saktë performanca e komunës në ofrimin e qëndrueshëm të këtij shërbimi, pa e kuptuar se sa ditë në vjet mblidhen mbeturinat nga pikat e grumbullimit të ekonomive përkatëse të komunës nga ditët e planifikuara për mbledhjen e mbeturinave. Duke ditur se numri i ditëve sipas orarit për mbledhjen e mbeturinave mund të jetë i ndryshëm, për pikat e ndryshme të grumbullimit, dhe në mënyrë që të thjeshtësohet matja e këtij treguesi kërkohet vetëm mesatarja e ditëve të planifikuara dhe mesatarja e ditëve të realizuara për të gjitha pikat e grumbullimit. Kusht për matjen e saktë të këtij treguesi është posedimi dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të orarit të mbledhjes së mbeturinave.

#### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet brenda vitit kalendarik. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i ditëve të planifikuara për mbledhjen e mbeturinave në territorin e komunës në vit
2. Numri i ditëve të realizuara për mbledhjen e mbeturinave në territorin e komunës në vit

## Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga kompanitë përkatëse publike apo operatorit përkatës ekonomik për menaxhimin e mbeturinave. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e dokumenteve zyrtare të monitorimit (raporteve apo shënimeve zyrtare) për zbatimin e orarit për mbledhjen e mbeturinave nga pikat e grumbullimit të ekonomive përkatëse dhe raportit zyrtar të prodhuar nga drejtoria e shërbimeve publike për këtë shërbim.

### Treguesi 14.2.2 - Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në menaxhimin e mbeturinave në territorin e saj.

#### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për shumën e mjeteve të paguara në euro nga shuma e faturuar, sipas tarifës përkatëse në komunën përkatëse për mbledhjen e mbeturinave. Termi “shuma e faturuar apo shërbim i faturuar” nënkupton gjithsej vlera e faturuar gjatë një periudhe prej 12 muajve kalendarik, që fillon në janar dhe përfundon në dhjetor të vitit për të cilin raportohet. Paga, sipas tarifës përkatëse për mbledhjen e mbeturinave, tregon performancën apo kapacitetet e komunës përkatëse për të inkasuar të hyrat vetanake për mbledhjen e mbeturinave.

#### Sqarime të hollësishme

Treguesi matë drejtpërdrejt shkallën e pagesave për shërbimin e ofruar, edhe pse nëse në ditët e planifikuara nuk është ofruar shërbimi, fatura duhet paguar e plotë, me arsyetimin se kudo që është hedhur mbeturina përkatëse nga ekonomia përkatëse, ajo prapë është mbledhur nga operatori ekonomik për mbledhjen e mbeturinave. Realisht kjo nuk është plotësisht e saktë, sepse kompania apo operatori nuk i mbledhë mbeturinat jashtë pikave të grumbullimit. Me këtë tregues matet shuma e mjeteve të paguara nga ekonomitë që prodhojnë mbeturina, që është shumë me rëndësi.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet brenda vitit përkatës fiskal. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës fiskal dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

## Formula e llogaritjes

1. shuma e mjeteve të faturuara në euro për mbledhjen e mbeturinave në vit
2. shuma e mjeteve të paguara (inkasuara) në euro për mbledhjen e mbeturinave

$$Treguesi = \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga kompanitë përkatëse për menaxhimin e mbeturinave. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e dokumenteve zyrtare (formularëve përkatës) për faturimin e shërbimit të ofruar – mbledhjen e mbeturinave nga secila ekonomi përkatëse, lista zyrtare e pagesave nga ekonomitë që iu ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbeturinave dhe raportit zyrtar të prodhuar nga drejtoria e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave në komunën përkatëse.

### Rezultati 14.3 - Deponimi i mbeturinave

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në administrimin e hallkës përfundimtare të ciklit për menaxhimin e mbeturinave. Deponimi i mbeturinave do të thotë vendosja e mbeturinave të mbledhura në vende të veçanta larg vendbanimeve të komunës përkatëse të ndërtuara sipas kriterëve përkatëse gjeografike, teknike dhe biologjike, për ta mbrojtur mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut nga ndotja me mbeturina. Kalimi i këtij shërbimi në kompetencë të nivelit qendror, konkretisht të Kompanisë për menaxhimin e deponive të Kosovës, e ka vështirësuar ciklin e administrimit të plotë të mbeturinave nga ana e nivelit të pushtetit lokal. Ndërtimi i kapaciteteve për ofrim të qëndrueshëm të deponimit të mbeturinave është i lidhur ngushtë me kapacitetet menaxhuese të kompanive përkatëse për mbledhjen e mbeturinave dhe të kompanisë përkatëse për menaxhimin e deponive të mbeturinave.

Deponimi i mbeturinave është rezultati themelor i ciklit të menaxhimit të mbeturinave me anë të cilit mundësohet riciklimi, kompostimi dhe “varrosja” e mbeturinave në shtresat e thella të dheut sipas kriterëve të caktuara të dëmshme për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut. Ky shërbim mundëson largimin përfundimtar të mbeturinave nga mjediset e banuara (urbane dhe rurale) dhe mjediset natyrore. Rezultati pasqyron arritjet e komunës përkatëse në klasifikimin e mbeturinave, riciklimin e tyre dhe pjesën e mbetur - të paricikluar ta deponojë në vendet përkatëse apo në deponitë legale. Sa më shumë mbeturina që deponohen aq më pak mbeturina do të duhej të mbeteshin në mjediset urbane dhe rurale. Edhe pse jo gjithherë sasia e grumbullimit të mbeturinave të deponuara tregon për suksesin e menaxhimit të mbeturinave në përgjithësi, megjithatë ky rezultat nuk pasqyron saktësisht shkallën e pastërtisë së mjedisit apo të higjienës publike, nga pikëpamja kohore, por jo edhe për sasinë dhe cilësinë e mbledhjes së tyre.

Rezultati bartë implikime buxhetore dhe arritja e tij është e lidhur me efikasitetin e menaxhimit të buri meve dhe kapaciteteve të komunës përkatëse, i kapaciteteve të kompanisë apo operatorit ekonomik për mbledhjen e mbeturinave të cilat paguajnë për deponimin e sasisë së mbeturinave për kilogram, e po ashtu edhe të mjeteve tjera nga niveli qendror. Rezultati ndihmon komunën, kompaninë përkatëse, MMPH dhe palët tjera të interesit për të vlerësuar prioritetet e veprimeve të saj në të ardhmen në arritjen e këtij rezultati. Arritja e këtij rezultati do të thotë: ndërtimi i kapaciteteve të mjaftueshme sipas kritereve dhe metodologjisë përkatëse për deponimin e mbeturinave për territorin e komunës apo të komunave përkatëse, sepse, kompanitë për deponimin e mbeturinave janë kryesisht rajonale nën menaxhim të qeverisë.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e një treguesi kryesor, pa e përja shtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### Treguesi 14.3.1 - Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në menaxhimin e ofrimit të shërbimit për deponimin e mbeturinave në territorin e saj.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë sasinë e mbeturinave të deponuara në kilogram për kokë të banorit në vit. **Ndërsa, komuna vlerësohet kundër një mesatare standarde minimale të mbeturinave të depunuara në Bashkim Evropian (BE)<sup>49</sup>. Mesatarja minimale e mbeturinave për person në BE është 300kg për person në vit. Andaj deponimi i mbeturinave në këtë nivel për person në komunë konsiderohet vlerësim maksimal (100%).**

#### Sqarime të hollësishme

Sasia e deponimit të mbeturinave në vit, tregon performancën apo kapacitetet menaxhuese të komunës përkatëse për deponimin e mbeturinave dhe administrimit të përgjithshëm të mbeturinave në territorin e saj dhe në të njëjtën kohë tregon edhe për trendin e sasisë së mbeturinave të prodhuara nga ekonomitë përkatëse në territorin e komunës përkatëse, përjashtuar sasinë e mbeturinave të prodhuara nga ekonomitë që nuk kanë qasje në sistemin e menaxhimit të mbeturinave dhe deponitë e egra.

Treguesi matë drejtpërdrejtë dhe saktë sasinë e mbeturinave të deponuara në kilogram për kokë banori në deponitë legale. Pra treguesi nuk matë sasinë e deponimit të mbeturinave në deponitë e egra (ilegale). Sa më e madhe përfshirja e ekonomive prodhuese të mbeturinave në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, aq më e vogël mundësia e krijimit të deponive të egra apo ilegale dhe aq më e madhe mundësia e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe e shëndetit të njeriut. Megjithatë treguesi prodhon informata të rëndësishme për kapacitetet prodhuese të mbeturinave në komunën përkatëse dhe në nivel të vendit, si dhe për sasinë e mbeturinave të deponuara, që në të ardhmen mund të shërbejnë si burim i zhvillimit ekonomik në shumë sektorë me riciklimin e tyre apo edhe si burim i energjisë. Ripërdorimi i mbeturinave për qëllime ekonomike kushtëzohet në masë të madhe edhe nga klasifikimi i mbeturinave i cili duhet të bëhet në të ardhmen nga sistemi për menaxhimin e mbeturinave, në mënyrë që një e keqe e madhe të shndërrohet në një pasuri të madhe, në veçanti në ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe pëmbushet brenda vitit përkatës kalendarik. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

<sup>49</sup> Eurostat. 18.03.2020. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/DDN-20200318-1>

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbliidhen dy të dhëna:

1. Numri i banorëve në komunën përkatëse
2. Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për komunën përkatëse brenda një viti kalendarik

### Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \left( \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} \right) / 3$$

Formula është e formuluar që vlerësimi maksimal është deponimi 300kg mbeturina për person në vit, që është mesatarja minimale e mbeturinave për person në BE. Që treguesi të matë thelbin e asaj që synojmë të matë, në të ardhmen duhet të mbliidhet edhe e dhëna se sa kilogram mbeturina prodhon një qytetar apo një ekonomi përkatëse në ditë apo në vit. Kjo do të ndihmonte shumë në prodhimin e informatave për të matë efikasitetin e grumbullimit, mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave në territorin e komunës përkatëse.

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mbliidhen nga drejtoria e shërbimeve publike dhe nga kompanitë përkatëse për deponimin e mbeturinave. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e dokumenteve zyrtare (regjistrat zyrtar) për sasinë e deponimit të mbeturinave nga kompanitë për mbledhjen e mbeturinave në territorin e komunës përkatëse dhe raportit zyrtar të prodhuar nga drejtoria e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave në komunën përkatëse.

## FUSHA 15 - MBROJTJA E MJEDISIT

Emërtimi i fushës është: “Mbrotjtja e mjedisit”. Mbrotjtja e mjedisit nënkupton veprimet e komunës përkatëse për mbrotjtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror. Mbrotjtja e mjedisit në kuptimin e ngushtë të fjalës nënkupton mbrotjtjen e tokës, ajrit, ujit, klimës, botës bimore e shtazore dhe të ndërveprimeve të tyre: ekosistemeve ujore e tokësore, trashëgimisë natyrore e kulturore dhe mjedisit urban e rural nga ndryshimet fizike të mjedisit, si: prerja e pyjeve, erozioni, vërshimet, zhurma, rrezatimi jonizues dhe radioaktiv, pluhuri, zjarret, hiri temperaturat etj.; nga ndryshimet kimike të mjedisit, si: tymi, smagu, oksidet e azotit, plumbit, sqfurit dhe nga ndryshimet biologjike, si: epidemitë, endemitë dhe pandemitë e ndryshme që rrezikojnë shëndetin e qytetarëve. Kjo kompetencë është e përzier apo e integruar me të drejta dhe detyrime të nivelit qendror dhe atij lokal, ku komunat kanë përgjegjësi të caktuara në mbrotjtjen e mjedisit në territorin e vetë në përputhje me ligjin (Ligji Nr. 03/L – 025 për Mbrotjtjen e Mjedisit dhe Ligji 03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 17). Komuna është e obliguar që në përputhje me ligjet në fuqi të marrë të gjitha masat për mbrotjtjen e mjedisit, me përjashtim të atyre veprimeve të cilat janë në kompetencë të nivelit qendror.

Mbrotjtja e mjedisit përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të planifikuara me Planet e veprimt lokal në mjedis dhe programet mjedisore, të cilat duhet të jenë në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim Mjedisor (Ligji Nr. 03/L – 025 për Mbrotjtjen e Mjedisit, neni 24), që ka të bëjë me mbrotjtjen e të gjitha llojeve mjedisore nga të gjitha veprimet dhe materiet të cilat e rrezikojnë mjedisin në komunën përkatëse. Ky është një shërbim shumë themelor dhe mjaftë i ndërlikuar dhe i integruar (me shumë palë të interesit) me ndikim të drejtpërdrejt në shëndetin e qytetarëve. Zhvillimet e shumta dhe të shpejta në ekonomi, teknologji, urbanistikë, komunikacion etj. po ndikojnë në shfrytëzimin e pakontrolluar të burimeve natyrore



dhe jo natyrore, të cilat po ndikojnë në degradimin e mjedisit jetësor, në veçanti të tokës bujqësore dhe ndotjen e mjedisit jetësor me materie kimike e fizike me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve të vendit. Kohëve të fundit është rritë numri i sëmundjeve kancerogjene dhe është rikthyer sëmundja e tuberkulozit. Kjo e bënë këtë fushë shumë prioritare në matjen e performancës e cila do t'iu ndihmoj institucioneve të pushtetit lokal për adresimin e problemeve dhe marrjen e masave profesionale për zgjidhjen e problemeve të shumta mjedisore, njëra prej fushave më problematike në vend.

Matja e performancës në këtë fushë është e rëndësishme (Ligji për vetëqeverisje lokale dhe Ligji për mbrojtjen e mjedisit), për planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në mbrojtjen e mjedisit në nivelin lokal, në veçanti për MMPH në zhvillimin e politikave më efektive për mbrojtjen e mjedisit nga degradimi dhe ndotja, për rritjen e investimeve në sektorin privat dhe palë të tjera të interesit.

Arritjet e komunës përkatëse në fushën e mbrojtjes së mjedisit matet nëpërmjet një rezultati kryesor 15.1.

### Rezultati 15.1 - Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm

Rezultati paraqet arritjet e komunës përkatëse në krijimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë qytetarët. Ky është synimi përfundimtarë i veprimit të organeve të pushtetit lokal, atij qendror dhe i publikut të gjerë. Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm do të thotë, marrja e masave të nevojshme nëpërmjet Planit të veprimit komunal në mjedis për mbrojtjen e mjedisit nga çfarëdo dëmtimi, shkatërrimi apo ndotje, marrja e masave të nevojshme për ruajtjen dhe përparimin e mjedisit që nuk është i dëmtuar dhe marrjen e masave të nevojshme për rikthimin e mjedisit në gjendje të natyrshme, i pastër dhe i shëndetshëm për qytetarët. Veprimet e komunës nëpërmjet planit të miratuar në kuvendin e komunës përkatëse duhet të jenë në përputhje me kohën e nevojshme për mbrojtjen dhe sanimin e gjendjes në mënyrë efektive për të krijuar mjedis për jetë normale të qytetarëve, botës bimore dhe shtazore.

Rezultati synohet të arrihet nëpërmjet zbatimit efektiv të Planit të veprimit lokal mjedisor(PVLM), duke përfshirë edhe publikun e gjerë dhe palët e ndryshme të interesit dhe kontrollit të veprimit në mjedis nëpërmjet Lejeve mjedisore komunale (Ligji për mbrojtje të mjedisit, neni 24 dhe 32). Qëllimi kryesor i rezultatit është që të mobilizojë të gjitha strukturat institucionale komunale e qendrore, bizneset, shkollat, spitalet komunitetin e ekspertëve të mjedisit dhe ata shkencor, komunitetin e shoqërisë civile, forcat e rendit, gjykatat dhe opinionin publik, secili nga këndi i vetë, në mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit për jetë të shëndetshme për të gjithë. Me rritjen e numrit të banorëve, vendbanimeve të shpërndara, ndërtimeve të reja të paplanifikuara, zhvillimit të trafikut etj. po rritet rreziku nga ndotja dhe shkatërrimi i mjedisit në pjesën më të madhe të territorit të vendit, në veçanti nga ndërhyrjet e egra të njeriut, si gurëthyesit, ndërtimet pa plan dhe pa leje në tokat e pëlleshme, hedhja e mbeturinave gjithandej, emetimi i gazrave helmues etj. veprimet e shumta të deritashme kanë rezultuar me suksese të kufizuara, gjë e cila kërkon zhvillim të politikave më të rrepta nga pushteti lokal dhe MMPH në menaxhimin me sukses në mbrojtje të mjedisit. Megjithatë komuna është e obliguar të rrisë kapacitetet menaxhuese për marrjen e masave të nevojshme dhe të menjëhershme për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit në territorin e vetë, që bien në

përgjegjësitë e saj me ligj. Komuna është e obliguar që, në radhë të parë, të krijojë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë qytetarët e saj.

Komuna është e obliguar që të ndaj fonde përkatëse nga taksat e qytetarëve dhe nga fondet qendrore për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit në tërë territorin e vetë pa diskriminim të të gjitha vendbanimeve. Me zbatimin e ligjit dhe udhëzimeve përkatëse profesionale në të gjitha veprimtaritë mjedisore edhe duke futë në përdorim gjobot përkatëse, rezultati është i arritshëm.

Në këtë fazë të zhvillimit të sistemit, rezultati matet me ndihmën e tre treguesve kryesor, pa e përja shtuar mundësinë që në të ardhmen të bëhen përshtatje dhe përmirësime të vazhdueshme.

### **Treguesi 15.1.1 - Realizimi i planit lokal të veprimit në mjedis**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në realizimin e veprimeve të planifikuara me Planin për Veprim Lokal Mjedisor (PVL) për mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për qytetarët (Ligji për mbrojtje të mjedisit, neni 24).

#### **Çfarë matet?**

Treguesi jep informata për të gjitha veprimet e ndërmarra nga komuna në partneritetet palët tjera të interesit për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit, të përcaktuara me Planin e veprimit komunal në mjedis dhe programet mjedisore (tani e tutje planit). Realizimi i planit komunal nënkupton numrin e llojeve të punëve të përfunduara në mënyrë efektive nga lloji dhe numri i përgjithshëm i punëve të planifikuara për vitin përkatës të raportimit në mbrojtjen e mjedisit në territorin e komunës përkatëse.

#### **Sqarime të hollësishme**

Nga pikëpamja e performancës komunale, miratimi i planit (PVL) dhe zbatimi i tij është përgjegjësi e komunës përkatëse (Ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 24) në përputhje me Planin e Kosovës për veprim mjedisor, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e tokës, ujit ajrit, klimës, ekosistemeve, llojllojshmërisë së botës bimore dhe shtazore, peizazheve, natyrës, administrimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme (ujërave të zeza), administrimin e fatkeqësive ekologjike (aksidenteve mjedisore), mbrojtjen nga zhurma etj. (Ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 23). Plani duhet të jetë në përputhje edhe me Hartat zonale dhe Planit rregullativ të hollësishëm të planifikimit hapësinor të komunës përkatëse dhe të planeve tjera komunale, në veçanti të planit për menaxhimin e emergjencave. Komunat janë të obliguara që t'i zbatojnë obligimet ligjore nëpërmjet zbatimit të planit duke siguruar kapacitetet e nevojshme administrative teknike, financiare dhe njerëzore me qëllim të pastrimit dhe përparimit të mjedisit jetësor në territorin e komunës apo të komunave përkatëse dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Nëpërmjet informatave të prodhuara nga matja e performancës, komuna ka mundësi që për çdo vit të bëjë rishikimin e planit dhe programeve mjedisore (PM) sipas prioriteteve të përcaktuara, por duke ruajtur pajtueshmërinë me Planin e Kosovës për veprim mjedisor (PKVM).

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kohës së përcaktuar me PVKM dhe PM. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Aktivitete e planifikuara për veprim lokal/komunal mjedisor
2. Aktivitete të realizuara (përfunduara) nga veprimet e planifikuara

## Formula e llogaritjes

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

## Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria përkatëse që merret me mbrojtjen e mjedisit. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e raporteve zyrtare të drejtorisë për mbrojtjen e mjedisit në krahasim me planin (PVLM) të komunave përkatëse, si dhe dokumentet zyrtare apo kontratat për kryerjen e punëve të caktuara që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

## Treguesi 15.1.2 - Lejet mjedisore komunale të lëshuara

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse në lëshimin e Lejeve Mjedisore Komunale (LMK), (Ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 32) për mbrojtjen e mjedisit gjatë ndërtimit të vendbanimeve përkatëse në territorin e komunës.

### Çfarë matet?

Treguesi jep informata për numrin e LMK të lëshuara nga komuna në raport me numrin e lejeve të ndërtimit për të cilat kërkohet leja mjedisore, po ashtu të lëshuara nga komuna. Kjo do të thotë se secili ndërtim që bëhet në territorin e komunës përkatëse dhe që për të cilin kërkohet leja mjedisore, pala e interesuar për ndërtim, përpos lejes së ndërtimit duhet ta posedojë edhe LMK me qëllim të mbrojtjes së mjedisit (Udhëzimi Administrativ nr. 17/2015 për Dhënien e Lejes Mjedisore). Lëshimi i LMK nënkupton se ndërtimi i objekteve apo i infrastrukturës rrugore etj. nga pala përkatëse nuk dëmton në asnjë mënyrë kushtet e mjedisit përkatës.

## Sqarime të hollësishme

Treguesi matë shumë saktë atë që synojmë ta masim, numrin e LMK të lëshuara në raport me lejet e lëshuara për ndërtim, por nuk matë thelbin e asaj që në fakt do të duhej të matë, shkallën e zbatimit të LMK. Lëshimi i LMK nuk nënkupton edhe zbatimin e saj të plotë apo të pjesshme. Në përgjithësi LMK nuk zbatohen në përputhje me kërkesat mjedisore dhe për pasojë kemi një degradim të mjedisit në territorin e të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim treguesi në të ardhmen duhet të zhvillohet në përputhje me kapacitetet e komunës për menaxhimin e zbatimit të LMK dhe mbrojtjen efektive të mjedisit.

Nga pikëpamja e performancës komunale, lëshimi i LMK është përgjegjësi e komunës përkatëse (Ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 32) dhe është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik i lejeve të ndërtimit. LMK duhet të jetë në përputhje edhe me Hartat zonale dhe Planin rregullativ të hollësishëm të planifikimit hapësinor të komunës përkatëse dhe të planeve tjera komunale, në veçanti të planit për menaxhimin e emrgjencave. Komunitat janë të obliguara që të sigurojnë mekanizma ligjor për zbatimin e LMK, nëpërmjet inspeksionit përkatës mjedisor. Nëpërmjet informatave të prodhuara nga matja e performancës, komuna ka mundësi që për çdo vit të bëjë rishikimin e lëshimit të LMK dhe marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e plotë të tyre.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mblidhen dy lloje të të dhënave:

1. Kërkesat për Leje Mjedisore Komunale në gjatë vitit (për objektet që kërkohet leja mjedisore)
2. Lejet mjedisore të lëshuara në gjatë vitit

$$\text{Treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Të dhënat mblidhen nga drejtoria përkatëse që mirret me mbrojtjen e mjedisit dhe drejtoria përkatëse për planifikim urban. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e regjistrave zyrtar për LMK të lëshuara brenda vitit përkatës, raporteve zyrtare të drejtorisë për mbrojtjen e mjedisit për shkallën e përmbushjes së kushteve mjedisore gjatë lëshimit të lejeve të ndërtimit të komunave përkatëse.

## Treguesi 15.1.3 - Ndërtesat E reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës së komunës përkatëse që ka të bëjë me zbatimin e ligjshmërisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

### **Çfarë matet?**

Për këtë qëllim treguesi demonstroi veprimet e organeve përgjegjëse të komunës, inspektorit komunal të mjedisit (Ligji për mbrojtjen e mjedisit, neni 81), për shkallën e zbatimit të ligjshmërisë, për të gjitha ato ndërtime që kërkohet leja mjedisore, gjatë ndërtimit të objekteve të cilat kanë marrë LMK, ose objektet të cilat gjatë inspektimit rezultojnë se nuk janë të pajisura me LMK sipas Udhëzimit Administrativ nr. 17/2015 për Dhënien e Lejes Mjedisore.

Ky tregues nuk paragjykon statusin ligjor të objekteve të ndërtimit, nëse kanë apo jo leje të ndërtimit, por ka për qëllim të matë nëse objektet e ndërtuara apo në ndërtim e sipër, kanë apo nuk kanë LMK dhe numrin e objekteve të inspektuara që e kanë LMK dhe e zbatojnë me korrektësi atë. Konkretisht matë shkallën e inspektimit të ndërtesave të reja dhe shkallën e zbatimit të LMK të objekteve të inspektuara të pajisura me LMK. Inspektori komunal i mjedisit kryen vizita sipas detyrës zyrtare, edhe në bashkëpunim me inspektorin e ndërtimit, në objektet e reja ndërtimore. Inspektimi bazohet në numrin e ndërtimeve të regjistruara gjatë vitit të raportimit në njësinë përkatëse në komunë – tatimi në pronë.

### **Sqarime të hollësishme**

Treguesi matë relativisht saktë. Megjithatë përvoja tregon se jo të gjitha ndërtimet në territorin e komunës mund të inspektohen dhe të vihet në zbatim ligji për këtë veprimtari. Treguesi e informon komunën, MMPH, MPL dhe palët tjera të interesit për performancën e inspektorit mjedisor në raport me vëllimin e ndërtimit në territorin e komunës, përkatësisht, treguesi e informon rezultatin për performancën e komunës në kapacitetet inspektuese për mbrojtjen e mjedisit gjatë ndërtimeve në territorin e komunës. Ky tregues e informon rezultatin në mënyrë të drejtpërdrejt për shkallën e zbatimit të LMK gjatë ndërtimit të objekteve në territorin e komunës përkatëse, si dhe informon komunën për kapacitetet inspektuese për mbrojtjen e mjedisit nga ndërhyrjet e paligjshme të palëve. Kjo informatë është e rëndësishme edhe për qytetarët e komunës, për të parë se çfarë është performanca e komunës në zbatimin e ligjshmërisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të rezultatit dhe përmbushet sipas kërkesave brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit mbledhen dy lloje të të dhënave:

1. Numri i objekteve të reja për të cilat kërkohet leje mjedisore të inspektuara gjatë vitit të raportimit.
2. Numri i objekteve që janë të pajisura me lejen mjedisore komunale
3. Numri i objekteve të cilat kanë LMK dhe e zbatojnë LMK

4. Numri i gjobave të shqiptuara për mos posedimin dhe zbatimin e LMK
5. Numri i fletëparaqitjeve në gjykatë për mos posedimin dhe zbatimin e LMK

$$Treguesi = \frac{e\ dhëna\ 3}{e\ dhëna\ 2} * 50 + \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 30 + \frac{e\ dhëna\ 4}{e\ dhëna\ 5} * 20$$

### **Burimi i të dhënave**

Të dhënat mbledhen nga drejtoria përkatëse që merret me mbrojtjen e mjedisit. Verifikimi i të dhënave bëhet me anën e regjistrave zyrtar për LMK të lëshuara brenda vitit përkatës, raporteve zyrtare të drejtorisë për mbrojtjen e mjedisit – inspektorit mjedisor për shkallën e zbatimit të LMK në komunën përkatëse, të cilat raporte i dërgohen edhe MMPH.

## FUSHA 16 - PËRFAQËSIMI GJINOR

Emri i fushës është “Përfaqësimi Gjinor.” Kjo fushë mbulon barazinë dhe përfaqësimin gjinor në institucionet komunale, proceset dhe zhvillimet e komunës. Kosova qëndron mjaft dobët në përfaqësim gjinor në aktivitete komunale, programe komunale si dhe zhvillime shoqërore, siç tregojnë statistikat. Studimet tregojnë mos përfshirja e barabartë e njëres gjini në procese politike e shoqërore ka pasoja edhe ekonomike e zhvillimore. Andaj kjo fushë është e veçantë për të ngrit performancën në barazi gjinor dhe për të ngrit përfaqësimin gjinor në zhvillime komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës tek neni 7, pika 2, thotë: Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Ligji për Barazi Gjinore jep parime për vendosjen e sistemit të mbajtjes së evidencës lidhur me mbledhjen dhe disagregimin e të dhënave në baza gjinore më interes të avancimit të interesave të grave në komunë dhe të grave në raport me komunën. Kështu, institucionet komunale kanë obligim të kenë institucionet me përbërje të balancuar të dy gjinive si dhe të bëjnë politika ku dy gjinitë përfitojnë sa më barabartë.

Matja e performancës së komunave për përfaqësim gjinor është shumë e rëndësishme për komunat me qëllim të identifikimit të përparësive dhe dobësive që paraqiten në barazi gjinore në Kosovë por dhe marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e sigurimin e barazisë gjinore. Ka mjaft arritje në dekadat e fundit në këtë drejtim. Në disa komuna madje performanca është mjaft e kënaqshme. Megjithatë, është një fushë ku ka nevojë për avancim.

Prandaj përmes kësaj fushe tentohet të matet barazia dhe përfaqësimi gjinor në trupa komunale, përfitime të programeve dhe aktiviteteve komunale si dhe në procese të rëndësishme shoqërore.

Kjo fushë matet me tri rezultate dhe 11 tregues, të përshkruar më poshtë.

### Rezultati 16.1 Përfaqësimi i grave në trupa komunale

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës për ngritjen e përfaqësimit gjinor në institucione komunale. Ky rezultat synon krijimin e një mjedisi jetësor që i trajton në mënyrë të barabartë apo pa diskriminim të gjithë qytetarët, në veçanti grupet e marginalizuara të një gjinie. Rezultati gjithashtu synon të sjellë produktet e veprimeve të komunës në trajtimin e barabartë gjinor.

Ky rezultat përfshin arritjet e përfaqësimit gjinor në pozita të rekrutuara dhe pozita të emëruara apo zgjedhura. Më konkretisht ky rezultat synon përfaqësimin gjinor në administratë komunale, në pozita udhëheqëse në institucionet komunale arsimore, shëndetësore, sportive/kulturore si dhe përfaqësimin gjinor në komitete dhe këshilla komunal, këshilla lokal si dhe drejtori komunale si pozita të rëndësishme të degës ekzekutive komunale.

Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohen grupet e caktuara të shoqërisë që kanë nevojë për përfaqësim institucionale në mënyrë që të jenë sa më të barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë.

Arritja e rezultatit matet me treguesin 16.1.1, 16.1.2, 16.1.3, 16.1.4 dhe 16.1.5.

### Treguesi 16.1.1 - Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale

#### Qëllimi

Ky tregues synon të matë përqindjen e grave dhe burrave të punësuar në institucionet komunale. Treguesi ofron informata për performancën e komunës përkatëse për shkallën e trajtimit të barabartë dhe të integritimit të të dy gjinive në jetën institucionale të nivelit lokal.

## Çfarë matet?

Treguesi matë thjeshtë raportin e të punësuarve nga pikëpamja e përfaqësimit gjinor në institucionet e nivelit lokal. Këtu hyjnë të gjithë të punësuarit e institucioneve të cilat menaxhohen dhe financohen nëpërmjet komunës përkatëse. Matja është shumë e rëndësishme dhe e ndërlidhur drejtpërdrejtë me politikat komunale të punësimit në përputhje me nenin 6.7 të Ligjit nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, i cili kërkon përfaqësim të barabartë prej 50% të secilës gjini. Matja e këtij treguesi është prioritet ligjor kur kemi parasysh se shumica e institucioneve publike nuk kanë përmbushur këtë obligim.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet vit pas viti. Për këtë tregues raportohet gjithsej numri i të punësuarve në dhjetor të vitit raportues.

## Të dhënat

**Të dhënave.** Të dhënat janë të disponueshme për informimin e plotë të treguesit dhe duhet të mbledh 2 lloje të të dhënave:

1. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet komunale
2. Numri i përgjithshëm i grave të punësuarve në institucionet komunale

## Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = \left( \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} \right) * 100 * 2$$

**Llogaritja:**

- Š Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzon për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave:** mbledhen nga Zyra e personelit për administratën komunale, Drejtoria e arsimit për institucionet arsimore të nivelit parauniversitar, Drejtoria e shëndetësisë për institucionet shëndetësore të nivelit primar, Drejtoria përgjegjëse për shërbime sociale për qendrat për punë sociale dhe institucionet e tyre vartëse (shtëpitë e pleqve për strehim rezidencial), Drejtoria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport për institucionet e kulturës, rinisë dhe sportit (teatrot, bibliotekat, etj.), Drejtoria përgjegjëse për shërbime publike për ndërmarrjet komunale (p.sh. tregu, stacionet e autobusëve, ndërmarrjet banesore, trafiku urban, hortikultura, etj.). Problem është mbledhja e të dhënave për të punësuarit që janë jashtë administratës komunale, ku zyra e personelit nuk e menaxhon bazën e tyre të të dhënave. Gjithashtu procedurat e punësimit nuk ofrojnë të dhëna për identifikimin e konkurrentëve sipas përkatësisë gjinore, por në këtë drejtim mund të ndihmojnë statistikën e brendshme, të miratuara nga institucionet përgjegjëse në komunë.



Verifikimi i të dhënave bëhet nga lista e pagave mujore gjatë një viti kalendarik, nëpërmjet kontratave të punës dhe statistikave zyrtare, të miratuara nga institucionet përgjegjëse të formës përfundimtare (të protokolluara).

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### **Treguesi 16.1.2 - Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive**

#### **Qëllimi**

Ky tregues synon të matë përqindjen e grave dhe burrave në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive nën menaxhim të komunës. Treguesi ofron informata për performancën e komunës përkatëse për shkallën e trajtimit të barabartë dhe të integritit të të dy gjinive në jetën institucionale të nivelit lokal.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë nivelin e përfaqësimit të dy gjinive udhëheqjen në këtyre institucioneve:

- Institucioneve shkollore nën menaxhim të komunës - institucione parashkollore publike, shkolla të cilkit të ulët dhe mesëm si dhe çdo shkolle tjetër publike të cilat menaxhohen dhe financohen nëpërmjet komunës përkatëse;
- Institucioneve shëndetësore nën menaxhim të komunës - qendrave të mjekësisë familjare (QKMF, QMF-të dhe AMF-të) si dhe
- Institucioneve kulturore e sportive - teatorve, sallave koncertale, fushave sportive.

Pozita udhëheqëse konsiderohen drejtorët e këtyre institucioneve pra drejtorët e shkollave, QMF-ve, fushave të sportit dhe institucioneve kulturore. E dhëna e parë kërkon numrin e zyrtarëve të lartë në këto institucionet dhe ky duhet të korrespondojë me numrin e institucioneve të këtyre fushave pasi që matet udhëheqësi i këtyre. Ndërsa e dhëna e dytë kërkon sa nga ata udhëheqës janë të gjinisë femërore.

#### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

#### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. Numri i zyrtarëve të lartë udhëheqës në institucionet komunale të arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit
2. Numri i zyrtarëve të lartë udhëheqës nga gjinia femërore

#### **Formula e llogaritjes**

**Formula:**

$$Treguesi = \left( \frac{E \text{ dhëna } 1}{E \text{ dhëna } 2} \right) * 100 * 2$$

#### Llogaritja:

- Š Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzon për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në drejtorinë e administratës në komunë, zyrën e personelit, zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet listës së të punësuarve, akteve të emërimit/procesverbaleve, raporteve të zyrtarit për barazi gjinore.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 16.1.3 - Zyrtarë të emëruar politik gra në postet politike në komunë

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim matjen e përmbushjes së obligimit të komunës për të siguruar balancën gjinor në postet politike të strukturës komunale, përkatësisht në pjesën e të emëruarve në postet politike si zv. Kryetar komune, drejtorë komunal, këshilltarë politik, dhe postet e me mandat politik. Përkatësisht për të matë zhvillimet në proceset e integritetit të grave dhe kundër diskriminimit të tyre.

#### Çfarë matet?

Treguesi mat mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për matjen e përkatësisë gjinore/femër për pozitat e theksuara udhëheqëse, përkatësisht për pozitat në të cilat personat emërohen nga niveli politik i komunës. Treguesi nuk matë cilësinë e udhëheqjes, përkatësisht nuk matë kontributin e grave dhe vajzave pjesëmarrëse në postet udhëheqëse të komunës.

Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, Sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi; dhe kontribuon në fushën Të drejtat e njeriut, shërbimet sociale dhe familjare, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e komunës në raport me qytetarët e saj lidhur me politikën për mos-diskriminimin dhe integritetin e grave në shoqëri, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe strategjive përkatëse.

#### Sqarime të hollësishme

Kuadri ligjor<sup>50</sup> jep parime për vendosjen e sistemit të mbajtjes së evidencës lidhur me mbledhjen dhe disagregimin e të dhënave në baza gjinore më interes të avancimit të interesave të grave në komunë dhe të grave në raport me komunën. Parimi në fjalë, si dispozitë ligjore, në kontekstin e këtij treguesi nënkupton se autoritetet komunale kanë për obligim, përmes bashkëpunimit më zyrtarin komunal për barazi gjinore,

<sup>50</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

të sigurojnë se evidenca relevante për agjendën e integrimit dhe sigurimit të përfaqësimit gjinor është e plotë në kuptimin se të dhënat si lista e të punësuarve duhet të përmbajë edhe informatën mbi gjininë, duke mos bërë në këtë pikë për nevojat e SMKP-së në mes të shërbyesve civil dhe politik të komunës. Mbledhja e informatave për përkatësinë gjinore është thelbësore për të siguruar mundësinë e shqyrtimit të përbërjes së personelit në komunë në bazë të gjinisë, me qëllim të avancimit të çështjeve gjinore në interes të integrimit të grave dhe sigurimit të parimeve të mos-diskriminimit.

Për nevojat e këtij treguesi duhet të merren parasysh vetëm të punësuarit/emëruarit në poste politike, duke siguruar se nuk janë të përfshirë edhe shërbyesit civil në listën e zyrtarëve të komunës. Konkretisht, duhet të konsiderohen: zv. kryetari, zv. kryetari për komunitete (ku është zgjedhur një i tillë), drejtorët e drejtorive komunale, si dhe këshilltarët politik dhe pozita të tjera të kabinetit të kryetarit sipas udhëzimit administrativ<sup>51</sup>.

Në këtë kontekst, treguesi bën matjen e zbatimit të dispozitave ligjore për përfaqësim të barabartë gjinor në pozita udhëheqëse. Matja e përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse në komunë, ka për qëllim forcimin e pozitës së grave/vajzave dhe përmirësimin e proceseve të demokracisë lokale, posaçërisht për nga perspektiva gjinore në kontekst të këtij treguesi.

Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë/aktet e emërimit për pozitat e theksuara, përkatësisht numri dhe disagregimi sipas gjinisë, për vitin e raportuar.

Në këtë mënyrë vlerësohet respektimi i dispozitës ligjore për të siguruar promovimin e integrimit dhe përfaqësimit në poste udhëheqëse, për të siguruar balancën gjinor.

Pjesëmarrja e grave dhe vajzave në nivel të barabartë me meshkuj në postet e udhëheqëse publike, nënkupton se gratë kanë mundësinë dhe fuqinë për tu marrë me vendimmarrje në interes të qytetarëve, pa paragjykuar gjininë e udhëheqësve të këtyre posteve si pengesë apo diskriminim në bazë të gjinisë nga ana e nivelit të pushtetit lokal.

Për nevojat e SMPK-së merret si mos-përmbushje të dispozitës nëse burimet/dëshmitë e të punësuarve të kërkuara për këtë tregues nuk kanë evidencë në përgjithësi, apo edhe nëse evidenca e pjesëmarrjes nuk e ka shënuar përkatësinë gjinore të zyrtarëve të listuar. Në rastet e mos-përmbushjes së obligimit për evidentim, treguesit i caktohet vlera zero (0).

## **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

---

<sup>51</sup> Udhëzimi i Administrativ (MPL) Nr. 02/2014 MAP Nr.1 për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. numri i përgjithshëm i grave dhe vajzave të emëruara në postet politike në komunë
2. numri i përgjithshëm i zyrtarëve të emëruar postet politike në komunë

Treguesi paraqet përqindjen e pjesëmarrjes së grave në takimet publike të organizuara nga komuna.

### Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = \left( \frac{E\ dhëna\ 1}{E\ dhëna\ 2} \right) * 100 * 2$$

**Llogaritja:**

- Š Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzon për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në drejtorinë e administratës në komunë, zyrën e personelit, zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet listës së të punësuarve, akteve të emërimit/procesverbaleve, raporteve të zyrtarit për barazi gjinore.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 16.1.4 - Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale

### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të arrihet përfaqësim i barabartë i gjinive në komitetet e kuvendeve komunale si trupa të rëndësishëm të politikëbërjes në kuvend komunal si dhe komisionet e themeluara nga kuvendi komunal.

### Çfarë matet?

Ky tregues matë nivelin e përfaqësimit gjinor në Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete, komitetet tjera të themeluara nga kuvendi komunal i komunës përkatëse dhe komisione të themeluara nga kuvendi komunal. Këtu nuk përfshihen komisionet e themeluara nga zyra e Kryetarit. Edhe pse në këto trupa numri i anëtarëve është numër tek dhe teknikisht është e pa mundur të arrihet përfaqësimi 50%, megjithatë sa më i lartë numri i dy gjinive aq më e lartë vlera. Po ashtu, ky tregues ka katër të dhëna prej të cilave nxjerrët vlera përfundimtare duke marrë mesataren. Andaj, barazi gjinore

matet duke marrë për bazë mesataren përgjatë këtyre katër të dhënave. Në përgjithësi gratë mbesin më pak të përfaqësuara në këto trupa edhe si shkak i përfaqësimit shpesh jo më të lartë se 30-35% në kuvend komunal.

Ky tregues ka edhe bazë ligjore tek Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020 ku në nenin 6.7 dhe 6.8 ku thuhet: *Neni 6.7 Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji. Neni 6.8. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.*

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten katër të dhëna:

1. Përqindja e grave në Komitetin për Politikë dhe Financa
2. Përqindja e grave në Komitetin për Komunitete
3. Përqindja e grave në komitetet tjera
4. Përqindja e grave në komisione të kuvendit komunal (komision për koordinimin e këshillave lokal, komisione të aksionarëve të ndërmarrjeve publike etj).

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$\text{Treguesi} = \left( \frac{e \text{ dhëna } 1 + e \text{ dhëna } 2 + e \text{ dhëna } 3 + e \text{ dhëna } 4}{4} \right) * 100 * 2$$

### Llogaritja:

- Š Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzon për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në drejtorinë e administratës në komunë, zyrën e personelit, zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet listës së të punësuarve, akteve të emërimit/procesverbaleve, raporteve të zyrtarit për barazi gjinore.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 16.1.5 - Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale

#### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të matet përfaqësimi gjinor tek anëtarët e këshillave lokal të zgjedhur në vendbanime të komunës.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë përfaqësimin e grave tek kryesuesit e këshillave lokal dhe tek anëtarët e këshillave lokal të themeluar në komunë. Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane rregullon organizimin e vendbanimeve të komunës për ushtrimin e disa aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës. Këshillat lokal mund të kenë pesë (5) deri në nëntë (9) anëtarë dhe zgjidhen nga një komision i themeluar nga kuvendi komunal. Njëri nga këta pesë (5) deri në nëntë (9) anëtarë zgjidhet kryetari i këshillit lokal dhe të gjithë anëtarët kanë mandat katër vjeçar që nga zgjedhja. Udhëzimi Administrativ neni 6.2 kërkon që këshillat lokal të kenë përfaqësim gjinor dhe etnik. Andaj, ky tregues mat nivelin e përfaqësi mit gjinor në përbërje të këtyre këshillave si dhe përfaqësimin gjinor tek kryetarët e këtyre këshillave.

Këta këshilla janë të rëndësishëm për organizim të lagjes dhe fshatit/rave që i përfaqësojnë dhe marrëveshja e bashkëpunimit me kuvendin komunal bëhet për bashkëpunim në çështje si: Planifikimin urban dhe rural; Furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimin; Shëndetësinë publike; Mbrojtjen lokale të ambientit; Turizmin; Hapësirave publike dhe varrezave; dhe Aktiviteteve kulturore dhe sportive etj.

#### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

#### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten katër të dhëna:

1. Numri i këshillave lokal të themeluar në komunë
2. Numri i këshillave lokal që kryesohen nga gra
3. Numri i përgjithshëm i anëtarëve nga gjithë këshillat lokal të themeluar dhe funksional gjatë vitit në komunë
4. Numri i përgjithshëm i anëtarëve gra nga gjithë këshillat lokal të themeluar

#### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \left[ \left( \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 70 \right) + \left( \frac{e \text{ dhëna } 4}{e \text{ dhëna } 3} * 30 \right) \right] * 2$$

Llogaritja:

- Š Përfaqësimi gjinor në mes të kryetarëve të këshillave lokal ka 70% të peshës së treguesit kurse përfaqësimi gjinor tek anëtarët e këshillave lokal ka 30%-shin tjetër të peshës së treguesit;
- Š Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzohet për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në drejtorinë e administratës në komunë, zyrën e personelit, zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet listës së të punësuarve, akteve të emërimit/procesverbaleve, raporteve të zyrtarit për barazi gjinore.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Rezultati 16.2 - Barazia gjinor në përfitime të programeve dhe aktiviteteve të komunës

Rezultati përfaqëson arritjen e performancës komunale në përfshirjen e dy gjinive në përfitimet komunale që ndahen gjatë vitit. Ky rezultat synon përfshirjen gjinore në buxhet, në ndarjen e subvencioneve komunale por edhe përfshirjen gjinore në konsultime publike e politika komunale.

Ky rezultat përfshin arritjet e buxhetimit dhe shpenzimit të përgjegjshëm gjinor si dhe planet komunale të përgjegjshme gjinore. Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohet gjinia femërore në përfitime më të mëdha në projekte komunale dhe aktivitete komunale përmes buxhetit, shpenzimit dhe planifikimit. Arritja e rezultatit matet me treguesin 16.2.1, 16.2.2, 16.2.3, dhe 16.2.4.

### Treguesi 16.2.1 - Buxheti dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor

#### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është të nxitë komunat që të vlerësojnë ndikimin e planifikimit buxhetor dhe shpenzimeve vjetore në gjini të ndryshme. Buxheti i përgjegjshëm gjinor si dhe shpenzimet e përgjegjshme gjinore sigurohet që dy gjinitë përfitojnë nga planifikimet dhe shpenzimet e komunës. Gjithashtu i shtyn institucionet komunale që në proces të hartimit të buxhetit të sigurohen që nga projektet komunale si dhe shpenzimet tjera përfitues do të jenë dy gjinitë sa më proporcionalisht dhe jo të favorizohet njëra gjini shumë më shumë.

#### Çfarë matet?

Ky tregues vlerëson nëse komuna e ka përfshirë deklaratën e vlerësimit gjinor në buxhetin komunal sipas Nenit 5 pika 1.5 Ligji për Barazi Gjinore dhe në raportet periodike të shpenzimeve. Në Ligjin për Barazi Gjinore tek neni për *Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore* një nga pikat për këtë është edhe përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve<sup>52</sup>.

Institucionet komunale dhe drejtoria përkatëse për buxhet duhet të përgatiten me trajnime për të vlerësuar ndikimin e projekteve komunale dhe shpenzimeve për ndikim gjinor. Shpesh ka ngatërime se si një projekt kapital, një subvencion apo një shpenzim tjetër komunal mund të ndikoj njërin gjini më shumë se tjetrën. Megjithatë praktika tregon se nëse nuk planifikohet me një përgjegjshmëri ndaj dy gjinive, pa dashje mund të favorizohet njëra gjini shumë më shumë.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. Përfshirja e aspektit gjinor në buxhetin komunal
2. Përfshirja e aspektit gjinor në raportet financiare periodike

### Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = (E\ dhëna\ 1 * 50) + (e\ dhëna\ 2 * 50)$$

**Llogaritja:**

- Š E dhëna 1 dhe e dhëna 2 duhet ta ketë vlerën '1' ose '0'.
- Š Shënimi me '1' tek e dhëna e parë ose e dytë nënkupton që ai dokument ka përfshirë aspektin gjinor, ndërsa '0' nënkupton që aspekti gjinor NUK figuron në atë dokument.
- Š Vlerësimi me '1' në secilën të dhënë jep vlerën 50%; dy të dhënat me vlerësim '1' (që nënkupton pohimin e dispozicionit të dokumenteve siç kërkohet) japin vlerën maksimale 100%;
- Š Duhet ta dini se nuk duhet shënuar numër më i madh se '1' pra ose '0' ose '1'.

### Burimi kryesor i të dhënave

<sup>52</sup> <https://gzkrks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>



**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në drejtorinë përkatëse për buxhet, zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet buxhetit të miratuar në kuvend dhe raporteve buxhetore tre-mujore të shtruara në kuvend komunal.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 16.2.2 - Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave

### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është që gratë dhe kompanitë e udhëhequra nga gratë në komunë të përfitojnë subvencione komunal në mënyrë të barabartë me burrat dhe kompanitë që udhëhiqen nga burrat.

### Çfarë matet?

Treguesi matë nivelin e buxhetit të subvencioneve komunale për gjininë femërore si dhe numrin e përfituesve të subvencioneve për gjininë femërore. Pra ky tregues matë dy aspekte të përfitimeve: atë të buxhetit dhe të përfituesve. Tek subvencionet komunale këtu përfshihen bursat për student, subvencionet për skemat e punësimit, subvencionet për ndërmarrjet afariste të komunës, subvencionet për bujqësi, subvencione për veprimtari kulturore, rinore dhe sportive si dhe subvencione tjera që ndan komuna për atë vit.

Dy të dhënat e para masin proporcionin e buxhetit për subvencione që ndahet për dy gjinitë ndërsa dy të dhënat e fundit masin proporcionin e përfituesve për subvencione që ndahet për dy gjinitë.

Në raste kur përfituesit nuk janë individë por janë subjekte juridike, si biznese apo organizata jo-qeveritare (OJQ), udhëheqësi/ja e atij biznesi apo OJQ-je futet në llogari.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten katër të dhëna:

1. Buxheti total i ndarë për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë, subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik
2. Buxheti i ndarë për skema të punësimit, dhe ndërmarrësisë për gra dhe vajza, subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik
3. Numri i përfituesve të përgjithshëm
4. Numri i grave përfituese

### Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = \left[ \left( \frac{E_{dhëna\ 1}}{E_{dhëna\ 2}} * 50 \right) + \left( \frac{E_{dhëna\ 3}}{E_{dhëna\ 4}} * 50 \right) \right] * 2$$

#### Llogaritja:

- Š Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzon për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në drejtorinë përkatëse për buxhet, zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, si dhe në arkivin e komunës. Të dhënat verifikohen nëpërmjet listës së përfituesve të subvencioneve (personave udhëheqës nëse përfitues ka qenë kompani apo organizatë jo-qeveritare)

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Treguesi 16.2.3 – Pjesëmarrja e grave në konsultime publike

#### Qëllimi

Ky tregues ka për qëllim matjen e përmbushjes së obligimit të komunës për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në gjitha konsultimet publike të komunës, përkatësisht për të matë zhvillimet në integrimin e grave-vajzave dhe kundër diskriminimit të tyre.

#### Çfarë matet?

Treguesi bën matjen e zbatimit të dispozitave ligjore për përfshirjen më të madhe të grave dhe vajzave në proceset që zhvillohen përmes takimeve publike në organizim të komunës. Matja e pjesëmarrjes së grave në takimet publike ka për qëllim përmirësimin e proceseve të demokracisë lokale, duke siguruar gjithëpërfshirjen dhe duke shtyrë përpara interesat për të përmirësuar përfshirjen e grave dhe uljen deri në zhdukje të diskriminimit gjinor. Përmes matjes së përfshirjes të grave-vajzave në proceset e takimeve publike, sigurohet transparenca dhe llogaridhënia, si dhe shqyrtimi i çështjeve me interes publik nga pikëpamja e grave.

#### Sqarime të hollësishme

Kuadri ligjor<sup>53</sup> jep parime për për vendosjen e sistemit të mbajtjes së evidencës lidhur me mbledhjen dhe disagregimin e të dhënave në baza gjinore më interes të avancimit të interesave të grave dhe vajzave në komunë dhe të grave në raport me komunën . Parimi në fjalë, si dispozitë ligjore, në kontekstin e këtij treguesi nënkupton se autoritetet komunale kanë për obligim, përmes bashkëpunimit më zyrtarin komunal për barazi gjinore, të sigurojnë se evidenca e pjesëmarrësve në takimet publike të organizuara nga komuna

<sup>53</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore

regjistron edhe të dhëna për gjininë e pjesëmarrësve, për shkak të kërkesës për ndarje dhe analizë të pjesëmarrësve në bazë gjinore.

Në kontekst të këtij treguesi, pjesëmarrja e grave në takime publike nënkupton të gjitha takimet që i organizon komuna me qytetarë, si takimet e rregullta me qytetarë (minimum 2 në vit), dëgjimet buxhetore (minimum 2 në vit), dhe takimet konsultative për akte komunale dhe dokumente të politikave lokale. Për nevojat e këtij treguesi, nuk është e rëndësishme agjenda dhe pikat e rendit të ditës së takimeve publike.

Akti i matjes së përmbushjes së obligimit për të siguruar pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në takime publike (të tri kategorive të takimeve me publikun), i referohet vitit paraprak. Në kontekst të këtij treguesi, nuk paragjykohet numri i takimeve publike, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve dhe disagregimi i tyre në bazë gjinore mblidhet për të gjitha takimet publike të organizuara nga komuna.

Për matjen e këtij treguesi kërkohen dëshmitë për mbajtjen e takimit publik nga ana e komunës, veçmas për secilin takim, dhe regjistrat me evidencën e pjesëmarrësve, qoftë si listë qoftë si vlerësim në raport për takimin.

Në këtë mënyrë vlerësohet respektimi i dispozitës ligjore për të siguruar promovimin e mos-diskriminimit dhe balancin gjinor, respektivisht gjithëpërfshirjen në proceset e ndërveprimit me qytetarët në nivel të komunës

Pjesëmarrja e grave në nivel të barabartë me meshkuj në takime publike, nënkupton se gratë dhe vajzat kanë mundësinë për tu informuar lidhur me punën e autoriteteve komunale, për paraqitjen dhe artikulumin e interesave që kanë, si dhe për të diskutuar/shqyrtuar lidhur me punën dhe planet e komunës si instancë e pushtetit lokal.

Treguesi nuk matë cilësinë e pjesëmarrjes, përkatësisht nuk matë kontributin e grave apo vajzave pjesëmarrëse në takimet publike.

Për nevojat e SMPK-së merret si mos-përmbushje të dispozitës nëse takimi publik nuk ka evidencë të pjesëmarrësve në përgjithësi, apo edhe nëse evidenca e pjesëmarrjes nuk e ka shënuar përkatësinë gjinore të pjesëmarrësve. Në rastet e mos-përmbushjes së obligimit për evidentim, treguesit i caktohet vlera zero (0).

Treguesi mat mjaftë saktë zbatimin e këtij obligimi ligjor për matjen e përkatësisë gjinore/grua-vajzë për popullatën pjesëmarrëse në takimet publike të komunës.

Matja e përmbushjes së këtij treguesi e informon drejtpërdrejt rezultatin, Sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi; dhe kontribuon në fushën Të drejtat e njeriut, shërbimet sociale dhe familjare, për arritjet dhe përgjegjshmërinë e komunës në raport me qytetarët e saj lidhur me politikat për mos-diskriminim dhe avancimin e grave në shoqëri, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe strategjive përkatëse.

## Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit, rrjedhimisht është tregues nominal apo jo-kumulativ, dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

## Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në konsultime publike
2. numri i përgjithshëm i grave dhe vajzave pjesëmarrëse në konsultime publike

Treguesi paraqet përqindjen e pjesëmarrjes së grave në takimet publike të organizuara nga komuna.

## Formula e llogaritjes

**Formula:**

$$Treguesi = \left( \frac{E\ dhëna\ 2}{E\ dhëna\ 1} * 100 \right) * 2$$

**Llogaritja:**

- § Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzon për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

## Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, sekretaria e kuvendit të komunës, arkiva e komunës, dhe faqen zyrtare të komunës në internet.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet listave të pjesëmarrjes, procesverbaleve dhe raporteve të takimeve publike, si dhe në aktet e publikuara për punën e komunës.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## Treguesi 16.2.4 - Plani komunal për barazi gjinore

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim të ngrit performancën komunale për barazi gjinore në komunë duke miratuar një plan komuna për avancimin e barazisë gjinore nëpërmjet aktiviteteve, hapësirave dhe buxhetit komunal.

### Çfarë matet?

Ky treguesi matë nëse komuna përkatëse e ka të miratuar një plan për barazi gjinore siç kërkohet ligjërisht si dhe nëse e ka zbatuar atë plan gjatë vitit përkatës. Ligji për Barazi Gjinore, tek neni për *Masat e*

*përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore*, një nga pikat për këtë është edhe miratimi i strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për barazi gjinore. Pra, secila komunë obligohet që të ketë planin komunal për barazi gjinore i cili është në vijë me Programin nacional. Një komunë konsiderohet se e ka planin komunal për barazi gjinore nëse ai plan është i miratuar direkt ose indirekt (përmes një dokumenti më afat gjatë) në kuvend komunal.

Ky plan vjetor duhet të parasheh aktivitetet vjetor për avancim të barazisë gjinore në fusha të ndryshme të cilat i kanë nën kompetencë institucionet komunale. Komuna mund të ketë strategji për barazi gjinore që ka afat tre-vjeçar, megjithatë ajo strategji duhet të ketë planin vjetor të veprimit.

E dhëna e dytë e këtij treguesi matë nëse plani komunal për barazi gjinore është zbatuar në përpikëri gjatë vitit.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit dhe fillon me vlerë zero (0) çdo vit raportues.

### **Të dhënat**

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. Dokumenti i zhvilluar, i miratuar dhe aktualisht në fuqi
2. Implementimi i aktiviteteve nga plani vjetor për barazi gjinore

### **Formula e llogaritjes**

**Formula:**

$$Treguesi = (E\ dhëna\ 1 * 50) + (E\ dhëna\ 2 * 50)$$

### **Llogaritja:**

- Š E dhëna 1 dhe e dhëna 2 duhet ta ketë vlerën '1' ose '0'.
- Š Shënimi me '1' tek e dhëna e parë ose e dytë nënkupton që komuna disponon me plan vjetor (për të dhënë 1) ose e ka zbatuar në përpikëri atë plan (për të dhënë 2), ndërsa '0' nënkupton që komuna nuk disponon me këtë dokument (për të dhënë 1) ose nuk e ka zbatuar në përpikëri atë plan (për të dhënë 2).
- Š Vlerësimi me '1' në secilën të dhënë jep vlerën 50%; dy të dhënat me vlerësim '1' japin vlerën maksimale 100%;
- Š Duhet ta dini se nuk duhet shënuar numër më i madh se '1' pra ose '0' ose '1';

### **Burimi kryesor i të dhënave**

**Burimi i të dhënave.** në zyrën e zyrtarit për barazi gjinore, zyrën e kryetarit të komunës, sekretaria e kuvendit të komunës, arkiva e komunës, dhe faqen zyrtare të komunës në internet.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet dokumentit të planit vjetor për barazi gjinore si dhe raportit për zbatueshmërinë e atij plani vjetor.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### Rezultati 16.3 - Përfaqësimi gjinor në procese të rëndësishme shoqërore në komunë

Rezultati përfaqëson arritjen e performancës komunale në përfshirjen e dy gjinive në procese komunale që kanë ndikim shoqërorë. Ky rezultat synon përfshirjen gjinore në proces si emërtime të rrugëve që vlerësojnë edhe kontributin e grave në shoqërinë kosovare si deh përfshirjen e grave në pronësinë e pronave të paluajtshme.

Ky rezultat përfshin arritjet e barazisë gjinore në emërtime të rrugëve dhe pronësi të përbashkët të pronës së paluajtshme. Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohet gjinia femërore në përfaqësim në procese të rëndësishme shoqërore.

Arritja e rezultatit matet me treguesin 16.3.1, dhe 16.3.2.

#### Treguesi 16.3.1 - Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve

##### Qëllimi

Qëllimi i këtij treguesi është që të rritet niveli i emrave të rrugëve komunale që emërohen pas personave të gjinisë femërore pasi rezultojnë të jenë në nivel jashtëzakonisht të ulët përkundër proporcionit të grave në përbërjen e popullsisë.

##### Çfarë matet?

Ky tregues matë nivelin e rrugëve të emërtuar me emra të gjinisë femërore. Një nga kompetencat vetanake të institucioneve komunale, sipas nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, është edhe emërimi i rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike. Komuna duhet të kenë komisione për emërimin e rrugëve dhe për të rezultuar me performancë sa më të mirë në këtë tregues, këto komisione duhet që të rrisin nivelin e emërimit të rrugëve pas personaliteteve të gjinisë femërore. Edhe pse në fillim gjitha komunat do të kenë nivel të ulët të përfaqësimit gjinor tek emërtimet e rrugëve, qëllimi i treguesëve është që kjo të ngritet ndër vite.

Tek e dhëna e parë futet vetëm numri i rrugëve për të cilat janë emëruar pas individëve, dhe jo rrugët të emëruara pas qyteteve, ngjarjeve historike apo subjekteve juridike. Pra këtu nuk llogariten rrugët me emra si "Tirana" "Dubrovniku" etj. Ndërsa në të dhënën e dytë futen vetëm numri i rrugëve të emëruara pas personaliteteve të gjinisë femërore.

##### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative.

##### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. Numri i rrugëve në komunë të emërtuar pas personave
2. Numri i rrugëve të emërtuar pas personave të gjinisë femërore

##### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \left( \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} * 100 \right) * 2$$

#### Llogaritja:

- Š Ky tregues pasi matë përfaqësimin gjinor, 50% pjesëmarrje është vlera maksimale prej 100%. Andaj dhe formula shumëzon për dy vlerën e përpjestuar të dy treguesve.

### **Burimi kryesor i të dhënave**

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në sekretarin e kuvendit komunal, drejtorinë përkatëse për urbanizëm.

Të dhënat verifikohen nëpërmjet listës së rrugëve të komunës me bazë emrat e personaliteteve.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

### **Treguesi 16.3.2 - Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij treguesi është të nxit institucionet komunale që të promovojnë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve dhe, në raste të trashëgimisë, në emër të motrave dhe vëllezërve.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë nivelin e pronësisë së pronës së paluajtshme në emër të dy gjinive (bashkëshortit dhe bashkëshortes apo, në raste trashëgimie, në emër të motrave dhe vëllezërve pasi është jashtëzakonisht e ulët. Autoritetet publike janë të obliguara që të zbatojnë masa të veçanta të përkohshme me qëllim të rritjes së numrit të grave të regjistruara si pronare të përbashkëta si dhe me qëllim të përsheptimit të realizimit të barazisë faktike midis burrave dhe grave në të drejtën pronësore. Ky obligim del nga Udhëzimi Administrativ i miratuar nga Qeveria e Kosovës me 4 mars, 2016 që thirret U.A. Nr. 03/2015 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në emër të dy Bashkëshortëve. Po ashtu, *Strategjia Kombëtar për të Drejtat Pronësore në Kosovë*<sup>54</sup> kërkon që të promovohet dhe mbrohet e drejta pronësore e grupeve të marginalizuara si gratë dhe personave të zhvendosur si në trashëgimi ashtu edhe në marrëdhënie martesore dhe jashtë martesore.

Udhëzimit Administrativ për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në emër të dy Bashkëshortëve është plotësuar dhe ndryshuar disa herë nga viti 2015 me qëllim të shtyrjes së periudhës së përkohshme të këtyre masave. Ky Udhëzim Administrativ është bërë me qëllim të promovimit të regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve në regjistrat publik. Këto masa të veçanta janë të përkohshme, të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushë specifike siç është regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve.

<sup>54</sup> Ministria e Drejtësisë. Dhjetor 2016. *Strategjia Kombëtar për të Drejtat Pronësore në Kosovë*. <http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/National Strategy and Annexes ALB.pdf>

Sipas Udhëzimit Administrativ në fjalë, **komunat në Kosovë**, përkatësisht Zyrat Kadastrale janë të obliguara të i zbatojnë këto masa duke i liruar nga tarifa e regjistrimit të pronës kur regjistrimi bëhet në emër të dy bashkëshortëve. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2014 Për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga zyrat kadastrale komunale, në Nenin 5 është paraparë Tarifa e Regjistrimit prej 20 Euro për regjistrimin e pronësisë së përbashkët nga të dy bashkëshortët të pronës së përbashkët.

Pronë e përbashkët nënkuptohet pasuri e krijuar gjatë jetës në martesë e cila regjistrohet si pronë e përbashkët, administrohet bashkërisht dhe nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e bashkëshortëve.

UNDP-ja e ka ranguar Kosovën me 0.76 në Indeksin e tij të zhvillimit gjinorë, që është më e ulëta në rajonin e Ballkanit. Aktualisht, Kosova ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes ekonomike të grave nga të gjitha shtetet në botë. Shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore në Kosovë është nën atë të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë. Pra për mes masave të përkohshme të caktuara me udhëzim administrativ por edhe masave të vazhdueshme synohet që të rritet regjistrimi i pronësisë nga dy gjinitë.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet në mënyrë përmbledhëse (komulative) vit pas viti. Për këtë tregues raportohet në mënyrë përmbledhëse apo komulative.

### Të dhënat

**Të dhënat.** Të dhënat janë të disponueshme dhe për përmbushjen e treguesit nevojiten dy të dhëna:

1. Numri i pronave të regjistruara në komunë
2. Numri i pronave të regjistruara në emër të dy apo më shumë personave dhe me gjini të ndryshme

### Formula e llogaritjes

Formula:

$$Treguesi = \frac{E \text{ dhëna } 2}{E \text{ dhëna } 1} \times 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

**Burimi i të dhënave.** Të dhënat gjinden në zyrat kadastrale dhe drejtoritë përkatëse për urbanizëm dhe kadastër. Të dhënat verifikohen nëpërmjet regjistrimit të pronave kadastrale të komunës.

Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave për vitin përkatës.

## FUSHA 17 - ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Emri i fushës është “Arsimi parauniversitar”. Këshilli i Evropës në përgjithësi e përkufizon arsimin si një proces përmes të cilit shoqëria transmeton njohuritë, aftësitë dhe vlerat e grumbulluara nga njëri brez në



tjetrin. Në kuptim më të gjerë, arsimimi mund të përfshijë çdo akt ose përvojë që ka një efekt formues mbi mendjen, karakterin ose aftësinë fizike të një personi. Ai ka një ndikim thelbësor në aftësitë dhe potencialet e njerëzve dhe komuniteteve për arritjen e zhvillimit, si dhe të suksesit shoqëror dhe ekonomik. Paraqet një nga faktorët kryesor për zhvillim dhe për fuqizimin e njerëzve. Arsimi i pajis njerëzit me njohuri dhe informata dhe kontribon në krijimin e ndjenjës së vetëbesimit dhe realizimin e potencialit të njeriut. Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut në nenin 26 thotë: “Gjithkush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore dhe të ulëta. Arsimi fillor është i detyrueshëm.” Shoqëria e arsimuar është një aspiratë më vete për të gjitha shoqëritë e civilizuar, kështu që arsimi dhe avancimi i tij përfaqësojnë një interes të veçantë për komunitetet, autoritetet lokale dhe autoritetet qeveritare të nivelit qendror. E drejta për arsimim dhe përfshirje në arsimin themelor publik është një nga të drejtat elementare të përcaktuara në nenin 47 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Arsimi i detyrueshëm fillon me nivelin 0 dhe përfundon me nivelin 2 sipas klasifikimit ISCED, ndërsa ligji për arsimin në komunat e Kosovës dhe kompetencat përkatëse të Drejtorisë Komunale të Arsimit, përcakton se niveli i kompetencave fillon me institucionet që ofrojnë nivelin 0 dhe përfundon me institucionet që ofrojnë nivelin 3. Komunat janë përgjegjëse për menaxhimin e institucioneve parauniversitare në (0) nivel parashkollor, (1) shkollave fillore, (2) shkollave të mesme të ulëta, dhe të (3) shkollave të mesme të larta. Tri ligje bazë e rregullojnë arsimin e nivelit parauniversitar në Kosovë: Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17 Kompetencat, paragrafi h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, neni 7 Kompetencat e Komunës; dhe Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat, neni 5 Kompetencat komunale për nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të Arsimit Publik (Parashkollor, Fillor, Niveli i Mesëm i Ulët dhe i Mesëm i Lartë). PSAK liston 6 objektiva strategjike që janë relevante për performancën e sektorit, (1) Pjesëmarrja dhe përfshirja, (2) Menaxhimi i sistemit arsimor, (3) Sigurimi i cilësisë, (4) Zhvillimi i mësimdhënësve, (5) Mësimdhënia dhe mësimnxënia, (6) Mësimdhënia dhe aftësimi profesional dhe edukimi i të rriturve. Si dokument referent për treguesit në këtë fushë është edhe Korniza e Treguesve të Arsimit në Kosovë, e zhvilluar nga MASHT, versioni i tetorit 2017. Komunat janë të detyruara të zbatojnë politikat arsimore të Ministrisë në sistemin parauniversitar të arsimit, të sigurojnë burimet, mbështetjen administrative dhe menaxhimin e shkollës përmes konceptit të shumë palëve të interesit (bordet drejtuese të shkollave). Arsimi parauniversitar ofrohet nëpërmjet rrjetit të organizuar të institucioneve arsimore bazuar në konceptin e arsimit parashkollor, të shkollës fillore dhe të mesme të ulët dhe të mesme të lartë (duke përfshirë AAP-në). Drejtoria Komunale e Arsimit është përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e shërbimit publik të arsimit parauniversitar në territorin e komunës. Matja e performancës së komunave në fushën e arsimit parauniversitar publik është e rëndësishme sepse shërben si mjet për matjen e punës së kryer nga autoritetet komunale në raport me qëllimet themelore. Rezultatet e performancës i mundësojnë MPL-së dhe organeve të tjera qeveritare mbikëqyrjen e punës së autoriteteve komunale, posaçërisht, për të përcjellur dhe identifikuar përparimin dhe zhvillimin, e po ashtu edhe stagnimin ose përkeqësimin, si dhe t'u ofrojnë autoriteteve relevante informata për shqyrtime të thelluar me qëllim të përmirësimit. Arritjet e komunës në fushën e “Arsimit parauniversitar komunal” maten nëpërmjet tri rezultateve dhe 16 treguesve, të përshkruar më poshtë.

## Rezultati 17.1 Shtrirje adekuate të infrastrukturës arsimore, objekte dhe hapësira të paisura me mjete bashkohore për zhvillimin e aktivitetetve mësimore

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës për shtrirje adekuate të infrastrukturës arsimore, objekte dhe hapësira të paisura me mjete bashkohore për zhvillimin e aktivitetetve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përfshirë edhe edukimin e hershëm. Aktivitetet dhe masat e përcaktuara këtu lidhen me dispozitat elementare që përcaktojnë arsimin parauniversitar, aktivitetet arsimore që mbahen përmes rrjetit të institucioneve arsimore nën autoritetin e Drejtorisë Komunale të Arsimit (parashkollor, fillor dhe i mesëm i ulët dhe i lartë, duke përfshirë AAP-në). Rezultati synon matjen e komponentëve kryesorë të shtrirë të arsimit parauniversitar publik siç parashihet në PSAK 2017-2021, të cilët paraqesin detyrime për Drejtorinë Komunale për Arsim përmes UA 23/2013, Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit. Prandaj, këto janë objektivat e planifikimit dhe zbatimit të planit vjetor të punës të drejtorisë të përcaktuara në nenin 11, si dhe për monitorimin dhe raportimin e zbatimit në nenin 13, paragrafi 1.10 raportimi mbi zbatimin. Përveç kësaj, rezultati është i informuar edhe nga disponueshmëria e infrastrukturës fizike të arsimit parauniversitar, objekteve dhe pajisjeve, si dhe disponueshmëria e materialeve pedagogjike/didaktike (mjeteve të konkretizimit). Rezultati gjithashtu synon të sjellë produktet e veprimeve të komunës në trajtimin e sfidave me të cilat ballafaqohet arsimi parauniversitar në nivel komune, në kontekst të komplekseve të cilat janë trashëguar nga historia e rënduar, si dhe sfidat të cilat burojnë nga mësimdhënia dhe mësimxënia në mileniumin e ri. Ky rezultat përfshin arritjet e drejtorisë komunale të arsimit dhe arsimore institucioneve vartëse, personelit të dedikuar menaxhues dhe arsimor (profesional), në krijimin infrastrukturës adekuate në kuptimin e objekteve, lokacionin e tyre me qëllim të shërbimit të krejt qytetarëve, si dhe paisjen e objekteve arsimore me mjete dhe paisje për zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Pikë e fundit në kontekst të këtij rezultati është edhe siguria në mjediset e arsimit parauniversitar, pasi që ky është edhe parakusht për sigurimin e vijimit dhe zhvillimit të papenguar të aktivitetetve mësimore. Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohen grupet e shoqërisë në mënyrë që të përfshihen në sistemin publik arsimore qysh prej nivelit të edukimit të hershëm, dhe të vijojnë tërë ciklin e arsimit parauniversitar me rezultatesa më të larta, ashtu që si qytetarë të edukuar mirë ti sjellin shoqërisë dobi përmes zbatimit të njohurive dhe shkathtësive që i kanë fitu, pa marrë parasysh se a jetojnë në zona rurale apo urbane, dhe pa paragjyku gjininë, apo përkatësinë etnike. Arritja e rezultatit matet me treguesit 17.1.1, 17.1.2, 17.1.3, 17.1.4, 17.1.5 dhe 17.1.6.

### Treguesi 17.1.1

### Çerdhe dhe kopshte në zona rurale për 10000 banorë

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në ngritjen e kapaciteteve dhe shtrirjen e kopshteve nëpër vendbanime rurale, me qëllit të ofrimit të shërbimit për fëmijë të moshës (0-3) ISCED 01 sipas UA 19/2013 MASHT. Niveli i performancës së këtij treguesi nënkupton edhe performancën e komunës në ofrimin dhe sigurimin e kapaciteteve të çerdheve-kopshteve,

konkretisht në zonat jo-urbane (rurale), si parakusht infrastrukturor për sigurimin e shërbimit në zonat tradicionalisht të pa shërbyera.

### **Çfarë matet?**

Treguesi matë numrin e çerdheve dhe kopshteve në vendbanimet rurale në shërbim të të gjithë fëmijëve të moshës (0-3 vjeç) sipas ISCED nivelit 01 në kopshte publike nën menaxhim të komunës, në raport me 10,000 banorë nga popullata në vendbanimet rurale në nivel të komunës. Përkatësisht, matja bëhet për numrin total të çerdheve apo kopshteve të cilat janë aktualisht duke operuar dhe në të cilat ka fëmijë të cilët vijnë rregullisht. Kurse konteksti është numri i banoërve në vendbanimet rurale, i shprehur si numër për çdo 10,000 banorë. Sipas ligjit për arsim parauniversitar, komunat kanë kompetenca për sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për vendosjen nëpër çerdhe-kopshte të fëmijëve të moshës (0-3). (neni 10, para 5, Ligji 04-L-032).

### **Sqarime të hollësishme**

Sipas ligjit për arsim parauniversitar, niveli 0 sipas ISCED përfshinë fëmijët e moshës (0-6), mirëpo ligji stipulon për nevojat e harmonizimit me sistemin arsimor në Kosovë, ndarjen mbrenda nivelit 0 të ISCED të fëmijëve sipas moshave (0-3) dhe (4-6) vjeçarë. (neni 9, para 1.1, Ligji 04-L-032). Për saktësim më të mirë të ndarjes, MASHT ka pregaditë UA 19/2013 për Përshatjen e përkufizimeve të ISCED-it. Në këtë UA, ndahet niveli 0 i ISCED në 01 dhe 02, sipas grupmoshave, ku 01 nënkupton fëmijët prej 0 deri 3 vjeç. Arsyeja e sigurimit të çerdheve dhe kopshteve në vendbanime rurale, siguron parakushtin infrastrukturor esencial mbi të cilin ngritet shërbimi i cili krijon mundësitë për vijim në kopsht për fëmijët në vendbanimet rurale. Përveç dobive në aspektin social dhe edukativ, rritja e e vijimit të këtyre fëmijëve është edhe në interes për shkak se ju mundëson rritjen e pjesëmarrjes aktive në ekonomi të fuqisë punëtore, mundëson punësimin e plotë të të dy prindërve, the faktikisht ndihmon në realizimit të potencialit ekonomik përmes rritjes së pjesëmarrjes së grave në ekonomi.

Me banorë në zona rurale, nënkuptohen banorët e regjistruar në vendbanimet rurale, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011. Për komunat me karakter rural, vendbanimi kryesor merret si rural nëse si i tillë është i klasifikuar në Agjencionin e Statistikave të Kosovës.

Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në sigurimin dhe shtrirjen e shërbimeve publike në fushën e arsimit para-fillor apo edukimit të hershëshëm (çerdhe dhe kopshte), më konkretisht në vendbanime rurale, por jo plotësisht për shkak se ka mjaft fëmijë të cilët banojnë në zona rurale dhe vijnë kopshtin në zonë urbane, ku kjo është e shprehur për një kohë të gjatë sidomos për vendbanimet rurale që kufizohen me qytete (zona urbane). Komunat zakonisht, bëjnë organizimin e vendosjes nëpër kopshte publike përmes sistemimit, ku banorët e zonave përkatëse i takojnë një qendre të dedikuar si kopsht i cili ofron shërbim për një territor të përkufizuar. Respektivisht, banorët e një zone nuk kanë shumë mundësi për ndryshimin e kopshtit, në kuptimin e ndërrimit të lokacionit të kopshtit, pasi që e drejta e tyre për dërgimin e fëmijëve në kopsht është e lidhur me adresën e banimit. Mundësitë infrastrukturore, apo më saktësisht, pamjaftueshmëria e hapësirave për vendosje të fëmijëve në bazë të popullatës dhe në bazë të kapaciteteve ekzistuese, shfrytëzohet nga komuna si parameter për planifikimin dhe ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve në nivel të komunës. Lëvizjet e parregullta të fëmijëve lidhur me vijimin në çerdhe-kopshte nga zonat peri-urbane, apo rurale sipas klasifikimit, e vështirësojnë planifikimin dhe realizimin e kapaciteteve në një masë për autoritetet komunale.

Periodha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit të rregullt kalendarik, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar.

## Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe matet situata e arritur brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet për gjendjen në vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.1.1. mblidhen tri të dhëna:

1. Gjithsej numri i çerdheve dhe kopshteve në vendbanime rurale në nivel të komunës
2. Gjithsej numri i banorëve të cilët jetojnë në zona rurale në nivel të komunës
3. Gjithsej numri i çerdheve dhe kopshteve në nivel të komunës në përgjithësi

## Formula e llogaritjes

Treguesi paraqet herësin në mes të numrit të çerdheve dhe kopshteve në zonat rurale, dhe herësit të numrit të banorëve në zona rurale dhe numrit 10,000!

$$\text{treguesi i përgjithshëm} = \frac{e \text{ dhëna } 1}{\frac{e \text{ dhëna } 2}{10,000}} * 100$$

## Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë raportet e dorëzuara nga ana e drejtorive të çerdheve dhe kopshteve në DKA për çerdhet dhe kopshtet në nivel të komunës. Poashtu të dhënat për numrin e banorëve në vendbanime rurale janë në dispozicion pranë Regjistrat Civil, si dhe nga Agjencioni i Statistikave. DKA-të kanë nën menaxhim edhe të gjitha kopshtet publike në nivel të komunës, prej nga merren edhe të dhënat për kopshtet sipas lokacioneve të tyre, me qëllim të ndarjes dhe grupimit të çerdheve dhe kopshteve sipas karakterit të vendbanimit, urban dhe rural. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga dosjet që mbahen në DKA. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

### Treguesi 17.1.2 m2 të hapësirave shkollore për kokë nxënësi – urban dhe rural

## Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e infrastrukturës së mjaftueshme shkollore në raport me numrin e nxënësve (4-18 vjeçar) të cilët vijojnë shkollën (parafillor, fillor, mesme ulët, dhe mesme të lartë), të ndarë në shkollat në vendbanime urbane dhe ato rurale. Sipas ligjit për arsim parauniversitar, komunat kanë obligim për sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për vendosjen e nxënësve nëpër hapësira shkollore. (neni 7, para 3.1, Ligji 04-L-032).

## Çfarë matet?

Treguesi matë raportin e sipërfaqës së përgjithshme të infrastrukturës shkollore të nivelit parauniversitar, përjashtuar këtu ato parashkollore, në raport me numrin e nxënësve të cilët vijojnë, duke veçuar shkollat në vendbanime urbane dhe ato rurale. Matet sipërfaqja e shkollave publike veçmas për ato në vendbanime urbane dhe ato në vendbanime rurale me të cilat komuna disponon, sipas ISCED (0, 1, 2, 3), duke

përrjashtuar kopshtet të cilat poashtu janë pjesë e (ISCED), në pajtim me ndarjen sipas stipulimit ligjor neni 9, para 1.1, Ligji 04-L-032). Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numri të nxënësve të cilët janë të përrfrshirë në sistemin arsimor në institucionet arsimore të nivelit parauniversitar në territorin e komunës.

### **Sqarime të hollësishe**

Objekt i matjes janë sipërfaqet e përrgjithshme të hapësirave të cilat shfrytëzohen (shkollat) në vendbanime urbane dhe ato rurale për arsim parauniversitar për nivelet sipas ISCED 02, 1, 2 dhe 3. Sipas ligjit për arsim parauniversitar, niveli 0 sipas ISCED përrfshinë fëmijët e moshës (0-6), mirëpo ligji stipulon për nevojat e harmonizimit me sistemin arsimor në Kosovë, ndarjen mbrenda nivelit 0 të ISCED të fëmijeve sipas moshave (0-4) dhe (5-6) vjeçarë. (neni 10, para 1, Ligji 04-L-032). Përkatësisht, për shkallën 0 sipas ISCED zbatohet UA 19/2013 i MASHT, niveli 02, i cili gjatë interpretimit në kontekst të ligjit për arsim parauniversitar saktëson se fëmijët prej moshës 4 vjeçare janë të obliguar për vijim në shkollë në nivelin parafillor. Kategoria e definuar për matje, fëmijët e moshës (4-17) përrbëjnë grupin e synuar për matje në aspektin e nxënësve të cilët vijoje në shkollën në nivelet ISCED 02, 1, 2, dhe 3. Në këtë kontekst, bëhet grupimi i nxënësve në vendbanimet urbane dhe ato rurale për qëllim të llogaritjes së treguesit, me ndarje në mes të shkollave në vendbanime urbane dhe atyre në vendbanime rurale. Kategoria e fëmijëve që vijoje në nivelin 01 sipas ISCED, është e qëllimisht e përrjashtuar nga matja, për shkak se bëhet fjalë për fëmijet e moshës 3 vjeçare e më poshtë. Për kategorizimin e nxënësve në ata që vijoje në shkolla urbane dhe ata të cilët vijoje në shkolla rurale bëhet në bazë të vijimit në shkolla, përkatësisht nuk merret vendbanimi i tyre aktual në kuptimin se ku ata jetojë, ku në këtë rast nxënësit të cilët jetojnë në vendbanime rurale por vijoje në shkolla urbane llogariten si nxënës nga vendbanimet urbane.

Për rastet kur një institucion arsimor me lokacion ka paralele të ndarë në vendbanim rural, për qëllim të këtij treguesi, konsiderohen si institucione të ndara, duke kushtëzuar llogaritjen e sipërfaqes dhe nxënësve në njësinë urbane vecmas nga sipërfaqja dhe nxënësit në degën me lokacion në vendbanim rural.

Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në krijimin e kushteve bazike infrastrukture në komunë, duke llogaritur të ndarë treguesin për vendbanime urbane dhe ato rurale, por jo në tërësi në aspektin e shpërndarjes apo formës së shfrytëzimit në nivel të një shkolle të vetme. Arsyeja është për shkak se treguesi nuk mat densitetin e nxënësve të shkollave të përrveçme, e që si fenomen shfaqet në forma të pakontrolluara, për shkak të lëvizjeve të vazhdueshme të popullsisë në Kosovë. Densitetet e larta në disa raste çojnë detyrimisht në krijimin e sistemeve të vijimit të shkollës në 2 ose 3 ndërrime, përrkundër raportit më racional të hapësirave për kokë nxënësi në nivel të komunës në përrgjithësi! Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përrfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky treguesi përrket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përrmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përrkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përrkatës kalendarik dhe vitin përrkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.1.2. mblidhen katër të dhëna:

1. Gjithsej numri i nxënësve të cilët vijojnë institucione arsimore të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3, në vendbanimet urbane
2. Gjithsej sipërfaqe të institucioneve arsimore në vendbanime urbane në shfrytëzim për nivelet ISCED 02, 1, 2, dhe 3
3. Gjithsej numri i nxënësve të cilët vijojnë institucione arsimore të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3, në vendbanimet rurale
4. Gjithsej sipërfaqe të institucioneve arsimore në vendbanime rurale në shfrytëzim për nivelet ISCED 02, 1, 2, dhe 3

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet në dy formula, formula e përgjithshme është llogaritja në vendbanime urbane dhe paraqet herësin në mes të totalit të sipërfaqeve të hapësirave shkollore në vendbanime urbane të nivelit përkatës me numrin e përgjithshëm të nxënësve në vendbanime urbane të cilët vijojnë shkollën.

Formula për llogaritjen e raportit të sipërfaqes së shkollave me nxënës në zona rurale, paraqet herësin në mes të totalit të sipërfaqeve të hapësirave shkollore në vendbanime rurale të nivelit përkatës me numrin e përgjithshëm të nxënësve në vendbanime rurale të cilët vijojnë shkollën.

$$\begin{aligned} \text{treguesi i përgjithshëm (zona urbane)} &= \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} \\ \text{treguesi në zona rurale} &= \frac{\text{e dhëna 4}}{\text{e dhëna 3}} \end{aligned}$$

### Burimi kryesor i të dhënave

të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e shkollave në DKA dhe MASHT përmes sistemit SMIA për hapësirat shkollore dhe numrin e nxënësve që vijojnë shkollën. Për nevojat e këtij treguesi, të dhënat nga burimet duhet të sistemohen në grupe, sipas lokacionit, nëse i përkasin vendbanimeve urbane apo atyre rurale. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes sistemit SMIA që mbahen në DKA, si dhe nga databaza e SMIA në MASHT. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

#### Treguesi 17.1.3 Shkolla të paisura me kabinet TIK

---

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e mjeteve dhe paisjeve të nevojshme bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësimnxënie sic është teknologjia informative dhe kompjuterike. Më saktësisht qëllimi i matjes është që të vlerësohet se sa përqind e shkollave të nivelit parauniversitar janë të paisura me kabinate të teknologjisë informative dhe kompjuterike, duke nënkuptuar këtu kabinate me paisje funksionale të TIK.

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e paisjes me kabinet të TIK në shkollat e nivelit parauniversitar, përjashtuar këtu ato të nivelit parashkollor. Në matje përfshihen shkollat publike me të cilat komuna disponon, sipas ISCED (1, 2, 3), duke përjashtuar këtu qendrat e kompetencës.

### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes janë (shkollat) për arsim parauniversitar për nivelet sipas ISCED 1, 2 dhe 3. Matja i referohet kabineteve të paisura me paisje të TIK, përkatësisht salla të paisura me kompjuterë dhe me kycje të internetit dhe poashtu me projektor apo tabela elektronike, duke siguruar se në këto kabinate mundësohet zhvillimi i lëndëve në fushën e teknologjisë informative si dhe aktivitete në fusha të tjera arsimore për të cilat nevojitet qasja në TIK. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në krijimin e kushteve bazike infrastrukturore në komunë, por jo në tërësi në aspektin e shpërndarjes apo formës së shfrytëzimit. Arsyeja është për shkak se treguesi nuk mat raportin në mes të numrit të nxënësve për një njësi (kompjuter). Pamjaftueshmëria e paisjeve në disa raste çojnë detyrimisht në krijimin e sistemeve të vijimit të punës në salla të TIK me grupe, ku 3-5 nxënës punojnë në një kompjuter të vetëm! Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.1.3. mblidhen dy të dhëna:

1. Numri i shkollave në nivelin parauniversitar ISCED 1-3
2. Numri i shkollave të nivelit parauniversitar të paisur me kabinet TIK

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjestuar totalin e shkollave në nivel parauniversitar ISCED 1,2,3 me numrin e përgjithshëm të shkollave të cilat janë të paisura me kabinet TIK.

$$treguesi = \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1}$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e shkollave në DKA dhe MASHT përmes sistemit SMIA për kabinetet dhe paisjet shkollore. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes sistemit SMIA që mbahen në DKA, si dhe nga databaza e SMIA në MASHT. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

## Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në zbatimin e masave lidhur me eficiencën e energjisë. Më saktësisht qëllimi i matjes është që të vlerësohet se sa përqind e shkollave të nivelit parauniversitar janë të paisura me masa të eficiencës së energjisë, duke nënkuptuar këtu sisteme të energjisë solare, gjeotermale, apo programeve të veçanta për kursimin e energjisë.

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e paisjes me masave të eficiencës së energjisë në shkollat e nivelit parauniversitar, përfshirë këtu ato të nivelit parashkollor. Në matje përfshihen shkollat publike me të cilat komuna disponon, sipas ISCED (0, 1, 2, 3), duke përjashtuar këtu qendrat e kompetencës.

### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes janë (shkollat) për arsim parauniversitar për nivelet sipas ISCED 0, 1, 2 dhe 3. Matja i referohet sistemeve për eficiencë energjetike, përkatësisht sistemeve për gjenerim të energjisë nga dielli (solare), apo gjeotermale, apo edhe vendosjen e sistemeve të veçanta si program për eficiencën e energjisë (sisteme elektronike për menaxhim të shpenzimit të energjisë me qëllim të kursimit). Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në krijimin e kushteve bazike infrastrukturore në komunë. Aktualisht në nivel vendi, buxhetet e shkollave në masë të madhe shpenzohen për sigurimin e energjisë, qoftë për ngrohje, apo edhe për ndriçim. Treguesi mat nivelin e shtrirjes së infrastrukturës për eficiencë energjetike, mirëpo nuk mat në tërësi efektin për shkak nuk bën matjen në aspektin e shpërndarjes apo formës së shfrytëzimit. Arsyeja është për shkak se treguesi nuk mat shkallën e shfrytëzueshmërisë apo zbatimin të masave për eficiencë të energjisë në objektet shkollore. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.1.4. mblidhen dy të dhëna:

1. Numri i shkollave në nivelin parauniversitar ISCED 0-3
2. Numri i shkollave të nivelit parauniversitar të paisura me masa për eficiencë të energjisë

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjestuar totalin e shkollave në nivel parauniversitar ISCED 0, 1,2,3 me numrin e përgjithshëm të shkollave të cilat janë të paisura me masa të eficiencës energjetike.

$$\text{treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}}$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e shkollave në DKA dhe MASHT përmes sistemit SMIA për sistemet e energjisë (dmth infrastruktura shkollore). Poashtu, te



dhenat për masat e eficiencës së energjisë gjenden edhe në zyren e ngarkuar me përgjegjësi për zbatimin e ligjit të eficiencës së energjisë në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes sistemit SMIA që mbahen në DKA, si dhe nga databaza e SMIA në MASH.T. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

### **Treguesi 17.1.5 Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar**

---

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në përmbushjen e detyrave të parapara me qëllim të ofrimit të një mjedisi të sigurtë për nxënësit në nivelin e arsimit parauniversitar. Më saktësisht, qëllim i matjes është përmbushja e detyrave dhe marrja e masave nga ana e autoriteteve komunale me qëllim të krijimit të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar dhe në rrethinë e afërt.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së aktiviteteve dhe ndërmarrjen e masave të parapara duke marrë për bazë Rregulloren e QRK 02/2013 për protokolin dhe për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar. Për nevojat e matjes së performancës në kontekstin e këtij treguesi, janë specifikuar masat në rrethin e brendshëm dhe atë të jashtëm të sigurisë. Për rrethin e brendshëm të sigurisë matet shkalla e paisjes së institucioneve parauniversitare me sisteme elektronike dhe fizike të sigurisë, (kamera) të sigurisë në ambientet shkollorë si dhe paisja me rrethoja të objekteve. Poashtu i matet edhe pregaditja dhe dorëzimin e raportit përmbledhës për DKA nga ana e institucioneve. Kurse në kontekstin e rrethit të jashtëm të sigurisë, për nevojat e këtij treguesi matet themelimi dhe funksionimi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB), sipas udhëzimit administrativ UA 03/2012 MPL, ku në këshill kërkohet pjesëmarrja e një përfaqësuesi të DKA dhe një përfaqësuesi të Këshillit të Prindërve. Respektivisht matet raportimi minimal prej 2 herë në vit i KKSB para kuvendit komunal. Më matjen e zbatimit të dispozitave në sigurimin e masave për krijimin e sigurisë në nivel të institucioneve të arsimit parauniversitar si dhe në afërsi të këtyre institucioneve, matet performanca e autoriteteve komunale në krijimin e mjedisit të sigurtë për nxënësit e shkollave në nivel të komunës. Objekte të matjes janë shkollat e nivelit parauniversitar, përjashtuar këtu ato të nivelit parashkollor. Në matje përfshihen shkollat publike me të cilat komuna disponon, sipas ISCED (1, 2, 3), duke përjashtuar këtu qendrat e kompetencës. Çdo njëra nga tri pikat e masave të sigurisë kontribuon proporcionalisht në vlerën e treguesit, për arritur shkallën maksimale kur të gjitha parametrat janë plotësuar.

#### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes janë (shkollat) për arsim parauniversitar për nivelet sipas ISCED 1, 2 dhe 3. Matja i referohet institucioneve të paisura me rrethoja, dhe sisteme të kamerave, si dhe pregaditjes dhe dorëzimit të raportit të përgjithësuar pr DKA nga ana e institucioneve. Në rastet kur institucionet e kanë njëren nga masat elektronike apo fizike (kamera apo rrethojë), atëherë numrohet si 0.5 në vend të numrit 1, me ç'rast ulet pjesëmarrja në përqindjen e kategorisë së matur, dhe kjo rezulton në ulje tek pikët e performancës së treguesit. Parimi i njejtë vlenë edhe kur raportimet e institucioneve arsimore nuk e kanë dorëzuar raportin e përgjithësuar 2 herë në vit! Matja për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi,

konsiston në shqyrtimin e raportimit të KKSBB sipas udhëzimit administrativ UA 03/2012 MPL, ku kërkohet që këshilli funksional të raportoj së paku 2 herë në vit para kuvendit komunal. Në këtë aspekt matet paraqitja e raportit të KKSBB para kuvendit komunal, ku duke nënkuptuar pjesëmarrjen në këshill të përfaqësuesve të DKA dhe Këshillit të Prindërve dhe ndërveprimin me institucionet e sigurisë si Policia e Kosovës, synohet koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve me qëllim të krijimit të mjedisit të sigurtë në rrethinën e shkollave dhe vet institucionet shkollore. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në krijimin e kushteve bazike infrastrukturore dhe organizative në nivel të komunës komunë, por jo në tërësi në aspektin e matjes së gjendjes së prodhuar apo edhe shpërndarjes uniforme të masave të sigurisë. Arsyeja është për shkak se treguesi nuk mat nivelet e dhunës apo paraqitjeve të tjera negative të lidhura me mungesën e sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar dhe përreth tyre. Janë dy kategori të të dhënave, për të cilat vlejné dy periudha të ndryshme të raportimit. Për të dhënat lidhur me aktivitetet e në institucionet e arsimit parauniversitar periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak. Për të dhënat lidhur me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, periudha kohore për të cilën raportohen është viti kalendarik, përka tësisht Janar-Dhjetor të vitit për të cilin raportohet.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.1.5. mbliidhen katër të dhëna:

1. Numri i shkollave në nivelin parauniversitar ISCED 1-3
2. Numri i shkollave të nivelit parauniversitar të paisura me sisteme të kamerave dhe rrethojave të objekteve
3. Numri i shkollave në nivelin parauniversitar të cilat kanë dorëzuar raportin përmbledhës në DKA 2 herë në vit
4. Numri i raportimeve të KKSBB para kuvendit komunal

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke mbledhur kontributin e komponenteve si në vijim: komponenti 1 e dhëna e 2 pjestuar për të dhënë e parë; Komponenti i parë përbën 40% te vlerës së treguesit; komponenti 2 e dhëna e 3 pjestuar për të dhënë e 1; Komponenti i dytë përbën 40% te vlerës së treguesit; dhe komponenti 3 e dhëna e 4 pjestuar me 2; Komponenti i tretë përbën 20% te vlerës së treguesit;

$$\text{treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 40\% + \frac{\text{e dhëna 3}}{\text{e dhëna 1}} * 40\% + \frac{\text{e dhëna 4}}{2} * 20\%$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e shkollave në DKA dhe MASHT përmes sistemit SMIA për infrastrukturën e shkollave (kamerat dhe rrethojat). Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes sistemit SMIA që mbahen në DKA, si dhe

nga databaza e SMIA në MASHT. Të dhënat për raportimin e KKSBB para Kuvendit Komunal mund të merren në sekretarinë e kuvendit, si dhe pranë DKA-së si anëtare e përfaqësuar në KKSBB. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

### **Treguesi 17.1.6 Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, paisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin kushteve për zhvillimin e aktiviteteve mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar, përkatësisht vlerësohet paisja me infrastrukturën (hapësirat), mjetet dhe paisjet për zhvillimin e aktiviteteve arsimore, si dhe kushtet higjienike. Më saktësisht qëllimi i matjes është që të vlerësohet se sa përqind e shkollave të nivelit parauniversitar janë të paisura me salla të edukatës fizike, kabinete dhe laboratore të paisura për zhvillimin e aktiviteteve mësimore sipas kërkesave kurrikulare (përfshi edhe punëtoritë për mësim praktik), bibliotekë, klasat e rregullta të paisura me sisteme për zhvillimin e mësimin përmes kompjuterit, si dhe paisje me inventar konvencional në gjendje të rregullt (banka, karrika, dërrasë të zezë).

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë shkallën e paisjes me elementet e infrastrukturës shkollore, si salla të edukatës fizike, kabinete, laboratore, punëtori (përfshi edhe firmat ushtrimore), biblioteka, si dhe klasat e rregullta. Ku këto për nevojat e raportimit kërkohet që të jenë të paisura plotësisht me mjete dhe paisje, në nivelin të cilin mundësohet realizimi i aktiviteteve siç kërkohet nga kurrikulat të cilat janë në zbatim në ato institucione! Kriteri i vlerësimit të performancës është edhe higjiena në shkollë.

Për nevojat e këtij treguesi janë të specifikuar 6 kritere të vlerësimit si në vijim:

1. Salla e edukatës fizike me mjete dhe paisje
2. Kabinete, laboratore, punëtori dhe firma ushtrimore me paisje, mjete dhe material shpenzues ku mundësohet zbatimi i mësimin të bazuar në kabinete dhe laboratore.
3. Biblioteka e shkollës e paisur dhe në funksion
4. Paisja e klasave të zakonshme me orendi të domosdoshme shkollore
5. Paisja e klasave të zakonshme me mjete elektronike për zhvillimin e aktivitetit mësimor (projektor, tabela elektronike)
6. Plotësimi i kushteve higjienike në bazë të kontrollit të inspeksionit sanitar

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesave të kritereve të specifikuar për secilin institucion nën menaxhimin e komunës, në të cilat zhvillohen aktivitetet mësimore në nivelet sipas ISCED (1, 2, 3), duke përjashtuar këtu qendrat e kompetencës. Bazë për përcaktimin e kritereve për vlerësimin e performancës është korniza e treguesve të SMIA, për të cilin raportojnë institucionet arsimore si dhe DKA-të. Poashtu kornizë për përcaktimin e kritereve është edhe Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë i MASHT 2017-2021, përkatësisht objektivat strategjike OS2, 3, 5 dhe 6. Respektivisht, zbatimi i sistemit për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar sipas UA 23/2016 për Planin zhvillimor të shkollës dhe planin zhvillimor komunal të arsimit, nëni 6 Fushat e cilësisë, pika 1.2 Mësimdhënia dhe të nxënësve si dhe 1.3 Mjedisi dhe kultura e

institucionit. Ku institucionet kanë për obligim zhvillimin dhe raportimin për vetëvlerësimin sipas fushave të cilësisë, përkatësisht përgatitjen e PZSHSH.

Matja bëhet në kontekst të institucioneve të cilat formojnë rrjetin e sistemit arsimor-edukativ në nivelin parauniversitar në territorin e komunës.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është raporti mbi arritjen e respektimit të kriterëve nga institucionet e arsimit parauniversitar, përkatësisht gjendja mbi kriteret e listuara gjatë vitit. Për secilin institucion arsimor nën menaxhim të komunës, duhet të shqyrtohet statusi i përmbushjes kundrejt 6 kriterëve të listuara, ashtu që për secilin kriter ndahen nga 16.7% të pikëve të performancës në rast të përmbushjes. Përmbushja e kriterëve lidhur me paisjen e institucionit me kabinete, laboratore, punëtori apo edhe firma ushtrimore, është e kushtëzuar dhe interpretohet në bazë të nivelit dhe kurrikulave të cilat zbatohen, dmth vlerësohet paisja me infrastrukturë dhe paisje në bazë të nevojës që e ka institucioni sipas fushëveprimit arsimor. Kriteri i higjienës mvaret nga vlerësimi i bërë nga ana e inspeksionit sanitar, i cili bën kontrolle të rregullta periodike, dhe lëshon raport mbi gjendjen e institucionit, në ushtrim të funksioneve nga neni 5 i ligjit NR. 2003/22 PËR INSPEKTORATIN SANITAR TË KOSOVËS. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e paisjes me infrastrukture, mjete dhe paisje për zhvillimin e aktiviteti mësimor në pajtim me kërkesat kurrikulare. Treguesi nuk matë raportin e infrastruktures, paisjeve dhe mjeteve në raport me kërkesen (numrin e nxënësve), e poashtu nuk mat as shkallën e shfrytëzimit.

Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraparak.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.1.6 mblidhen 7 të dhëna:

1. Numri i institucioneve parauniversitare të nivelit sipas ISCED 1,2, dhe 3 në menaxhim të komunës
2. Numri i institucioneve parauniversitare të paisura me sallë të edukatës fizike me mjete dhe paisje
3. Numri i institucioneve parauniversitare të paisura me kabinete, laboratore, punëtori dhe firma ushtrimore me paisje, mjete dhe material shpenzues ku mundësohet zbatimi i mësimit të bazuar në kabinete dhe laboratore.
4. Numri i institucioneve parauniversitare të paisura me bibliotekë të shkollës të paisur dhe në funksion
5. Numri i institucioneve parauniversitare të paisura me klasa të zakonshme të paisura me orendi të domosdoshme shkollore
6. Numri i institucioneve parauniversitare me klasa të zakonshme të paisura me mjete elektronike për zhvillimin e aktivitetit mësimor (projektor, tabela elektronike)

7. Numri i institucioneve parauniversitare për të cilat inspeksioni sanitar ka lëshuar raport se i plotësojnë kushtet higjienike

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet si shumë e përqindjeve të llogaritura veçmas për secilin nga 6 kriteret, të cilat peshojnë me 16.7% në totalin e treguesit, psh. herësi mes të dhënës së dytë dhe të dhënës së parë, shumëzuar me 16.7%, herësi mes të dhënës së tretë dhe të dhënës së parë shumëzuar me 16.7%,...deri te herësi mes të dhënës së 7 dhe të dhënës së parë shumëzuar me 16.7%.

*treguesi i përgjithshëm*

$$= \frac{\text{dhëna 2}}{\text{dhëna 1}} * 16.7\% + \frac{\text{dhëna 3}}{\text{dhëna 1}} * 16.7\% + \frac{\text{dhëna 4}}{\text{dhëna 1}} * 16.7\% + \frac{\text{dhëna 5}}{\text{dhëna 1}} * 16.7\% + \\ + \frac{\text{dhëna 6}}{\text{dhëna 11}} * 16.7\% + \frac{\text{dhëna 7}}{\text{dhëna 1}} * 16.7\%$$

### Burimi kryesor i të dhënave

të këtij treguesi janë të dhënat e mbajtuara në DKA dhe të menaxhuara përmes njësisë përgjegjëse për Planet zhvillimore të shkollës, si dhe për Planin zhvillimor komunal të arsimit. Të dhënat poashtu mund të merren nga sistemi SMIA, ku DKA ka qasje e poashtu edhe nga MASHT-i si instancë përgjegjëse për SMIA. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara në MASHT nga ana e DKA, si dhe nga PZHK-të individuale të institucioneve arsimore, si dhe raportet e Inspeksionit Sanitar lidhur me kriterin e higjienës në institucionet e arsimit parauniversitar. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

### Rezultati 17.2 Resurset dhe personeli i pregaditur dhe i mjaftueshem për zhvillimin e aktiviteteve mësimore

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës për zhvillimin e e kuadrit të pregaditur dhe të mjaftueshëm për sigurimin e zhvillimit të proceseve arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përfshirë edhe edukimin e hershëm. Aktivitetet dhe masat e përcaktuara këtu lidhen me dispozitat elementare që përcaktojnë arsimin parauniversitar, aktivitetet arsimore që mbahen përmes rrjetit të institucioneve arsimore nën autoritetin e Drejtorisë Komunale të Arsimit (parashkollor, fillor dhe i mesëm i ulët dhe i lartë, duke përfshirë AAP-në). Rezultati synon matjen e komponentëve kryesorë të shtrirë të arsimit parauniversitar publik siç parashihet në PSAK 2017-2021, të cilët paraqesin detyrime për Drejtorinë Komunale për Arsim përmes UA 23/2013, Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit. Prandaj, këto janë objektivat e planifikimit dhe zbatimit të planit vjetor të punës të drejtorisë të përcaktuara në nenin 11, si dhe për monitorimin dhe raportimin e zbatimit në nenin 13, paragrafi 1.10 raportimi mbi zbatimin. Përveç kësaj, rezultati është i informuar edhe nga disponueshmëria e mësuesve të kualifikuar dhe materialeve pedagogjike/didaktike (mjeteve të konkretizimit), si dhe nga performanca e zbatimit të procedurave gjatë punësimit të mësimeve dhe kuadrit drejtues të institucioneve arsimore. Poashtu matet edhe kontributi i autoriteteve komunale në fushën e arsimit parauniversitar, përmes matjes së kontributit në buxhetin e arsimit në nivel komune, përkatësisht plotësimi i buxhetit për arsim përmes ndarjes nga të hyrat vetanake të komunës. Rezultati gjithashtu synon të sjellë produktet e veprimeve të komunës në trajtimin e sfidave me të cilat ballafaqohet arsimi parauniversitar në nivel komune, në kontekst të komplekseve të cilat

janë trashëguar nga historia e rënduar, si dhe sfidat të cilat burojnë nga mësimdhënia dhe mësimxënia në mileniumin e ri. Ky rezultat përfshin arritjet e drejtorisë komunale të arsimit dhe arsimore institucioneve vartëse, personelit të dedikuar menaxhues dhe arsimor (profesional), në krijimin kuadrit të mjaftueshëm dhe të licensuar në kuptimin e numrit të mësimdhënësve të licensuar, të pregaditur për për zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies.

Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohen grupet e shoqërisë të përfshira në sistemin publik arsimor, që të arrijnë nivelin e pregaditjes që të mund të integrohen në rrjedhat globale të arsimit dhe ekonomisë. Arritja e rezultatit matet me treguesit 17.2.1, 17.2.2, 17.2.3, 17.2.4, 17.2.5 dhe 17.2.6

## Treguesi 17.2.1

### Mësimdhënësit e kualifikuar sipas licensimit

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e mësimdhënësve të kualifikuar në tërë sistemin e arsimit parauniversitar. Me kualifikim nënkuptohet mësimdhënësi i licensuar sipas UA 5/2017 MASHT Sistemi i licensimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë! Sipas këtij UA, komunat kanë obligime specifike në nivel lokal për zbatimin e sistemit të licensimit sipas nenit 24 të UA 05/2017 MASHT, tërthorazi edhe sipas nenit 25.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për ndërtimin e një personeli të kualifikuar të mësimdhënësve, ku kualifikimet e kërkuara njihen përmes procesit të licensimit të mësimdhënësve. Prej trupit të përgjithshëm të mësimdhënësve në nivelin e arsimit parauniversitar në komunë, sipas niveleve ISCED 02, 1, 2, dhe 3, përqindja e atyre që janë të paisur me licensë sipas UA 05/2017 MASHT. Me mësimdhënësit të paisur me licensë valide, përveç mësimdhënësve me licensë të rregullt sipas nenit 10 të UA 05/2017 (para 1), nënkuptohet përfshirja edhe e atyre mësimdhënësve të cilëve ju është dhënë zgjatë licensa në kuptim të përkohshëm 1 vjeçar sipas nenit 12 pika 4 e UA 05/2017 MASHT. Nga llogaritja në trupin e mësimdhënësve nuk përfshihen mësimdhënësit e niveleve parashkollore, edhe pse janë pjesë e (ISCED), në pajtim me ndarjen sipas stipulimit ligjor neni 9, para 1.1, Ligji 04-L-032). Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numrit të mësimdhënësve të cilët janë të përfshirë në sistemin arsimor në institucionet e nivelit parauniversitar në territorin e komunës.

#### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes janë mësimdhënësit e (shkollat) sistemit parauniversitar për nivelet sipas ISCED 02, 1, 2 dhe 3. Kategoria e definuar për matje, mësimdhënësit e licensuar përbëjnë grupin e synuar për matje në aspektin e mësimdhënësve të cilët janë të përfshirë si mësimdhënësit e shkollave në nivelet ISCED 02, 1, 2, dhe 3. Kategoria e mësimdhënësve të përfshirë në nivelin 01 sipas ISCED, është e qëllimisht e përjashtuar nga matja, për shkak se bëhet fjalë për institucionet parashkollore. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e një trupe të pregaditur të mësimdhënësve sipas kërkesave për kualifikim, kjo në nivel të komunës, por jo në tërësi në për shkak se i tërë sistemi ka akterë të tjerë si MASHT, Këshilli Shtetëror për Licensimin e Mësimdhënësve, Agjencia e Kosovës për Akreditim, Universitetet e përfshira, Divizioni për Zhvillim të Mësimdhënësve, dhe Inspektorati i Arsimit. Mirëpo në kontekst të qeverisjes lokale, DKA-ja ka mandat mjaft të gjërë për të siguruar aktivitet me qëllim të avancimit të statusit të licensimit të

mësimdhënësve në nivelin e arsimit parauniversitar në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraparak.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.2.1. mblidhen dy të dhëna:

1. Gjithsej numri i mësimdhënësve në instituzione arsimore të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3
2. Gjithsej numri i mësimdhënësve të licensuar në instituzione arsimore të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjestuar totalin e mësimdhënësve të licensuar me numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve të përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar në nivel komunë, shumëzuar me 100.

$$\text{treguesi} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e shkollave në DKA dhe MASHT përmes sistemit SMIA për numrin e mësimdhënësve të përfshirë, dhe nga regjistri i licensimit sipas pikës 6, të nenit 22 të UA 05/2017 të MASHT. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes sistemit SMIA që mbahen në DKA, si dhe nga databaza e SMIA në MASHT. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

### Treguesi 17.2.2

### Niveli i pajtueshmërisë me raportin e synuar nxënës për mësimdhënës – urban dhe rural

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e raportit të kërkuar nxënës për mësimdhënës, të ndarë në shkollat në vendbanime urbane dhe ato rurale. Me raport të kërkuar nxënës për mësimdhënës nënkuptohet mesatarja e raporteteve nxënës (26) për mësimdhënës (1), sipas UA 22/2013 MASHT Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti nxënës – mësimdhënës.

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e një numri të arsyeshëm të personelit të mësimdhënësve, në raport me numrin e nxënësve, duke veçuar shkollat në vendbanime urbane dhe ato rurale. Trupi i përgjithshëm i mësimdhënësve në nivelin e arsimit parauniversitar në vendbanime urbane ndaras nga ato rurale, sipas niveleve ISCED 02, 1, 2, dhe 3, në raport me numrin e nxënësve të cilët vijnë në mësimin. Përkatësisht, matet përmbushja duke bërë matjen e raportit të nxënësve për mësimdhënës, dhe duke krahasuar rezultatin e arritur me nivelin e synuar 28 nxënës për

mësimdhënës. Në këtë aspekt, synohet matja e përputhshmërisë me nivelin e synuar të raportit, qoftë nga shkalla më e lartë apo nga shkalla më e ulët në drejtim të vlerës 28/1. Nga llogaritja në trupin e mësimdhënësve nuk përfshihen mësimdhënësit e niveleve parashkollore, edhe pse janë pjesë e (ISCED), në pajtim me ndarjen sipas stipulimit ligjor nëni 9, para 1.1, Ligji 04-L-032). Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numri të mësimdhënësve të cilët janë të përfshirë në sistemin arsimor në institucionet e nivelit parauniversitar në territorin e komunës.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është raporti nxënës – mësimdhënës në vendbanime urbane dhe ato rurale për arsim parauniversitar, në nivelin e institucioneve të sistemit parauniversitar për nivelet sipas ISCED 02, 1, 2 dhe 3. Në këtë kontekst, bëhet grupimi i mësimdhënësve dhe nxënësve në vendbanimet urbane dhe ato rurale për qëllim të llogaritjes së treguesit, me ndarje në mes të shkollave në vendbanime urbane dhe atyre në vendbanime rurale. Nënkatëria e definuar për matje, nxënësit dhe mësimdhënësit, përbëjnë grupet e synuara për matje të cilët janë të përfshirë në nivelet ISCED 02, 1, 2, dhe 3. Kategoria e nxënësve (fëmijëve) si dhe mësimdhënësve (edukatorëve) të përfshirë në nivelin 01 sipas ISCED, është e qëllimisht e përjashtuar nga matja, për shkak se bëhet fjalë për institucionet parashkollore. Për kategorizimin e nxënësve në ata që vijojnë në shkolla urbane dhe ata të cilët vijojnë në shkolla rurale bëhet në bazë të vijimit në shkolla, përkatësisht nuk merret vendbanimi i tyre aktual në kuptimin se ku ata jetojnë, ku në këtë rast nxënësit të cilët jetojnë në vendbanime rurale por vijojnë në shkolla urbane llogariten si nxënës nga vendbanimet urbane. Për rastet kur një institucion arsimor me lokacion ka paralele të ndarë në vendbanim rural, për qëllim të këtij treguesi, konsiderohen si institucione të ndara, duke kushtëzuar llogaritjen e sipërfaqes dhe nxënësve në njësinë urbane veçmas nga sipërfaqja dhe nxënësit në degën me lokacion në vendbanim rural. Kategorizimi i vendbanimeve dhe lokacioneve në urbane dhe rurale i referohet publikimeve nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Vlera referente e raportit [26]/[1] nxënës për mësimdhënës është marrë duke ju referuar mesatares aritmetikore për raportet normative nxënës-mësimdhënës, siç është stipuluar në UA 22/2013 MASHT në nenin 3, paragrafet 1,2, 4 dhe 5.

Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në sigurimin e raportit të synuar të numrit të mësimdhënësve krahasuar me numrin e nxënësve, duke llogaritur të ndarë treguesin për vendbanime urbane dhe ato rurale. DKA-ja ka mandat mjaft të gjërë për të siguruar numrin optimal të mësimdhënësve në raport me nevojat sipas numrit të nxënësve në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.2.2. mblidhen katër të dhëna:

1. Gjithsej numri i mësimdhënësve në institucione arsimore në zona urbane të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3



2. Gjithsej numri i nxënësve në institucione arsimore në vendbanime urbane të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3
3. Gjithsej numri i mësimdhënësve në institucione arsimore në zona rurale të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3
4. Gjithsej numri i nxënësve në institucione arsimore në zona rurale të nivelit ISCED 02, 1, 2, dhe 3

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet në dy formula, formula e përgjithshme është llogaritja në vendbanime urbane dhe llogaritet duke marrë vlerën absolute të ndryshimit mes konstantës 26 dhe herësit aktual mësimdhënës për nxënës në nivel të shkollave në zona urbane, i cili poashtu pjestohet me konstanten 26 dhe herësi i arritur zbritet nga konstantja 1, ku merret vlera absolute dhe shumëzohet me 100 për të paraqitur vlerën me përqindje.

Formula për llogaritjen e raportit të sipërfaqes së shkollave me nxënës në zona rurale, dhe llogaritet duke marrë vlerën absolute të ndryshimit mes konstantës 26 dhe herësit aktual mësimdhënës për nxënës në nivel të shkollave në zona rurale, i cili poashtu pjestohet me konstanten 26 dhe herësi i arritur zbritet nga konstantja 1, ku merret vlera absolute dhe shumëzohet me 100 për të paraqitur vlerën me përqindje.

$$\text{treguesi i përgjithshëm (zona urbane)} = \left| 1 - \frac{26 - \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1}}{26} \right| * 100$$

$$\text{treguesi në zona rurale} = \left| 1 - \frac{26 - \frac{e \text{ dhëna } 4}{e \text{ dhëna } 3}}{26} \right| * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e shkollave në DKA dhe MASHT përmes sistemit SMIA për numrin e mësimdhënësve dhe nxënësve. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes sistemit SMIA që mbahen në DKA, si dhe nga databaza e SMIA në MASHT. Për nevojat e këtij treguesi, të dhënat nga burimet duhet të sistemohen në grupe, sipas lokacionit, nëse i përkasin vendbanimeve urbane apo atyre rurale. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

Treguesi  
17.2.3

Plotësimi i buxhetit për arsim nga të hyrat vetanake

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e plotësimit të buxhetit për arsim përmes ndarjes nga të hyrat vetanake. Më saktësisht, qëllimi i matjes është pjesa e buxhetit të arsimit e cila është financuar nga të hyrat vetanake të komunës, nga totali i buxhetit të shpenzuar për arsim në nivel komune. Ligji nr. 03/l-049 Për financat e pushtetit lokal.

### Çfarë matet?

Treguesi matë raportin e shtesës të cilën e ndanë komuna krahasuar me madhësinë e grantit specifik për arsim i cili i ndahet komunës nga qeveria. Përkatësisht matet përqindja e buxhetit të cilën e ndanë komuna nga të hyrat vetanake për qëllim të DKA-së, respektisht për sektorin e arsimit parauniversitar në nivel të komunës.

### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes është pjesa e shtuar e buxhetit për arsim, e cila vjen nga të hyrat vetanake të komunës, duke krahasuar pjesën e ndarë nga komuna si përqindje ndaj grantit specifik për arsim. Nuk paragjykohej forma e shpenzimit të buxhetit, përkatësisht qëllimi i ndarjes, nëse është për investime kapitale, apo për mallëra dhe shërbime. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në lidhje me përkushtimin e treguar në lidhje me përmirësimin e arsimit. Si tregues, mat pjesën e resurseve dhe ndarjen e tyre në aspektin e prioriteteve, përmes së cilit nuk mund të kuptohet eficientia e buxhetit të plotësuar, mirëpo nënkuptohet si parakusht për krijimin e kushteve për cilësi dhe nivel më të lartë të arsimit në nivelin parauniversitar në nivel komune.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.2.3. mblidhen dy të dhëna:

1. Gjithsej shuma e ndarë për arsim nga të hyrat vetanake të komunës
2. Gjithsej shuma e grantit specifik për arsim

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjesëtuar shumën e ndarë për arsim nga të hyrat vetanake me shumën e grantit specifik për arsim.

$$\text{treguesi} = \frac{\text{e dhëna 1}}{\text{e dhëna 2}}$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e në DKA dhe drejtoritë komunalë për financa, si dhe nga procesverbalet e kuvendeve komunale me rastin e miratimit të planeve buxhetore. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga raportet e kryetarit të komunës, si dhe nga raportet 3 mujore dhe vjetore për buxhet. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

## Treguesi 17.2.4 Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt

---

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në raport me procesin e punësimit të mesimdhënësve të rinj në kontekst të plotësimit të vendeve të lira në arsim, përmes

afatit të rregullt të konkursit. Me performancën e kërkuar të punësimit në raport me vendet e lira për mësimdhënës, nënkuptohet raporti mes punësimit dhe vendeve të lira për mësimdhënës, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimit të mësimdhënies në institucionet e arsimit parauniversitar në nivel të komunës. Vlerësohet punësimi përmes konkursit gjatë afatit të rregullt para vitit të ri shkollor.

### **Çfarë matet?**

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për plotësimin e vendeve të lira të punës, përkatësisht punësimin e mësimdhënësve të rinj, për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit të mësimdhënies, kjo pasi që planifikimi i rregullt i personelit dhe siguri i numrit të nevojshëm të mësimdhënësve është obligim i DKA-së. Përkatësisht, DKA-ja është përgjegjëse për mbledhjen dhe shqyrtimin e kërkesave për punësimin e mësimdhënësve nga ana e shkollave si dhe identifikimin e mësimdhënësve të cilëve i afrohet mosha e pensionimit, dhe në këtë kontekst pregaditen dhe zhvillohen procedurat për rekrutimin dhe punësimin e mësimdhënësve të rinj për të siguruar mbarëvajtjen, përkatësisht tranzicionin e papenguar të procesit mësimor në institucionet e arsimit parauniversitar. Ligji për Zyrtarët Publik, 06 L-114, në nenin 15 specifikon obligimet e njesisë përgjegjëse për personelin, duke stipuluar sipas nenit 65 përgjegjësinë e komunës, se autoritetet komunale kanë përgjegjësi për planifikimin e personelit; ku përgjegjësia shtrihet si nën-kategori e zyrtarëve profesional edhe te planifikimi i personelit mësimdhënës si nëpunës të shërbimit publik. Duke ju referuar nenit 67, pika 7, e Ligjit për Zyrtarët Publik, ku thuhet se “Personel profesional është personeli që kryen dhënie profesionale të shërbimit, si, p.sh personeli mësimdhënës në institucionet e sistemit arsimor, personeli mjekësor në një institucion të sistemit shëndetësor, etj”. Ligji për arsimin parauniversitar Nr. 04/L-032 e përkufizon vitin shkollor në periudhën 1 Shtator-31 Gusht, ku oraret mësimore pregaditen në javën e fundit të Gushtit duke reflektuar me numrin e nxënësve, kapacitetet infrastrukturore, kërkesat kurrikulare, dhe numrin e mësimdhënësve në dispozicion. Institucionet arsimore i identifikojnë nevojat për mësimdhënës pas afatit të parë të regjistrimit, dhe këto i komunikohen DKA-së në formë të propozimit, në fillim të muajit Korrik, së bashku me numrin e nxënësve të regjistruar. Numri i mësimdhënësve të propozuar merret për shqyrtim nga ana e DKA, dhe kalon në pjesën për planifikim të personelit, me ç’rast pas trajtimit të procedurave përkatëse bëhet identifikimi i vendeve të lira të punës për mësimdhënës të rinj.

Ligji bazë për Arsimin në Komunitet e Kosovës 03 L-068, në nenin 5 pikën c, përcakton përgjegjësinë e autoriteteve komunale duke theksuar se komunat janë përgjegjëse për: *“punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publik”*. Aspekti procedural i punësimit rregullohet përmes udhëzimit administrativ, UA 07/2017 i MPMS për, “Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik”.

Përgjegjësia komunale për punësimin e mësimdhënësve sipas këtij ligji, nënkupton punësimin e mësimdhënësve për nivelet e arsimit 0,1,2, dhe 3 sipas klasifikimit të ISCED. Shprehimisht, edhe në kontekst të këtij treguesi, me mësimdhënës nënkuptohen mësimdhënësit e nivelit 0,1,2 dhe 3 sipas ISCED. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numrit të mësimdhënësve të cilët janë të përfshirë në sistemin arsimor në institucionet e nivelit parauniversitar në territorin e komunës.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është raporti në mes të vendeve të lira të punës për mësimdhënës dhe të punësuarve të rinj gjatë vitit, në nivelin e institucioneve të sistemit parauniversitar për nivelet sipas ISCED 0, 1, 2 dhe 3, dhe atë deri në datën e fillimit të vitit të ri shkollor, 31 Gusht! Nënkatëgoria e definuar për matje, vendet e

lira të punës dhe mësimdhënësit e punësuar të rinj, përbëjnë grupet e synuara për matje të cilët janë të përfshirë në nivelet ISCED 0, 1, 2, dhe 3. Për nevojat e këtij treguesi, me vend të lirë të punës për mësimdhënës nënkuptohen vendet e lira për mësimdhënës në nivelin parauniversitar, për të cilat DKA ka bërë planifikim të personelit për punësim për vitin e rregullt shkollor duke filluar prej 1 Shtatorit. Me mësimdhënës të punësuar të ri, nënkuptohet mësimdhënësi i cili ka formu mardhënien e punës gjatë vitit për të cilin raportohet, e cila mardhënie mundëson fillimin e punës prej 1 Shtatorit, duke mos paragjykuar statusin e kontraktimit, me vendim apo punësim i përkohshëm, apo edhe duke qenë në fazën provuese të punës. Zbatimi i procesit të punësimit zhvillohet dhe vlerësohet për performancë në afatin e rregullt, duke pasqyruar se procesi për nevojat e këtij treguesi me marrjen e propozimeve nga institucionet arsimore, dhe zhvillohet përmes hapave si planifikimi i personelit, shpallja e konkursit, vlerësimi i kandidatëve, dhe mbaron me përzgjedhjen dhe kontraktimin e kandidatëve të suksesshëm. Përkatesisht, me afat të rregullt nënkuptohet periudha e zbatimit të procedurave të punësimit para fillimit të vitit të ri shkollor! Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e numrit optimal të mësimdhënësve në raport me planifikimin e personelit mësimdhënës, duke respektuar afatet kohore sipas kalendarit arsimor për të mundësuar zhvillimin e papenguar të aktiviteteve mësimore. DKA-ja ka mandat mjaft të rregulluar për të siguruar numrin optimal të mësimdhënësve në raport me nevojat për mësimdhënës në nivel komune. Meqenëse si aktivitet, plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim, mund të mos zhvillohet në baza të rregullta çdo vit, përkatesisht zhvillohet si aktivitet në bazë të nevojave të paraqitura dhe aktiviteteve të planifikuara për personelin mësimor. Rrjedhimisht, mund të paraqiten situata kur mbrenda një vitit kalendarik nuk paraqitet nevoja për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim, dhe komuna nuk zhvillon procedura për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim. Me qëllim të sigurimit që komunat të cilat nuk kanë aktivitete për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim për shkak se nuk kanë nevojë dhe nuk kanë planifikuar aktivitete të tilla, të mos penalizohen në performancë, në këto raste komunave ju ndahet performancë e plotë (100%). Mirëpo në vitin kur kur komuna zhvillon procedura për plotësimin e vendeve të lira në arsim, apo ka planifikuar aktivitetet për plotësimin e vendeve të lira në arsim, pa marrë parasysh statusin lidhur me zhvillimin e aktivitetit, performanca duhet të raportohet sipas realizimit, në këtë rast në bazë të performancës së arritur, dhe jo të asaj për vitet kur komuna nuk ka zhvilluar aktivitet për shkak se nuk ka pasqyruar nevojë! Për vitin kur komuna nuk ka zhvilluar aktivitet për plotësimin e vendeve të lira në arsim dhe nuk ka pasqyruar planifikim të tillë, raportohet edhe ky fakt, përmes të dhënës përkatese.

Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkates. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkates kalendarik dhe vitin përkates të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.2.4 mblidhen pesë të dhëna:

1. Gjithsej vende të lira të punës për mësimdhënës në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2, dhe 3 sipas planifikimit të DKA përmes konkursit të rregullt
2. Gjithsej numri i mësimdhënësve të punësuar të rinj përmes konkursit të rregullt në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2, dhe 3 sipas planifikimit të DKA
3. Gjithsej numri i planifikuar i mësimdhënësve në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2, dhe 3
4. Gjithsej numri i mësimdhënësve të punësuar në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2 dhe 3
5. Komuna nuk ka zhvillu aktivitet për plotësimin e vendeve të lira të punës dhe nuk ka pasë planifikim për aktivitet të tillë gjatë vitit

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet në dy forma, formula e përgjithshme paraqet herësin në mes të numrit të mësimdhënësve të punësuar të rinjë sipas planifikimit të DKA dhe numrit të përgjithshëm të vendeve të lira të punës për mësimdhënës sipas konkursit të rregullt të DKA, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes. Në pjesën e parë të formulës, e dhëna e 5 na jep statusin e performancës me 100% për vitet kur komuna nuk ka zhvillu aktivitet për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim, dhe nuk ka pasë planifikim për aktivitet të tillë për vitin që raportohet. Kurse në vitin kur komuna ka zhvillu aktivitet për plotësimin e vendeve të lira në arsim, apo edhe ka planifikuar aktivitet të tillë, e dhëna e 5 merr vlerën 0%, dhe formula na jep vetëm performancën e arritur sipas pjesës së dytë të formulës.

$$\text{treguesi i përgjithshëm} = e \text{ dhëna } 5 + \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 100$$

$$\text{treguesi për tërë personelin mësimor} = e \text{ dhëna } 5 + \frac{e \text{ dhëna } 4}{e \text{ dhëna } 3} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

të këtij treguesi janë të dhënat e mbajtuara në DKA dhe të menaxhuara përmes njësisë përgjegjëse të personelit, përkatësisht përmes SIMBNj për numrin e mësimdhënësve të planifikuar (vende të lira të punës) dhe të punësuar të rinj gjatë afatit të rregullt. Poashtu, të dhënat mund të sigurohen edhe nga zyra për informim e komunës, duke siguruar shpalljet e konkurseve. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes zyrës së personelit në DKA, si dhe nga dosjet e personelit, raportet e punës së DKA. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

## Treguesi 17.2.5 Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs plotësues

---

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në raport me procesin e punësimit të mësimdhënësve të rinj në kontekst të plotësimin të vendeve të lira në arsim, përmes konkursit plotësues gjatë vitit shkollor. Me performancën e kërkuar të punësimit në raport me vendet e lira për mësimdhënës, nënkuptohet raporti mes punësimit dhe vendeve të lira për mësimdhënës në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimit të mësimdhënies në institucionet e arsimit parauniversitar në nivel të komunës, duke vlerësuar punësimin përmes konkursit plotësues gjatë vitit shkollor.

## Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përbushjes së kërkesës për plotësimin e vendeve të lira të punës, përkatësisht punësimin e mësimdhënësve të rinj, për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit të mësimdhënies, kjo pasi që gjatë vitit shkollor shfaqen situatat kur është e nevojshme që të punësohen mësimdhënës të rinj, duke mos paragjykuar formën e punësimit, me afat të caktuar apo pa afat. Përveç punësimit të planifikuar, edhe punësimi (plotësimi i pozitave) jasht kornizave të personelit të planifikuar, gjegjësisht sigurimi i numrit të nevojshëm të mësimdhënësve është obligim i DKA-së. Përkatësisht, DKA-ja është përgjegjëse për mbledhjen dhe shqyrtimin e kërkesave për punësimin e mësimdhënësve me konkurs plotësues, dhe në këtë kontekst pregaditjen dhe zhvillimin e procedurave për rekrutimin dhe punësimin e mësimdhënësve të rinj për të siguruar mbarëvajtjen, përkatësisht tranzicionin e papenguar të procesit mësimor në institucionet e arsimit parauniversitar. Ligji për Zyrtarët Publik, 06 L-114, në nenin 15 specifikon obligimet e njësisë përgjegjëse për personel, duke stipuluar sipas nenit 65 përgjegjësinë e komunës, se autoritetet komunale kanë përgjegjësi për planifikimin e personelit; ku përgjegjësia shtrihet si nën-kategori e zyrtarëve profesional edhe të planifikimi i personelit mësimdhënës si nëpunës të shërbimit publik. Duke ju referuar nenit 67, pika 7, e Ligjit për Zyrtarët Publik, ku thuhet se “Personel profesional është personeli që kryen dhënien profesionale të shërbimit, si, p.sh personeli mësimdhënës në institucionet e sistemit arsimor, personeli mjekësor në një institucion të sistemit shëndetësor, etj”. Ligji për arsimin parauniversitar Nr. 04/L-032 e përkufizon vitin shkollor në periudhën 1 Shtator-31 Gusht, dhe proceset e punësimit gjatë periudhës së procesit mësimor, nënkuptojnë punësim përmes konkursit plotësues, kjo pasi që punësimet sipas planit zbatohen deri në fillim të vitit të ri shkollor. Institucionet arsimore identifikojnë nevojat për mësimdhënës shtesë, për punësim përmes konkursit plotësues, dhe këto i komunikohen DKA-së në formë të propozimit, gjatë periudhës së zhvillimit të aktiviteteve mësimore. Numri i mësimdhënësve të propozuar merret për shqyrtim nga ana e DKA, dhe kalon në pjesën për planifikim të personelit në rrethatat e konkursit plotësues, me ç’rast pas trajtimit të procedurave përkatëse lidhur me autorizimin e buxhetit dhe formën e punësimit bëhet identifikimi i vendeve të lira të punës për mësimdhënës të rinj. Ligji bazë për Arsimin në Komunitet e Kosovës 03 L-068, në nenin 5 pikën c, përcakton përgjegjësinë e autoriteteve komunale duke theksuar se komunitetet janë përgjegjëse për: *“punësimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të të punësuarve publik”*. Aspekti procedural i punësimit rregullohet përmes udhëzimit administrativ, UA 07/2017 i MPMS për, “Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik”.

Përgjegjësia komunale për punësimin e mësimdhënësve sipas këtij ligji, nënkupton punësimin e mësimdhënësve për nivelet e arsimit 0,1,2, dhe 3 sipas klasifikimit të ISCED. Shprehimisht, edhe në kontekst të këtij treguesi, me mësimdhënës nënkuptohen mësimdhënësit e nivelit 0,1,2 dhe 3 sipas ISCED. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numrit të mësimdhënësve të cilët janë të përfshirë në sistemin arsimor në institucionet e nivelit parauniversitar në territorin e komunës.

## Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes është raporti në mes të vendeve të lira të punës për mësimdhënës dhe të punësuarve të rinj në kontekst të konkursit plotësues, në nivelin e institucioneve të sistemit parauniversitar për nivelet sipas ISCED 0, 1, 2 dhe 3, dhe atë në periudhën prej 1 Shtatorit deri në datën përfundimit të kalendarit mësimor, 1 Korrik! Nënkatëgoria e definuar për matje, vendet e lira të punës dhe mësimdhënësit e punësuar të rinj, përbëjnë grupet e synuara për matje të cilët janë të përfshirë në nivelet ISCED 0, 1, 2, dhe 3. Për

nevojat e këtij treguesi, me vend të lirë të punës për mësimdhënës nënkuptohen vendet e lira për mësimdhënës në nivelin parauniversitar, për të cilat DKA nuk ka bërë planifikim të personelit për punësim gjatë afatit të rregullt, por zbaton konkurs plotësues gjatë kohëzgjatjes së aktiviteteve mësimore. Me mësimdhënës të punësuar të ri, nënkuptohet mësimdhënësi i cili ka formu mardhënien e punës gjatë vitit për të cilin raportohet, e cila mardhënie mundëson fillimin e punës prej 2 Shtatorit, duke mos paragjykuar statusin e kontraktimit, me afat të pacaktuar apo punësim i përkohshëm, apo edhe duke qenë në fazën provuese të punës. Zbatimi i procesit të punësimit zhvillohet dhe vlerësohet për performancë në afatin plotësues, duke pasë parasysh se procesi për nevojat e këtij treguesi me marrjen e propozimeve nga institucionet arsimore, dhe zhvillohet përmes hapave si planifikimi i personelit, shpallja e konkursit, vlerësimi i kandidatëve, dhe mbaron me përzgjedhjen dhe kontraktimin e kandidatëve të suksesshëm. Përkatësisht, me konkurs plotësues nënkuptohet periudha e zbatimit të procedurave të punësimit gjatë kohës sa zgjatë edhe procesi mësimor i rregullt! Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e numrit optimal të mësimdhënësve në raport me planifikimin e personelit mësimdhënës, duke respektuar afatet kohore sipas kalendarit arsimor për të mundësuar zhvillimin e papenguar të aktiviteteve mësimore. DKA-ja ka mandat mjaft të rregulluar për të siguruar numrin optimal të mësimdhënësve në raport me nevojat për mësimdhënës në nivel komune.

Meqenë se si aktivitetet, plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim, mund të mos zhvillohet në baza të rregullta çdo vit, përkatësisht zhvillohet si aktivitet në bazë të nevojave të paraqitura dhe aktiviteteve të planifikuara për personelin mësimor. Rrjedhimisht, mund të paraqiten situata kur mbrenda një vitit kalendarik nuk paraqitet nevoja për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim, dhe komuna nuk zhvillon procedura për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim. Me qëllim të sigurimit që komunat të cilat nuk kanë aktivitetet për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim për shkak se nuk kanë nevojë dhe nuk kanë planifikuar aktivitetet të tilla, të mos penalizohen në performancë, në këto raste komunave ju ndahet performancë e plotë (100%). Mirëpo në vitin kur kur komuna zhvillon procedura për plotësimin e vendeve të lira në arsim, apo ka planifikuar aktivitetet për plotësimin e vendeve të lira në arsim, pa marrë parasysh statusin lidhur me zhvillimin e aktivitetit, performanca duhet të raportohet sipas realizimit, në këtë rast në bazë të performancës së arritur, dhe jo të asaj për vitet kur komuna nuk ka zhvilluar aktivitetet për shkak se nuk ka pasë nevojë! Për vitin kur komuna nuk ka zhvilluar aktivitetet për plotësimin e vendeve të lira në arsim dhe nuk ka pasë planifikim të tillë, raportohet edhe ky fakt, përmes të dhënës përkatëse.

Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.2.5 mblidhen pesë të dhëna:

1. Gjithsej vende të lira të punës për mësimdhënës në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2, dhe 3 sipas planifikimit të DKA me konkurs plotësues
2. Gjithsej numri i mësimdhënësve të punësuar të rinj në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2, dhe 3 sipas planifikimit të DKA përmes konkursit plotësues
3. Gjithsej numri i planifikuar i mësimdhënësve në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2, dhe 3
4. Gjithsej numri i mësimdhënësve të punësuar në institucione arsimore të nivelit ISCED 0, 1, 2 dhe 3
5. Komuna nuk ka zhvillu aktivitet për plotësimin e vendeve të lira të punës dhe nuk ka pasë planifikim për aktivitet të tillë gjatë vitit

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet në dy forma, formula e përgjithshme paraqet herësin në mes të numrit të mësimdhënësve të punësuar të rinj përmes konkursit plotësues dhe numrit të përgjithshëm të vendeve të lira të punës për mësimdhënës me konkurs plotësues, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes. Në pjesën e parë të formulës, e dhëna 5 na jep statusin e performancës me 100% për vitet kur komuna nuk ka zhvillu aktivitet për plotësimin e vendeve të lira të punës në arsim, dhe nuk ka pasë planifikim për aktivitet të tillë për vitin që raportohet. Kurse në vitin kur komuna ka zhvillu aktivitet për plotësimin e vendeve të lira në arsim, apo edhe ka planifikuar aktivitet të tillë, e dhëna 5 merr vlerën 0%, dhe formula na jep vetëm performancën e arritur sipas pjesës së dytë të formulës.

$$\text{treguesi i përgjithshëm} = e \text{ dhëna } 5 + \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 100$$

$$\text{treguesi për tërë personelin mësimor} = e \text{ dhëna } 5 + \frac{e \text{ dhëna } 4}{e \text{ dhëna } 3} * 100$$

### Burimi kryesor i të dhënave

të këtij treguesi janë të dhënat e mbajtuara në DKA dhe të menaxhuara përmes njësisë përgjegjëse të personelit, përkatësisht përmes SIMBNj për numrin e mësimdhënësve të kërkuar përmes konkursit plotësues (vende të lira të punës) dhe të punësuar të rinj gjatë këtij afati. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes zyrës së personelit në DKA, si dhe nga dosjet e personelit, raportet e punës së DKA. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

**Treguesi 17.2.6 Respektimi i procedurave ligjore për zgjedhjen e stafit drejtues të shkollave (drejtorëve dhe zv.drejtorëve)**

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në raport me procesin e punësimit të personelit udhëheqës të shkollës, drejtorit dhe zv. drejtorit, përkatësisht zbatimin e normave ligjore gjatë emërimit të stafit drejtues.

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesave procedurale dhe menaxhimin përkatës të procesit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar, duke marrë për bazë kushtet e specifikuara në nenet 3, 5,6,7, 8 dhe 9 të UA 15/2019 MASHT Detyrat, përgjegjësite, procedurat



dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zv.drejtorit të institucionit publik edukativ-arsimor dhe aftësues parauniversitar.

Janë 10 kriteret mbi të cilat vlerësohet matja e performancës së komunës në kuptimin e zbatimit të procedurave dhe afateve kohore:

1. Shpallja e konkursit publik nga DKA në njëerën nga gazetatat në gjuhët zyrtare në Kosovë
2. Shpallja e konkursit publik nga DKA 3 muaj para skadimit të mandatit të drejtorit/zëvendës drejtorit
3. Respektimi i afatit 15 ditë të konkursit
4. Njoftimi në konkurs për dokumentet e nevojshme
5. Njoftimi për MASHT dhe Këshillin e shkollës për planin dhe datat e procesit të përzgjedhjes, së paku 10 ditë pune më herët
6. Formimi i komisionit përzgjedhës nga DKA në përbërje sipas nenit 5 të UA
7. Përgjedhja sipas rezultateve të vlerësimit përmes sistemit të rezultatit dhe pikëve, format B, C,H dhe D
8. Informimi i kandidatëve për rezultatet e konkursit në afat kohor jo më shumë se 45 ditë prej datës së mbylljes së konkursit
9. Miratimi i rezultateve të vlerësimit për zgjedhjen e drejtorit/zv.drejtorit nga ana e kryetarit të komunës mbrenda kornizës kohore 3 mujore;
10. Nënshkrimi i kontratës me drejtorin/zv.drejtorin pas vendimit, mbrenda kornizës kohore 3 mujore.

Ligji bazë për Arsimin në Komunitet të Kosovës 03 L-068, në nenin 5 pikën c, përcakton përgjegjësinë e autoriteteve komunale duke theksuar se komunat janë përgjegjëse për: *” zgjedhjen e Drejtorit dhe/ose Zëvendës Drejtorit të institucioneve edukativo- arsimore në pajtim me procedurat ligjore për rekrutimin e të dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT-i nga një komision i caktuar nga Kuvendi Komunal në të cilin duhet të jenë anëtarë të jener nga Komuna dhe një nga MASHTI-i;”*.

Përgjegjësia komunale për punësimin e drejtorëve dhe zv.drejtorëve sipas këtij ligji, nënkupton punësimin e stafit drejtues për institucione të cilat zbatojnë nivelet e arsimit 1,2, dhe 3 sipas klasifikimit të ISCED. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të institucioneve të cilat formojnë rrjetin e sistemit arsimor-edukativ në nivelin parauniversitar në territorin e komunës.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është raporti i respektimit të kriterëve gjatë procedurave të punësimit, për të gjithë të punësuarit në pozitat e drejtorit apo zv.drejtorit për të cilët është zbatuar procesi i punësimit gjatë vitit. Për secilin të punësuar në pozitat drejtuese duhet të shqyrtohet procesi i punësimit kundrejt 10 kriterëve të listuara, ashtu që për secilin kriter ndahen nga 10% të pikëve të performancës në rast të pëmbushjes. Për 2 ose më shumë raste të proceseve të punësimit të drejtorëve apo zv. drejtorëve, pikët e llogaritura ndaras sipas kriterëve formohen proporcionalisht në bazë të pëmbushjes. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave, sipas UA 15/2019, por vetëm në rastet kur drejtori dhe zv.drejtori zgjedhen përmes konkursit. Në nenin 9, pika 3 parasheh mundësinë që kontrata të ju vazhdohet deri në dy mandate në institucionin që kanë ushtruar funksionin e drejtorit/zv.drejtorit pa procedurë të konkursit, nëse drejtorët kanë performancë të mirë. Treguesi nuk matë rastet e zgjatjes së mandatit ku nuk zbatohet procedura e konkursit publik, e poashtu nuk matë rastet e përsëritjes së konkursit, meqënëse kur tejkalohe afatet apo në rast të anulimit, konkursi duhet të përsëritet ku në ndërkohe bëhet edhe emërimi i ushtruesit të

detyrës. Meqenë se si aktivitet, procesi i zgjedhjes së drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave, mund të mos zhvillohet në baza të rregullta çdo vit, përkatësisht zhvillohet si aktivitet në bazë të nevojave të paraqitura dhe aktiviteve të planifikuara për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave. Rrjedhimisht, mund të paraqiten situata kur mbrenda një vitit kalendarik nuk paraqitet nevoja për proces të zgjedhjes së drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave, dhe komuna nuk aktivitet të këtilla. Me qëllim të sigurimit që komunat të cilat nuk kanë aktivitetet për zgjedhje të drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave për shkak se nuk kanë nevojë dhe nuk kanë planifikuar aktivitetet të tilla, të mos penalizohen në performancë, në këto raste komunave ju ndahet performancë e plotë (100%). Mirëpo në vitin kur kur komuna zhvillon procedura për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave, apo ka planifikuar aktivitetet për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave, pa marrë parasysh statusin lidhur me zhvillimin e aktivitetit, performanca duhet të raportohet sipas realizimit, në këtë rast në bazë të performancës së arritur, dhe jo të asaj për vitet kur komuna nuk ka zhvillu aktivitetet për shkak se nuk ka pasë nevojë! Për vitin kur komuna nuk ka zhvillu aktivitetet për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave dhe nuk ka pasë planifikim të tillë, raportohet edhe ky fakt, përmes të dhënës përkatëse. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me vitin kalendarik të rregullt, 1 Jan – 31 Dhjetor.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.2.6 mblidhen 13 të dhëna:

5. Gjithsej pozita të hapura për drejtorë apo zv.drejtor
6. Shpallja e konkursit publik nga DKA në njërin nga gazetatat në gjuhët zyrtare në Kosovë
7. Shpallja e konkursit publik nga DKA 3 muaj para skadimit të mandatit të drejtorit/zëvendësdrejtorit
8. Respektimi i afatit 15 ditë të konkursit
9. Njoftimi në konkurs për dokumentet e nevojshme
10. Njoftimi për MASHT dhe Këshillin e shkollës për planin dhe datat e procesit të përzgjedhjes, së paku 10 ditë pune më herët
11. Formimi i komisionit përzgjedhës nga DKA në përbërje sipas nenit 5 të UA
12. Përgjedhja sipas rezultateve të vlerësimit përmes sistemit të rezultatit dhe pikëve, format B, C,H dhe D
13. Informimi i kandidatëve për rezultatet e konkursit në afat kohor jo më shumë se 45 ditë prej datës së mbylljes së konkursit
14. Miratimi i rezultateve të vlerësimit për zgjedhjen e drejtorit/zv.drejtorit nga ana e kryetarit të komunës mbrenda kornizës kohore 3 mujore;
15. Nënshkrimi i kontratës me drejtorin/zv.drejtorin pas vendimit, mbrenda kornizës kohore 3 mujore
16. Numri i institucioneve arsimore në nivelin parauniversitar me ushtrues detyre gjatë vitit

17. Komuna nuk ka zhvillu aktivitetet për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave dhe nuk ka pasë planifikim për aktivitetet të tillë gjatë vitit

Të dhënat kërkohen për secilën pozitë veçmas, duke e formuluar plotësimin e kriterit si numër dhe duke formuar shumën në nivel të kriterit. Psh. sa konkurse janë hapë në respektim të a fatit (nëse është një shpallje për tri pozita, atëher llogariten si tri konkurse për qëllim të këtij treguesi, apo tri komisione, etj). E dhëna e 12 mbledhet për nevoja të analizës nga MPL, mirëpo nuk hyn në llogaritjen e treguesit.

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet si shume e përqindjeve të llogaritura veçmas për secilin nga 10 kriteret, të cilat peshojnë me 10% në totalin të treguesit, psh. herësi mes të dhënës së dytë dhe të dhënës së parë, shumëzuar me 10%, herësi mes të dhënës së tretë dhe të dhënës së parë shumëzuar me 10%,...deri te herësi mes të dhënës së 11 dhe të dhënës së parë shumëzuar me 10%. Në pjesën e parë të formulës, e dhëna e 13 na jep statusin e performancës me 100% për vitet kur komuna nuk ka zhvillu aktivitetet për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave, dhe nuk ka pasë planifikim për aktivitetet të tillë për vitin që raportohet. Kurse në vitin kur komuna ka zhvillu aktivitetet për zgjedhjen e drejtorëve apo zv drejtorëve, apo edhe ka planifikuar aktivitetet të tillë, e dhëna e 13 merr vlerën 0%, dhe formula na jep vetëm performancën e arritur sipas pjesës së formulës në vazhdim.

$$\text{treguesi i përgjithshëm} = e \text{ dhëna e } 13 + \frac{e \text{ dhëna } 2}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 3}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 4}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 5}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 6}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 7}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 8}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 9}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 10}{e \text{ dhëna } 1} * 10\% + \frac{e \text{ dhëna } 11}{e \text{ dhëna } 1}$$

### Burimi kryesor i të dhënave

të këtij treguesi janë të dhënat e mbajtuara në DKA dhe të menaxhuara përmes njësisë përgjegjëse të personelit, përkatësisht përmes SIMBNj për numrin e punësimeve të drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave. Të dhënat specifike mund të merren në raportin e punës së komisioneve përgjegjëse, dhe materialet e punës (format e zbatuara) së komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv.drejtorëve. Poashtu, të dhënat mund të sigurohen edhe nga zyra për informim të komunës, duke siguruar shpalljet e konkurseve. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes zyrës së personelit në DKA, si dhe nga dosjet e personelit, raportet e punës së DKA. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

**Rezultati 17.3 Shkallë e lartë dhe e qëndrueshme e vijueshmërisë së nxënësve si dhe rezultate të mira në nivelet e arsimit parauniversitar**

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës për sigurimin e shkallës së lartë dhe të qëndrueshme të vijimit të nxënësve si dhe arritjes së rezultateve të larta të mësimnxënies, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përfshirë edhe edukimin e hershëm. Aktivitetet dhe masat e përcaktuara këtu lidhen me dispozitat elementare që përcaktojnë arsimin parauniversitar, aktivitetet arsimore që mbahen përmes rrjetit të institucioneve arsimore nën autoritetin e Drejtorisë Komunale të Arsimit (parashkollor, fillor dhe i mesëm i ulët dhe i lartë, duke përfshirë AAP-në). Rezultati synon matjen e komponentëve kryesorë të

shtrirë të arsimit parauniversitar publik siç parashihet në PSAK 2017-2021, të cilët paraqesin detyrime për Drejtorinë Komunale për Arsim përmes UA 23/2013, Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit. Prandaj, këto janë objektivat e planifikimit dhe zbatimit të planit vjetor të punës të drejtorisë të përcaktuara në nenin 11, si dhe për monitorimin dhe raportimin e zbatimit në nenin 13, paragrafi 1.10 raportimi mbi zbatimin. Përveç kësaj, rezultati është i informuar edhe nga shkalla e përfshirjes të fëmijëve në nivelin e edukimit të hershëm, regjistrimi në klasën e parë, shkalla e tranzicionit nga kl9 në kl10, arritjet në parandalimin e braktisjes, si dhe rrezultatet e arritura në testet e standardizuara në fund të niveleve të arsimit. Poashtu matet edhe angazhimi i autoriteteve komunale në fushën e arsimit parauniversitar, përmes matjes së barazisë gjinore në mes të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në nivel komune. Rezultati gjithashtu synon të sjellë produktet e veprimeve të komunës në trajtimin e sfidave me të cilat ballafaqohet arsimi parauniversitar në nivel komune, në kontekst të komplekseve të cilat janë trashëguar nga historia e rënduar, si dhe sfidat të cilat burojnë nga mësimdhënia dhe mësimxënia në mileniumin e ri. Ky rezultat përfshin arritjet e drejtorisë komunale të arsimit dhe arsimore institucioneve vartëse, personelit të dedikuar menaxhues dhe arsimor (profesional), në krijimin mjedisit dhe kushteve të favorshme për mësimdhënie dhe mësimxënie efektive për të gjitha kategoritë e shoqërisë në nivel të komunës. Me arritjen e këtij rezultati synohet që të ndihmohen grupet e shoqërisë të përfshira në sistemin publik arsimor, që të arrijnë nivelin e pregaditjes që të mund të integrohen në rrjedhat globale të arsimit dhe ekonomisë. Arritja e rezultatit matet me treguesit 17.3.1, 17.3.2, 17.3.3, 17.3.4, 17.3.5, 17.3.6, 17.3.7 dhe 17.3.8

## Treguesi 17.3.1

### fëmijë që vijnë kopshtin - përgjithësi dhe rural

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në përfshirjen në kopshte të fëmijëve të moshës (0-3) ISCED 01 sipas UA 19/2013 MASHT. Niveli i performancës së këtij treguesi nënkupton edhe performancën e komunës në ofrimin dhe sigurimin e kapaciteteve të kopshteve, si parakushte infrastrukturore dhe të shërbimit (personeli dhe resurset e tjera). Treguesi mat nivelin e përfshirjes në kopshte të fëmijëve të moshave të specifikuar në nivel të komunës pa dallim, si dhe të fëmijëve në zona rurale, dmth vijimi në çerdhe dhe kopshte jashtë zonës urbane të komunës.

#### Çfarë matet?

Treguesi matë përqindjen e vijimit të të gjithë fëmijëve të moshës (0-3 vjeç) sipas ISCED nivelit 01 në kopshte publike nën menaxhim të komunës, në raport me popullatën e përgjithshme të fëmijëve të moshës (0-3 vjeç) në komunë. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të fëmijëve të cilët e kanë të paraqitur (regjistruar) vendbanimin në komunë dhe numrit të fëmijëve të raportuar nga kopshtet në territor të komunës. Përveç vlerës së përgjithshme të vijimit në çerdhe-kopsht për fëmijët grupmoshës (0-3), treguesi mat edhe vijueshmërinë në kopsht të grupmoshës së njejt të fëmijëve me vendbanim në zonat rurale. Sipas ligjit për arsim parauniversitar, komunat kanë kompetenca për sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për vendosjen nëpër kopshte të fëmijëve të moshës (0-3). (neni 10, para 5, Ligji 04-L-032). Vijimi i fëmijëve në çerdhe dhe kopshte i matur në dy kontekstet, në nivel të komunës dhe në zona rurale, më tutje ndahet

edhe sipas gjinisë mirëpo nuk raportohet në vet vlerën e treguesit ( të dhënat mbledhen dhe sistemohen, por nuk paraqiten si vlerë e treguesit).

### **Sqarime të hollësishme**

Sipas ligjit për arsim parauniversitar, niveli 0 sipas ISCED përfshinë fëmijët e moshës (0-6), mirëpo ligji stipulon për nevojat e harmonizimit me sistemin arsimor në Kosovë, ndarjen mbrenda nivelit 0 të ISCED të fëmijëve sipas moshave (0-3) dhe (4-6) vjeçarë. (neni 9, para 1.1, Ligji 04-L-032). Për saktësim më të mirë të ndarjes, MASHT ka pregaditë UA 19/2013 për Përshatjen e përkufizimeve të ISCED-it. Në këtë UA, ndahet niveli 0 i ISCED në 01 dhe 02, sipas grupmoshave, ku 01 nënkupton fëmijët prej 0 deri 3 vjeç. Arsyeja e sigurimit të vendeve për vijim në çerdhe-kopsht për këta fëmijë, përveç dobive në aspektin social dhe edukativ, është edhe në interes për shkak se duke i liruar prindërit nga obligimi i përkujdesit për një kohëzgjatje të caktuar mundëson pjesëmarrje aktive në ekonomi, përkatësisht mundëson punësimin e plotë të të dy prindërve. Me fëmijë në zona rurale, nënkuptohen fëmijët e moshës prej 0 deri 3 vjeç, të cilët rezident dhe vijnë kopshtin në vendbanimet e karakterizuara si rurale, dmth fëmijët vijnë nga familjet të cilat jetojnë në vendbanime rurale dhe fëmijët janë të regjistruar pranë çerdheve -kopshteve në zona rurale. Kategoria e definuar për matje, fëmijët e moshës (0-3) sipas ISCED-it të përkufizuar nivelit 01, është e përkufizuar duke përjashtuar nga matja fëmijët e moshës 4 vjeçare e më lartë, pasi që ky grup ka për detyrim ligjor vijimin në nivelin parafillor sipas ligjit për arsim parauniversitar. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në përfshirjen e fëmijëve në kuadër të kopshteve në komunë, por jo plotësisht në kuptimin për shkak se fëmijët të cilët banojnë në zona rurale dhe vijnë kopshtin në zonë urbane llogariten në vlerën e përgjithshme të vijimit. Për vijim në zona rurale, hyjnë në llogaritje të treguesit vetëm fëmijët të cilët vijnë kopshtet të cilat janë me lokacion në zona rurale. Komunitet zakonisht, bëjnë organizimin e vendosjes nëpër kopshte publike përmes sistemimit, ku banorët e zonave përkatëse i takojnë një qendre të dedikuar si kopsht i cili ofron shërbim për një territor të përkufizuar. Respektivisht, banorët e një zone nuk kanë shumë mundësi për ndryshimin e kopshtit, në kuptimin e ndërrimit të lokacionit të kopshtit, pasi që e drejta e tyre për dërgimin e fëmijëve në kopsht është e lidhur me adresën e banimit. Vendbanimet dhe kategorizimi në urban dhe rural është i dhënë në publikimet e Agjencionit të Statistikave të Kosovës. E dhëna për përkatësinë etnike, respektivisht se sa nga fëmijët që vijnë kopshtin janë nga komunitetet jo shumicë, mbledhet për nëvoja të analizës së performancës dhe planifikim të politikave, mirëpo nuk hyn drejtpërdrejt në llogaritjen e këtij treguesi. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraparak.

### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.1. mbledhen shtatë të dhëna:

1. numri fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare në nivel të komunës

2. numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare në zona rurale në komunë
3. numri fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare në nivel të komunës vajza në zona rurale
4. numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare që vijnë kopshtin
5. numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare që vijnë kopshtin në zona rurale
6. numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçarë vajza që vijnë kopshtin
7. numri i fëmijëve të moshës 0-3 vjeçarë nga komuniteti joshumicë që vijnë kopshtin

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet në dy formula, formula e përgjithshme paraqet herësin në mes të numrit fëmijëve të moshës 0 deri 3 vjeçar të cilët vijnë në çerdhe-kopsht dhe numrit të fëmijëve të moshës 0 deri 3 vjeçare në nivel të komunës, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes! Formula për llogaritjen e vijimit të fëmijëve të cilët vijnë çerdhen-kopshtin në zona rurale, paraqet herësin në mes të numrit të fëmijëve që vijnë çerdhet-kopshtet në zonat rurale dhe numrit të përgjithshëm të fëmijëve të moshës 0-3 vjeçare në vendbanimet rurale në nivel të komunës, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes!

$$\begin{aligned}
 \text{treguesi për vijim në zona rurale} &= \frac{\text{e dhëna 5}}{\text{e dhëna 2}} * 100 \\
 \text{treguesi i përgjithshëm} &= \frac{\text{e dhëna 4}}{\text{e dhëna 1}} * 100
 \end{aligned}$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë raportet e dorëzuara nga ana e çerdheve-kopshteve në DKA për fëmijët e regjistruar. Poashtu të dhënat për fëmijët e moshës për edukim të hershëm janë në dispozicion pranë DKA, të cilat merren nga Regjistri Civil si dhe nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. DKA-të kanë nën menaxhim edhe të gjitha çerdhet-kopshtet publike në nivel të komunës, prej nga merren edhe të dhënat për kopshtet sipas lokacioneve të tyre, me qëllim të ndarjes së çerdheve-kopshteve dhe fëmijëve që vijnë për kopshtet në zona rurale. Vendbanimet dhe klasifikimi në urban dhe rural merret nga Agjencia e Statistakave të Kosovës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga dosjet që mbahen në DKA si dhe shërbimi i regjistrimit civil në nivel komune. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

#### Treguesi 17.3.2 Shkalla bruto e regjistrimit kl.1

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e nivelit të performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e përfshirjes së të gjithë fëmijëve të moshës shkollore në klasën e parë. Më saktësisht, qëllimi i matjes është pjesa e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë të shkollës fillore në raport me numrin e fëmijëve të moshës shkollore në komunë.

### Çfarë matet?

Treguesi matë raportin e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë (ISCED 1), si pika hyrëse në sistemin arsimor, përveç nivelit parafillor (ISCED 0), duke e vendosur në kontekst të numrit të përgjithshëm të

fëmijëve të moshës shkollore sipas ligjit. Ligji për Arsim Parauniversitar, 04 L-032, në nenin 9, para 2, e specifikon moshën për arsimin e detyruar si fillimi i vitit shkollor pasi që fëmija ti ketë mbushur 6 vjet.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është shkalla bruto e regjistrimit në klasën e parë. Për nevojat e këtij treguesit merret drejtpërdrejt vlera e raportuar për treguesin specifik të SHBR në klasën e parë. Treguesi ka për homolog treguesin e formuluar në publikimin, “Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë, 2017”, si bazë e treguesve për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Në Kornizën e treguesve të arsimit treguesi homolog përshkruhet si në vijim, “Regjistrimi i përgjithshëm i nxënësve në klasën e parë fillore, pavarësisht nga moshja, e shprehur si përqindje ndaj popullatës që e ka moshën zyrtare e cila korrespondon me të njëjtin nivel të arsimit.” Rezultati i shërben autoriteteve komunale për planifikim dhe zhvillimi të aktiviteteve, me qëllim të njohjes dhe strukturimit të ndërhyrjeve me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të gjithëpërfshirjes në fushën së arsimit parauniversitar në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.2. mblidhet vetëm një e dhënë:

1.SHBR\_ISCED1 (Shkalla bruto e regjistrimit niveli fillor)

### **Formula e llogaritjes**

Treguesi nuk ka llogaritje, vetëm bartet vlera nga pasqyra e raportuar

$$\text{treguesi} = \text{e dhëna 1}$$

### **Burimi i të dhënave**

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara në SMIA, si dhe nga të dhënat të cilat MASHT i ndanë me DKA, poashtu edhe nga të dhënat që DKA i mbledh nga institucionet vartëse në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga pasqyrat e raportuara të MASHT dhe DKA, respektivisht nga sistemi elektronik i integruar për menaxhim të informacioneve dhe statistikave të arsimit (SMIA). Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

**Treguesi 17.3.3**   **Shkalla e qasjes – tranzicioni k19- k10**

---

### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen e nivelit të performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e përfshirjes së të gjithë nxënësve tek kalimi prej shkollës së mesme të ulët në atë të mesme të lartë. Më saktësisht, qëllimi i matjes është shqyrtimi i kalimit apo qasjes së nxënësve në shkollën e mesme të lartë në

klasën e 10, të atyre që në vitin paraprak kanë qenë të regjistruar në klasën e fundit (9) në shkollën e mesme të ulët.

### **Çfarë matet?**

Treguesi mat raportin në mes të nxënësve të regjistruar në nivelin e shkollimit të mesëm të lartë (ISCED 3) klasën e 10 dhe numrit të nxënësve të cilët në vitin paraprak kanë qenë të regjistruar në ciklin e shkollimit të mesëm të ulët (ISCED 2) klasën e 9. Numri i nxënësve që janë regjistruar në klasën e 10, matet për vitin e ri shkollor, dhe është neto për nxënësit e rinj (pa përsëritësit). Numri i nxënësve që kanë qenë të regjistruar në klasën e 9, merret për vitin shkollor paraprak.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është shkalla e qasjes, apo tranzicionit të grupit i cili në vitin për të cilin raportohet është regjistruar në klasën e 10, kurse matja bëhet për grupin e njëjtë të nxënësve për të cilët merret statistika e vijimit në klasën e 9 të vitit paraprak. Shkalla e tranzicionit përcjell kalimin prej nivelit të arsimit të mesëm të ulët në atë të mesëm të lartë, dhe për këtë arsye përcjellët dhe matet grupi i njëjtë i nxënësve. Për nevojat e këtij treguesit merret drejtpërdrejt vlera e raportuar për treguesin specifik të shkallës së tranzicionit. Treguesi ka për homolog treguesin e formuluar në publikimin, “Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë, 2017”, si bazë e treguesve për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Në Kornizën e treguesve të arsimit treguesi homolog përshkruhet si në vijim, “Përmes këtij treguesi monitorohet shkalla e qasjes apo tranzicionit nga një nivel i arsimit në një tjetër më të lartë. Shikuar nga aspekti i nivelit më të ulët të arsimit, ky tregues konsiderohet si një tregues i rezultatit. Kurse, shikuar nga aspekti i nivelit më të lartë të arsimit, ky tregues na paraqitet si një tregues i qasjes.” Rezultati i shërben autoriteteve komunale për planifikim dhe zhvillimi të aktiviteteve, me qëllim të njohjes dhe strukturimit të ndërhyrjeve me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të gjithëpërfshirjes në fushën së arsimit parauniversitar në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.3. mblidhet vetëm një e dhënë:

1. SHT (Shkalla e transicionit nga kl9 në kl10)

### **Formula e llogaritjes**

Treguesi nuk ka llogaritje, vetëm bartet vlera nga pasqyra e raportuar

$$\text{treguesi} = e \text{ dhëna } 1$$

### **Burimi i të dhënave**



Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara në SMIA, si dhe nga të dhënat të cilat MASHT i ndanë me DKA, poashtu edhe nga të dhënat që DKA i mbledh nga institucionet vartëse në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga pasqyrat e raportuara të MASHT dhe DKA, respektivisht nga sistemi elektronik i integruar për menaxhim të informacioneve dhe statistikave të arsimit (SMIA). Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

**Treguesi**  
**17.3.4**

**Rezultatet e testit të arritshmërisë për klasën e 9**

### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen e performancës, përkatësisht arritjen në nivel të komunës të nxënësve të cilët i nënshtrohen testit të arritshmërisë në fund të klasës së 9 (përfundimi i shkollës së mesme të ulët). Udhëzimi administrativ 08/2016 MASHT, neni 14 para 4. Vlera e përgjithshme e arritur në formë të përqindjes, tregon në mënyrë të përmbledhur cilësinë e arsimit të arritur në nivelin e shkollës së mesme të ulët në nivel të komunës ISCED niveli 2. Ky tregues mat edhe arritshmërinë të ndarë sipas gjinive, përkatësisht ka për qëllim matjen e arritshmërisë edhe të raportuar veçmas për vajza.

### **Çfarë matet?**

Treguesi matë shkallën e arritjes së nxënësve në mësimnxënie në nivelin e përfundimit të klasës së 9, respektivisht të nivelit të mesëm të ulët. Tërthorazi vlerësohet Drejtoria Komonale e Arsimit, përkatësisht arritja e performancës së autoriteteve komunale për të siguruar mjedis dhe shërbime të mira për arsimimin e fëmijëve të moshës shkollore në nivelin deri në përfundim të shkollës së mesme të ulët, ISCED niveli 2. Për qëllim të sigurimit të zbatimit të agjendave për barazi gjinore, ky tregues mat rezultatin e testit të arritshmërisë të ndarë sipas gjinive (raportohet edhe veçmas për vajza).

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është rezultati i përgjithshëm nga testi i arritshmërisë në fund të klasës së 9, përkatësisht në përfundim të shkollimit të nivelit 2 sipas ISCED. Si nënkategori e matjes, nënkuptohet edhe matja e arritshmërisë e vlerësuar veçmas për vajza. Rezultati i shërben autoriteteve komunale për planifikim dhe zhvillimi të aktiviteteve, me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të fushës së arsimit parauniversitar në nivelin 2 sipas ISCED. UA 08/2016 MASHT, neni 14 para 4. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e zbatimit të politikave të arsimit parauniversitar, ku kjo performancë pasqyrohet përmes rezultateve të arritura nga nxënësit në përfundim të klasës së 9. DKA-ja ka mandat të qartë për të siguruar zbatimin e politikave dhe për të ofruar mjedis dhe resurset e nevojshme për arsim cilësor në nivelin parauniversitar në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollos të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollos në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.4. mblidhen dy të dhëna:

1. Rezultati i arritur në testin e arritshmërisë për klasat e 9
2. Rezultati i arritur nga vajzat në testin e arritshmërisë për klasat e 9

## Formula e llogaritjes

Treguesi nuk ka formulë të llogaritjes, merret vetëm vlerësimi në formë të përqindjes si mesatare e arritur, për të gjithë nxënësit si dhe e veçuar për vajza!

## Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga MASHT për DKA, dhe shkollat në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara të MASHT dhe DKA. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

**Treguesi**  
**17.3.5**

**Kalueshmëria në maturën kombëtare klasa 12**

## Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen në nivel të komunës të nxënësve të cilët i nënshtrohen testit të maturës shtetërore në fund të klasës së 12 (përfundimi i shkollës së mesme të lartë). Ligji Nr. 05/L-018 Për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, specifikon se pragu i kalueshmërisë është 40% (neni 18, para 3). Ky tregues mat edhe shkallën e kalueshmërisë së pragut, të ndarë sipas gjinive, përkatësisht ka për qëllim matjen e kalueshmërisë të raportuar veçmas edhe për vajza. Vlera mesatare e kalueshmërisë, tregon në mënyrë të përmbledhur cilësinë e arsimit të arritur në nivelin e shkollës së mesme të lartë në nivel të komunës ISCED niveli 3.

## Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përgjithshme të kalueshmërisë së pragut të kërkuar si kusht për njohjen e kalimit të provimit të maturës shtetërore. Përkatësisht, vlerësohen arritjet në mësimnxënie të nxënësve në nivelin e përfundimit të klasës së 12, respektivisht të nivelit të mesëm të lartë. Tërthorazi vlerësohet Drejtoria Komunale e Arsimit, përkatësisht arritja e performancës së autoriteteve komunale për të siguruar mjedis dhe shërbime të mira për arsimimin e fëmijëve të moshës shkollë në nivelin deri në përfundim të shkollës së mesme të lartë, ISCED niveli 3. Për qëllim të sigurimit të zbatimit të agjendave për barazi gjinore, ky tregues matë rezultatin e kalueshmërisë së testit të maturës të ndarë sipas gjinive (raportohet edhe veçmas për vajza).

## Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes është rezultati i kalueshmërisë së pragut për test të maturës kombëtare në fund të klasës 12, përkatësisht në përfundim të shkollimit të nivelit 3 sipas ISCED. Si nënkategori e matjes, nënkuptohet edhe matja e kalueshmërisë e vlerësuar veçmas për vajza. Rezultati i shërben autoriteteve komunale për planifikim dhe zhvillimi të aktiviteteve, me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të fushës së arsimit parauniversitar në nivelin 3 sipas ISCED. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e zbatimit të politikave të arsimit parauniversitar, ku kjo performancë pasqyrohet përmes rezultateve të arritura nga nxënësit në përfundim të klasës së 12. DKA-ja ka mandat të qartë për të siguruar zbatimin e

politikave dhe për të ofruar mjedis dhe resurset e nevojshme për arsim cilësor në nivelin parauniversitar në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.5. mblidhen 4 të të dhëna:

1. Numri i nxënësve të cilët kanë mbaruar klasën e 12
2. Numri i nxënësve me rezultate mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa 12
3. Numri i nxënësve vajza të cilët kanë mbaruar klasën e 12
4. Numri i nxënësve vajza me rezultate mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa 12

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet në dy formula, formula e përgjithshme paraqet herësin në mes të numrit maturanëve të cilët kanë kaluar pragun dhe numrit të nxënësve të cilët kanë mbaruar klasën e 12 në nivel të komunës, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes! Formula për llogaritjen e kalueshmërisë së testit nga vajzat, paraqet herësin në mes të numrit të maturanëve vajza që kanë kaluar pragun e arritshmërisë dhe numrit të përgjithshëm të vajzave që kanë vijuar klasën e 12 në komunë, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes!

$$\text{treguesi i përgjithshëm} = \frac{\text{e dhëna 2}}{\text{e dhëna 1}} * 100$$

$$\text{treguesi për kalueshmërinë e vajzave} = \frac{\text{e dhëna 4}}{\text{e dhëna 3}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga MASHT për DKA, dhe shkollat në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara të MASHT dhe DKA. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

Treguesi  
17.3.6

Indeksi i barazise gjinore (per te gjitha niveliet ISCED 0-3)

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e nivelit të performancës, përkatësisht arritjen në nivel të komunës të barazisë gjinore të fëmijëve dhe nxënësve në 4 nivelet e arsimit parauniversitar: parafillor, fillor, mesëm i ulët, dhe mesëm i lartë. Vlera mesatare e treguesve, tregon në mënyrë të përmbledhur ekuilibrin gjinor të fëmijëve dhe nxënësve të cilët vijnë në arsimin në nivel parauniversitar në nivel të komunës.

### **Çfarë matet?**

Indeksi i barazisë gjinore (IBGJ) mat progresin në arritjen e barazisë gjinore në arsim dhe/apo krahasueshmërinë e mundësive të ofruara për arsimimin e femrave në raport me mundësitë ekzistuese për meshkuj. Përkatësisht, vlerësohet shkalla e arritur e gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor në nivelin parauniversitar. Tërthorazi vlerësohet Drejtoria Komunale e Arsimit, përkatësisht arritja e performancës së autoriteteve komunale për të siguruar mjedis dhe shërbime të mira për arsimimin e fëmijëve të moshës shkollore në nivelin deri në përfundim të shkollës së mesme të lartë, ISCED niveli 3, pa marrë parasysh gjininë.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është raporti gjinor tek nxënësit e gjithë nivelit parauniversitar. Për nevojat e këtij treguesit mbledhen vlerat e raportuara për treguesit specifik të IBGJ-ve sipas kornizës së treguesve të MASHT. Treguesi ka për homolog treguesit e formuluar në publikimin, “Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë, 2017”, si bazë e treguesve për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Treguesi bazohet në llogaritjen e mesatares aritmetikore të treguesve të formuluar në kuadër të kornizës së lartëpërmendur, respektivisht mesatarja e vargut të treguesve me emrin Indeksi i Barazisë Gjinore (IBGJ). Vargu i treguesve përbëhet nga IBGJ-të për nivelet 0, 1, 2, dhe 3 sipas ISCED. Gjendja e matur në nivelet e specifikuar të arsimit nënkupton gjendjen e raportuar në fund të vitit shkollor të fundit, sipas të dhënave të raportuar në SMIA. Rezultati i shërben autoriteteve komunale për planifikim dhe zhvillimi të aktiviteteve, me qëllim të njohjes dhe strukturimit të ndërhyrjeve me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të gjithëpërfshirjes në kontekst të barazisë gjinore në fushën së arsimit parauniversitar në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.6. mbledhen 4 të të dhëna:

1. IBGJ\_ISCED0 (Indeksi i barazisë gjinore niveli parafillor)
2. IBGJ\_ISCED1 (Indeksi i barazisë gjinore niveli fillor)
3. IBGJ\_ISCED2 (Indeksi i barazisë gjinore niveli mesem I ulët)
4. IBGJ\_ISCED3 (Indeksi i barazisë gjinore niveli mesem I lartë)

### **Formula e llogaritjes**

Treguesi llogaritet duke marrë mesataren aritmetikore të 4 treguesve, përkatësisht duke pjestuar me 4 shumën e 4 vlerave të IBGJ sipas nivelit, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes raportin ideal!

$$\text{treguesi i përgjithshëm} = \frac{e \text{ dhëna } 1 + e \text{ dhëna } 2 + e \text{ dhëna } 3 + e \text{ dhëna } 4}{4} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara në SMIA, si dhe nga të dhënat të cilat MASHT i ndanë me DKA, poashtu edhe nga të dhënat që DKA i mbledh nga institucionet vartëse në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga pasqyrat e raportuara të MASHT dhe DKA, respektivisht nga sistemi elektronik i integruar për menaxhim të informacioneve dhe statistikave të arsimit (SMIA). Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

### Treguesi 17.3.7 Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)

---

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen e nivelit të performancës, përkatësisht arritjen e komunës në zbatimin e strategjive dhe masave përkatëse për parandalimin e braktisjes së shkollimit të obligueshëm (ISCED 1 dhe 2). Më saktësisht, qëllimi i matjes është vlerësimi i shkallës së braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve, e shprehur në shkalle të invertuar, për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (ISCED 1 dhe 2).

#### Çfarë matet?

Treguesi mat raportin në mes të nxënësve të regjistruar në nivelin e shkollimit në nivelin vijues në raport me numrin e nxënësve që kanë vijuar në vitin që përfundon. Në nivelin vijues mbledhen edhe përsëritësit, të cilët vazhdojnë shkollimin duke përsëritur nivelin paraprak (dmth. nuk e kanë braktisë shkollimin). Matja bëhet për të gjitha nivelet prej klasës së parë deri në klasën e 9 (ISCED 1 dhe 2).

#### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes është shkalla e braktisjes së shkollimit në nivelin e arsimit të obliguar, prej klasës së parë deri në mbarim të klasës së 9. Shkalla inverse e braktisjes paraqet shkallën e tranzicionit, duke i përfshirë edhe përsëritësit që vijnë në vitin në nivelin që e përsërisin. Për nevojat e këtij treguesit merret drejtpërdrejt vlera e raportuar për treguesin specifik të shkallës së braktisjes për klasët 1,2,3,4,5,6,7,8, dhe 9. Treguesi ka për homolog treguesin e formuluar në publikimin, “Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë, 2017”, si bazë e treguesve për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Në Kornizën e treguesve të arsimit treguesi homolog përshkruhet si në vijim, “Përqindja e nxënësve të një gjenerate të regjistruar në një klasë të caktuar, në një vit të caktuar shkollor, të cilët nuk registrohen më tej në vitin e ardhshëm shkollor.” Rezultati i shërben autoriteteve komunale për planifikim dhe zhvillimi të aktiviteteve, me qëllim të njohjes dhe strukturimit të ndërhyrjeve me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të gjithëpërfshirjes dhe parandalimit të braktisjes në fushën së arsimit parauniversitar në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen në

fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.7. mblidhen 12 të dhëna:

1. SHBK\_KI1
2. SHBK\_KI2
3. SHBK\_KI3
4. SHBK\_KI4
5. SHBK\_KI5
6. SHBK\_KI6
7. SHBK\_KI7
8. SHBK\_KI8
9. SHBK\_KI9
10. Numri i nxënësve nga komuniteti shumicë që e kanë braktisë shkollimin
11. Numri i nxënësve nga komuniteti joshumicë që e ka braktisë shkollimin
12. Numri i nxënësve të gjinisë femrore që e kanë braktisë shkollën

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke marrë vlerën mesatare për vargun e 9 klasëve, dhe duke e zbritur atë prej vlerës 100% me qëllim të orientimit të vlerave që tregon ky tregues, përkatësisht me rritje komunikon vlerë pozitive të fenomenit. E dhëna e 10, 11 dhe e 12 mbledhen për arsye të analizës por që nuk hyjnë në llogaritje të treguesit.

$$treguesi = 100\% - \sum \frac{e\ dhëna\ 1\ \dots\ 9}{9}$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara në SMIA, si dhe nga të dhënat të cilat MASHT i ndanë me DKA, poashtu edhe nga të dhënat që DKA i mbledh nga institucionet vartëse në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga pasqyrat e raportuara të MASHT dhe DKA, respektivisht nga sistemi elektronik i integruar për menaxhim të informacioneve dhe statistikave të arsimit (SMIA). Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

**Treguesi 17.3.8**    **Shkalla e realizimit të orëve të planifikuara sipas kalendarit vjetor të arsimit**

---

## **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës për të siguruar implementimin e orëve të planifikuara të mësimi sipas kalendarit vjetor të arsimit. Institucionet e arsimit parauniversitar, planifikojnë orët e mësimi sipas numrit të nxënësve/paraleleve, infrastrukturës, personelit arsimor, dhe kërkesave kurrikulare. Zbatimi i planit për zhvillimin e orëve mësimore sipas kalendarit mësimor është qëllim i matjes së këtij tregues.

## **Çfarë matet?**

Treguesi matë shkallën e arritur të realizimit të kalendarit mësimor në nivel të komunës, duke mbledhë nga të gjitha institucionet vartëse informata mbi orët e planifikuara të mësimi dhe orët e realizuar mësimore. Përmes matjes së zbatimit të kalendarit shkollor, përkatësisht përmes matjes së zhvillimit të aktivitetetve mësimore sipas orëve të planifikuara, matet tërthorazi zbatimi i kurrikulës dhe zhvillimi i mësimi në pajtim me orarin e planifikuara dhe normat e parapara të mësimdhënësve sipas udhëzimit administrativ përkatës UA 10 -2018 MASHT. Përgjegjësia komunale për zbatimin e kalendarit shkollor është e rregulluar në ligjin për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës 03/L-068. Për nevojat e këtij treguesi matet zbatimi i kalendarit shkollor për nivelet e arsimit 1,2, dhe 3 sipas klasifikimit të ISCED. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të orëve mësimore të planifikuara dhe zbatuara në institucionet e nivelit parauniversitar në territorin e komunës, fillor, të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë. Orët planifikohen dhe realizohen në nivel të institucionit, kurse për tregues orët e planifikuara dhe të realizuara mësimore aggregohen në nivel të DKA-së për të gjitha institucionet e përfshira.

## **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është raporti në mes të numrit të orëve të planifikuara dhe të mbajtuara gjatë vitit, në nivelin e institucioneve të sistemit parauniversitar për nivelet sipas ISCED 1, 2 dhe 3. Nënkatëgoria e definuar për matje, orët e planifikuara sipas kalendarit shkollor nënkuptojnë orët mësimore të planifikuara në nivel të DKA-së, rrethimisht orët e planifikuara nga të gjitha institucionet vartëse. Poashtu edhe orët e realizuara mësimore, në pajtim me orët e planifikuara sipas kalendarit shkollor, në nivel të DKA-së, rrethimisht orët e realizuara mësimore nga të gjitha institucionet vartëse. Pregaditja e kalendarit shkollor për arsimin parauniversitar është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, sipas pikës 2.1 të nenit 5 të ligjit LIGJI Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar. Kurse institucionet e arsimit parauniversitar janë përgjegjëse për mbajtjen e evidencës dhe raportim në sistemin për menaxhimin elektronik të informacioneve në arsim (SMIA) sipas, UA 25/2013 MASHT Regjistrim, mbajtje dhe mbrojtje të të dhënave personale në sistemin e arsimit. Në sistemin elektronik raportohen në tërësi të dhënat lidhur me infrastrukturën, organizimin, personelin mësimor, administrativ, nxënësit, dhe procesin mësimor të planifikuara dhe realizuar (orët). Oërt e planikuara në nivel të institucionit dhe të realizuara mbahen dhe raportohen rregullisht në SMIA, kurse për nevojat e këtij treguesi orët raportohen të agreguara në nivel të DKA duke i mbledhur orët e planifikuara dhe ato të realizuara në grupe të posacme nga të gjitha institucionet vartëse të nivelit 1,2, dhe 3 sipas ISCED. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e monitorimit të zbatimit të kalendarit shkollor, i cili zërthehet në nivel të institucionit duke marrë parasysh nivelin, numrin e nxënësve, paraleleve, personelit mësimdhënës, dhe profileve (kërkesave kurrikulare. DKA-ja ka mandat mjaft të gjërë për të siguruar alokimin optimal të resurseve në raport me nevojat për zhvillimin e orëve mësimore të planifikuara sipas kalendarit në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit shkollor të rregullt, dmth pasi që për SMPK raportohen

në fund të vitit kalendarik, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar shkollor në Gusht të vitit paraprak.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 17.3.8. dy të dhëna:

1. Gjithsej numri i orëve të planikuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ISCED 1, 2, dhe 3
2. Gjithsej numri i orëve të realizuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ISCED 1, 2, dhe 3

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjestuar shumën totale të orëve të realizuara mësimore me shumën totale të orëve të planifikuara mësimore sipas kalendarit.

$$treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e mbajtuara në DKA dhe të menaxhuara përmes SMIA për orët mësimore të planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit, në nivel të secilit institucion vartës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara përmes SMIA në DKA, nga raportet e punës së DKA-së, si dhe në nivel të MASHT. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.



## FUSHA 18 - KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR

Emri i fushës është “Kujdesi parësor shëndetësor publik komunal”. Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon Kujdesin Shëndetësor Parësor si një qasje gjithë përfshirëse të shoqërisë ndaj shëndetit dhe mirëqenies e orientuar në nevojat dhe preferencat e individëve, familjeve dhe komuniteteve. Ajo trajton përcaktuesit më të gjerë të shëndetit dhe fokusohet në aspektet gjithëpërfshirëse dhe të ndërlidhura në mes të shëndetit fizik, mendor, social dhe mirëqenies. Ofrimi i kujdesit themelor shëndetësor publik është një nga të drejtat elementare të parashikuara në nenin 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafi 1, i cili ua lë rregullimin e kujdesit shëndetësor publik akteve statutores. Në Kosovë, sistemi i kujdesit shëndetësor publik është i përshtatur në një fushë të gjerë shërbimesh dhe aktiviteteve, të rregulluara dhe të organizuara në një sistem prej tre nivelesh, ku përgjegjësia për nivelin e kujdesit shëndetësor parësor është caktuar në nivelin komunal. Dyligje themelore rregullojnë mandatin e kujdesit parësor shëndetësor: Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17 Kompetencat, paragrafi j) ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor publik; dhe m) shëndetësinë publike; dhe Ligji nr. 04/L-125 për Kujdesin Shëndetësor, neni 18 Kujdesi parësor shëndetësor, paragrafi 3) Komunitetet janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre; dhe paragrafi 4) Komunitetet obligohen të zbatojnë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor. Gjithashtu, Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 08/2017 Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor, në aktiviteteve të institucioneve parësore të kujdesit shëndetësor në nenin 4, paragrafi 1, parasheh se “KPSH-ja bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta, të ndërtuara mbi parimet e konceptit të Mjekësisë Familjare, të drejtuara nga nevojat dhe kërkesat e individëve dhe komuniteteve që synojnë promovimin e ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit për të gjithë qytetarët e Kosovës.”

Aktivitetet e Kujdesit Parësor Shëndetësor specifikohen në paragrafët e nenit 8 (1.2) Shërbimet e promovimit shëndetësor, duke përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin; (1.3) Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbime të tjera parandaluese; (1.4) Shërbime esenciale kurative dhe intervenime të vogla kirurgjike; (1.5) Shërbimet të kujdesit akut dhe urgjent; (1.6) Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike; (1.7) Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinj; (1.8) Shërbimet e planifikimit familjar; (1.9) Shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal; (1.10) Shërbimet e shëndetit pral parandalues; (1.11) Shërbimet e shëndetit mendor; (1.12) Shërbimet e kujdesit shtëpiak, duke përfshirë shërbimet e kujdesit neonatal dhe atij paliativ/terminal; (1.13) Shpërndarja e barërave nga lista esenciale. Komunitetet janë të detyruara të zbatojnë politikën shëndetësore të Ministrisë në kujdesin parësor shëndetësor përmes konceptit të Mjekësisë Familjare. Kujdesi parësor shëndetësor ofrohet nëpërmjet një rrjeti të organizuar të institucioneve të kujdesit shëndetësor bazuar në konceptin e Qendrës të Mjekësisë Familjare, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Ambulancave të shpërndara të Mjekësisë Familjare. Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor publik është një sistem i shërbimit të kujdesit shëndetësor në të mirë të qytetarëve, i menaxhuar nga qeveria komunale sipas akteve rregullatore dhe nën mbikëqyrjen e ministrisë së linjës. Shërbimet e përcaktuara shëndetësore ofrohen nga (1) Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (dhe njesite perberese QMF dhe AMF) ose degët e lidhura me (2) Qendrat

e Mjekësisë Familjare, (3) Ambulanca e Mjekësisë Familjare nëpërmjet sigurimit të kujdesit bazë mjekësor dhe referimit në nivelin tretësor. Drejtoria Komunale e Kujdesit Shëndetësor është përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e sistemit të shërbimit parësor shëndetësor në territorin e komunës. Komunitat obligohen të zbatojnë politikën e nivelit qendror.

Matja e performancës së komunave në fushën e kujdesit parësor shëndetësor publik është e rëndësishme sepse shërben si një mjet për të matur punën e kryer nga autoritetet komunale karshi qëllimeve thelbësore. Rezultatet e performancës i mundësojnë MPL-së dhe organeve të tjera qeveritare përkatëse që të mbikëqyrin punën e autoriteteve komunale, në mënyrë të veçantë, që të përcjellin dhe identifikojnë përparimin dhe zhvillimin, ose stagnimin ose përkeqësimin, si dhe u ofrojnë autoriteteve përkatëse informata për hetime të mëtejshme me qëllim të përmirësimit.

Arritjet e komunës në fushën e “kujdesit parësor shëndetësor publik komunal” maten nëpërmjet tri rezultateve dhe 7 treguesve.

### **Rezultati 18.1 Shtrirje adekuate të infrastrukturës së KPS, objekte dhe hapësira të paisura me mjete bashkohore për ofrimin e shërbimeve shëndetësore**

Përfaqëson arritjen kryesore të komunës në përmbushjen e kompetencave të saj për të planifikuar dhe realizuar aktivitetet dhe për të siguruar infrastrukturë, si dhe paisjet e domosdoshme në domenin e teknikës medicinale (pajisje dhe mjete). Aktivitetet dhe masat e përcaktuara këtu lidhen me dispozitat elementare që përcaktojnë kujdesin parësor shëndetësor, shërbimet parësore shëndetësore publike dhe aktivitetet që realizohen nëpërmjet Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Qendrave të shpërndara të Mjekësisë Familjare në parandalimin, trajtimin, kujdesin dhe këshillimin. Rezultati synon matjen e shpërndarjes së komponentëve kryesorë të kujdesit shëndetësor parësor siç është paraparë në përkufizimin e Kujdesit Parësor Shëndetësor sipas UA MSH-08/2017, ku elementet e specifikuar përbëjnë fushëveprimin e Drejtorisë Komunale të Kujdesit Shëndetësor; prandaj, këto janë objektivat e planifikimit dhe zbatimit të planit vjetor të punës të drejtorisë, si dhe monitorimit dhe raportimit të zbatimit të kryetari i komunës (drejtpërdrejt), dhe kuvendit komunal (në mënyrë indirekte) nëpërmjet kryetarëve të komunave. Përveç kësaj, rezultati informohet edhe nga disponueshmëria e infrastrukturës fizike të kujdesit parësor shëndetësor siç janë objektet dhe pajisjet (përfshi edhe mjetet). Me arritjen e këtij rezultati synohet që të sigurohen parakushtet për ngritjen e sistemit për ofrimin e shërbimit shëndetësor të nivelit parësor, përkatësisht të sigurohet përmbushja e parakushteve nga aspekti i infrastrukturës së domosdoshme fizike dhe materiale. Arritja e rezultatit matet me treguesit 18.1.1 dhe 18.1.2.

**Treguesi  
18.1.1**

**m2 të hapësirave të kujdesit primar shëndetësor për 10,000 banorë**

#### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e infrastrukturës së mjaftueshme të kujdesit primar shëndetësor në raport me numrin e banorëve.

#### **Çfarë matet?**

Treguesi matë raportin e sipërfaqës së përgjithshme të infrastrukturës të nivelit të shëndetësisë primare, në raport me 10, 000 banorë. Matet sipërfaqja e përgjithshme e objekteve të kujdesit primar shëndetësor, QKMF, QMF, dhe AMF me të cilat komuna disponon. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numri të banorëve (10,000) në nivel të komunës.

### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes janë sipërfaqet e përgjithshme të hapësirave të cilat shfrytëzohen për ofrimin e shërbimeve të shëndetësisë primare, sipas ligjit për shëndetësi 04-L-124. Në komunat të cilat kanë edhe nivel sekondar të shëndetësisë, shprehimisht nuk duhet të përfshihen objektet e infrastrukturës në të cilën ofrohen shërbimet shëndetësore të nivelit sekondar, apo edhe terciar. Përkatësisht, duhet të sigurohet se objekte të matjes janë vetëm objektet në të cilat ofrohen shërbimet e nivelit primar të shëndetësisë. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në krijimin e kushteve bazike infrastrukturore në komunë, por jo në tërësi në aspektin e shpërndarjes apo formës së shfrytëzimit. Arsyeja është për shkak se treguesi nuk mat densitetin sipas numrit të banorëve apo shfrytëzuesve potencial tek situatat e objekteve të përveçme, e që si fenomen shfaqet në forma të pakontrolluara, për shkak të lëvizjeve të vazhdueshme të popullsisë në Kosovë. Densitetet e larta në disa raste çojnë detyrimisht në krijimin e kufizimeve në kuptimin e pritjeve në rradhë apo caktime të termineve për shërbim, përkundër raportit më racional të hapësirave për 10,000 banorë në nivel të komunës në përgjithësi!

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të pragut, përkatësisht është matje (kumulative) dhe raportohet gjendja në fund të vitit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 18.1.1. mblidhen dy të dhëna:

1. Gjithsej numri i banorëve në nivel të komunës
2. Gjithsej sipërfaqe të institucioneve të kujdesit të shëndetësisë primare

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjestuar totalin e sipërfaqeve të hapësirave të kujdesit të shëndetësisë primare me herësin në mes të numrit të banorëve dhe 10,000.

$$treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{\left(e\ dhëna1 * \frac{1}{10,000}\right)}$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e DKSHMS për infrastrukturën dhe numrin e banorëve në nivel të komunës, numri i banorëve mund të merret edhe nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës (regj. 2011). Saktësia e të dhënave mund të verifikohet raporti i kryetarit të komunës, në seksionin për drejtorinë e shëndetësisë, raportin sektorial të drejtorisë së shëndetësisë, si dhe nga statistikat e publikuara të ASK. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e paisjeve të plota me inventar (paisje dhe mjete) dhe shërbime laboratorike të njërive të kujdesit primar shëndetësor, sipas kërkesës së udhëzimit administrativ 08/2017 MSH, shtojca 1, pika 2 (inventari, paisjet mjekësore dhe teknike), dhe shtojca 2 (shërbimet laboratorike). Me paisje nënkuptohet tërësia e listës të inventarit dhe paisjeve mjekësore dhe teknike, e cila është e nevojshme për nivelin e njësisë (QKMF, QMF, apo AMF).

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për zhvillimin e një infrastrukture të plotë sa i përket inventarit, mjeteve, dhe llojeve të shërbimeve laboratorike të cilat janë në dispozicion në nivel të njësisë së mjekësisë familjare (QKMF, QMF, dhe AMF), sipas kërkesës së specifikuar në shtojcat 1 dhe 2 të udhëzimit administrativ 08/2017 MSH. Listimi me emërtimet konkrete të inventarit të paisjeve, mjeteve dhe shërbimeve laboratorike, është i specifikuar në shtojcën 1 dhe 2 të UA, ku theksohen në formë të pikave për secilin nivel të njësisë së mjekësisë familjare në formë të përveçme (QKMF, QMF, dhe AMF). Rastet e mospërmbushjes së plotë tek njësitë e mjekësisë familjare, në kuptim kur ato posedojnë pjesërisht inventarin apo mjetet të cilat kërkohen, si dhe mospërmbushje të plotë të shërbimeve laboratorike, merren si mospërmbushje të njësisë në përgjithësi.

### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes janë njësitë e mjekësisë familjare, prej QKMF-së, QMF-të, dhe AMF-të, duke shqyrtuar se nëse këto njësi janë të paisura me inventar, mjete dhe instrumente, si dhe nëse ofrohen shërbimet laboratorike sipas udhëzimit administrativ 08/2017 MSH-së. Më saktësisht, për çdo njësi specifike të kategorisë së mjekësisë familjare, në shtojcën 1 dhe 2 të udhëzimit administrativ përshkruhet inventari, paisjet, instrumentet, si dhe llojet e analizave laboratorike që duhet ti ofrojë, respektivisht ti kenë në posedim. **Për nevojat specifike të raportimit, njihet gabimi në shtojcën 2 të UA i cili obligon AMF-të për analiza të cilat nuk i kryejnë QKMF-të dhe QMF-të**, përkatësisht nënkuptohet lëshimi dhe provizioni për këtë pikë të matjes për raportim në SPMK. Më saktësisht, nuk njihet si mospërmbushje nëse AMF-të nuk e ofrojnë këtë shërbim specifik laboratorik! Me emërtimin “njësi e mjekësisë familjare”, në kontekst të këtij treguesi nënkuptohet objekti ose grupi i objekteve në të cilin ofrohet kujdesi shëndetësor i nivelit primar, përfshi këtu edhe objektet e destinuara për shërbim mjeksor të nivelit primar por ku aktualisht nuk funksionojnë. Më saktësisht, nënkuptohen QKMF-të, QMF-të, si dhe AMF-të. Kategoria e definuar për matje, njësitë e mjekësisë familjare, me rastin e posedimit të inventarit, paisjeve dhe mjeteve, si dhe plotësimin e ofrimit të shërbimeve laboratorike, njihet si njësi e cila përmbush kërkesën sipas shtojcës së udhëzimit administrativ. Nga llogaritja në njësitë e shëndetësisë primare largohen njësitë në nivel komune të cilat i përkasin nivelit sekondar apo edhe terciar. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e një njësie të kompletuar në aspektin e paisjeve me inventar, mjete dhe paisje-shërbime laboratorike, në shërbim të shëndetit të qytetarëve. Në këtë kontekst, komuna ka përgjegjësi si të drejtpërdrejt në kuptim të kompetencave ligjore, poashtu edhe politike, me ç'rast ka përgjegjësi për të punuar me instancat e tjera

për sigurimin e përbushjes, sic është Ministria e Shëndetësisë, si dhe Inspektorati Shëndetsor. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me gjendjen në fund të vitit.

### Kategoria

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 18.1.2. mbliidhen dy të dhëna:

1. Gjithsej numri i njësive të mjeksisë familjare
2. Gjithsej numri i njësive të mjeksisë familjare të cilat përbushin kërkesat për inventar, mjete, dhe ofrimin e shërbimeve laboratorike

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke pjestuar numrin e njësive të cilat përbushin kërkesat e shtojcës 1 dhe 2 të udhëzimit administrativ me numrin e përgjithshëm të njësive të mjeksisë familjare në nivel komune, shumëzuar me 100.

$$treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana QKMF-së në DKSHMS dhe MSH, si dhe raportimet në inspektoratin shëndetësor. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara për inventar, pajisje dhe mjete, si dhe për llojin e analizave laboratorike të cilat ofrohen. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

## Rezultati 18.2 Resurset dhe personeli i pregaditur dhe i mjaftueshem për ofrimin e shërbimeve shëndetësore

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës për zhvillimin e e kuadrit të pregaditur dhe të mjaftueshëm për sigurimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor primar në cilësinë e kërkuar dhe ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve. Poashtu, përfaqëson arritjen kryesore të komunës në përbushjen e kompetencave të saj për të planifikuar dhe realizuar aktivitetet dhe për të siguruar personel të kualifikuar dhe të mjaftueshëm në përbushje të objektivave strategjike për shëndetësinë në nivelin e kujdesit parësor. Rezultati synon të matë shpërndarjen e komponentëve kryesorë të kujdesit shëndetësor parësor siç është paraparë në përkufizimin e Kujdesit Parësor Shëndetësor sipas UA MSH-08/2017, ku të gjitha elementet paraqesin fushëveprimin e Drejtorisë Komunale të Kujdesit Shëndetësor; prandaj, këto janë objektivat e planifikimit dhe zbatimit të planit vjetor të punës të drejtorisë, si dhe monitorimit dhe raportimit të zbatimit të kryetari i komunës (drejtpërdrejt), dhe kuvendit komunal (në mënyrë indirekte) nëpërmjet kryetarëve të komunave. Përveç kësaj, rezultati informohet nga disponueshmëria e mjekëve dhe nga alokimi i resurseve në nivel të komunës, përkatësisht ndarjet nga instanca komunale prej të hyrave

vetanake për qëllim të plotësimit të buxhetit të kujdesit shëndetësor parësor. Me arritjen e këtij rezultati synohet që të sigurohen parakushtet për ngritjen e sistemit për ofrimin e shërbimit shëndetësor të nivelit parësor, përkatësisht të sigurohet përmbushja e parakushteve nga aspekti i personelit të kualifikuar dhe të mjaftueshëm në numër, si dhe mbështetja me burime materiale meqenë se ndarjet buxhetore nga nivel qendror rrallëherë i plotësojnë të gjitha nevojat që ka sistemi i KPS. Arritja e rezultatit matet me treguesit 18.2.1 dhe 18.2.2.

**Treguesi  
18.2.1**

**Niveli i pajtueshmërisë me raportin nje specialist i mjeksisë familjare dhe 2 infermire për 2000 banorë**

### **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e raportit të synuar të ekipit të mjeksisë familjare (1 specialist dhe 2 infermierë). Me raport të kërkuar ekip i mjeksisë familjare nënkuptohet mesatarja e numrit të banorëve (2000) për ekip të mjeksisë familjare (1), sipas UA 07/2017 MSH Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH).

### **Çfarë matet?**

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për formimin dhe mirëmbajtjen e një numri të arsyeshëm të personelit të shëndetësor, në raport me numrin e banorëve. Trupi i përgjithshëm i personelit kyç në KPSH, numri i ekipeve të kompletuara të mjeksisë familjare në komunë, në raport me numrin e banorëve në nivel komune (të shprehur për 2000 banorë). Përkatësisht, matet përmbushja duke bërë matjen e raportit të banorëve (2000 banorë) për numrin e ekipeve të mjeksisë familjare, dhe duke krahasuar rezultatin e arritur me nivelin e synuar 2000 banorë për një ekip të mjeksisë familjare. Në këtë aspekt, synohet matja e përputhshmërisë me nivelin e synuar të raportit, qoftë nga shkalla më e lartë apo nga shkalla më e ulët në drejtim të vlerës 1/2000. Nga llogaritja në trupin e ekipeve të mjeksisë familjare nuk llogariten ekipet e pakompletuara (1 specialist dhe 2 infermierë), edhe pse janë pjesë e institucionit dhe ofrojnë shërbime. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numrit të ekipeve të kompletuara të mjeksisë familjare në territorin e komunës.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është raporti 2000 banorë për një ekip të mjeksisë familjare, në nivelin e institucioneve të kujdesit primar shëndetësor. Nënkatëgoria e definuar për matje, banorët dhe ekipet e mjeksisë familjare, përbëjnë grupet e synuara për matje. Kategoria e personelit tjetër shëndetësor me qëllim është e përjashtuar nga kjo matje, për shkak se treguesi ka për synim matjen e një aspekti specifik i cili përbën thelbin e sigurimit të resurseve në nivel optimal sipas numrit të banorëve (baza e kërkesës për kujdes shëndetësor). Vlera referente e raportit [2000]/[1] banorë për ekip të mjeksisë familjare është marrë duke ju referuar raportit të specifikuar në UA 07/2017 MSH neni 8, paragrafi 6. Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin e raportit të synuar të numrit të ekipeve të mjeksisë familjare krahasuar me numrin e banorëve. DKSHMS-ja ka mandat mjaft të gjërë për të siguruar numrin optimal të personelit adekuat shëndetësor në raport me nevojat sipas numrit të banorëve në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me gjendjen në fund të vitit kalendarik.

## Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 18.2.1. mblidhen dy të dhëna:

1. Gjithsej numri i ekipeve të mjekësisë familjare [1 mjek specialist dhe 2 infermier].
2. Gjithsej numri i banorëve në komunë sipas regjistrimit 2011

## Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke marrë vlerën absolute të ndryshimit mes konstantës 2000 dhe herësit aktual spec. i mjekësisë familjare për kokë banori në nivel të komunës, i cili poashtu pjestohet me konstaten 2000 dhe herësi i arritur zbritet nga konstantja 1 dhe shumëzohet me 100, për të paraqitur me përqindje vlerën.

$$treguesi = \left(1 - \frac{|2000 - \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1}|}{2000}\right) * 100$$

## Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e QKMF-së në DKSHMS, si dhe në MSH, përkatësisht në inspektoratin shëndetësor të MSH-së. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara në Drejtorinë e Shëndetësisë në nivel të komunës, si dhe në Divizionin e Kujdesit Parësor Shëndetësor në nivel të MSH-së. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

### Treguesi 18.2.2 Përqindja e buxhetit për KPSH e mbështetur nga komuna prej të hyrave vetanake

---

## Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në sigurimin e plotësimin të buxhetit për shëndetësi përmes ndarjes nga të hyrat vetanake. Më saktësisht, qëllimi i matjes është pjesa e buxhetit të shëndetësi primare e cila është financuar nga të hyrat vetanake të komunës, nga totali i buxhetit të shpenzuar për shëndetësi - KPSH në nivel komune. Ligji nr. 03/I-049 Për financat e pushtetit lokal dhe UA 08-2017 MSH.

## Çfarë matet?

Treguesi matë raportin e shtesës të cilën e ndanë komuna krahasuar me madhësinë e grantit specifik për shëndetësi i cili i ndahet komunës nga qeveria. Përkatësisht matet përqindja e buxhetit të cilën e ndanë komuna nga të hyrat vetanake për qëllim të DKSHMS, respektisht për sektorin e KPSH në nivel të komunës.

## Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes është pjesa e shtuar e buxhetit për shëndetësi primare, e cila vjen nga të hyrat vetanake të komunës, duke krahasuar pjesën e ndarë nga komuna si përqindje ndaj grantit specifik për shëndetësi. Nuk paragjykohet forma e shpenzimit të buxhetit, përkatësisht qëllimi i ndarjes, nëse është për investime

kapitale, apo për mallëra dhe shërbime. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në lidhje me përkushtimin e treguar në lidhje me përmirësimin e KPSH në nivelin e shërbimeve bazike. Si tregues, mat pjesën e resurseve dhe ndarjen e tyre në aspektin e prioriteteve, përmes së cilit nuk mund të kuptohet eficientia e buxhetit të plotësuar, mirëpo nënkuptohet si parakusht për krijimin e kushteve për cilësi dhe nivel më të lartë të shërbimeve shëndetësore në nivelin KPSH në nivel komune.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 18.2.2. mblidhen dy të dhëna:

1. Gjithsej shuma e ndarë për shëndetësi nga të hyrat vetanake të komunës
2. Gjithsej shuma e grantit specifik për shëndetësi

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet si herës i shumës së ndarë për shëndetësi nga të hyrat vetanake me shumën e grantit specifik për shëndetësi, shumëzuar me 100 për paraqitje në formë të përqindjes!

$$\text{treguesi} = \frac{\text{e dhëna 1}}{\text{e dhëna 2}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e në DKSHMS dhe drejtoritë komunalë për financa, si dhe nga procesverbalet e kuvendeve komunale me rastin e miratimit të planeve buxhetore. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga raportet e kryetarit të komunës, si dhe nga raportet 3 mujore dhe vjetore për buxhet. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

## Rezultati 18.3 Shkallë e lartë dhe e qëndrueshme e ofrimit të shërbimeve shëndetësore si dhe rezultate të mira

Rezultati përfaqëson arritjen kryesore të komunës për sigurimin e shkallës së lartë dhe të qëndrueshme të ofrimit të shërbimeve dhe marrjes së shërbimeve nga ana e qytetarëve, në nivelin e KPSH. Poashtu, përfaqëson arritjen kryesore të komunës në përmbushjen e kompetencave të saj për të planifikuar dhe realizuar aktivitetet dhe për të siguruar personel të kualifikuar dhe të mjaftueshëm në përmbushje të objektivave strategjike për shëndetësinë në nivelin e kujdesit parësor. Rezultati synon të matë shpërndarjen e komponentëve kryesorë të kujdesit shëndetësor parësor siç është paraparë në përkufizimin e Kujdesit Parësor Shëndetësor sipas UA MSH-08/2017, ku të gjitha elementet paraqesin fushëveprimin e Drejtorisë Komunale të Kujdesit Shëndetësor; prandaj, këto janë objektivat e planifikimit dhe zbatimit të planit vjetor



të punës të drejtorisë, si dhe monitorimit dhe raportimit të zbatimit të kryetari i komunës (drejtpërdrejt), dhe kuvendit komunal (në mënyrë indirekte) nëpërmjet kryetarëve të komunave. Përveç kësaj, rezultati informohet nga shkalla e shërbimeve të ofruara, përkatësisht të shërbimeve të pranuar nga qytetarët, shërbime këto të ofruara përmes rrjetit të institucioneve të KPS. Me arritjen e këtij rezultati synohet që të sigurohen parakushtet për sigurimin e ofrimit të shërbimeve të KPS të cilësisë së deklaruar, përmes rrjetit të institucioneve të KPS. Në kontekst të shërbimeve poashtu vlerësohet për këtë rezultat, edhe niveli i zbatimit të masave të shëndetësisë publike, si imunizimi, si dhe ofrimi i shërbimeve specifike shëndetësore për gra dhe foshnje. Arritja e rezultatit matet me treguesit 18.3.1, 18.3.2 dhe 18.3.3.

### Treguesi 18.3.1

### Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori

#### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës për rritjen e numrit të vizitave nga ana e qytetarëve në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor. Synimi i rritjes ka për qëllim rritjen e shkallës së marrjes së shërbimit nga institucionet e KPSH, duke vlerësuar numrin e vizitave të qytetarëve pranë institucioneve të KPSH (QKMF, QMF, dhe AMF).

#### Çfarë matet?

Treguesi matë vizitat e qytetarëve pranë qendrave të mjekësisë familjare si institucione të KPS, duke krahasuar numrin e vizitave në raport me numrin e banorëve. Përkatësisht në matje numërohen të gjitha vizitat e bëra nga ana e qytetarëve pranë qendrave të KPSH-së. Në matje përfshihen vizitat në të gjitha njësitë e KPSH, duke filluar nga QKMF, QMF e poashtu edhe nëpër AMF. Përkatësisht, matja bëhet në kontekst të numrit të vizitave të qytetarëve për marrjen e shërbimit shëndetësor pranë institucioneve të KPSH në territorin e komunës.

#### Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes janë vizitat e qytetarëve pranë institucioneve të KPSH, të cilat janë të evidentuara në librat e protokoleve, me ç'rast nuk bëhet dallim në lidhje me arsyen e vizitës, duke përfshirë vizitat në mjeksinë familjare, intervenime-shërbime ambulatorë, laboratorike, apo edhe dentare. Për arsye të matjes në kontekst të madhësisë së popullatës në nivel të komunës, numri i vizitave të përgjithshme merren në forma të 1/10, dmth numri i përgjithshëm i vizitave pjestohet me 10, me qëllim të mundësimin të relativizimit të matjes në përqindje dhe krijimit të mundësisë së krahasimit të treguesit në kontekstin relevant. (dmth numri i vizitave sipas madhësisë së popullsisë). Treguesi matë mjaft saktë performancën e komunës në sigurimin qasjes dhe të cilësisë së shërbimit shëndetësor në nivelin e KPSH. Numri më i madh i vizitave korrespondon jo domosdoshmërisht vetëm me aspekte të prevalencës së sëmundjeve, por edhe me arsye të vizitave kontrolluese dhe parandaluese. Numri më i madh i vizitave poashtu korrespondon edhe me nivelin e cilësisë dhe afërsisë së shërbimit/qasjes, me ç'rast numri i vizitave rritet kur qytetarët e vlerësojnë pozitivisht shërbimin e marrë, përkatësisht të dobishëm në raport me nevojat që kanë. DKSHMS-ja ka mandat mjaft të gjërë për të siguruar shtrirjen e infrastrukturës së bashku me paisjet dhe materialet e nevojshme, e poashtu edhe sigurimin e numrit optimal të personelit adekuat shëndetësor në raport me

nevojat sipas numrit të banorëve në nivel komune. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me gjendjen në fund të vitit kalendarit.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 18.3.1. mblidhen dy të dhëna:

1. Gjithsej numri i vizitave të qytetarëve në KPSH
2. Gjithsej numri i banorëve në komunë sipas regjistrimit 2011

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke llogaritur herësin në mes të numrit të vizitave pjesë për 10, dhe numrit të banorëve, shumëzuar me 100 për të paraqitur vlerën në formë të përqindjes.

$$treguesi = \frac{\text{e dhëna 1}}{\text{e dhëna 2}} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e QKMF-së në DKSHMS, si dhe në MSH, përkatësisht në inspektoratin shëndetësor të MSH-së. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga ekstraktet e raportuara në Drejtorinë e Shëndetësisë në nivel të komunës, si dhe në Divizionin e Kujdesit Parësorë Shëndetësor në nivel të MSH-së. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

<b>Treguesi</b> <b>18.3.2</b>	<b>fëmijë të përfshirë në program të imunizimit</b>
----------------------------------	---

---

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në përfshirjen e fëmijëve në program të imunizimit. Niveli i performancës së këtij treguesi nënkupton edhe performancën e komunës në ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve të kujdesit primar shëndetësor, në fushën e aktiviteteve për parandalimin e sëmundjeve (zbatimin e programit të imunizimit).

### Çfarë matet

Treguesi matet përqindjen e përfshirjes së të gjithë fëmijëve në program të imunizimit sipas fushëveprimit të KPSH, për të gjithë fëmijët sipas planit vjetor për imunizimim (vaksinim). Komunitat, përkatësisht QKMF-të së bashku me DKSHMS-të pregadisnin plan vjetor për përfshirje të fëmijëve në program të imunizimit, në bazë të profilit demografik të komunës përkatësisht në bazë të numrit të fëmijëve në komunë. Konkretisht, treguesi mat shkallën e zbatimit të planit vjetor për imunizim të fëmijëve në nivel të komunës.

### Sqarime të hollësishme

Sipas ligjit për shëndetësi 04/L-125, neni 18 para 2, pika 3 KPSH-të janë përgjegjëse për zbatimin e masave të cilat bien nën fushëveprimin e imunizimit (vaksinimit); duke pasë parasysh se komunat kanë kompetenca në shëndetësi në kuadër të kujdesit primar shëndetësor, atëherë autoritetet komunale janë kompetente për zbatimin e detyrimit lidhur me programin e imunizimit në nivel të komunës. Treguesi matë mjaftë saktë performancën e komunës në përfshirjen e fëmijëve në kuadër të programit kombëtar të imunizimit, i cili pregaditet dhe mbikqyret nga Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit kalendarik.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 18.3.2. mblihen dy të dhëna:

1. Gjithsej fëmijë të planifikuar për program të imunizimit
2. Gjithsej fëmijë në program të cilët janë imunizuar

### Formula e llogaritjes

Formula për llogaritjen e treguesit të përfshirjes së fëmijëve në program të imunizimit, paraqet herësin në mes të numrit të fëmijëve të imunizuar dhe numrit të përgjithshëm të planifikuar për imunizim në komunë, kjo e shumëzuar me 100 për paraqitje në formën e përqindjes!

$$treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë planet vjetore të punës të pregaditur nga DKSHMS, QKMF, si dhe raportet vjetore për punën e QKMF dhe DSH. Poashtu të dhënat për fëmijët e moshës për përfshirje në program të imunizimit sipas orarit të imunizimit janë në dispozicion pranë Regjistrat Civil dhe DKA. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga dosjet që mbahen në DSH si dhe raportet për zbatimin e programit të imunizimit të cilat dërgohen pranë IKSH. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

**Treguesi**  
**18.3.3**

**Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë**

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës për të siguruar shërbimin specifik shëndetësor për gra dhe fëmijë, i cili ofrohet si shërbim specialistik pranë IKPSH-ve.

### Çfarë matet?

Treguesi matë ofrimin e shërbimit specifik shëndetësor për gra dhe fëmijë në nivel të KPSH-së, në bazë të nenit 4 para 2, pikës 7 të UA 08-2017 MSH Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së KPSH. Përkatësisht gjatë matjes shqyrtohet ofrimi i shërbimit specifik shëndetësor për gra dhe fëmijë, duke vlerësuar elementet si hapësira e dedikuar në QKMF, paisjet, si dhe personeli mjekësor (gjinekologu, neonatologu apo pediatri).

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është ofrimi i shërbimit specifik shëndetësor për gra dhe fëmijë pranë QKMF-së. Për shkak se sigurimi i këtij shërbimi specifik shëndetësor është i kufizuar edhe me parametra të tjerë, në kuptimin e obligimit ligjor, në komunat ku nuk kërkohet ligjërisht ky shërbim atëher për përmbushjen e këtij treguesi mund të shërbejë marrëveshja ndërkomunale në fushën e shëndetësisë në mes të komunës raportuese dhe një komune fqinje në të cilën ofrohet shërbimi specifik shëndetësor (për gra dhe fëmijë). Për shkak të nevojës për njohje të performacës në bazë të përmbushjes të këtij treguesi, kur kemi përmbushje të treguesit me rastin e sigurimit të plotë të shërbimit specifik shëndetësor, treguesi merr vlerën prej 100%. Kurse në rastet kur treguesi përmbushet përmes marrëveshjes ndërkomunale, treguesi merr vlerën prej 66% apo 2/3 e vlerës maksimale. Skema e pikëve është e tillë për shkak të nivelit të implikimit në sigurimin e resurseve në kontekst të sigurimit të shërbimit. Neni 4, para 2 pika 7 i UA 08-2017 i MSH parasheh ofrimin e shërbimit specifik shëndetësor për gra dhe fëmijë në kuadër të QKMF, mirëpo në kontekst të komunave të vogla, DKSHMS-ja e siguron shërbimin përmes marrëveshjeve ndërkomunale. Përkatësisht në nenin 14 para 2, kërkohet që në komunat ku ekzistojnë maternitetet të sigurohet në kuadër të QKMF-së edhe gjinekologu dhe neonatologu ose pediatri! Kategoria e definuar për matje, hapësira dhe ekipi i specialistëve sipas UA, me rastin e përmbushjes njihet si e tillë për qëllim të raportimit. Nëse ekipi dhe hapësirat nuk janë të përmbushura në tërësi, nuk njihet për qëllim të matjes në kontekst të këtij treguesi. Treguesi nuk mat nivelin e shfrytëzimit apo cilësinë e shërbimeve të dhëna, e poashtu nuk mat as furnizimin me barëra falas në kontekst të shërbimeve mjekësore në fushën specifike të shërbimeve shëndetësore. Për SMPK raportohet për vitin përkatës dhe atë me mbarimin e vitit për të cilin raportohet.

### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të pragut dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 18.3.3. mblidhet vetëm një e dhënë:

6. Ofrohet shërbimi specialistik për gra dhe fëmijë pranë QKMF

### **Formula e llogaritjes**

Treguesi nuk ka llogaritje, mirëpo pikët ndahen në bazë të përmbushjes së ofrimit të shërbimit specifik shëndetësor, si në vijim:

- < kur ofrohet shërbimi specifik shëndetësor *treguesi = 100%*
- < kur shërbimi specifik shëndetësor ofrohet përmes marrëveshjes ndërkomunale *treguesi = 66%*

- ✗ kur shërbimi specifik shëndetësor nuk ofrohet dhe nuk ka marrëveshje ndërkomunale *treguesi = 0%*

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të dhënat e raportuara nga ana e QKMF-së në DKSHMS-së dhe MSH, si dhe raportimet në inspektoratin shëndetësor, si dhe marrëveshjet ndërkomunale në rastet e tilla. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga raportet e DKSHMS-së. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

### FUSHA 19 – ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL

Emri i fushës është “Zhvillimi ekonomik lokal”. Komunat janë përgjegjëse për krijimin e një klime dhe një mjedisi të favorshëm e të bërit biznes, me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal. ZHEL do të thotë më shumë sesa thjesht rritje ekonomike, ai promovon pjesëmarrjen dhe dialogun lokal, lidh njerëzit dhe burimet e tyre për një punësim më të mirë dhe një cilësi më të lartë të jetës për burrat dhe gratë. Komunitetet, qytetet dhe qeveritë në mbarë botën gjithnjë e më shumë u drejtohen strategjive të Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL) në përgjigje të sfidave të globalizimit dhe përpjekjeve për decentralizim. Sipas Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2019-2023, komunat do të bëjnë përpjekje përmes zhvillimit ekonomik lokal që të përmirësojnë dhe rrisin cilësinë e jetesës së qytetarëve duke krijuar mundësi të reja për mirëqenie ekonomike dhe sociale. Zhvillimi ekonomik lokal mund të arrihet vetëm kur komunat tregojnë qeverisje më të mirë dhe ofrojnë shërbime të nevojshme për publikun nëpërmjet përmirësimit dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në fushën e ekonomisë. Për të arritur këto qëllime, komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale, krijimit të kushteve të përshtatshme të zhvillimit, promovimit të bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, zhvillimit të sektorit bujqësor dhe promovimit të krijimit të vendeve të reja të punës përmes investimeve të reja të brendshme dhe të jashtme. Ligji bazë që rregullon mandatin e Zhvillimit Ekonomik Lokal është Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale neni 17 Kompetencat, paragrafi a) zhvillimi ekonomik lokal. Strategjia e MPL-së për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2019-2023 përshkruan karakterin shumëdimensional të konceptit të Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe gjithashtu përcakton fushat e ndërhyrjes me qëllime specifike me qëllim të sigurimit të koordinimit të politikave komunale për zhvillimin lokal. Ligjet sektoriale dhe udhëzimet administrative rregullojnë më tej fushat specifike të ndërhyrjes së Zhvillimit Ekonomik Lokal. Komunat janë të detyruara të zbatojnë politikat e zhvillimit ekonomik të ministrive të linjës në kuadër të Zhvillimit Ekonomik Lokal nëpërmjet instrumenteve nën autoritetin e komunës, si: zgjerimi i shërbimeve të regjistrimit të biznesit dhe shërbimeve të këshillimit të biznesit; sigurimi i transparencës komunale për rregulloret dhe sistemin e lejeve; transaksionet e përshpejtuara në lidhje me të drejtat pronësore për të lehtësuar më shumë likuiditet në treg; lëshimi i lejeve të ndërtimit; caktimi dhe inkasimi i tatimit në pronë dhe investimi i të hyrave vetanake për të nxitur zhvillimin ekonomik nga investimet në përmirësimin e infrastrukturës; zbatimi i politikave për zhvillimin e fuqisë punëtore të kualifikuar nëpërmjet sistemit arsimor; zbatimi i masave të politikave sektoriale për të mbështetur sektorë të veçantë industrialë dhe kategori biznesesh, si bujqësia, turizmi, etj. Gjithashtu, komunat duhet të ndërmarrin masa aktive për të përfshirë bizneset në mundësitë për të bashkëpunuar me komunën ose në cilësinë e palëve kontraktuese, për shembull nëpërmjet

projekteve të partneritetit publik (PPP). Drejtoria Komunale për Ekonomi dhe Zhvillim është përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit të biznesit në territorin e komunës. Kjo përfshin krijimin e stimujve dhe dhe granteve për zhvillim të bujqësis dhe ekonomisë rural, si dhe mbështetje për aktivitete në fushën pylltarisë dhe vjeljen e drunjëve, si dhe aktiviteteve në fushën e zhvillimit të turizmit. Matja e performancës së komunave në fushën e zhvillimit ekonomik lokal është e rëndësishme sepse shërben si mjet matjen e punës së nga autoritetet komunale në raport me aksiomet. Rezultatet e performancës i mundësojnë MPL-së dhe organeve të tjera qeveritare përkatëse që të mbikëqyrin punën e autoriteteve komunale, në mënyrë të veçantë, që të përcjellin dhe identifikojnë përparimin dhe zhvillimin, ose stagnimin ose përkeqësimin, si dhe u ofrojnë autoriteteve përkatëse informata për hetime të mëtejshme me qëllim të përmirësimit. Matja e performancës në fushën e zhvillimit ekonomik lokal është poashtu e rëndësishme edhe për bizneset ekzistuese, si dhe për investitorët potencial, pasi që sinjalizon për kushtet dhe mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve biznesore. Arritjet e komunës përkatëse aktualisht maten nëpërmjet të vetem një fushe, dhe 4 treguesve.

**Rezultati 19.1 Aktivitete të planifikuara dhe të zbatuara për zhvillimin e aktivitetit ekonomik në nivel lokal duke mobilizuar pronat komunale, dhe përditësim i rregullt i regjistrit të tatimpaguesve, dhe shkallë e lartë e inkasimit**

Rezultati përfaqëson arritjet kryesore të komunës në përmbushjen e kompetencave të saj për të planifikuar dhe realizuar aktivitetet dhe për të ndërmarrë masa për zhvillimin ekonomik lokal. Aktivitetet dhe masat e përcaktuara këtu lidhen me grupin e gjerë të dispozitave që përcaktojnë zhvillimin ekonomik lokal, zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe aktivitetet, si dhe ato të ndërmarra përmes masave specifike nën-sektoriale si ato për bujqësi dhe zhvillim rural, në promovim të bizneseve, mbështetje financiare të drejtpërdrejtë dhe këshillim për krijimin e bizneseve të reja. Nga perspektiva e përgjithshme, rezultati arrihet përmes përmbushjes së komponentëve të zhvillimit ekonomik lokal siç janë paraparë në përkufizimin e zhvillimit ekonomik lokal sipas Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023 të MPL-së, ku elementet përfaqësojnë fushëveprimin e Drejtorisë Komunale për Ekonomi dhe Zhvillim. Rrjedhimisht, këto paraqesin objektivat e planifikimit dhe zbatimit të planit vjetor të punës të drejtorisë, si dhe monitorimit dhe raportimit të zbatimit të kryetari i komunës (drejt përdrejt) dhe në kuvendin komunal (në mënyrë indirekte) përmes raportit të kryetarëve të komunave para kuvendit komunal. Zbatimi i masave në kontekst të realizimit të planit për zhvillim ekonomik lokal, kushtëzohet nga resurset, ku të hyrat nga tatimi në pronë paraqesin shtyllën kryesore të të hyrave për pushtetin lokal, dhe rrjedhimisht përcaktojnë në masë të madhe aftësinë për realizimin e aktiviteteve në zbatim të planit në fjalë. Rezultati informohet nga shkalla e mobilizimit të resurseve publike komunale në funksion të zhvillimit të aktiviteteve biznesore, nga niveli i faturimit dhe i mbledhjes së të hyrave tatimore. Arritja e rezultatit matet me treguesit 19.1.1, 19.1.2, 19.1.3, dhe 19.1.4.

Treguesi  
19.1.1

Plani për zhvillim ekonomik lokal

## **Qëllimi**

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në përgaditjen dhe zbatimin e planit për zhvillim ekonomik lokal – Plani ZHEL.

## **Çfarë matet?**

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për miratimin (përgaditjen) dhe zbatimin e planit komunal për zhvillim ekonomik lokal. Objektiva të matjes janë dy momente, (1) miratimi i planit (të cilit i paraprijnë përgaditja dhe miratimi) dhe i cili plan duhet të jetë i vlefshëm për vitin të cilin rportohej; (2) zbatimi i planit, me ç'rast nënkuptohet realizimi i aktiviteteve të parapara si pjesë e planit vjetor i cili buron nga plani komunal për zhvillim ekonomik lokal.

## **Sqarime të hollësishme**

Objekte të matjes janë dokumentet për, planin për zhvillim ekonomik lokal të vlefshëm për vitin të cilin raportohet, zbatimin e planit vjetor sipas aktiviteteve dhe shpenzimit të buxhetit të paraparë. Koncepti i treguesit për matje ka për synim matjen në dy nivele, atë të planifikimit të planit për zhvillim ekonomik lokal, si dhe matjen e zbatimit në bazë vjetore. Koncepti merr parasysh se plani për zhvillim ekonomik lokal, është plan shumëvjeçar, në të cilin apo prej të cilit rrjedhin aktivitetet të cilat e përbëjnë planin vjetor. Plani vjetor me aktivitetet e parapara shoqërohet edhe me buxhet, ku shpenzimi i buxhetit sipas planit vjetor pasqyron tërthorazi zbatimin e pjesës vjetore të planit lokal për zhvillim ekonomik. Komunitat janë të obliguara që të përpilojnë plane për zhvillim ekonomik lokal, dhe atë në bazë të kompetencave që burojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale, si dhe nga vendimi i i qeverisë 11/58 i dt. 24-07-2018 për të adresuar objektivat zhvillimore sipas Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023. Komunitat janë të njoftuara përmes komunikatës së dt.14-08-2108 për obligimet që kanë për zhvillimin e planeve për zhvillim ekonomik lokal, apo amendamentimin e planeve ekzistuese me qëllim të sigurimit dhe koordinimit të aktiviteteve për përmbushjen e qëllimeve të specifikuara në strategjinë për ZHEL 2019-2013.

Përmbushja e pjesës së parë të treguesit, dokumenti për zhvillim ekonomik lokal në nivel të komunës, sigurohet përmes shqyrtimit të aktit të miratimit dhe përmbajtjes së dokumentit, ku kërkohet validiteti i dokumentit për vitin për të cilin raportohet (të jetë në fuqi). Përmbushja e pjesës së dytë të treguesit, zbatimi i planit vjetor (aktiviteteve të parapara në planin vjetor), sigurohet përmes shqyrtimit të shpenzimit të mjeteve buxhetore të parapara për zbatimin e aktiviteteve nga plani. Duke shqyrtuar fillimisht buxhetin e paraparë sipas planit vjetor në kontekstin e zbatimit të planit për zhvillim ekonomik lokal, dhe në vijim duke shqyrtuar raportet financiare për shpenzimin e mjeteve të dedikuara për këtë plan. Drejtoria komunale përgjegjëse për zhvillim ekonomik, ka mandat mjaft të gjërë për të siguruar aktivitetet me qëllim të planifikimit të planit strategjik, si dhe të zbatimit të masave në jetësim të planit. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit kalendarik i cili korrespondon edhe me vitin fiskal, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar.

## **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

## **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 19.1.1. mblidhen dy të dhëna:

1. Plani i miratuar në fuqi
2. Realizimi i planit vjetor

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke interpretuar informatat nga të dhënat dhe duke formuar pikët për plotësimin e secilit nga kushtet, sipas skemes 50% për një kusht apo një të dhënë.

$$\text{treguesi} = 50\% \text{ e dhëna e parë} + 50\% \text{ e dhëna e dytë}$$

Evidentimi në formularin e raportimit për tregues, zbatohet duke shënuar vlerën "1" nëse kushti është i plotësuar për të dhënë specifike, ashtu që vlera 1 paraqet 50% të pikëve.

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të si në vijim, për planin për zhvillim ekonomik lokal burim është drejtoria kompetente komunale për zhvillim ekonomik. Për zbatimin e planit vjetor, burim i të dhënave është drejtoria kompetente komunale për zhvillim ekonomik. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga procesverbalet e kuvendit komunal ku dëshmohet për miratimin e planit për zhvillim ekonomik lokal, si dhe në raportet e drejtorisë komunale për financa lidhur me shpenzimin e buxhetit lidhur me planin vjetor të aktiviteteve për zhvillim ekonomik lokal. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

---

## **Treguesi 19.1.2 Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim**

---

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në pregaditjen dhe publikimin e listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim. Qëllimi është i specifikuar si pikë konkrete në Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023.

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për miratimin (pregaditjen) dhe listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim me qëllim të zhvillimit të aktivitetit ekonomik. Objektiva të matjes janë dy momente, (1) lista me prona të planifikuara për dhënie në shfrytëzim e pregaditur (të cilit i paraprijnë pregaditja dhe miratimi i listës) dhe e cila listë duhet të jetë e aktuale për vitin të cilin raportohet; (2) publikimi i listës, me ç'rast nënkuptohet akti i komunikimit të listës në media zyrtare, si publikimi në webfaqen e komunes dhe media të tjera..

### Sqarime të hollësishme

Objekte të matjes janë dokumentet për, një sërë masash paraprake si inventarizimi, vlerësimi, dhe pregaditja e listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për aktivitet ekonomik, e cila listë është aktuale dhe e vlefshme për vitin të cilin raportohet; aktin e publikimit të listës së pronave komunale të parapara për dhënie në shfrytëzim, me fokus në aktin e publikimit në uebfaqen zyrtare të komunës, përkatësisht akti i njoftimit për publikim dhe lista e publikuar. Koncepti merr parasysh se



pregaditja e listës së miratuar me pronat komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim (edhe përmes koncesionit), paraqet një tërësi të aktiviteteve të strukturuar si identifikimi inventarizimi, vlerësimi, dhe vet akti i miratimit. Pas miratimit vjen akti i shpalljes publike të listës, i cili kërkohet që të përmbajë komunikimin zyrtar për shpalljen e listës si dhe vendosjen e listës për qasje publike në uebfaqen zyrtare të komunës. Komunitat janë të obliguara që të pregadisnin dhe të publikojnë lista me pronat komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim (edhe me koncesion), në kontekst të masave për zhvillim ekonomik lokal, dhe atë në bazë të kompetencave që burojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale, si dhe nga vendimi i i qeverisë 11/58 i dt. 24-07-2018 për të adresuar objektivat zhvillimore sipas Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023. Komunitat janë të njoftuara përmes komunikatës së dt.14-08-2108 për obligimet që kanë për zhvillimin e planeve për zhvillim ekonomik lokal, apo amandamentimin e planeve ekzistuese me qëllim të sigurimit dhe koordinimit të aktivitete për përmbushjen e qëllimeve të specifikuara në strategjinë për ZHEL 2019-2013. Më saktësisht, në pikën 3.2 të Strategjisë për ZHEL 2019-2023 thuhet se duhet të arrihet, *Rritja e transparencës komunale në funksion të krijimit të kushteve për investime të huaja*. Më tutje nën këtë objektivi, elaborohet mbi arsyeshmërinë e pregaditjes së listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për qëllim të zhvillimit të aktivitetit ekonomik. Përmbushja e pjesës së parë të treguesit, lista e azhornuar dhe e miratuar me pronat e planifikuara për dhënie në shfrytëzim, sigurohet përmes shqyrtimit të aktit të miratimit dhe përmbajtjes së dokumentit, ku kërkohet validiteti i dokumentit për vitin për të cilin raportohet (të jetë në fuqi). Përmbushja e pjesës së dytë të treguesit, akti i publikimit, njoftimi mbi publikimin dhe vendosja e dokumentit (listës me prona) në uebfaqen zyrtare të komunës. Duke shqyrtuar fillimisht dokumentacionin për njoftime në zyrën përgjegjëse komunale për komunikim publik, si dhe uebfaqen zyrtare të komunës në të cilën ekziston dokumenti dhe qasja për marrjen e dokumentit nga uebfaqja. Drejtoria komunale përgjegjëse për zhvillim ekonomik, ka mandat mjaft të gjërë për të siguruar aktivitet me qëllim të pregaditjes së listës me prona komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim, si dhe të publikimit të listës respektive. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit kalendarik i cili korrespondon edhe me vitin fiskal, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar.

### **Kategoria**

Ky tregues i përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 19.1.2. mblidhen dy të dhëna:

1. Lista e përgatitur dhe e përditësuar me prona të planifikuara për dhënie në shfrytëzim
2. Publikimi i listës së përditësuar të pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim

## Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet duke interpretuar informatat nga të dhënat dhe duke formuar pikët për plotësimin e secilit nga kushtet, sipas skemes 50% për një kusht apo një të dhënë.

$$\text{treguesi} = 50\% \text{ e dhëna e parë} + 50\% \text{ e dhëna e dytë}$$

## Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë të si në vijim, për dokumentin e listës së azhurnuar dhe të miratuar është drejtoria kompetente komunale për zhvillim ekonomik. Për aktin e publikimit, burim i të dhënave është zyrja për komunikim me publikun apo entiteti përgjegjës për menaxhimin e përmbajtjes së faqes së internetit të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga procesverbalet e drejtorisë komunale ku dëshmohet për miratimin e listës, si dhe në raportet e punës së zyrër përgjegjëse për komunikim me publikun. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

**Treguesi**  
**19.1.3**

**Niveli i azhurnimit të regjistrit të tatimit në pronë**

## Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në mbajtjen e azhurnuar të regjistrit të tatimit në pronë sipas targetit 20% të listës së pronave të kategorizuara si objekte. Qëllimi është i specifikuar si pikë konkrete në 06-L005 për tatimin në pronën e paluajtshme.

## Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së kërkesës për azhornimin e regjistrit të pronave dhe tatimpaguesve për qëllim të tatimit në pronë. Në thelb, matet zbatimi i dispozitës ligjore sipas 06-L005 për tatimin në pronën e paluajtshme, sipas nenit 15 para 2, ku kërkohet nga komuna që të kryej inspektimin në terren e së paku 20% të pronave të paluajtshme “objekteve”, (duke mundur këtu përjashtimin e parcelave apo tokave të pandërtuara).

## Sqarime të hollësishme

Objekt i matjes është niveli i azhurnimit, duke marrë për bazë numrin e përgjithshëm të pronave (të cilësuar si objekte) në regjistër të tatimit në pronë kundrejt së cilës vlerësohet zbatimi i dispozitës për verifikimin në terren të së paku 20% të pronave të cilat cilat figurojnë si objekte. Koncepti i treguesit është i ndërtuar me qëllim të vlerësimit të nivelit arritur në inspektimin e pronave e që në thelb përbën aktivitetin kyç për azhornimin e regjistrit tatimor, ashtu që arritja në nivelin e inspektimit të krahasohet kundrejt nivelit të përcaktuar prej 20% të pronave të cilësuar si objekte. Inspektimi me qëllim të verifikimit i së paku 20% të pronave (kategori e objekteve) nga regjistri i tatimit në pronë dhe tatimpaguesve bëhet për qëllim të rivlerësimit, dhe përmes këtij aktiviteti sigurohet cilësia e regjistrit përkatës, përkatësisht niveli i lartë i azhurnimit ka për synim që në një cikël prej 5 vitesh të sigurohet përfshirja e gjitha pronave dhe tatimpaguesve në proces të rivlerësimit. Prej obligimit për inspektim prej 20% për arsye të verifikimit të gjendjes dhe azhurnimit në regjistër të pronave, përjashtohen pronat e kategorisë së tokave të pandërtuara apo parcelave, duke kufizuar obligimin për inspektim dhe azhornim të pronave të kategorizuara si objekte (ndërtime). Drejtoria komunale përgjegjëse për zbatimin e tatimit në pronë, ka mandat mjaft të gjërë për

të siguruar organizimin e aktivitetit me qëllim të përgatitjes së listës së objekteve për inspektim si dhe azhornimin e listës së pronave për tatim në pronë si dhe të tatimpaguesve. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit kalendarik i cili korrespondon edhe me vitin fiskal, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar.

### Kategoria

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### Të dhënat

Për informimin e plotë të treguesit 19.1.3. mbledhen dy të dhëna:

1. Numri i pronave (objekte) në komunë
2. Numri i pronave (objekteve) të inspektuara - verifikuara

### Formula e llogaritjes

Treguesi llogaritet si herës i herësit në mes të numrit të objekteve të inspektuara (verifikuara) me numrin e pronave të kategorisë objekte, dhe koeficientit 0.2, në fund kjo shumëzuar me 100 për paraqitje në formë të përqindjes!

$$treguesi = \frac{\frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1}}{0.2} * 100$$

### Burimi i të dhënave

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi janë dokumentet të cilat dëshmojnë për aktivitetin e inspektimit, si procesverbal apo raport pune të drejtorisë komunale e cila është përgjegjëse për tatimin në pronë. Lista e pronave të kategorisë objekte nga drejtoria përkatëse komunale, për menaxhimin e tatimit të pronë. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga procesverbalet e drejtorisë komunale ku dëshmohet për raportin e punës dhe numrin e inspektimeve dhe numrin e përgjithshëm të pronave (kategori e objekteve). Poashtu të dhënat mund të verifikohen edhe në raportet të cilat komuna ja përcjell Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Tatimit të Pronë. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

**Treguesi**  
**19.1.4**

**Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)**

### Qëllimi

Treguesi ka për qëllim matjen shkallën e performancës, përkatësisht arritjen e komunës në mbledhjen e tatimit në pronë mbrenda afateve ligjore, përkatësisht pa ndëshkime dhe interes, si dhe duke zbritur të hyrat në emër të borxhit tatimor të viteve paraprake (pa borxhe)!

### Çfarë matet?

Treguesi matë shkallën e përmbushjes së obligimit për pagesën e tatimit në pronë në nivel të komunës. Përkatësisht, nivelin e pagesave të mbledhura nga qytetarët tatimpagues në raport me faturimin në nivel vjetor. Në thelb, matet zbatimi i dispozitës ligjore sipas 06-L005 për tatimin në pronën e paluajtshme, gjegjësisht zbatimi i nenit 12, paragrafeve 2.6 dhe 2.7 ku kërkohet nga komuna lëshoj fatura tatimore për tatimin në pronë, dhe të mbledh tatimin në pronë.

### **Sqarime të hollësishme**

Objekt i matjes është shkalla e inkasimit të faturimit vjetor të tatimit në pronë, duke mos përfshirë inkasimet e borxheve nga faturimet e viteve paraprake, apo inkasimet në emër të interesit apo ndëshkimeve lidhur me mospagesën e tatimit në pronë. Drejtoria komunale përgjegjëse për zbatimin e tatimit në pronë, ka mandat mjaft të gjërë për të zbatuar aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së inkasimit të tatimit në pronë, dhe kjo në aspektin e rritjes së përmbushjes vullnetare, pasi që vetëm pagesat e tatimit të pronë të bëra në brenda afatit ligjor hyjnë në llogaritjen e treguesit. Periudha për të cilën kërkohen të dhënat ka të bëjë me fundin e vitit kalendarik i cili korrespondon edhe me vitin fiskal, për treguesin merren të dhënat për vitin e përfunduar.

### **Kategoria**

Ky treguesi përket kategorisë së treguesve të prodhimit dhe përmbushet sipas kërkesave të planit brenda vitit kalendarik përkatës. Për këtë tregues raportohet vetëm për vitin përkatës kalendarik dhe vitin përkatës të raportimit.

### **Të dhënat**

Për informimin e plotë të treguesit 19.1.4. mblidhen dy të dhëna:

1. Vlera e faturës vjetore
2. Pagesat e faturës vjetore (pa borxhe dhe penalti)

### **Formula e llogaritjes**

Treguesi llogaritet si herës në mes të pagesës vjetore të faturave me vlerën e faturës vjetore, dhe kjo shumëzuar me 100 për paraqitje në formë të përqindjes!

$$treguesi = \frac{e\ dhëna\ 2}{e\ dhëna\ 1} * 100$$

### **Burimi i të dhënave**

Burimi kryesor i të dhënave të këtij treguesi është Drejtoria Komunale e cila është përgjegjëse për tatimin në pronë, nga e cila si burim për të dhënat shërbejnë dokumentet të cilat dëshmojnë për aktivitetin e drejtorisë. Më saktësisht, dëshmia konkrete për faturim merren në njësinë e faturimit të tatimit të pronë. Poashtu për inkasim, të dhënat merren nga njësia e cila merret me përcjelljen e nivelit të inkasimit, në kuadër të tatimit të pronë në nivel të komunës. Saktësia e të dhënave mund të verifikohet nga raportet financiare 3 mujore të drejtorisë për buxhet dhe financa. Poashtu të dhënat mund të verifikohen edhe në raportet të cilat komuna ja përcjell Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Tatimit të Pronë. Përpunimi dhe pasqyrimi i të dhënave bëhet në përputhje me formatin e kërkuar dhe të miratuar të raportimit të të dhënave në raportin e performancës së komunave.

Annex 7 - Udhëzime të punës për të gjithë treguesit

Përkrahur nga: Projekti për decentralizim dhe përkrahja komunave (DEMOS)



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sweden  
Sverige



Norwegian Embassy  
Prishtina



**HELVETAS**  
KOSOVO